




KONFERENCË SHKENCORE KOMBËTARE

“Asdreni në 150-vjetorin e lindjes”



Konferencë shkencore kombëtare me temë: “Asdreni në 150-vjetorin e lindjes”

**KONFERENCË SHKENCORE KOMBËTARE ME TEMË:
“ASDRENI NË 150-VJETORIN E LINDJES”**

Mbajtur në Universitetin “Fan S. Noli” të Korçës më 26 janar 2023.

KOMITETI SHKENCOR I KONFERENCËS

Prof. dr. Dhimitri Bello, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë
Prof. as. dr. Jonela Spaho, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë
Prof. dr. Ali Jashari, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë
Prof. dr. Shaban Sinani, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë
Prof. dr. Artur Lamaj, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, ASA, Tiranë
Prof. dr. Valter Memisha, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, ASA, Tiranë

Përgatitja për botim:

Olger Brame, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë
Eftiona Bylykbashi, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë

**Publikuar nga Universiteti “Fan S. Noli” Korçë,
Shëtitörja “Rilindasit” Korçë, Shqipëri**

Redaktor gjuhësor: Msc. Eftiona Bylykbashi

ISBN: 978-9928-4808-1-1 (e-book)

KORÇË, 2024

TABELA E PËRMBAJTJES

VËSHTRIM SINTAKSOR NË POETIKËN E ASDRENIT	
Tefë TOPALLI	5
SHQIPËRIA MES VARGJEVE TË ASDRENIT	
Adelina XHAFFERI	44
MUZIKALITETI I POEZIVE TË ASDRENIT	
Pandi BELLO	54
ASDRENI – PROFETI I ATDHEDASHURISË NË VARGJE	
Daniela STOICA	
Arjan KALLÇO	63
MODERNITETI NË POEZINË SHQIPE PËRMES VËLLIMIT “PSALLME MURGU” TË ASDRENIT	
Jonela SPAHO	75
QASJE NDAJ VEPRËS SË ASDRENIT NË TEKSTET E ARSIMIT 9-VJEÇAR	
Rriollza AGOLLI	
Eftiona BYLYKBASHI	89
LIRIKA MEDITATIVE E ASDRENIT, VLERAT DHE RISITË NË ZHVILLIMIN E POEZISË SHQIPE	
Laureta KONOMI	
Mirela SARAÇI	95
FUNKSIONET E FJALËZËS NJË NË GJUHËN E VEPRËS SË ASDRENIT	
Hysnie HAXHILLARI	106
“PSALLME MURGU” – MËRZIA SI PARADOKS	
Mirela SHELLA	117

Konferencë shkencore kombëtare me temë: “Asdreni në 150-vjetorin e lindjes”
NGA PËRSHTATJA DREJT NJË POLIFONIE INTERTEKSTUALITETI

(Jehona intertekstuale në krijimtarinë e Asdrenit dhe poetëve që u ndikuan prej tij)

Esmeralda HIDRI

Valbona KALO 128

ASDRENI, PERSONALITET I NJOHUR I RILINDJES KOMBËTARE
SHQIPTARE

Ermelinda KASHAH..... 138

REXHEP QOSJA PËR ADRENIN

Edlira GUGU..... 144

SIMBOLIZMI STRATEGJIK NË POEZINË E ASDRENIT

Elvira LUMI..... 163

Lediona LUMI..... 163

ASDRENI, HIMNI KOMBËTAR DHE KISHA SHQIPE E BUKURESHTIT
NË SHËNIMET E LASGUSHIT

Ilir SHYTA..... 171

VËSHTRIM SINTAKSOR NË POETIKËN E ASDRENIT

Tefë TOPALLI

(Profesor Emeritus)

Abstrakt

Asdreni, që zë një vend nderi në letërsinë e Rilindjes sonë Kombëtare, duke u shtrirë edhe gjatë periudhës së Pavarësisë, është ndër poetët më të kompletuar që ka tërhequr vëmendjen e studiuesve të traditës dhe që radhitet me të drejtë përkrah Mjedës, Nolit, Zef Skiroit dhe Migjenit. Ai jetoi e shkroi në mërgim, Bukuresht të Rumanisë, dhe ishte pjesëmarrës e veprimtar aktiv i lëvizjeve për liri e pavarësi, përparim shoqëror dhe lulëzim të Shqipërisë. Pa u zgjeruar në jetëshkrimin e tij, themi se vjershëtari drenovar pati një fëmijëri të hidhur, rini të vështirë dhe pjekuri të palumtur, derisa u nda së gjallësh, në mjerim, më 1947.

Në këtë shkrim, autori ka bërë objekt të punës së tij gjuhën poetike të Asdrenit, përndryshe, vështrimin e sintaksës së vargjeve, në rrafshin stilistikor të disa vjershave që autori ynë i Rilindjes Kombëtare dhe i Pavarësisë, i ka hartuar në variantin e shkruar të Veriut, përfshirë edhe një paraqitje të vjershërisë së poetit për larminë e strukturave strofike, nga distikët, tercinat, strofat me katër dhe gjashtë e tetë vargje, ndërtimet kolonë, strofat safike, tingëllimat, si dhe rimemat e skemat e tyre brenda kësaj njësie poetike. Mendojmë se ky vështrim brenda nivelit sintaksor dhe stilistik, sillet për herë të parë në këtë masë, ka mjaft risi hulumtimi nga këndvështrimi i poetizimit të leksikut, sintagmave dhe ndërtimit të frazës me përbërësit e saj funksionalë, aq më tepër që autori i këtij kumti ka veçuar edhe vjershat e gjata, duke i quajtur poemtha, pasi kalojnë mbi njëqind e më tepër, deri 400 vargje. Për Asdrenin, na duket me vend ajo që, autori, në pjesën e parë të punimit sjell të dhëna e fakte vlerësimi e studime që janë bërë për artin e këtij poeti drenovar, si para Luftës II Botërore, kur ai bëri emër në letërsinë tonë, ashtu edhe pas saj, duke përfshirë sidomos, botimet e herëpashershme të krijimtarisë së tij dhe lartësimit të asaj që pruri të re në vjershërinë shqipe, prej personaliteteve, si: Konica, Fishta, Karl Gurakuqi, Dh. Shuteriqi, L.Poradeci, R. Qosja në veçanti, S. Hamiti, K. Bihiku, J.Bulo, R.Elsie.

Hyrje: Çdo gjë për Asdrenin...Vlerësimi.

Në këtë hyrje të këtij shkrimi për Asdrenin, po sjellim në mënyrë kronologjike studimet që i takojnë krijimtarisë së poetit drenovar. I pari që e ka njohur dhe vlerësuar është Faik Konica, i cili ka shkruar tek revista e tij, “Albania” një kritikë, ku, ndër të tjera lexojmë: “Duke qenë

se këndonjësit e së Përkohëshmes e njohin zotin Asdreni si vjershëtuar, nuk do t'i zgjat tepër fjalët: veç dua, aq shkurt sa më mundet, të shfaq këtu disa mendime: të parën, përmi karakterin e vjershësjes në “Rreze të Diellit”: të dytën, përmi metrikë a masërie: të tretën përmi gjuhë të “Rrezeve”.

I. Që në fletë të para të librit, vjershësia e z. Asdren shfaqet e lehtë, e qetë: fjalët kullojnë jo si dropull a përrua, po si një lumë pa vala, i shtrihur në mes barërash: Ashtu në krye, dhe ashtu gjer në fund. Mund të thohet përmi vjershësie të z. Asdren, ato që thotë vetë te vjersha “Natyra” (f.12) ... Po vjershëtori i luleve e i gjelbërimit gjen një zë të gjerë e të rëndë kur këndon atdhenë e të ngjarat e mbëdha të Shqipërisë. Palla e Skënderbeut, që dolli më parë te “Albania” (e mbajnë mend, besoj, të gjithë këndonjësit tanë), mund të tregohet si pasqyra e mënyrës së z. Asdren në vjershësi trimërie. Ç’mendim i bukur, e sa bukur i derdhur, mendimi i dy vijëve të fundit:

...Se s’pret palla q’është një hekur i dheut
Po pret dor’e fuqishm’e Skënderbeut !

II. Kanunet e metrikës shqipe janë të shumta. Masa më klasike është ajo tetëkëmbëshe....

III. Tërësia e “Rrezeve” është plot me vlerë letrare, e ky libër është një nga fare të pakët që meritojnë të jenë në libërtore të çdo shqiptari a të huaji që punon gjuhën shqipe. Mënyra e shieshme me të cilën u shtyp libri, është sipër çdo lëvdate. (1904)¹

Pas tij, ka vlerë të njihemi me paraqitjen që i bën Gjergj Fishta kësaj vepre poetike të Asdrenit, botuar në revistën e njohur të urdhërit françeskan “Hylli i Dritës”, që duhet të jetë i dyti shkrim, lidhur me përmbledhjen “Ëndrra e lotë”.²

Asdren – **Endra e lotë**
Vjerrsha- Bukuresht – Shtyp.”Gutenberg”
Str. Doamnei 20. 1912.


¹ Faik Konica, Vepra I, Botimet Dudaj, Shtypshkronja “Guttenberg”, Tiranë, 2001, f. 239-242.

² Gjergj Fishta, Ëndrra e lotë, Hylli i Dritës, Shkodër, 1914/9, f. 264.



Qe një libër sikush!³ Mundet me u thanë me gjithë arsye, se me këtë libër vjershash asht shtue fort pasunia e literaturës shqipe; pse fillim e mbarim këtij libri ndihet një fllad i ambël njomësie e hijeshie fort të kandshme. Për në qoftë e vërtetë çka thotë Bajroni, se poezia përbahet prej ndiesive të nalta e të ambla, e prej shqiptimit të mbarë e të ardhshëm, padyshim libri i z.Asdren, “Endra me Lotë” përmbledh në vetvete shumë poezi të thjeshta, tue qenë që ndër të pesë pjesët, ndër të cilat asht nda libri, vegojnë mendime të naltueshme, të shprehuna me gjuhë të pastër e të hijshme. Mbas mendimit tim, ky libër tfaqë⁴ ma së miri çka ka të hijshëm në vetvete dialekti i Toskënisë. Do shqiptarë, kur shkruajnë shqip, e përziejnë gegnishten e toskënishten në një mënyrë kaq të vrazhdë, sa mos me t’u ba me e këndue. Ajo s’asht gjuhë: ajo asht si mushku, që s’asht kalë as gomar. Për me u përba⁵ gjuha letrare, nuk asht nevoja, nuk asht nevoja me krijue një gjuhë të re: lypet vetëm me e njoftë gjuhën e me i ditë rregullat e saj mirë, e masandej me i rreshtue fjalët në shkrim me mjeshtri; e, atëherë koha e dija e estetika kanë me gjykue se cili dialekt do zgjedhë për gjuhë letrare në Shqipni. Për këtë arsye libri i Asdrenit asht një shembull, që do ndjekë prej shumëkujt. Unë shpresoj se autori ka me punue prap e prap, pa u lodhë, në Parnas të Shqipnisë, e se, me botime të tjera, ka me begatë ma tepër pasuninë e literaturës shqipe, tue u mundue mbas sotit me iu vu pak gja ma tepër teknikës së vjershave e trajtës së përjashtme të poezisë.”

(Gjergj Fishta, Vepra-9, Botimet “Fishta”, Lezhë, 2004, f. 155-156) (Hylli i Dritës, 1914/9, f. 264)



³ sikush – për të qenë. (Ja një libër për të qenë!).


⁴ tfaqë – shfaqë.

⁵ për me u përba – për t’u përbërë; këtu: për t’u formuar.

Njëri nga poetët në foton më lart, Lasgush Poradeci, i ka kushtuar një *vjershë* – *portret* me dy tercina, poetit drenovar:⁶

Asdrenit
Burr’i urtë-e i veçuar,
Shqipëtar me shpirt të qruar,
Vjershëtor vjershëkënduar:

Pate shkruar e punuar
Kombin për ta kombësuar,
Shqipen për ta shqipëzuar



Studiuesi i tretë, i nivelit të lartë shkencor, që e ka pranuar Asdrenin si poet të shquar, madje edhe në një libër mësimi për shkollat e mesme, është E.Çabej, i cili e ka radhitur autorin mes shkrimtarëve shqiptarë që duhen studiuar nëpër shkollat shqiptare të kohës.⁷Në faqet e para që shënuam Çabej jep pak të dhëna jetëshkrimi, tre vëllimet e botuara: *Rreze Dielli*, *Ëndrra e Lotë* e *Psallme Murgu*. Lidhur me artin e Asdenit, shkruhet: “Asdreni është poet lirik që rron në artin e për artin e tij. Ay është poet artist në kuptimin e plotë të fjalës. Vjershat e tij janë të punuara mirë dhe të përsosura në pikëpamje formale. Ay është mjeshtër i formës.Është për t’u vërtetuar se gjithë veprat e Asdrenit kanë një njësi dhe kontinuitet organik midis tyre. Kjo njësi i përshkon të gjitha.Bashkë me këtë njësi shohim dhe zhvillimin e poetit nëpër veprat e tij: ky vjen gjithnjë duke u përsosur. Ideja e atdheut dhe ndjenja e natyrës gjejnë shprehje të gjallë te ky poet. Ky është këngëtar i jetës së katundit dhe i qyteteve të vjetra shqiptare. Gjuha shqipe...Por me rëndësi ka fakti që


⁶ Lasgush Poradeci, Ylli i zemrës, Tiranë, 1933. (Vepra letrare, Tiranë, 1990,f. 106).

⁷ Eqrem Çabej, Elemente të gjuhë[sisë e të literaturës shqipe, excupere 20, Shtypshkroja e Ministrisë s’Arsimit, Tiranë, 1936, f. 54-55, 149-162.

Asdreni formon kalimin nga brezi i kaluar në poezinë moderne shqiptare. Gjuha shqipe është duke u derdhur te ky poet në forma të ra...⁸ Në lëndën antologjike autori ka zgjedhur 7 poezi, kryesisht prej përmbledhjes “Psallme Murgu”.

Edhe poeti e përkthyesi Petraq Kolevica, ka një të dhënë mjaft interesante, e cila lidhet me Asdrenin, nga L.Poradeci, botuar së voni, si kujtime për poetin e liqenit.

“...Siç thashë, poezia duhet të jetë koncize. Ja për shembull, pozia që kam bërë për Asdrenin. Tepër e shkurtë është, po unë i kam thënë të tëra ç’duhet thënë për të: Burr i urtë e i veçuar. Kështu ishte Asdreni. Shumë njeri i mirë, i urtë dhe gjithmonë i vetmuar: Shqipëtar me shpirt të qruar. Patriot i madh ishte. Erdhi edhe vullnetar në kohën e princ Vidit për të luftuar me armë. Dhe pastaj i përmend atributet e tjera: Pate shkruar e punuar -S hqipen për ta shqipëzuar - Kombin për ta kombësuar. Po ai Maloki thotë: Pse, ky është Asdreni? Po, ky është! Kaq mund të them unë për të. Për Naimin kam thënë më tepër, se për Naimin ke ç’të thuash më tepër.”⁹



“Mbledhja e parë e vjershave të tij me titullin “Rreze dielli” u botua në Bukuresht më 1904. Zef Skiroi e pret me këto fjalë lindjen e kësaj veprë....”Nuk kemi nevojë për shumë fjalë për të lavdëruar veprën e Asdrenit, vetëm themi, me gëzim të math, se në këto vjersha, të cilat shpërndajnë me të vërtetë rreze dielli, ay ka fituar një vend me nder pranë poetëve kombëtarë më të famshëm.”

Revista “Albania”, nga ana e saj, shkruan: “...Gjuha e z. Asdren është e kulluar, elegante dhe e gjallë...” Duke u njohur me paraqitjen e poetit drenovar, në këtë tekst letërsie, mësojmë se te revista e mësipërme Faik Konica, shkruan

⁸ Po ai, po aty, f. 55.

⁹ Petraq Kolevica, Lasgushi më ka thënë...Shtypur Shtypshkronja “Tirana”,Tiranë, 1992, f. 93..

se Asdreni “është një poet i cili në vargjet e tij është përpjekur që të përhapij midis djalërisë shqiptare ndienjën kombtare.”¹⁰

Botime e studime pas Luftës II Botërore



LIBRARIA IME

ASDRENI
Aleksandër Stavre Drenova
(1872-1947)

RREZE
DIELLI

Libraria Dixhitale
www.librariaime.com

Asdreni i kushtoi shumë vëmendje dhe përpjekje formës poetike. Në krye gjuha e krijimeve të tij ishte e ngathët, shprehja e zbetë, krahasimet të zakonshme; në një varg krijimesh të para gjejmë mfigura të kërkuara, dikimi i leximeve romantike, si “rngjëllore”, “magjiplotë”, “verbim magjie” etj. Ndonëse kjo dukuri do të ndeshet edhe në disa krijime të periudhës së mëvonshme të stërholluara, në përgjithësi prireja themelore e gjuhës së Asdrenit është qartësia dhe thjeshtësia. Duke punuar me dashuri të veçantë dhe me këmbëngulje, Asdreni arriti ta përsosë më tej gjuhën e vet dhe ta çlirojë nga të gjitha pengesat, që ia kufizonin forcën shprehëse. Krijimet e periudhës së pjekurisë shquhen nga rrjedhshmëria, muzikaliteti, thjeshtësia...Disa mjete stilistike të Asdrenit lidhen me poetizimin dhe idealizimin e jetës fshatare dhe sidomos me synimin e poetit për të shprehur dashurinë e vet për natyrën dhe ndienjën e dashurisë së pastër....Në stilistikën e poetit gjejmë edhe ndonjë ndikim nga folklori. Kjo vihet re në krahasimet me të cilat jepet bukuria e vashës në poezinë “Ti me sytë e zinj” (“o moj ti me sy të zij , q’i ke buzët si qersh”) edhe në ndonjë krijim tjetër letrar.

(Koço Bihiku, *Asdreni- Vepra-1, Tiranë, 1976, f. 47-48*)

Veçori tjetër e poezisë së Asdrenit është strofika e larme. Ai përpunoi një pasuri të madhe strofash. Gjejmë tek ai katrenin, strofat gjashtëshe, tetëshe, dhjetëshe e dymbëdhjetëshe; krahas distikut, poeti përdori edhe

¹⁰ Karl Gurakuqi, Shkrimtarë shqiptarë - 2, Rilindja - Histori e Letërsisë shqipe, nën kujdesin e Ernest Koliqit, Tiranë, 1941; Botim II “Pakti”, Tiranë, 2008, f. 200-208. Zëri i Asdrenit në këtë tekst mësimor është përgatitur nga shkrimtari e përkthyesi Vedat Kokona. Fragmentet prej këtij autori janë marrë nga vëllimet “Ëndrra e lotë” dhe “Psallme murgu”, gjithsej 4 poezi.



LIBRARIA IME


ASDRENI
Aleksandër Stavre Drenova
(1872-1947)

ËNDRA E LOTË

Libraria Dikhitale
www.librariaime.com

vjershën monokolare. Ndër strofat më të preferuara të Asdrenit ishte soneti; ai shkroi rreth 30 sonete, disa prej të cilave përfaqëojnë modele në llojin e tyre në poezinë tonë...(f. 48 – 49). Shkroi kryesisht në *jamb* katërkëmbësh dhe pesëkëmbësh; në sonetet e viteve të fundit përdori më shpesh vargun njëmbëdhjetërokësh. Pas *jambit* vjen *trokeu* si forma që Asdreni e shfrytëzoi në shkallë të gjerë në krijimet e tij. Në varg *trokaik* janë shkruar poemi “Burri i dheut”, “Lulëkuqja”, “Ditë prenvere”, “Gjendja jonë”, “Vlorës” etj. ..Në disa krijime, si në “Flamur të rrosh”, “Apolloni”, “Vdekja e Byronit” etj. Zgjodhi *amfibrakun* si formë për të shprehur në mënyrë të plotë mendimet dhe ndjenjat e tij. E reja që solli Asdreni në lëmin e prosodisë është *vargu i lirë*, me të cilin ai e pasuroi poezinë shqipe...Vargu i lirë që solli Asdreni mori zhvillim të mëtejshëm në krijimtarinë e Migjenit, G.Palit etj., duke hyrë përfundimisht si arritje me vlerë në fondin e poezisë shqipe.


(Koço Bihiku, *Asdreni- Vepra-1, Tiranë, 1976, f. 47- 48 – 49*)



Përmbledhja “Psallme Murgu” që sollëm këtu, është një botim postum, me komente të stiduesit Leka Ndoja,¹¹me 81 vjersha motivesh të ndryshme dhe ndarë në 5 pjesë, sipas E.Çabej: *Flaga e vatrës, Vallja e jetës, Ngjyra ylberi, Lule dhe gjëmba*. L.Ndoja shkruan: “Asdreni “*murgu*” i artit, përmbledh në “*Psallmet*” lutjet e mërgimtarit, që i ndarë nga familja e atdheu përjeton një gjendje të dyfishtë largësie fizike e shpirtërore, një “*vjeshtë*” lirike të idealizuar, për të theksuar shrehjen e izolimit,

¹¹ Asdreni, *Psallme Murgu*, Komentuar nga Leka Ndoja, Botimet “Pakti”, Tiranë, 2009 (me 208 faqe). Lidhur me këtë vëllim, R. Qosja shkruan se *Psallme Murgu* shënon fazën e katërt të krijimtarisë së Asdrenit, që merr fund më 1945, kur na lë vjershat e mbrame. (Asdreni, jeta dhe vepra e tij, Toena, Tiranë, 2002, f. 243.)

tëhuajsimi shpirtëror në vendin e huaj....Veçoria e madhe e Asdrenit është se ai përdor një gjuhë të pasuruar me trajta të gegënishtes, duke krijuar një ekuilibër të përsosur të formës shprehëse standarte për kohën, dhe tepër të stilizuar si gjuhë letrare duke e tejkaluar dhe Lasgushin që në këtë pikë nuk e ka ndjekur mjeshttrin pararendës, duke ruajtur ngjyrat lokale të Pogradec-Korçës...”...Jo më kot Konica i vishte Asdrenit si poet, kualitetin e futjes së frymës kombëtare tek të rinjtë e kohës, e të gjitha kohëve, por ky opinion i përhapur tashmë nuk mund të vërë në dyshim Asdrenin e hymneve triumfale kundrejt lirikës universale të tij...”¹².



“Kur më 1930 u botuan “Psallmet e murgut”, rinia nisi ta njohë për herë të parë Asdrenin në mënyrë pak a shumë të plotë. Ky rizbulim i vonë i ka ngjarë më se një poeti në të kaluarën, bie fjala Çajupit. Poezia e Asdrenit, e cila ishte ndër më populloret e kohës, ishte gati vetëm “antologjike” popullore. Libri i tij i fundit, më 1930, ka qenë, nga kjo anë, një revelacion. Pa dyshim, nuk ishte e lehtë atëherë të thelloheshe në kontradiktat që përmbështillte arti i Asdrenit dhe në disa dobësi. Po nuk ishte dhe e vështirë të kuptoje se fliste një zemër e gjakosur. Ne sot e shohim mirë se si ai zien kundër padrejtësive shoqërore (le të kujtojmë vjershën mbi Luftën e Vlorës), ai që pati shpresuar shumë më shumë nga çlirimi kombëtar. Poeti lëshonte psherëtima tragjike, sepse nuk mund të duronte fatin që e kishte pllakosur Shqipërinë e 12-ës. Po, së fundi, ai kërkoi të shkëputej nga “kjo botë e pandrerqshme”, të ndrydhej në një si qeli, ku të mos depërtonte dhimbja e kohës, si një vjershërit “mjerush”, për të cilin e tashmja bëhej argëtim shpirtëror i mbyllur, - ngushëllim me vargjet vetë, - kurse e ardhmja, - e ardhmja çfarë do të sillte? Këto lloj kontradiktash kanë shumë domethënie për veprën e Asdrenit e për kohën. Pati njerëz që koha i shpuri të thyejnë penën e ta jetojnë thuajse

¹² Po ai, po aty, f. 4 – 5.

fatalisht batërdinë e Shqipërisë së tradhtuar nga bejlerët e agallarët me shokë. Mihal Gramenoja, vërsniku i Asdrenit, qe njëri ndër ta...Ne e përkujtojmë Asdrenin në çka ai i dha Shqipërisë më të bukur e me vlerë, në çka mbetet prej tij e pavdirë, dhe Asdreni la një trashëgim, që e rendit ndër poetët të cilët e ngritën lart vjershërinë shqipe.

(Dh.S.Shuteriqi, *Autorë dhe tekste, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Kombinati poligrafik “Shtypshkronja e Re”, Tiranë, 1977, f. 419-420).*



“Asdreni është nga ata shkrimtarë të paktë që jetoi dy epoka të zhvillimit historik të shoqërisë shqiptare dhe arriti të përshëndeste lindjen e “diellit të ri” për Shqipërinë, epokën që agoi me fitoren erevolucionit popullor.


Shqetësimet e mëdha të dy epokave, të Rilindjes dhe të epokës që nisi me fitoren e pavarësisë më 1912 dhe mbaroi me humbjen e saj më 7 prill, aspirata e një shoqërie të ndërtuar mbi baza të vërteta demokratike, të cilën nuk e pa të

realizuar veçse kur ishte duke numëruar ditët e fundit, përbëjnë brendinë e tërë veprës së poetit, lëvrijnë në vargjet e tij, u japin atyre forcë dhe jetë...

Asdreni e pa kryesisht vegjëlinë si viktimë të pabesisë dhe të tradhtisë së shtresave të larta, në poemën realiste “Burri i dheut” (1920) ai e dha përfaqësuesin e vegjëlisë me tipare sociale konkrete, me vetëdijën e interesave të shtresës së vet. “Burri i dheut” është nga të paktat krijime që pasqyroi veprën e vegjëlisë në Luftën e Vlorës dhe gjendjen e saj të mjeruar sociale pas fitores...Kësaj teme poeti do t’i kthehet sërishmi me “Luftëtarin lypës” (1922) që është një rrëfim tronditës i luftëtarit të mbetur rrugëve pa asnjë ndihmë e përkrahje dhe një akuzë therëse për ata që “zhgryhen mbi fron” pa i vrarë ndërgjegjia për tradhtinë dhe pabesinë e tyre....

(Jorgo Buló, *Tradita dhe risi letrare, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Kombinati poligrafik “Shtypshkronja e Re”, Tiranë, 1981, f. 131, 134, 135.*)

Për Himnin shqiptar të Asdrenit: Karakterizime dhe krahasime



“Himni është këngë solemne, këngë e lavdit, vjershë që hartohet në frymë kombëtare, duke përfshirë përhershmëritë kombëtare në trajtë të dendur e simbolike. Vetëm kur kjo i përmban këto esenca dhe njëherësh pranohet nga të gjithë si e tillë, mbërrin nivelin e këngës simbolike e përfaqësuese të kombit. ..Në shqip vjersha të tilla kanë shkruar Asdreni, Fishta, Noli e Lasgushi. Sipas dëshmisë së Lasgush Poradecit, **Asdreni** himnin kombëtar *Rreth flamurit të përbashkuar* (me 6 strofa) e shkroi rreth vitit 1907 në Bukuresht, me kërkesën e Korit Kishtar Shqiptar, kor që po bënte punë kulturore atdhetare. Kjo vjershë për herë të parë u botua në *Liri e Shqipërisë* në Sofje, më 1912. Në fillim ky u bë himni i kolonisë së shqiptarëve të Bukureshtit, u përhap në Shqipëri dhe u pranua si himn, edhe pa u përgatitur për këtë qëllim, por u pranua nga populli dhe nga kryengritësit dhe u këndua edhe me rastin e ngritjes në flamurit më 1912, në Vlorë.

Aty janë bashkimi, besa, shpëtimi dhe betimi, koncepte kombëtare, po edhe fryma kundërshtuese, kryengritëse që do të zhvillohet në pesë strofa të tjera. Në këtë nivel kënga e himnit hyn njëmend në sferën e lavdit, përkushtimit të tërësishëm deri në nivel identifikimi; po edhe në nivel të shenjtërimit, që është një shkallë sipërfaqësore e lavdimit. Në këtë mënyrë, kënga e Asdrenit nis udhën e ngritjes nga kënga tokësore në një këngë qiellore, të përjetshme, si lavdim i therorisë për atdhe. Krijimi i kultit të heroizmit, i cili është provuar më parë në nivelet jetësore. Atdhetare.


Poezinë *Hymni i flamurit kombtar* Gjergj Fishta (me 10 strofa) e shkroi më 1913, dhe kjo këngë u këndua për të parën herë nga nxënësit françeskanë nëpër rrugët e Shkodrës, ditën që Fishta me miq të vet kishte ngritur flamurin kombëtar në kumbonaren e Kishës së Gjuhadolit. Janë bërë këtu bashkë bekimi dhe mallkimi hyjnor, një

prose i provuar me denduri edhe në vjersha të tjera atdhetare të Fishtës. Është këtu figura e tokës së bekuar e dhënë nga vetë Zoti, garancë e një konvence hyjnore që shkon përtej bindjeve individuale. Tema tjetër e zhvilluar në himnin e Fishtës është kryengritja dhe qëndresa shqiptare, që merr konotacione kohore, historike, tejhistorike, po që përfundon rëndom në figurën identifikuese të luftës së Kastriotit, si identitet i brendshëm kombëtar, po i njohur dhe i pranuar edhe nga të huajt...*Hymni flamurit kombtar* i Gjergj Fishtës është vërtetë një këngë kombëtare me të gjitha karakteristikat e poetit Fishta.

Noli e shkroi vjershën *Hymni i Flamurit* (me 6 strofa) me 14 nëntor 1926 dhe u botua në një numër të *Lirisë kombëtare* të Gjenevës, numër që i kushtohet festës së 28 Nëntorit. Është kjo një thirrje e drejtpërdrejtë e identifikimit me simbolet nacionale, të cilat zbulohen në figura të dashurisë së dheut e të familjes, në figurat themelore të fashurisë njerëzore, duke gjetur kështu ngjyrimet e flamurit për të theksuar gjenezën dhe historinë e këtyre shenjave si produkte të jetës kombëtare. Në këtë vështrim himni i Nolit është i zotëruar nga retorika dhe ideologjia kombëtare.

Lasgush Poradeci e shkroi *Marshin e djalërisë* me përcaktim zhanror (Himn Kombëtar) në vitet '20 dhe e botoi në librin e poezisë *Vallja e yjeve* në vitin 1933. Kjo në të vërtetë është një këngë për zemrën e djalërisë. Himni i Lasgushit është një himn, para së gjithash, poetik, duke ruajtur skemën e njohur lasgushiane të krijimit të figurave, të pamjeve e të vizioneve kombëtare, që përherë përfundojnë me atë artikulin e kualitetit të veçantë të brendshëm: të dhembjes e të lavdit të vetvetes. Vjershat-himne të dy autorëve të fundit, janë pa përpunim muzikor.

(Sabri Hamiti, Vepra letrare-6, Shtëpia Botuese “Faik Konica”, Prishtinë, 2002, f. 304-313)



I pari nga studiuesit e huaj, albanologë, që kanë njohur një pjesë të mirë të krijimtarisë së poetit drenovar, përndryshe, të përmbledhjes *Reze Djelli* (Sonnenstrahlen), Bukarest, 1904 (Toskisch), ka qenë albanologu austriak Maximilian Lambertz (1882 – 1963). Autori ka vjelë nga poezitë e Asdrenit, shembuj e modele ndërtimi të frazës (periudhës), në monografinë gjuhësore *Periudha hipotetike në gjuhën shqipe*¹³ “Die hypothetische Periode im Albanischen”, botuar në revistën *Hulumtime indogjermanike* (“Indogermanische Forschungen”, 1914-1915, Vëllimi i 34-t.)

Tetëdhjetë e tri vjet pas Lambertz-it, shkrimtari, përkthyesi, interpreti dhe specialisti në studimet shqiptare, kanadezi Robert Elsie (1950-2017), hartoi një *Histori të letërsisë shqiptare* (1997)¹⁴, në 13 krerë, plus *Kronologjinë e letërsisë shqiptare*, *Bibliografinë dhe Indeks*in e emrave. Autori, me dëshirën e tij, është varrosur në kryeqendrën e Dukagjinit, Theth. Elsie është quajtur *Bir shpirtëror i Shqipërisë*.

Nga ky studiues i botës shqiptare, për Asdrenin, s’kemi çfarë të shënojmë, përveçse një pohim, ndoshta jo aq të njohur, lidhur me qëndrimin që mori poeti ndaj pushtimit të vendit nga Italia fashiste. Shkruan kanadezi: “ Asdreni në fillim përshëndeti pushtimin e Shqipërisë nga Italia në Pashkët e vitit 1939 dhe shkroi *Credere, obbedire, combattere*,¹⁵ por rrëmuja e shkaktuar nga pushtimi dhe lufta ia bëri fare të qartë dhe me dhimbje se shpresat për pension qenë të kota. Për këtë të dhënë, Elsie nuk e jep burimin, që kërkon një vepër shkencore.

¹³ Qendra e Studimeve Albanologjike, Maximilian Lambertz, *Periudha hipotetike në gjuhën shqipe*, përgatitur për botim: Prof.as.dr. Tefë Topalli & Dr. phil.MA Edmond Malaj, Botime Albanologjike,Tiranë, 2011 (329 faqe).

¹⁴ Robert Elsie, *Histori e letërsisë shqiptare*, Dukagjini, Tiranë - Pejë, 1997 (Përk.: A.Myftiu) me 687 faqe.

¹⁵ *Credere, ubbidire, combattere* – me besue, me u bindë, me luftue.



Të fundit për këtë Hyrje po japim punimin më të shënuar shkencor, kushtuar artit poetik të Asdrenit, hartuar si tezë Doktrate nga prof. R.Qosja, me titull “Asdreni. Jeta dhe vepra e tij”, në vitin 1972, mbrojtur në Universitetin e Tiranës.¹⁶ Pa hyrë në përshkrimin shkurt të përbërësve që e formojnë këtë monografi, sjellim një vlerësim që ka bërë studiuesi fishtolog, Dr. Tonin Çobani për këtë

libër, ditën e promovimit të ribotimit të saj në Drenovë të Korçës, ku merrte pjesë edhe autori i saj: *“Monografia voluminoze e prof. Rexhep Qoses "Asdreni, jeta dhe vepra e tij" është shëmbull i një shkolle estetike shqiptare për metodologjinë që ka përpunuar ky autor në shtrimin dhe strukturimin e lëndës së paraqitur. Si një ngrehinë e padukshme ndihet gjatë gjithë librit qartësia e koncepteve estetike që e kanë udhëhequr autorin me konsekuencë nga konkluzioni në konkluzion, nga kapitulli në kapitull. Këtë cilësi, që lidhet me talentin prej studiuesi të autorit dhe me punën voluminoze dhe sistematike, mund ta krahasojmë pa frikë se gabojmë me punën e instituteve apo të institucioneve të specializuara dhe me tradita, që, shpesh herë ose na kanë munguar ose nuk kanë qenë eficiente te ne.”*¹⁷


Pasazhin në vijim (me pak ndërhyrje tonat) e shkëputem nga libri *Panteon i rralluar*¹⁸ i R.Qosjes, ku është botuar kreu XIX i monografisë. Në këto 17 faqe, autori ndalet në mënyrë të veçantë tek stili letrar dhe figuracioni në poezinë e Asdrenit, duke nisur nga:

Epitetet dhe krahasimet – Autori fillon me një kredo të punës që do të ndjekë gjatë studimit: *“Karakteristika e stilit të një poeti është e arsyeshme të kërkohe në poezitë e tij më të mira, por kjo kurrsesi nuk*

¹⁶ Rexhep Qosja, Asdreni. Jeta dhe vepra e tij, Dukagjini, Prishtinë 1972. (Ribotuar nga TOENA, më 2002).

¹⁷ Tonin Çobani, Referuar në promovimin e librit "Asdreni, jeta dhe vepra e tij", TOENA, 2002 , shkruar nga akademiku Rexhep Qosja, promovim që u bë gjatë ditëve të sallorit të librit në Korçë. Botuar te gazeta “Koha jonë

¹⁸ Rexhep Qosja, Panteoni i rralluar- Studime, kritika dhe ese, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1988, f. 519 – 536.



do të thotë se edhe në vjershat e tjera, që nuk janë në nivel artistik të atyre më të mirave, nuk dallohen karakteristikat e stilit të atij poeti. Asdreni e fillon krijimtarinë poetike me vargje bombastike, retorike, të cilat e tregojnë natyrën e ndjenjës së tij në momentet e krijimit të tyre më të mirë se ç'ë përmbajnë atë ndjenjë brenda strukturës së vet figurative dhe ritmike. Vjershat e tij të para ai i shkruan nën presionin e një temperature të lartë emocionale që nuk është shndërruar pra edhe në vlerë të tyre të brendshme artistike. Në këto vjersha duhet kërkuar me pishë ndonjë figurë e përshtatshme stilistike dhe nuk është e sigurt se mund të gjendet aq lehtë....Përkrah këtij përcaktimi të akademikut Qosja ka ecur edhe gjuha poetike e këtij poeti. Në konkretizimin vizual, figurativ, të botës poetike të Asdrenit rolin më të madh e luajnë epitetet dhe krahasimet, personifikimet dhe metaforat e simbolet, megjithëse toni retorik, i shfaqur në fillimet krijuese, mbetet një prej cilësive të përhershme të shprehjes së tij. ...Kështu, për shembull, epitetet janë më të shpeshta në vjershat e tij lidhur me natyrën dhe dashurinë, sesa në vjershat patriotike, sociale dhe politike si dhe meditative, ashtu sikundër janë më të shpeshta në përmbledhjet Ëndrra e lot dhe Psallme murgu, si përmbledhje të pjekurisë krijuese, sesa në përmbledhjen Rreze dielli apo në vjershat e përmbledhjes së pabotuar Kambana e Krujës. Mund të vërehet, gjithashtu, se në dy përmbledhjet e tij më të mira epitetet janë më të shpeshta se ç'mund të jenë në krijimtarinë e poetëve tanë më të dalluar të Rilindjes: Jeronim de Radës, Zef Serembes dhe Naim Frashërit... Kjo nuk do të thotë se të gjitha epitetet e Asdrenit janë të reja, të freskëta, të panjohura në poezinë shqipe përpara tij; një numër i mirë i epiteteve që shfrytëzon ai në vjershat e përmbledhjes së parë dhe, madje edhe të dytë, janë aq të përdorura si në poezinë e Rilindjes, ashtu edhe në poezinë popullore, saqë lehtë mund të quhen epitate të banalizuara nga shfrytëzimi i tepërt.

Sikundër përdor epitete të shfrytëzuara dhe banale, por edhe të reja dhe befasuese, Asdreni përdor në poezinë e tij edhe karahsime të shfrytëzuara dhe bamale, por edhe të reja, origjinale, të panjohura në poezinë shqipe. Në vijim të këtij kreu autori merr e përshkruan krahasimet, personifikimet, metaforat dhe simbolet, në të cilat është derdhur gjithë mjeshtëria e dija letrare e këtij shkrimtari e studiuesi, si Rexhep Qosja. (f. 519 – 536).

Në udhën e Naimit

Le ta nisim nga versniku i Asdrenit, siç e quan Dh. Shuteriqi M.Gramenon, novelisti i këndshëm i viteve të para të shekullit të kaluar, i cili ka përdorur paskajoren geqe që në strofën e parë të vjershës “Për mëmëdhenë”, ku dalin dy paskajore geqe me vlerën e urdhërores (strofa I, III): ¹⁹

*Për Mëmëdhenë, për Mëmëdhenë,
Vraponi, burra, se s’ka me prit !
Të vdesim sot ne me besa besë
Pranë Flamurit të kuq q’u ngrit !*

*Tym edhe flakë, ujë të valë
Baba Tomorri nxjerr e buçet,
Të gjithë trimat atje me dalë,
Se dita erdhi, koha më s’pret !*

Te një krijim tjetër i kohës, me titull “Uratë për Liri”,²⁰ gjejmë vetëm një tregues të tillë: një leksemë - emri “krye”(SP “Për mbi krye”- në vend të “Për mbi kokë”).

Nëse në tekstin e këngës, më sipër, shfaqen dy trajta foljore me paskajoren geqe, tek kënga e Asdrenit, të gjitha strofat kanë gegizma:

¹⁹ Karl Gurakuqi, Shkrimtarë shqiptarë - 2, Rilindja - Histori e Letërsisë shqipe, nën kujdesin e Ernest Koliqit. Zëri i M.Gramenos është përgatitë nga shkrimtari Sterjo Spasse, f. 188-199.

²⁰ Po aty, f. 193.

në leksik apo në vështtrimin gramatikor të tri foljeve, siç i kemi nënvizuar më poshtë:

Kënga e Bashkimit ²¹
Eja gegë, këtu pranë,
Qasu, qasu porsi **zanë**,
Dorën zgjate me dëshirë
Si një burrë **i pavidrë** !

Gegë, toskë, **vllazën** jemi,
Të dy bashkë një emër kemi
Dhe një fat në këtë botë:
Shqyptar 'jemi, fjala thotë.

Prej një **nane** jemi lerë
Mysliman'e të krishterë,
Me një diellë jemi rritur,
Si dy lisa pranë ngjitur.

Të dy kemi një dëshirë,
Se një sisë kemi pirë,
Një të qeshur, një **të qame**
E një zemër **të pandame**.

Prej Viose gjer te Drini
Mos na ndajë dot Shkumbini,
Porsi **vllazën** na të rrojmë,
Dhe **Shqypninë** ta forcojmë.

Se **Shqypnia** është besa,
Nderi i ynë, jeta, shpresa,
Besën tonë, pra ta mbajmë
Kurrë armiqtë mos na **çajnë** !

Veç si burra pa një **drojë**

²¹ Asdreni - Vepra I, Tiranë, 1976, f. 277-278. (Botuar për herë të parë në “Korça”, Korçë, v.I, 1909, nr. 17, 15 tetor, f. 2).

*Si ndë luftë edhe nevojë,
Tërë bota **ka me ditur**,
Se na **s’jena** për t’u shitur.*

*Po të fortë e të bashkuar,
Kryelartë e shpirtndritur,
Të gjithë **kena m’u përpyjekun**:
Për **Shqypninë** sot **me vdekun** !*

Leksik

Kângë-a, e – kur përdoret në tituj, siç e vë autori, duhet kuptuar “teksti i këngës”.

Zânë-a, figurë e besimeve popullore shqiptare, e përfytyruar si një vajzë e bukur luftëtare,

që jetonte në male e pyje e ndihmonte trimat, por që kishte fuqi edhe të ndeshkonte duke të shituar. Fjalë e dy dialekteve me mbizotërim të trajtës geqe. Trajtën toske zërë e ka Labëria dhe Bregdeti për “vashë e bukur”; sot, pothuajse e dalë nga përdorimi. Huazim nga *lat. Diana*-Perëndesha romake e pyjeve.

Pavdirë (i) mb. “që s’shuhet, që s’humbet”. Fjalë krahinore e dialektit gegë. Formim i brendshëm nga *vdjerr* “humb”, prej foljes *bjerr* me të njëjtin kuptim.

Vllâzën, trajtë dialektore e dialektit gegë; toskërisht: *vëllezër*.

Shqyptar-i, e, mb. trajtë dialektore e gegërishtes; e vjetëruar prej kohësh: *khs.* Shqiptar.

Prej, *prf.*- parafjalë e rasës rrjedhore, më tepër e përdorur në variantin dialektor të

Gegërishtes; në vend të saj del më së shpeshti, parafjala e rasës emërore “nga”.

Nânë-a, e. dialektore e veriut: leksiku standard: nënë.

Të qâme, *emër* prejfoljor asnjans; leksiku standard: të qara.

Të pandâme, mb. formim nga pjesorja ndarë (-me), me paranyjëzim.

Çaj – *f.* fjalë e vjetër shqipe nga rrënja i.e., me kuptimin “pres”, “ndaj”.

Drojë-a, e. droe-ja, frikë, e trembur (Fj. i Bashkimit, 1908); fjalë e gegërishtes, e vjetëruar.

Gramatikë

Më vete duhen parë trajtat foljore, që përdoren vetëm në të folmet geqe:

ka me ditur



kohë e përtëjardhme

(me + pjesore tosk.)

kena m’u përpjekun:



kohë e përtëjardhme

(kam+paskajore geqe)

me vdekun

paskajore geqe

(me pjesore të vjetëruar, khs.“vdekë”)

Vërejmë se, duke lexuar këtë tekst poetik, në strofën VII, vargu II , lexojmë: *“Prej Viose te Drini/ Mos na ndajë dot Shkumbini”*, menjëherë na shkon mendja tek studimet dialektologjike, ku prej kohës, specialistët tanë, lumin Shkumbin e kanë caktuar si kufi gjuhësor që i ndan dy kryedialeket e shqipes. Nuk e dimë nëse poeti drenovar e ka njohur këtë të vërtetë shkencore, por mund të gjykojmë se ai del kundër ndarjes dialektore gjuhësore, sepse vargjet e tjera janë: *“Porsi vllazën na të rrojmë,/Dhe Shqypninë ta forcojmë.”* Lidhur me këtë, R.Qosja, duke pohuar ndikimin e Naimit tek Asdreni, shkruan: *“Ndikimi gjuhësor i Naimit mbi krijimtarinë e Asdrenit, gjithsesi, do të jetë shumë i frytshëm, megjithëse nxënësi do të bëjë më tepër përpjekje se sa mësuesi për afrimin e dy kryedialekteve.”*²².

Nga kritika jonë është thënë e shkruar se Asdreni, *hapat e tij të parë i bëri nën ndikimin e Naimit, nga i cili huazoi traditat progresive, si frymën e zjarrtë patriotike, shpresën në të ardhmën e bukur të Shqipërisë dhe besimin në forcën e dijes dhe të arsyes*. Sepse vepra poetike e këtij rilindësi të madh ushtroi një ndikim të thellë në ata autorë që nisën punën e tyre letrare në kapërcyellin e shekullit të kaluar dhe të shekullit XX.²³ Tek vjersha e gjatë kushtuar Naimit- *si poem lirik dhe botuar në librin “Naim Frashëri-prej një grupi studentësh të Austrisë (Graz), 1925, Lasgush Poradeci shkruan: “Këtë vjershë e kam bërë në Poradec më 1921, kohë e mbushjes së 20 vjetëve pas vdekjes*

²² Rexhep Qosja, Asdreni- Jeta dhe vepra e tij, Botimet Toena; Tiranë, 2002, f. 253.

²³ Koço Bihiku, në Asdreni-I, Kombinati Poligrafik, Shtypshkronja “Mihal Duri”- Tiranë 1976, f. 18.

së Naim Frashërit. *Një sëmund’e rëndë dyke më hedhur në spitale, j-a dorëzova vjershëtorit Asdren për çdo eventualitet...(Bukuresht, Qershor 1921). Sot po e botoj me rastine një të katërte shekulli pas vajtjes së Këngëtorit Kombëtar në të Vërtetën. – L.P.*²⁴

Edhe te ky apostull i Shqiptarizmit, ka shembuj me ngjyrimë leksiku e tregues gramatikorë, si tek poema e njohur dhe aq popullore e rilindësit të madh, “Bagëti e Bujqësija”, nëpër gjashtëmbëdhjetërrokëshat e begatë të kësaj vepre:

*Të munjam të fluturonja e të kisha krahë si ti !
Me gas të math do t’i vinjam Shqipërisë brënda në gji !
Për me marrë drejt Shkumbinë edhe Elbasan’e Tiranën,
E me arth ke ti, o Shkodrë, të shoh Drinin e Bujanën.
Kostur, Përlep, Fëllërinë, Dibrë, Ipek e Jakovën,
Mat e Ysqyp e Prështinë, dhe Mirëdit’e Tetovën;
Krojënë e Skënderbegut, q’i ka pas dhân ner Shqypnisë,
Tue bam me trimat luftë, e me munt mren’e Turqisë,...*²⁵

Kjo “ngjyerje pene” në dialektin e të folmet e begata të gegërishtes, nuk ka asgjë të përbashkët me konceptionsin e paqëndrueshëm të F.Konocës, kaluar nëpër disa faza, njëra prej të cilave njëra ishte: “*E mira e së mirave do të jetë të përdoshin prej të gjithë Shqiptarëve toskërishtja për prozën, gegërishtja për poezinë*”²⁶ Më tej, ai shtonte se *dialekti gegë ruan qindra trajta të humbura prej toskëve, e që janë thesarë të vërtetë të trashëguara nga stërgjyshët t’anë që në kohë të*

²⁴ Lasgush Poradeci, Naim Frashërit- Poem lirik- Nxjerrë nga libra “Naim Frashëri” prej një grupi studentësh të Austrisë (Graz), 1925. Edhe duke shfletuar poetikën e poetit pogradecar, ndeshen aty-këtu gegizma leksikorë, si: *avitem, shendi, rektin, atme, krepa, katund...Skanderbegu*, e pak të tjera. Shënojmë se për fjalën “zanë-a”, Lasgushi përdor “zërë-a”, sikur do t’i ikë rotacizmit.

²⁵ Naim Frashëri, Vjersha lirike- Nën redaktimin e L.Poradecit. Shtëpia Botonjëse “Naim Frashëri”, Tiranë, 1950, f. 13.

²⁶ ASHAK, Drejtshkrimet e shqipes Përgatitotut nga Rexhep Ismajli, Prishtinë, “005, f. 41.

vjetër.”²⁷ Sipas N.Resulit, Konica ishte “përkrahës i shkrirjes së dy dialekteve.

Ngjyerja e penës, që shënuam më sipër me anë të metaforës, mund të jetë një aluzion i teorive të ndryshme linguistike që qarkullonin në fillim të shekullit XX për unifikimin e gjuhës letrare shqipe me anë të *përzierjes armonike* të të dy dialekteve.²⁸ Termin “*përzierje të gjuhës*” e shpreh edhe Fishta në recensionin e shkurtë që i bën veprës së Asdrenit “*Ëndrra e lotë*”, para 109 vjetësh, duke u shprehur kundër një planifikimi të tillë për gjuhën e njësuar letrare.

Është me vend të tregojmë këtu se krijimet në idiomën geqe në poezi të Asdrenit, i ka vlerësuar me mjaft pëlqim edhe Faik Konica; në një letër të tij të vitit 1902, ku i drejtohet “I dhëmbshur atdhetar!, “I shtrënjtë atdhetar”: “*Të përshëndosh për viershat që më çove. Shumë të bukura, edhe gegnishtet janë mirë të goditura.*”²⁹ .

II. Një shikim për strukturat e vjershërisë së Asdrenit

Kur ke në dorë librat me poezi të Asdrenit dhe merr e lexon, duke shijuar artin e tij, gjëja e parë që bie në sy është larmia e strofave, struktura e tyre sipas numrit të vargjeve, nisur prej tingëllimave, si formë poetike e vjetër dhe asnjëherë e ndryshuar, vargjet monokolonë, poezi me distikë vargjesh, me tercina, vjersha me strofa katërshe, gjashtëshe, rrallë edhe me tetëshe. Grup më vete dalin te ky poet strofat safike, afërsisht aq sa janë sonete, në dy vëllimet “*Rreze dielli*” e “*Ëndrra e lotë*”. Shpesh ndërtimet me dy vargje e tercina, lidhen edhe nga ana sintaksore, si për shembull, te “*Ardhi dita*”³⁰:

²⁷ Po aty, f. 40.

²⁸ Po aty, f. 40.

²⁹ Faik Konica, *Vepra-4*, Botimet Dudaj, Shtypshkronja “Guttenberg”, Tiranë, 2001, f. 116.

³⁰ Asdreni, *Vepra*, Tiranë, 1976, f. 60.

Për trima, ju, trima jini,
Këtë dhe ju vet'e dini

Po ç'dobi është' për atdhenë
Kur s'është'si ka qenë"

Në jini ju atdhetarë
Dhe të thjeshtë shqipëtarë,

Bënie ju atdhenë
Siç qe nënë Skënderbenë !"

Po një zë kështu më tha:
Mos u çirr e mos u vra,
Se i lumtur këtu s'ka,

Se çdo grimë që po shkon
Jeta çduket, koha ndërron;
Askush botën s'trashëgon.³¹

Në strofa katërshe, më e zakonshmja është që fraza nis dhe mbyllet sintaksorisht nga vargu i parë deri tek i katërti, por sipas kuptimit, ngjet që në segmente të ndryshme, strofa vijuese është e lidhur semantikisht me atë pararendëse, si në vjershën "Në mërgim":³²ku katër strofat e fundit janë të lidhura edhe gjuhësisht:

Edhe ti, ylli i mëngjezit
Që sheh ditën kur mburon,
Që ke qenë bres pas brezit
Ylli i bukur që ndriton;

Si kandile e pashuar
Që ndë jetë s'ka shtërrim,
Dërgoi dritë të uruar
Atij vendit, dheut tim!

Shqipëri, i vent i bukur,
Fusha e male plot me ar,
Ku çdo burrë në të dukur
Është trim dhe luftëtar;

Me sa mall e sa dëshirë
Atë ditë po e pres,
Që edhe unë atje i lirë
Pranë prindërve të vdes"

Në dy strofat e para, autori i drejtohet "yllit të mëngjezit", kurse në të tretën e të katërtën, drejtimi i shkon thirrorit "Shqipëri".

Në strofat pesëshe, që janë më të rralla për krijimtarinë e poetit, gjendet një lidhje e tillë bashkuese nga ana kuptimore, në atë masë sa më tepër se një strofë – një varg i tërë prej tyre – kanë varësi vetëm te një varg,

³¹ Po aty, f. 326.

³² Po aty, f. 225-226.


përndryshe tek një gjymtyrë – kryefjalë – siç ngjet në strofën e 9-të (f.19), tek e cila marrin kuptim 7 stzrofa të tjera, deri në mbyllje të poezisë. Në 28 vargjet në vijim rimerret **S** “Ju male” me anë të përemrave në rasi të ndryshme, edhe të shoqëruar me parafjalë; ka edhe strofa pa subjekte:

Ju male, jini ndjenja jonë
Burim i çdo dëshirës gjallë,
Tek ju e kemi shpresën tonë
Se kur e keqja vjen, gjithmonë
Me ju, ne do t’i bëjmë ballë.³³
.....

nër ju, prej jush, ju, me ju,
me ju, nër gjnjt’ tuaj, ju (fali),
nër brigjet e luginat tuaj, ju,
tek ju, s’ju (tundin), tek ju,

Edhe në krijimet me strofa gjashtëshe, si ndër më të bukurat vjersha, “Balashit”,³⁴ ndër tri strofat e para, vetëm njëra qëndron kuptimisht më vete, kurse II dhe III kanë varësi kuptimore me të parën, përndryshe, me kalin *balash e bukurosh e trim dragua*:

*O balash, o bukurosh,
Që je trim si një fatosh,
O dragua, kali im,
Që po pret me padurim;
Në ke mall për Shqipëri,
Ngjeshu, kalë, ji gati !*



*Shih sa vent plot bukuri
Ku del ar, ku del flori,
Ku ndrit dielli me shkëlqim
Dhe qesh hëna me pëlqim;*

³³ Adreni, Psallme Murgu, Botimet “Pakti”, Tiranë, 2009, f. 18- 21 (Sipas botimit në Bukuresht, 1930).

³⁴ Po aty, f. 242-243.

*Si në vent të prrallave,
Trimave dhe pallave!*

*Ku një pyll, ku një mburim
Male e fusha pa mbarim,
Me lëndina plot magji,
Ku derth këngë trimi i ri ,
Ku del zana për mëmgjes
Lulethurur gjer në bres*




Te kjo strukturë strofike, me 6 vargje, R.Qosja vjen e gjen shfaqje të karakteristikave të poezisë së parnasizmit, që shpjegojmë më sipër dhe që janë: *depersonalizimi i krijuesit, pamja klasike, shprehja e ftohtë, e kristaltë dhe ndërtimi me 6 vargje* - si skemë e kësaj rryme.³⁵

Kështu ngjet edhe në strofat 7-she, tepër të rralla në vjershërinë e Asdrenit, si te poezia “Lutje” (romantike),³⁶ ku 35 vargjet e lira të autorit (nga metri, jo nga rimemat), kanë mbiemra dhe epitete, drejtuar thirrorit në v. I

Vajz’ e bukur
Më je dukur
Dritë jete plot shkëlqim;
Pa lëvdatë
Ke dhuratë
Që prure gaz e dëshirim
Me plot mall e ngushëllim!

“Vajzë e bukur”:



Në 4 strofat e vjershës në vijim, ka vetëm dy rimarrje përemërore (përemër pronor, v. II dhe një përemër vetor), të gjitha të tjerat kuptohen nga foljet-kallëzues në vetën II: *tënd, (më) çel, shpall, kundërmon, shëron, dashuron, çile, ndriçon, eja, të (kërkon), teje, hapi, fal(mi), prit.*

³⁵ Rexhep Qosja, Asdreni, jeta dhe vepra e tij, Botimet Toena, Tiranë, 2002, f. 277. (Sjellë vetëm për strukturën gjashtëshe të strofës, jo si vjershë përfaqësuese e parnasizmit.)

³⁶ Po aty, f. 78-79.

Strofa tetëshe gjejmë edhe në vëllimet “Reze Djelli”: *Dua*, f. 69, *Frori*, f. 129, *Përfytyrime*, f. 170, *Djalëria*, f. 198, *Rreth mësallës*, f. 206; tek vëllimi “Ëndrra e lotë: Betim mi flamur, f. 224, Shqiponja me dy krerë, f. 250, Të falura, f. 265, Zëri i kryengritësve, f. 274, Krujës, f. 279. Kurse, tri vjersha me strofa tetëshe përmban përmbledhja “Psallme Murgu”, poezitë: *Vlorës* (f. 37), *Marshi i djalërisë shqiptare* (f. 40), *Mëkati i fshehur* (f. 112).

Edhe më interesante është arkitektura e poezisë me 10 strofa, kushtuar Vlorës (80 vargje), ku vetëm në vargun I të strofës së parë del thirrori i nënvizuar, ngjishet me epitete të qëlluara:

“Vlorë, Vlorë, zall e det...”:

Hyll prej qiellit *je pikuar* →
Dorës Zotit *e gatuar* →
Si rrallë shoqe *ke mbi dhet.* ↑
Vlorë e bukur, lumja ti! ↑
Dita, nata sy-kulluar ↑
Ver’e dimër lule-shtruar ↑
Je si nuse plot stoli. ↑

Në 9 strofat e tjera, autori i drejtohet Vlorës me folje e përemra, si: *ti je, ngjalle, të sjell nder, ta ka shkruar, ti trime, ke tjerre; je kurore, t’i radhuan,, që lakmon, ti përballë, jashtë teje, por ti, hap, ti je, të vu Zoti, t’jesh, t’i mbash, ta tundësh, ta pat dhënë, dergje gjakun, të ta korrin, mban, ke, por ti, mos u dro, mbaj mburojën.* Ndër 72 vargje, vetëm tri herë dalin thirrëret si në vargun e parë të poezisë.

Strukturë të veçantë (përveç përmbajtjes së papritur për kohën kur u shkrua), ka edhe poezia “Mëkati i fsheur”,³⁷ ku heroina shkon të rrëfejë mëkatin tek psallti dhe, duke mos e kallëzaur atë, ngrhet edhe kundër Perëndisë që e bëri ashtu një qenie “me shpirtin-shkëndijë”, sa të mëkatojë dhe deklarohet: “*E di se ka pjesë djalli/Po zemrën kur ma ngjalli/I tij le t’jem e tërë.*”

Tek ky syth duhet vënë në dukje se, përveç vargut të lirë, poeti drenovar, ka sjellë në letërsinë tonë (së bashku me Mjedën), edhe

³⁷ Po aty, f. 112.

strofata safike (13 poezi, tek dy vëllimet e para “Reze Djelli” dhe “Ëndrra e Lotë”), ai ka 31 sonete në veprat e tij të botuara, ka hartuar vjersha të gjata, në përmasat e një poemthi, si: *Epogonët*, me 234 vargje; *Koshtutta...* me 134 vargje; *Drini*, me 128 vargje; *Prej katundit*, me 140 vargje; *Një ëndërr*, me 156 vargje; *Paradokse*, me 216 vargje, *Shqipëria më 1914*, me 128 vargje; *Shega*, me 135 vargje, *Hija e keqe*, me 384 vargje; *Burri i dheut*, me 419 vargje; *Durrësi*, me 70 vargje (5 tingëllima radhazi); *Vlorës*, me 80 vargje. Nuk mungojnë tek ky poet edhe vjersha me distikë, tercina, monokolonë- si *Dëshirë pagane*, me 90 vargje; me shumicë janë dhe strofat me nga 4 vargje. Por në strofikën gjithnduerëshe të Asdrenit gjen edhe strofa me 10 e 12 vargje, të organizuara mjaft saktë nga ana gjuhësore. Në vëllimin “Psallme Murgu” ka leksema geqe përgjatë poezive; si te “Kanga e bashkimit” që sollëm më lart. Në mënyrë të pashjegueshme, gjenden shenja diakritike, që përdor autori, sidomos për llojet e theksave e hundorësinë, por mungojnë provat që ka bërë poeti për të shkruar vjersha të plota në idiomën gegërishte.

II. Krijime në vargje sipas idiomës geqe

“I shtrënjtë atdhetar: “*Të përshëndosh për viershat që më çove. Shumë të bukura, edhe gegnishtet janë mirë të goditura.*”

(“Albania”, Faik Konica- 1904)

“*Veçoria e madhe e Asdrenit është se ai përdori një gjuhë të pasuruar me trajta të gegënishtes, duke krijuar një ekuilibër të prësosur të formës së shprehëse standarte për kohën, dhe tepër të stilizuar si gjuhë letrare, duke e tejkaluar dhe Lasgushin që në këtë pikë nuk e ka ndjekur mjeshtrin pararendës, duke ruajtur ngjyrat lokale të Podradec-Korçës* ”

(L. Ndoja-studiuues dhe botues: Psallme Murgu-Hyrje, f. 4)

Asdreni krijoi disa poezi sipas variantit të shkruar të gegërishtes, gjithsej 6 vjersha, të gjitha- 336 vargje: tri në përmbledhjen “Reze

Djelli” dhe 3 në “Lndrra e Lotë”. Duket se ai e ka ndjerë që ekzistonte ndërmjet shqiptarëve një kufi gjuhësor, si ndarje edhe në gjuhë, prandaj, siç shprehet vetë të *Kënga e Bashkimit*, kërkonte të mos na ndajë dot *Shkumbini*.³⁸ Janë me interes edhe titujt e vjershave, si: *Nata e mrame e Skanderbegut* (me 108 vargje),³⁹ *Për Shqypninë* (me 25 vargje),⁴⁰ *Për Atldhenë* (me 60 vargje)⁴¹ *Zani i Lahutës* (me 32 vargje),⁴² *Kosovës* (me 90 vargje)⁴³ dhe *Të tanë janë gëzu* (me 24 vargje).⁴⁴

Vjersha e parë “Nata e mrame e Skanderbegut” thuret sipas motivit që lëvrohej më tepër gjatë Rilindjes sonë Kombëtare: evokimi i kohës heroike të Gj.Kastriotit. Përdorimi me shkrim i këtij varianti të shkruar të dialektit verior dëshmon se autori nuk e ka zotëruar në shkallën e duhur idiomën gege deri në shprehësinë e saj. Le të vërejmë me radhë disa tregues, nisur nga foljet dhe kategoritë e saj gramatikore:

- A. Janë përdorur paskajore gege, përgjithësisht të rregullta, si: *me dekë me u shue, pa i këshillue, me iu dhan'këshilla, kan'rrethu, mos m'e len, me ngordhë, mos m'e coptu, me iu falë, me e shtrëngue, me i thanë, m'e tunt, me i dëbue...*
- B. Autori anon më tepër nga format e vjetëruara të paskajores, një pjesë e mirë prej të cilave, nuk përdorej më as në kohën kur krijonte poeti “me + pjesore”, si: *m'e shejtnumun, me nerue, m}e çporr', me hy, rrethue, me luftu, me i zbardh', (ish) mulue, me ardh' pran', me nigjue zan', ish bjerrun, m'e prit', m'i qitë, m'u pamun, e mjerume, me i numurue, me rrue, të shejtnumun, me*

³⁸ Asdreni - Vepra I, Tiranë, 1976, f. 277-278. (Botuar për herë të parë në “Korça”, Korçë, v.I, 1909, nr. 17, 15 tetor, f. 2).

³⁹ Asdreni, Vepra-1, Tiranë, 1976, f. 89.

⁴⁰ Po aty, f. 115.

⁴¹ Po aty, f. 124.

⁴² Po aty, f. 261.

⁴³ Po aty, f. 281. Me një të lexuar, merret vesh se poezia vjen pothuajse si imitim i odës së njohur të Rilindjes “O moj Shqypni!” të P.Vasë Shkodranit. Ka jo vetëm leksema të njëjta, por edhe segmente prej saj.

⁴⁴ Po aty, f. 355.

lotu, me punu, me e pështu, me dalë, me u përment, me ia çduk’, me dek’, me i thanë, me iu çnderu, me e ba, me rrnu, m’e zhdrivilluje, m’e lirue, t’helmumun, etj.

- C. Dalin trajta të gabuara të kohës së tashme, si: *shofin, njofin, munim (nd), njen (ndjen), etj.*
- D. Dëshmohet paskajorja e dytë gege, si: *për me mujt’ m’u folë, për me iu dhan’, për me ma shkurtu, për me i qit’, ka shu, për me i njëkun, për m’e qitun, për m’e shunt, për t’lulëzumun, për me u kthye, për me ardhë, për m’e pshtumun, për me i çporrë, për me e përqaful, për me ia amëlcue (pleqninë), për të nuhmumun, për me e shkue, për m’e mpru, për me t’rrëzu, për me t’shkel’, për me t’ba, etj.*
- E. Koha e përtëjardhme: *s’ka ma me shënrit’, për me i dhanë, kini me vajt’, ka me ra, ka me qa, për me kqyrë, s’ka me arth, për me pa, ke me hjekujn, kam me ranun, s’ka me shënrit’, etj.*
- F. Përcjellore: *tuj shenrit’, ishte tuj prit’, ish tuj thirr’, tuj luftumun, tuj qa, jan’tuj lotue, tuj përcjell’, tuj e bekuje, tuj përpjekun, tuj hjekun, tuj luftumun, tuj lanun, tuj e prekun, tuj gatumun, tuj pritun, tuj pvetun, tuj luftumun, tuj e thirrë, tuj luftumun, tuj i nxjerrë, tuj këndu, tuj na thirrë, tij shku, tuj ta pamun, tuj këndu, tuj pushu, tuj u mposhtumun, tuj pa, tuj kërkumun, tuj ngja, tuj u qafu, tuj u përqasun, tuj xhixhillue...*
- G. Krahës paskajores, del edhe trajta e lidhore: *të më rrëmbejë, t’u flasë, t’i keni kujdes, t’jen bes’, mos m’lini (mos me m’lanë), t’u puth (me u puthun), t’u flasë, etj.*
- H. Krijon mbiemra jashtë natyrës së shqipes, si dhe pjesore të vjetëruara: *të mretëreshme, të lotueshme, t’mramen her’, të vlerëshmit, e mallku (-uar), i shejtnumun, m’ke shptumun, i lavdumun, asht vumun, asht marumun, e vorfnumun, robënin’, damun, robnu, dëbu, e dashtnumun, vumun, t’lulëzumun, i çmenue, t’tërbue, t’gazmumun, të dobtue, t’munun, t’therrun, hasun (jena), kalumun (me kalë), etj.*

- I. Fjalor: kan e kan (kënd e kënd), shnet, prep, qiella, mrena, katuni, i tan', met (mbet), vullnesë-a, kurrma, kryet, gjaksi, luana, atdhesi, ven-i, shembue, nanë, men, prehen, hup, tane (jetën), të rana (rënda), vobesi-a, gjimon, e mallënjyshme, e hyjyshme, gazmend, djelmënisë, buri-a, dashtni-a, krye, kunorë-a, i lavdum, ke pas kjen (si shembëllim me vargun e Pashko Vasës: *Ti pas'kenë një zojë e randë...*), Shqypnija, sakola, shoq, drojë (frikë), tetem, duhi, rrokin (armët), pa pra (pa pushue), dojë-a (dëshirë-a), ka le (ka lindur), e bekume, shkëlzen, nalt, kurm-i, çudë-a, të tana, të mramen (të fundmen) ... gjinja (gjindja-njerëzit). burrisht, me trimni, etj.

Jo rrallë, poeti përziën leksema toske në vjershat shkruar gegërisht, dhe leksema geqe (pa rotacizëm), shkruar toskërisht, si: toskizma: për mua, njej, tutje, diq, lavdim, s't'la me bjerrun, , t'kan'shue, , rrënjosun, në të dukur, ay, emri, vonim (!) Emra pa rotacizëm: vorfni, dituni, e pritun, burrisht, ernat, breshni, luftna, urdhënon, etj.

Çka u rreshtua më sipër me shembuj të marrë nga vjershat e autorit, mund të shihen qartë në disa strofa në vijim, vjelë prej 6 poezive:

*Kumonat tinglloin me trishtim,
Gjinia e padurueshme nxiton
Për me pa mretin, edhe pa vonim
Atje mlidhet, e po qan e vajton!
Njen se Shqypnia q'sot ka me ra n'zi
Dhe për jet' ka me qa krahun e tij !⁴⁵*

*Për Shqypnin' e dashtnumun
që ka met'n'vorfni,
Djelmt' e saj n' kam jan'vumun
Për me i dhan'dituni.⁴⁶*

⁴⁵ Asdreni, Vepra-I, Shtypshkronja “Mihal Duri”, Tiranë, 1976, f. 91.

⁴⁶ Po aty, f. 115.

*Atdheu prej anmiqsh ish rrethue,
Kur nana tuj përcjellë birin e vet
E përshënosh gjith' tuj e bekue
Nga lufta për me u kthye me shnet;
I uron nga zemra prep për me ardh',
Burrisht me luftu, armët me i zbardh'.⁴⁷*

*Si ndë luftë tek ushtari
Me hov hidhet tuj këndu,
Ashtu bujku dhe tregtari
Gjith' me kang'ven' me punu.⁴⁸*

*Shqyptarë, mos kujtoni bes'e fe,
Po nanën ju kujtoni që u ka le,
Që ka mbet'fill e vetum si gru e ve
Prej bijvet e harrume mi kët dhe !
Se asht turp i math për ju
Të huejt me iu çnderu !⁴⁹*

*T'tana jan' tuj u mposhtumun,
Syni jot sa q'asht tuj pa;
Dhe me çud jan' tuj kërkumun
Për punën q'asht tuj ngja.⁵⁰*

Sapo lexon tubën e vjershave në dialektin e Veriut, bindesh se ato janë poezitë më të dobëta të autorit, se ai nuk e zotëron dot në shkallën e duhur idiomën gegërishte dhe se poeti ka jo pak toskizma fjalësh, çka dëshmon se bën një përzierje leksikore. Është një vjershërim ekzotik që Asdreni do ta bëjë si provë e mundësi, por pa e arritur poetizimin e vargut, as figuracionin e kërkuar, siç e ka në poezitë e endura në të

⁴⁷ Po aty, f. 124.

⁴⁸ Po aty, f. 261.

⁴⁹ Po aty, f. 283.

⁵⁰ Po aty, f. 355.

folmen e tij të jugut.

III. Struktura sintaksore e soneteve

Kushdo që merr përsipër të hulumtojë në sintaksën e vargjeve, duhet baza teorike që ka sjellë e trajtuar në veprën e njohur “Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika” prof.Xhevat Lloshi, ku poetizim i i fjalës, është një tregues aq i rëndësishëm, që, me shumë kërkesa të tjera, shtrihen brenda aritit të gjuhës.⁵¹

Në llojin poetik, siç janë ndërtimet e vargjeve në tingëllima, ka vështirësi organizimi gjuhësor e sintaksor të 14 vargjeve, pasi vetë skema e rreptë në vendin e theksave, masën metrike në 11-rrokësja, dhe skemën e rimemave, e caktuar e pa ndryshime. Pas Mjedës, që ka edhe poema të tëra sonetesh⁵² varg, Asdreni është lëvruesi më i njohur i këtij lloji poetik në Letërsinë e Pavarësisë. Të ndarë sipas përmbledhjeve që ka botuar, gjejmë: tek “Rreze Djelli” – 1 sonet; “Ëndrra e Lotë” – 9 tingëllima; kurse në “Psallme Murgu” përfshihen 21 sonete. Gjithsej 31 poezi të kësaj gjinie. Me një lexim të vëmendshëm, nga soneti i parë në “Rreze Djelli”,⁵³ deri në tingëllimat e përmbledhjes së fundit, duket se autori ka ngritje cilësore poetike, si në përzgjedhjen e fjalëve të poetizuara, ashtu edhe në klauzolat rimema, të cilat, tek 14 vargjet e para, dalin më tepër nga klasa e foljeve: 8 folje, 2 përemra dhe 4 emra. Skema që zgjedh poeti është: ABAB/ ABAB/ ABA/BAB; metri: me 12 rrokje. Vargjet e dy strofave të para – vargje katërshe - kanë një sintaksë të veçantë, më së shumti: me *varg e fjali* (rrallë me dy folje brenda vargut); të ndryshme nga

⁵¹ Xhevat Lloshi, Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika, Albas, Tiranë, 2012, f. 247, 273.


⁵² Ferdinand Leka, Fjalor i termave të letërsisë, Infobotues, Tiranë, 2013. Sipas këtij autori vjersha sonet ka lindur në Itali, me Danten dhe F.Petrarken, sidomos, në vepërën “Il Canzoniere”. Në disa poetë të Rilindjes europiane dalin sonete që i shmangen formës klasike tradicionale, si b.f., sonetet e Shekspirit, që përbëhen nga tri strofa katërshe dhe një distik në fund...Në letërsinë shqiptare soneti është lëvruar në shek.XIX nga P.Zarishi; në shek.XX mjeshtri i sonetit është Ndre Mjeda në poemat “Lisus”, “Scodra” dhe “Liria”; sonete me vlerë kanë shkruar edhe Asdreni e E.Kolliqi.

⁵³ Asdreni Vepra I, Tiranë, 1976, f. 200.

thurja kuptimore e dy tercinate (6 vargje), duke ruajtur lidhje sintaksore me bazë fjalie, megjithëse poeti (me shumë mundësi) redaktorët e veprës që kemi në dorë, kanë vendosur pikësim të gabuar, pasi më dendur vargu i 11-të vjen e plotësohet sintaksorisht me vargun e 12-të, ose edhe me gjithë tercinen që mbyll tingëllimën:

Për faqet e syt' e tu zemra më rënkon	a	një fjali	
Dhe nat' e dit' jam duk' u menjtuar për to,	b	një fjali	
Me mall t' i vështronj, moj çupë, udhës kur shkon,	a	dy fjali	
Që kurrë nuk më vjen të ndahem nga ato.	b	një fjali	
<u>Rima të kryqëzuara</u>			
Përandaj unë gjendem ndë aq mundime;	a	një fjali	
Ah! Shpirtit s' munt t' i gjenj asfare qetësi,	b	një fjali	
Zemra, kur ty të shoh, më bëhet thërrime,	a	dy fjali	
Vetën e ndjenj të dobët pa nonjë fuqi !	b	një fjali	
<u>Rimë me kombinime</u>			
Ti me nënqeshjen tënde ëmbëlsomë,	c	një fjali	
Shpirtit tem jepi një frymë të çelet	d	dy fjali	
Edhe nga plagat që po vuanj shëromë !	c	një fjali	
<u>Rimë me kombinime</u>			
Se veç nga gjiri yt dashuria vjelet;	d	një fjali	
Pra, edhe mua atje të vjel lëshomë,	c	dy fjali	
Se me atë shpirt e zemër më përkëdhelet !	d	një fjali	
<u>Rimë me kombinime</u>			

Nëse dy strofat katërshe kanë organizim sintaksor më vete me parataksë dhe hipotaksë, dy tercinate e kësaj tingëllime, përbëjnë një ndërtim fraze, e cila nuk mund të ndahet nga gjithë struktura e periudhës; kështu kemi të bëjmë me një ndërtim të drejtë (nis me një fjali kryesore, tek e cila nuk varet asnjëra njësi predikative), vijon me një njësi drejtuese, ku varet fjalia pasardhëse- pa mjete lidhëse sintaksore, por vetëm me pjesëzën “të” të lidhores; pas tyre vjen fjalia përcaktore lidhore e bashkuar me fjalën lidhëse-përemrin lidhor “që-të cilat”; në strofën e dytë del njësia me marrëdhënie shkaku e lidhëzn “se-sepse”, vazhdon fjalia tjetër drejtuese (vargu 13, ku janë dy njësi predikative (me ndërvendosje) dhe mbyllet fraza me një njësi kallëzuesore shkakore; ja dhe skema:



Në sintaksën e vargjeve që po ndjekim rendi merr rëndësi të veçantë: në str.I foljet dalin pothuajse në fund, në str.II ato vendosen në mes të vargjeve, kurse në dy tercinat e sonetit foljet janë vënë në mbyllje të vargjeve; autori ka përdorur edhe dy leksema të idiomës gege: *teme* dhe *vjelet*. Tridhjetë vjet më vonë, Asdreni publikon përmbledhjen “Psallme Murgu”, ku përfshihen 21 sonete, prej të cilëve tërheq vëmendjen tuba prej 3 tingëllimash me titull “Adriatikut”.⁵⁴ Katërmëdhjetë vargjet e para dalin në trajtën e një kornize,⁵⁵ po të vërejmë me kujdes foljen “pashë”, që del në vargun e parë dhe vjen e përsëritet në vargun e 14-të; brenda kësaj hapësire lëviz vështrimi i ligjëruesit-poet; duket sikur dy vargjet:


“Të pashë det Adriatik, të pashë
Si Zanë je prej qiellit i pikuar.....Kujtime t’êmle, botë lumërije
M’u duk se pashë vetë Perëndinë!”

Gjithë soneti për detin Adriatik ngjet me një tablo pikturë, para së cilës ndjen dhe reflekton autori, sikur ndodhet para një filmi që shfaqet ngadalë, duke gëzuar kënaqësinë e ujit të pamasë. Tingëllima ka edhe një veçori tjetër, që edhe e kemi zënë në gojë: vetëm një herë na del emri i detit dhe në të gjitha vargjet, drejtimi ndaj thirrorit realizohet nëpërmjet foljes: *je* (trazuar), *përemrit* pronor yt (gjiri), *përemri* vector ty (të rashë), *të* (lashë), *të* shkrepitjën; kjo është njëfarë tablo; tabloja tjetër nuk ka asnjë lidhje me detin, autori sjell para vetes: dritë ari, pallate përrallash, dhe menjëherë i shfaqet magjia: me vajza e djem që

⁵⁴ Asdreni, Psallme Murgu, Pakti, Tiranë, 2009, f. 16.


⁵⁵ Xhevat Lloshi, Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika, Albas, Tiranë, 2012, f. 102.

derdhen në lëndinë e atij i ngjallen kujtime të ëmbla lumturie...të perëndishme! Po nga ana sintaksore? Përgjigjemi se vetëm strofa e parë ka semantikë të plotë e të pavarur, kurse të gjitha të tjerat: strofa katërshe I dhe dy tercinat nuk japin të dhëna për të qëndruar më vete kuptimisht. Atëherë, poezia-kornizë ravijëzon një tablo pranë një tjetre dhe kalimit e përceptimit që bën autori në këtë pamje të perëndishme. Le ta sjellim në vështrimin e përbërësve frazorë këtë gjashtëvargësh. Tercina e parë ka *varg e fjali* (me nga një folje në fund e në mes vargjeve):



Ndër vëllimet poetike të Asdrenit ka vjersha me sintaksë të natyrshme për shqipen, ndërtime sintaksore të thjeshta, të qarta dhe me mjete lidhjeje të pasura, njëherësh, edhe me njësi predikative asindete; shfaqjet e dukurisë l'enjambement, janë të rralla në teknikën e vargëzimit të këtij autori. Por, veç ndërtimeve lineare të njësive përbërëse frazore, nuk mungojnë tek Asdreni edhe strukturat me ndëvendosje, çka puqen me një sintaksë më ndërlikuar poetike, si në dy strofat në vijim, vjelë prej vjershës “Lulja e këputur”:⁵⁶

E mjera lule, të këputa
Pa pikë mëshire e dhembshuri,
As unë s'di //pse kaq u nguta//
Që nuk t'u solla si njeri.



Nga shoqet// rrebtë kur të ndava//
T'afrova plot fisnikëri,/
Të mora erën //e mënt qava
Në ty //kur pashë aq bukuri.




Vargu III dhe IV ndërtohen me dukurinë e tejkalimit)

⁵⁶ Asdreni, Psallme Murgu, Pakti, Tiranë, 2009.

IV. Sintaksa në strofat safike

Asdreni, ashtu si dhe poeti i madh N. Mjeda, ka mjaft strofa safike,⁵⁷ të cilat po i shohim nga pikëvështrimi i mësipërm. Për poetin e Drenovës, themi se praktikon formën e strofave safike jo pak në vjershërinë e tij, por edhe duke dalë jashtë skemës me të dhënat që jep teoria letrare. Poezi të tilla gjejmë që tek “Rreze Djelli”, në strofa pesëshe, 11 rrokëshe, plus vargun e shkurtuar, me 6 rrokje, në “Zërin e Flamurit”,⁵⁸ në të cilin jepen përgjithësime e përcaktime sa i takon përmbajtjes së gjithë strofës së ndërtuar me kombinime të parataksës dhe hipotaksës, me njësi funksionale homogjene, si në shmebullin që vijon, ku vargu përmbyllës është njësi predikative:

“Oh, veç aher’ka vlerë trimëria,
Kur për atdhen’ajo derdhet pa kursim,
Kur armiqtë shuhën si mizëria
E flamuri është ndë nder’e lavdim!
Pra, përpara djem, se s’do Perëndia
T’vdesë Shqipëria !”



Mjaft vjersha të autorit, me strifa safike që mbyllen me varg të shkurtuar, dalin jashtë këtyre rregullave dhe ndërtohen me vargje 7-8 rrokëshe + 5-rrokësh, si në vijim, te vjersha “I burgosuri”, ku vargu final është vetëm një sintagmë stileme e anasjellë:⁵⁹

*I lidhur këmb’e duar
Shkon udhës me unjësi;
Jetën duke mallkuar,
i mjeri njeri.*

⁵⁷Strofat safike – quhen kështu strofat e poezisë klasike greke, imituar edhe nga latinët. Emri vjen nga poetesha Safo (shek. VI para Krishtit), e cila e ka përdorur me mjeshtri të rrallë. Është strofë e melodishme dhe hijerëndë, prandaj është imituar shumë nga poetët modernë të letërsive europiane. Në letërsinë tonë e ka lëvruar jo pak Nd.Mjeda; përbëhet nga katër vargje, tri të parat janë 11 rrokëshe ose dhjetërrrokëshe dhe i fundit një pesërrrokësh që quhet adonian. Te Asdreni, ky varg na del edhe gjashtërrrokësh. (F.Leka, Fjalor...)

⁵⁸Asdreni, Vepra-1, Tiranë, 1976, f. 74.

⁵⁹Po ai, po aty, f. 165.

Në vëllimin e parë “Reze Djelli”, gjejmë edhe ndërtime safike në tercina 9-rrokëshe +6 vargu mbyllës dhe me 5-rrokëshe + vargun 3 rrokësh, si tek “Malli i peshkatares”,⁶⁰ “Bëj një të mirë”⁶¹ dhe “Mos kërko”⁶²:

*Peshkatar, peshkatar, mos nxito,
Mbaje lundrën e më vent qëndro,
se më kënda të t’shoh !*

<i>Gushën e bardhë</i>	<i>Kur foshnja ishim</i>
<i>Falma një herë,</i>	<i>Dashuri kishim</i>
<i>Faqet si dardhë</i>	<i>Si motr’e vëlla</i>
<i>m’i bjerë.</i>	<i>të dy.</i>

Edhe në këtë lloj poetik, autori ka mundur të krijojë skema aq të rralla, sa vetëm në vjershërinë e tij mund të gjenden thurje të tilla, si te “Mall nate”,⁶³ ku rimemat e gjashtë e shtatërrrokëshit dalin ABBCCA dhe vargu i fundit vendoset si në strofat safike, duke qenë i metruar si të tjerët:

*Del hëna si ar
Lart bregut porsi korë,
Me rrezet rreth kurorë;
Çel buzët, qesh si zanë
Me kryet gjith’mënjane
Dhe faqet plot me zjarr !*

Po kështu vepron poeti edhe në skema, ku përshkruhet mërgimi i zogjve, si te vjersha “Shpesët udhëtare”:⁶⁴

⁶⁰ Po ai, po aty, f. 184,

⁶¹ Po ai, po aty, f. 187.

⁶² Po ai, po aty, f. 202.

⁶³ Po ai, po aty, f. 322.

⁶⁴ Po ai, po aty, f. 296.

*Tok mbledhur si nga mot
Po shkojnë ndaj mërgimi,
Nga kulmi, nga largimi
Na lënë “lamtumirën”
Dhe çajnë hapësirën
I bien erës m’not.*

Strofat safike, më së shumti përmbajnë vargje të shkurtuara pa folje (si në disa strofa të vjershës “Zëri i Flamurit”), por edhe të kombinuar me klasa të tjera fjalësh, shoqëruar me epitete, edhe vetëm me folje që përmbyllin kuptimin e *frazës-strofë*, duke qenë njësi predikative, si tek poezia e njohur “Lulkuqja...”,⁶⁵ e cila përmban disa *strofë-fraza*⁶⁶ me parataksë:

*Lulëkuqeja, e mjera,
Asgjëkundi s’ka shtëpi,
E shkon jetën nd’arrati
Ajo s’është si të tjera
S’ka stoli*

*Ajo ngjyrë nd’ato fletë
Është shpresa që tregon
Një të ardhme që ëndërron..
Është Flamuri ynë vetë
që valon !*

Te “Psallme Murgu”, ka një adaptim tek vjersha “Shi po bije!”,⁶⁷ ku në një strofë safike del fugura morfosintaksore e enalagës, që shfaqet në ndërrimin e gjinisë për emrin “lulet”:

*Shi bije! Le të bjerë!
Kopsht, lendinë zun’e thahen
Lulet epur sa po mbahen
Si të mjerë.*



Përfundime

⁶⁵ Po ai, po aty, f. 245.

⁶⁶ Me termin *strofë-frazë* duhet kuptuar ndërtimi i tërë strofës, si një periudhë e pandarë nga ana sintaksore.

⁶⁷ Asdreni, Psallme Murgu, Botimet “Pakt”, Tiranë, 2009, f. 156.

Asdreni është një prej poetëve m[të njohur i Rilindjes sonë Kombëtare dhe i periudhës së Pavarësisë, i cili u njoh që në krijimet e para.

Ai ka pasur vëmendjen e kritikës dhe u vlerësua gjatë gjysmë shekullit XX, duke nisur nga Faik Konica dhe Gjergj Fishta.

Poeti drenovar jetoi e krijoi jashtë Shqipërisë dhe formimi gjuhësor i tij i përket kohës së fëmijërisë dhe rinisë, që lidhet më gjatë me gjuhën rumune sesa me gjuhën amtare, kështu që nuk mund të quhej njohës i nivelit të lartë të pasurisë leksikore dhe shprehësisë së shqipes. Sidomos, kjo duket qartë në krijimet e pakëta që ka lënë në idiomën gegërishte.

Asdreni ka sjellë jo pak risi në vjershërimin shqip, sidomos në pasurinë e larminë e strofikës, nga distikët, tercinat, strofat katërshe, pesëshe, gjashtëshe, tetëshe, strofat safike dhe sonetet e shumta që ka krijuar.

Ka mjaft të dhëna që ky poet lëvroi për herë të parë edhe vargjet e lira (kryesisht në metrikë), një udhë e re që vazhdoi gjatë, më pas, në letërsinë shqipe.

Motivet e krijimtarisë së Asdrenit janë temat që u lëvruan gjatë Rilindjes Kombëtare, si dhe problemet shoqërore shqiptare, të gjysmës së parë të shek. XX.

Për vjershat në tingëllima, për nga mjeshtëria, Asdreni, vjen pas Mjedës, i cili, me sonete krijoi poema të tëra në vargje.

Ai është një ndër shkrimarët shqiptarë që u çmua dhe u përfshi në librat shkollorë para dhe pas Luftës II Botërore.

Bibliografi e shfrytëzuar

Adreni, Psallme Murgu, Botimet “Pakti”, Tiranë, 2009, (Sipas botimit në Bukuresht, 1930).

Asdreni - Vepra I, Tiranë, 1976. (Botuar për herë të parë në “Korça”, Korçë, v.I, 1909, nr. 17, 15 tetor, f. 2).

Asdreni, Psallme Murgu, Komentuar nga Leka Ndoja, Botimet “Pakti”, Tiranë, 2009 (me 208 faqe).¹ Qendra e Studimeve Albanologjike, Maximilian Lambertz, Periudha hipotetike në gjuhën shqipe, përgatitur

për botim: Prof..dr.Tefë Topalli & Dr. phil.MA Edmond Malaj, Botime Albanologjike, Tiranë, 2011.

ASHAK, Drejtshkrimet e shqipes Përgatitur nga R. Ismajli, Prishtinë, 2005.

Eqrem Çabej, Elemente të gjuhë[sisë e të literaturës shqipe, excupere 20, Shtypshkroja e Ministrisë s’Arsimit, Tiranë, 1936.

Faik Konica, Vepra I, Botimet Dudaj, Shtypshkronja “Guttenberg”, Tiranë, 2001.

Faik Konica, Vepra-4, Botimet Dudaj, Shtypshkronja “Guttenberg”, Tiranë, 2001.

Ferdinand Leka, Fjalor i termave të letërsisë, Infobotues, Tiranë, 2013. Gjergj Fishta, Ëndrra e lotë, Hylli i Dritës, Shkodër, 1914/9.

Karl Gurakuqi, Shkrimtarë shqiptarë - 2, Rilindja - Histori e Letërsisë shqipe, nën kujdesin e Ernest Koliqit, Tiranë, 1941; Botim II “Pakti”, Tiranë, 2008..

Koço Bihiku, në Asdreni-I, Kombinati Poligrafik, Shtypshkronja “Mihal Duri”- Tiranë 1976.

Lasgush Poradeci, Naim Frashërit- Poem lirik- Nxjerrë nga libra “Naim Frashëri” prej një grupi studentësh të Austrisë (Graz), 1925. Naim Frashëri, Vjersha lirike- Nën redaktimin e L.Poradecit. Shtëpia Botonjëse “Naim Frashëri”, Tiranë, 1950.

Lasgush Poradeci, Ylli i zemrës, Tiranë, 1933. (Vepra letrare, Tiranë, 1990).

Petra Kulevica, Lasgushi më ka thënë. Shtypur Shtypshkr. Tirana”, Tiranë, 1992.

Rexhep Qosja, Asdreni- Jeta dhe vepra e tij, Botimet Toena; Tiranë, 2002.

Rexhep Qosja, Asdreni, jeta dhe vepra e tij, Botimet Toena, Tiranë, 2002.

Rexhep Qosja, Asdreni. Jeta dhe vepra e tij, Dukagjini, Prishtinë 1972 (Ribotuar nga TOENA, më 2002).

Rexhep Qosja, Panteoni i rralluar- Studime, kritika dhe ese, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1988.

Robert Elsie, Histori e letërsisë shqiptare, Dukagjini, Tiranë - Pejë, 1997.

Tonin Çobani, Referuar në promovimin e librit "Asdreni, jeta dhe vepra e tij", TOENA, 2002. , shkruar nga akademiku Rexhep Qosja, promovim që u bë gjatë ditëve të sallonit të librit në Korçë. Botuar te gazeta "Koha jonë".

Xhevat Lloshi, Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika, Albas, Tiranë, 2012.

SHQIPËRIA MES VARGJEVE TË ASDRENIT

Adelina XHAFERI

Universiteti i Tetovës

adelinaxhaferii@gmail.com

Përmbledhja

Me anë të kësaj kumtese të shkurtër shkencore duke u ndalë në rëndësinë dhe vlerën e madhe të vargjeve të krijuara në periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, mëtohet të tregohet se sa për periudhën në fjalë kanë qenë të nevojshme vargjet e Asdrenit dhe sa ky i fundit është i spikatur në letërsinë tonë edhe në ditët e sotme, duke e pasur parasysh nevojën e vazhdueshme të ndryshimit për shprehjen letrare dhe spikatjen e tokës Shqipëri. Ky punim duke i dhënë në mënyrë konkrete vargjet lirike të cilat e paraqesin në një mënyrë a në një tjetër fatin e dikurshëm dhe të sotëm të Shqipërisë, bën me dije dhe vë në vëmendjen e duhur se sa i nevojshëm ishte vargu moralizues dhe thirrës për një ndryshim të përbashkët në të mirën kombëtare. Në raste të tjera, punimi thekson se pavarësisht asaj se si ishte dhe si do të rridhte vetë ecuria e mëvonshme e tokës Shqipëri, ajo sërish do të vazhdonte që me pika të caktuara të ndërlihej me të kaluarën dhe atë ta merrte dritë përkatëse për veprim të një të nesërmeje.

Fjalët kyçe: toka Shqipëri, Asdreni, letërsia shqipe, vargjet lirike, e përditshmja kombëtare

“Lart Shqipëri,
Ti je e zonja.”¹

Në morinë dhe bollëkun e madh të autorëve shqiptarë dhe të atyre të cilët në mënyrë të vetëdijshme krijuan në periudhën e zëshme të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, vargu i fuqishëm për tokën Shqipëri dhe simbolikat e saj jetike del edhe nga pena e Asdrenit. Për letërsinë shqipe dhe tematikat e larmishme të cilat ajo i përfshinë brenda vetes nuk mbetet pa qenë në vëmendjen e studiuesve të ndryshëm edhe krijimtaria letrare dhe publicistike e tij, sepse mënyra se si ky autor e paraqet këndvështrimin e tij mbi ndërtimin, historinë dhe rrjedhën

¹ Asdreni, (2009), Jeta dhe vepra, Vatra, Shkup, f. 48.

fatkeqe të Shqipërisë është shumë më ndryshe nga këndvështrimi i autorëve romantikë shqiptarë, nga fryma e të cilëve iku në mënyrën më të natyrshme. Kjo gjë nuk thuhet vetëm duke parë se toka Shqipëri si vend, ishte e vetmja të cilën kthehej gjithmonë, nëpërmjet vargjeve dhe jo vetëm fizikisht, për ta dhënë atë në paraqitjen e saj më të thjeshtë, por edhe për vetë faktin se Asdreni u njoh si krijues i poezisë së re meditative në letërsinë shqipe. Kjo e fundit duke qenë se ishte e nevojshme që edhe letërsia jonë të merrte një frymë të re, u ndihmua nga një numër i madh letrarësh.

Sa herë që flitet për letërsinë tonë studiuesit dhe lexuesit e ndryshëm brenda dhe jashtë asaj që quhet hapësirë kombëtare, nuk e kanë në mendje vetëm ndarjen e saj në periudha konkrete dhe kohëra të njëpasnjëshme për proceset e ndryshme krijuese, por edhe vetë mënyrën se si brenda saj u trajtuan tematika të shumta e mjaft të rëndësishme, të cilat ndonëse mund të ishin edhe nga bota mitike, sërish u shfrytëzuan si elemente për ndërtimin e asaj që sot njihet letërsi e mirëfilltë.

Duke pasur parasysh faktin se letërsia është një botë e madhe brenda së cilës gjenden një mori e madhe fjalësh, të cilat me fuqinë dhe natyrën e tyre shprehëse arrijnë që të shprehin po ashtu një mori të madhe ndjenjash, atëherë po brenda asaj bote është e nevojshme që të shihen jo vetëm mënyrat se si subjektet lirike a personazhet funksionojnë në rrethana të caktuara nga autori, por edhe atë se si pranohen nga lexuesit dhe se si për to bëhen të pavdekshëm. Sepse ashtu siç është e nevojshme që të ndiqen për aq kohë sa kanë lidhje me nevojat/kërkesat e vazhdueshme të kohës, në të njëjtën kohë duhet të lënë gjurmë që të ndiqen më vonë nga krijuesit letrarë dhe njerëzit e tjerë. Kjo gjë bën me dije se vetëm në këtë mënyrë në morinë e madhe të gjërave të cilat i përafrojnë dhe i bashkojnë njerëzit, edhe letërsia si botë e bollshme fjalësh duhet ta tregojë një gjë të tillë, misionin bashkues dhe lirshmërinë e të shprehurit të gjërave.

Kjo e fundit nuk ndodh vetëm me atë pjesë që u takon shkrimeve prozaike, të cilat synojnë që ta japin karakterizimin sa më të plotë të

personazheve dhe pikat karakterizuese të një hapësire që zgjidhet për veprim, por edhe veprave të ndryshme poetike, të cilat po ashtu përveç shprehjes së lirshme të ndjenjave të brendshme të poetit, tregojnë edhe për lashtësinë e tyre si krijime artistike njerëzore të (pre)destinuara për të ndodhur. Me këtë rast është e nevojshme të theksohet se krijimet e ndryshme letrare, si bota të mëdha fjalësh të përzgjedhura në mënyrën më të bukur nga ana e autorëve, siç kanë thënë edhe studiuesit e ndryshëm, janë të shumta, por përmbajtja e tyre është tërësia e asaj që poeti a prozatori ka perceptuar në jetën e përditshme.²

Kjo gjë nga ky autor, siç edhe do të dëshmohet me vargjet e ilustruara më poshtë, të cilat në thelb kanë misionin moralizues dhe thirrjen për veprim në të mirën kombëtare dëshmon se arti, shoqëruesi i kahershëm i njeriut, pavarësisht natyrës, llojeve dhe mesazhit që përçon te të tjerët dhe krijuesve të tij në kohëra të ndryshme, gjithnjë, siç edhe është pranuar, e mori, e merr dhe do të vazhdojë që ta marrë brumin krijues nga e përditshmja njerëzore.

Kjo gjë ashtu siç është dëshmuar edhe më parë në vepra të tjera artistike e studimore tregon se arti në një mënyrë a në një tjetër do të vazhdojë që edhe më tej ta bëjë të përafërt për të gjithë çdo tipar karakterizues për këtë përditshmëri njerëzore. Sepse, jo më kot edhe Shqipëria e ndodhur në një gjendje të padëshiruar në kohën kur krijoi poeti në fjalë, apo në gjendjen e saj të mëvonshme, u bë e pranuar nga të gjithë si element që hyri në art në vazhdimësi të ditëve, me preokupime të njëpasnjëshme, por gjithnjë e pamposhtur para fuqisë së huaj. Ja se si del kjo në vargjet e poetit:

*“Qindra vjete gjith në zi,
Qindra vjetësh i helmuar,
Po një vlerë pate ti,
Që s’ka shëmbëlle s’është dëgjuar;
Vala shkuan përmbi ty,
Kombe shkelnë pa mëshirë,*

²Austin Warren, Rene Wellek, (2015), Teoria e letërsisë, Onufri, Tiranë, f. 86.

Po një s'pati faq' e sy,
Të të shohë prej dheut fshirë”.³[sic!]

Do të thotë, mënyra se si autori në fjalë e bën kapërcimin e kollajshëm të viteve, ashtu siç edhe i kapërcen vargjet gjatë shprehjes së ndjenjave të brendshme, menjëherë nga vargjet e dhëna kuptohet se vëmendja e tij nuk ishte vetëm në atë se ç'peshë do të kishte ky kapërcim dhe si do të jepej para të tjerëve, por se sa në të do të ndihej fryma e pamposhtur e tokës së Shqipërisë. Këtë gjë Asdreni në përmbledhjen e tij poetike e sheh si virtytin më të lartë dhe si veprimin më të drejtë në raport me nevojat e anës tjetër, që në këtë rast mund të dilte çdo armik a dëmtues i saj, sepse Shqipëria, siç edhe tregohet nga historia dhe dokumentimi i gjërave të caktuara, për gjatë kohë u shoqërua dhe u ndikua nga faktorët e sapopërmendur.

Gjithë kjo gjë erdhi si nevojë e vazhdueshme që e përditshmja e përjetuar të dokumentohej dhe të sillej me natyrën e saj të vërtetë para të gjithëve me qëllimin kryesor që të bëheshin hapa të duhur për ndryshimin e saj. E kush më mirë se sa poeti në fjalë mund ta bënte këtë, sepse siç edhe tashmë është theksuar, ky i fundit edhe në kohë me trazira të njëpasnjëshme për popullin e tij, arriti që me anë të poezive të tij të njëpasnjëshme e me vargje bartëse në mes të dëshmonte se *‘për poetin fjala nuk është kryesisht një “shenjë”, një banak transparent, por një “simbol” i vlefshëm në dy anë - në vetvete dhe si përfaqësues, fjala mund të jetë madje një “objekt” ose një “send” i dashur për tingullin ose, pamjen që ka’*.⁴

Duke pasur parasysh faktin se periudha e Rilindjes Kombëtare Shqiptare e solli tokën Shqipëri në qendër të vëmendjes jo vetëm për të kaluarën dhe për çdo figurë kombëtare që ndihmoi në pasqyrimin e saj sa më të drejtë, për të duhet thënë se në të njëjtë kohë me vargje të lira dhe pa rregulla të shumta ndërtimi ajo u pa edhe në gjendje të shkretuar e të mrrolur. Këtë gjë e dëshmojnë edhe vargjet e mëposhtme, të cilat

³Asdreni, (2009), Jeta dhe vepra, Vatra, Shkup, f. 47.

⁴Austin Warren, Rene Wellek, (2015), Teoria e letërsisë, Onufri, Tiranë, f. 89.

të marra nga poezia e plotë e Asdrenit, përveç një vargu bartës që dëshmon për një element tërheqës dhe mjaft të harxhuar sidomos në periudhat e para të letërsisë sonë, tregojnë për një thirrje të vazhdueshme për ecjen e saj në kohë të drejtë:

*“Mos kij kujdes,
Mos trembesh kurrë,
Jij trime si qëmoti,
Se sot ti s’vdes,
Kur djal’ e burrë
Me armë del i zoti
E drejta sheshit do të dalë
Na thot’ e shenjta fjalë;
Përpara shko, përpara”!⁵ [sic!]*

Do të thotë, të dhëna në renditje të lehtë të fjalëve dhe me një dëshirë të brendshme që toka Shqipëri të mos ndihej e frikësuar në raport me gjërat që do t’i bënte e do t’i ndërmernte më vonë, ajo nga autori thirret që të ecë përpara duke e ditur se djemtë dhe burrat me armë në krahë do të vazhdonin t’ia mbronin shpinën. Dhe pas gjithë kësaj, duke besuar se e nesërmja e saj do të ishte më e ndritur siç edhe flasin vetë vargjet, autori edhe te lexuesi (qoftë ai i kohës së tij, apo ai i ditëve të sotme) lë një fije shprese se e vërteta e kësaj toke dhe e çdo veprimi jo të duhur që u bë mbi hapësirën e saj do të dilte në shesh dhe do të mësohej nga të gjithë.

Në këto vite të caktuara të cilat u munduan të sjellin gjëra që me origjinalitetin e tyre do të linin gjurmë për ndërtimin e një të ardhmeje më të mirë për Shqipërinë, e cila në secilën formë të paraqitjes së saj gjeti vend në vargjet e Asdrenit, krijuan njerëz të shumtë e të natyrave të ndryshme duke dëshmuar në këtë mënyrë, se vargu, pavarësisht se kujt do t’ia vinte theksin, se sa brenda tij do të kishte rregulla krijuese, sërish në një të ardhme do të agonte i lirshëm. Dhe kjo gjë nëse jo

⁵ Asdreni, (2009), Jeta dhe vepra, Vatra, Shkup, f. 48.

shumë në periudhën në fjalë, u dëshmuar në krijimet e periudhave të mëvonshme të letërsisë shqipe. Me këtë rast, duhet thënë se kjo gjë ashtu siç tashmë edhe dihet brenda asaj që përfshijnë kornizat e letërsisë sonë dëshmon se, *“kjo brezni poetësh i bëri me dije opinionit të lexuesve se një letërsi mund të përparojë e të zhvillojë seriozisht vetëm duke e vënë në funksion secili krijues prirjen dhe aftësinë e tij, intuitën dhe imagjinatën, ndjenjën dhe mendimin etj, sigurisht pa pranuar asnjë lloj nënshtrimi e imponimi të jashtëm”*.⁶

Vëmendja e veçantë dhe fuqia e penës së këtij krijuesi të njohur për letërsinë shqipe del sidomos në rastin kur për motiv tematik letrar e merr tokën Shqipëri në gjendjen e saj të tanishme, por gjithnjë duke e pasur në mendje të kaluarën e saj të bëshme, të cilën ajo edhe në vazhdimësi të ditëve do të duhej ta kishte shembull dhe element mbështetës në të ardhmen e saj. Sepse si kurrë më parë kjo tokë e vuajtur dhe e bërë ballë kundrejt fuqive të huaja e të njëpasnjëshme e që u përshkrua nga autori në mënyrën më të ndierë, erdhi si pasojë e veprimeve të dëmshme dhe jo të drejta, jo vetëm të fuqive të huaja, por edhe të vetë njerëzve të saj, nga ana e penës së poetit u thirr guximshëm me vargjet e mëposhtme:

*“Mos ki frikë, mos vajto,
Mos me kryet, trupin e zgjatur,
Tunde krahun u forco,
Dëfto namin që ke patur”!*⁷[sic!]

Do të thotë, “nami” i dikurshëm i kësaj toke e ndihmoi jo vetëm vargun e Asdrenit në kohën e krijimit të tij që ta sillte gjënë më të realizuar nga pena e tij, por në të njëjtën kohë ndihmoi që edhe vetë lexuesi i cilësdo kohë ta kuptonte se si natyra e saj e pamposhtur lidhej me atë që ajo kishte qenë dikur dhe me atë se në ç’rrugë kishte kaluar për të rënë në

⁶ Ahmet Selmani, (1996), Poezia dhe individualiteti, Flaka e vëllazërimit, Shkup, f. 20.

⁷ Asdreni, (2009), Jeta dhe vepra, Vatra, Shkup, f. 47.

gjendjen e kohës së tij.

Pjesa më e bukur e letërsisë sonë e cila brumin e ka nga natyra dhe fryma e letërsisë popullore, një letërsi kjo mjaft e pasur dhe e bollshme për nga tematikat, motivet dhe elementet e bukura letrare është dialogu i thjeshtë dhe lehtë i rrjedhshëm në mes krijuesit letrar, i cili në të shumtën e herës mëton që të fshihet prapa subjekteve lirike apo personazheve të karakterizuar në pika të përgjithshme dhe qenieve të bukura e të veçanta jofrymore (në të shumtën e herës dalin zërat e heshtur të zogjve të ndryshëm) të cilat me vetëdijen më të madhe duan ta lënë veprimin e mëvonshëm të asaj që synohet të paraqitet në suaza të një krijimi artistik-letrar. Kjo gjë paraqitet edhe në vargjet e lehta lirike dhe në mesin e strofave të penës së Asdrenit, roli i të cilit në shoqërinë e kohës nuk ishte vetëm dhënia e vargjeve mbi një tokë shqiptare që shkelej e lihej në mëshirë të fatit, por edhe vetë emancipimi i popullit mbi veprimet e tyre të mëvonshme.

Kjo gjë duke pasur parasysh se mund ta paraqesë dhe ta ndërtojë shpresën edhe nga largësia për një tokë që rridhte e lotonte dhimbje në vazhdimësi të ditëve, apo për një të ardhme më të mirë kombëtare, sipas bindjes së poetit në fjalë, i cili u mundua që në vargjet e tij Shqipëria të jepej në natyrën e saj reale, duhej që gjithnjë të lidhej me simbole të bukura dhe tërheqëse. Kjo duhej të bëhej jo vetëm duke u nisur nga nevoja dhe kërkesa individuale që t’i shtoej vlera edhe vetë krijimit letrar, por edhe nga nevojat e gjithë njerëzve të tjerë, të cilët në një mënyrë a në një tjetër do duhej të ishin faktorë ndihmues për ndërtimin e saj më të mirë.

Këtë gjë të sapopërmendur në mënyrën më të mirë e japin edhe vargjet e mëposhtme, të cilat të shkëputura natyrshëm nga poezia e plotë e Asdrenit, këtë dialog tërheqës dhe të arrirë letrar (me fjalë të përzgjedhura kundrejt zogjve të bukur) ndonëse me zë të njohur vetëm të njëjës palë, siç edhe shihet (që në këtë rast del vetëm zëri i subjektit lirik/vetë autorit) e japin më të bukurën për tokën Shqipëri. Ja se si del kjo gjë e ilustruar në vargje konkrete:

“O zoçka të bukura lart që fluturon!

*Ju qi të vrapuara erën e trazoni,
Thonimë vallë asaj udhe tek shkuat
Ndër malet e Shqipërisë nukë qëndruat?”⁸ [sic!]*

Kjo tokë e mbajtur gjallë me shpresën e paktë të mbetur në zemrat e shqiptarëve që për poetin në fjalë (dhe jo vetëm) ka peshën dhe vlerën më të madhe përkrah gjërave të tjera ekzistuese, në morinë e vargjeve të poezive të Asdrenit, ndonëse në shikim të parë nuk është se jep një përshkrim të theksuar për pamjen madhështore të jashtme, ajo nënkuptohet vetvetiu nga elementet dytësore të përdorura për ndërtimin e saj më të mirë. Me pyetje të njëpasnjëshme për gjelbërimin e brigjeve dhe zbukurimin e vazhdueshëm të maleve në tokën e Shqipërisë dhe në të njëjtën kohë edhe me pyetje mjaft të natyrshme për nga natyra e parashtrimit nëse nga lart ishin parë fushat, pyjet, lumenjtë dhe fshatrat shqiptare, ja si del kjo gjë në vargjet e mëposhtme lirike:

*“Vall’ i patë ata brigjet që gjelbërojnë
Edh, ata malet qi aq’ e zbukurojnë?
I patë ato fushat, pyllët dhe lumënjtë
Ato fshatrat si edhe njerëzit’ e shtrënjtë?”⁹ [sic!]*

Vargje të bukura nga krijimtaria letrare e Asdrenit dalin edhe të mëposhtmet, të cilat duke qenë të realizuara në mënyrën më të natyrshme rreth ndjenjave të brendshme dhe mallit të shtuar të poetit ndaj tokës Shqipëri, e japin dëshirën më të bukur që shpirti i tij në vazhdimësi të ishte i mbushur me gjërat jetike të atdheut. Të tillat, të lidhura gjithmonë me simbolin e bukurisë së jetës (zogjtë) në hapësirat shqiptare (dhe jo vetëm) ilustrohen si në mënyrën e dhënë më poshtë:

*“Ëmbël të ligjironi, zemrën të ma çmallni
Dëshirën të ma mbushni, shpirtin të ma ngjallni,*

⁸ Asdreni, (2009), Jeta dhe vepra, Vatra, Shkup, f. 50.

⁹ Po aty, f. 51.

*T'më çelni si prëndvera, qi çel trëndafilët
Edhe zë më jipni të këndojsi bilbilët!”¹⁰ [sic!]*

Në vargje të lehta dhe mjaft të bukura e të guximshme në të njëjtën kohë, poeti në fjalë duke u nisur nga nevoja e vazhdueshme që Shqipërinë ta jepte në formën më të mirë, në mënyrë që të ndikonte në ndërtimin e saj sa më të drejtë në vitet e mëvonshme dalin edhe vargjet e mëposhtme, të cilat siç edhe do të shihet duke e vënë theksin te njeriu që e tradhtonte atdheun me vetëdijen më të madhe, thotë se atij nuk do t'i mungonte epiteti i një tradhtari. Ja si del kjo:

*“Ay s'asht njeri me mënt
këtë duhet m'e çpor,
as me hy me 'të n'kuvënt
se ky asht tradhëtor”!¹¹ [sic!]*

Do të thotë, nga të gjitha vargjet e ilustruara më lart dhe nga çdo gjykim i vetëdijshëm që poeti në fjalë ia bëri tokës Shqipëri, duke e dhënë atë në paraqitje të ndryshme e të larmishme vargore, duhet pranuar fakti se poezitë e Asdrenit janë të një natyre ndryshe nga fryma e poezive të romantikëve shqiptarë. Në shumicën e tyre, siç flasin edhe vetë përmbledhjet e tij poetike shihet se ndihet një shpresë dhe dëshirë e vazhdueshme që toka Shqipëri të bëhej trime siç kishte qenë dikur, të kërkonte ndihmë nëse do ta kishte të nevojshme dhe pas durimeve/mundimeve të njëpasnjëshme ta priste një të ardhme më të mirë.

E shprehur me varg përsëritës në fillim të çdo strofe, poezia e Asdrenit, këtij poeti të talentuar të letrave shqipe, kushtuar Shqipërisë si tokë dhe si ëndërr, thërret në vazhdimësi që me kthimin e përhershëm në të kaluarën dhe në dëshmitë e Motit të Madh, ajo të rronte krenare para botës dhe para elementeve të cilat i shihte identifikuese. Ja se si thirret

¹⁰Asdreni, (2009), Jeta dhe vepra, Vatra, Shkup, f. 51.

¹¹ Po aty, f. 57.

kjo në vargjet ilustruese:

*“Shqipëri, o mëma jime
S’është kohë për mejtime
Ngjeshe pallën trimërisht,
Tunde krahun si qëmoti
Dëfto botës se do Zoti:
Të rrosh vetë shqiptarisht!”¹² [sic!]*

Literatura e shfrytëzuar:

- [1] Asdreni, (2009), Jeta dhe vepra, Vatra, Shkup;
[2] Selmani, A., (1996), Poezia dhe individualiteti, Flaka e vëllazërimit, Shkup;
[3] Warren, A., Wellek, R., (2015), Teoria e letërsisë, Onufri, Tiranë.

13

¹² Po aty, f. 62.

MUZIKALITETI I POEZIVE TË ASDRENIT

Pandi BELLO

Universiteti “Fan S. Noli” Korçë

pandibelo@yahoo.com

Poeti Aleksandër Stavre Drenova ngjante sikur vinte nga një botë krejt e veçantë nga ajo që njohin të gjithë. Ai kishte një shpirt shumë të lartë etik.

Ishte nga luftëtarët më të rëndësishëm të zgjimit kombëtar të shqiptarëve në fillim të shek. XX, indiferent ndaj shpërblimeve apo përfitimeve materiale.

Por, për shkak të mungesës së vëmendjes dhe të mirënjohjes të administratës të shtetit shqiptar iu desh të luftojë edhe me skamjen.

Idealist, me një pastërti morale të rrallë Asdreni, kur shkruante për poetin Naim Frashëri në vitin 1925, në botimin e poezive të tij nga studentët shqiptarë të Vienës, flet për “zgjimin e ndjenjave tona të ngurosur” dhe “një trompetë engjëlli që thërret së Larti dhe na thotë: “Kujtoni të parët tuaj dhe gjurmojini në idetë dhe porositë që ju patën lënë trashëgim, për të parë dritë e për ta gjetur udhën e vërtetë për lumturinë tuaj dhe për fatbardhësinë e Shqipërisë”. Këto fjalë të Asdrenit mund të luajnë një efekt me vlerë për shoqërinë shqiptare edhe në kohën e sotme.

Poezitë e Asdrenit dallohen për meditimin e lartë dhe lirizmin e thellë, ritmet dhe rimat e reja. Në botën e letrave është pohuar që në kohën e botimit të veprave të tij poetike : *Rreze dielli* (1904), *Endrra e lot* (1912), *Psallme murgu* (1930) se Asdreni i dha poezisë shqipe përmasat artistike që i mungonin më parë.

Asdreni shkruante poezi i frymëzuar nga dashuria e madhe për atdheun. Mirëpo ai shkroi edhe i nxitur nga dashuria që kishte për gjuhën dhe për zhvillimin e saj si dhe nga dashuria që kishte për artin.

Në parathënien e vëllimit *Rreze dielli* poeti shkruante: “Që të shkruash gjuhën shqipe s’është punë e rëndë, por s’është as aq e lehtë. S’është e rëndë se shqiptari e ka dashur kurdoherë gjuhën e tij...S’është e lehtë...më tepër për vjershat ku gjuha duhet të rrjedhë në mos si ar i kulluar fare, të paktën si argjend...”

Origjina e njëjtë e poezisë dhe e muzikës bazohet në organizimin harmonik të shprehjes artistike. Kështu rrjedh shqipja e Asdrenit me një tingull harmonik që buron nga intonacioni i zgjedhur i vargjeve, përsëritja plot shije estetike e zanoreve të njëjta në disa fjalë që pasojnë njëra-tjetrën, ritmi me rrahje nxitëse të balancuara dhe kadencat mbyllëse të pëlqyeshme.

Shkrimin e poezisë Asdreni e njehsonte me aktin e të kënduarit:

*Kur mallit zemra më lëndohet
prehje s’shijoj,
A prej një ngjarjeje më trishtohet
unë këndoj!*

Kështu fillon poezia me titull *Këndoj*, nga vëllimi *Endra e lotë*.

Në vargjet e Asdrenit këndon bilbili dhe zogjtë e tjerë, por edhe djemtë dhe vajzat. Edhe poezia kushtuar mikut të tij Hil Mosi mban titullin *Kënga e udhëtarit*. Shumë nga poezitë e Asdrenit janë si disa këngë malli që vertetojnë vlerën magjike e tingujve të gjuhës që përdor autori. Poet romantik, Asdreni, në vargjet që shkruante shihte shpirtin dhe dëgjonte zërin e vet, por ndiente tek ato edhe jehonën e tingullit të violinës, instrumentit muzikor me ndjeshmërinë më të lartë dhe më të afërt me shpirtin e njeriut, siç mund të shihet në poezinë *Vjershave të mia* nga vëllimi *Psallme murgu* :

*Ndër këngë dhembjes barin ia kam gjetur
Me ‘to trishtimin munda që ta shterr,
Qysh zëri i një violine tingull-fjetur
Çdo brengë si me dorë që ta mer*

...

Jo kurr’o vjersha s’kam për t’ju harruar

*Se jush ka dalë tingll-i zërit tem,
Dëshir’e zemrës sime dhembshuruar :
Ndër ju q’e le si peng kur të mos jem!*

Melodia dhe harmonia e brendshme e vargjeve iu japin poezive të poetit nga Drenova e Korçës një muzikalitet sugjestiv me origjinë nga vendlindja, i cili vibron në konsonancë me kulturën e tij artistike. Ky melodizm bart një etos me vlerë dhe zgjon ndjenja të lidhura me bukurinë e gjuhës dhe mund të frymëzojë mendime dhe ide edhe tek një lexues i apasionuar.

Disa nga poezitë e dy vëllimeve të para të poetit mbajnë titullin me ngarkesë dhe kuptim muzikor: *Tingëllimë*. Mes tyre ndodhet edhe poezia kushtuar pretendentit të fronit të Shqipërisë, në periudhën e Rilindjes Kombëtare, Aladro Kastrioti. Në këto tingëllima autori duket sikur i shoqëron vargjet e tij me lirën e Orfeut, por në poezi të tjera me këtë titull flitet për instrumente dhe për një melos të ndryshëm nga të parat:

*Në zë trumbetash,këngë muzikore
Këmbana mijë bukur rreth tingllonin,
Lart qiejtë llambarisnin,zjarr lëshonin
Verbim shkëlqimi : një çudi qiellore*

*Rradhë ëngjëjsh vargje dukeshin për dore
Me falje kryetarin adhuronin,
Kitara,himne veshët t’i depërtonin
Një udhë hapej,udhë madhështore*

Në poezinë *Fyelli* shkruar në “Kujtim të Dëshirës të pashuar të Naim Frashërit për Bagëtinë dhe Bujqësinë e Shqipërisë”, pra poema me këtë titull, Asdreni poetizon një instrument popullor të lashtë të shqiptarëve, por edhe të disa popujve të tjerë :

*O fyell, t'adhuroj me mall e besë
Se bashk' me zërin tënd hyjnor jam rritur*

Në këtë poezi autori përmend dhe poetin Virgilius (autori latin i epopesë në vargje *Eneida*) edhe kompozitorin klasik V. A. Mozart, por dhe poetët e kohës, të cilët i thurrën himne fyellit (dhe flautit):

*Se mbi të gjithë prap' ti plot forcë – trimi
Qëndron o fyell magjstar!*

Në poezinë *Fyelli i Minervas* muzika është gjuha e hyjnive :

*Minerva rij një ditë me fyell e këndonte
Me zë hyjnor si nj'ëngjëll plot mburrje hyjësore,
Junona dh' Afrodita, secila po dëgjonte
Këndimin aq të bukur e plot magji qiellore.*

Një instrument tjetër i lashtë në poezitë e Asdrenit është lahuta :

*Zani i ambël i lahutës
Kjo asht kanga e Malësisë
Porsi krisma e asaj hutës
Që ashtë kanga e trimënis*

Melodika e vargjeve të shkruara në dialektin geg dëshmon idealin e zjarhtë të poetit e lidhur me bashkimin kombëtar, por edhe aftësinë e tij për të shkruar me shije edhe në këtë formë të të shprehurit në gjuhën shqipe.

Ndërsa përdorimi i instrumentave arhetipalë si fyelli dhe lahuta zgjojnë lidhje të lashta me frymë popullore kombëtare.

Figurat mitike shqiptare, me simbolikën që i karakterizon, Asdreni i përmend në poezitë e tij jo vetëm në planin e përmbajtjes, por edhe si burime frymëzimi për aspektin muzikor të kësaj përmbajtjeje. Kështu vepron ai në poezinë *Kushtrimi i djalërisë*:

*Si lum ti moj Djalëri
Me plot hov e zjarr në gji,
Si lum ti moj Arbëri
Që rit bij me shpirt të ri!*

*Eja Zanë syqiellore,
Engjëll drite Perëndije,
Thirrja këngës madhështore
Me zë fryme Trimërije!*

...

*Ngreu moj Zanë këngëtare
Lart mbi qiell të Shqipërisë,
Thurr kurora shkëlqimtare
Për lavdimin e Trimërisë!*

Poezi si kjo ngjasin me ato *Këngë Lirie* ku zanat kanë një mision të spikatur kombëtar:

*O zana të perëndishme,
Që këndon trimëritë
Dhe lumtësin' e njerëzis',
Shqipërisë së tanishme
Jepini edhe saj dritë
Të shohë rrezet e liris'.*

Përveç të kënduarit dhe instrumentave muzikorë tema të tjera si natyra, ëndërimi, nostalgjia, vetmia, trishtimi, dashuria etj, janë për Asdrenin subjekte ku jo vetëm tingëllimi në përgjithësi por edhe muzikalizmi mishërohet në thellësi të vargjeve, duke shprehur në një formë të pasur auditive thellësinë e përjetimeve të unit poetik. Është fjala kryesisht për poezi lirike të cilat në periudhën antike karakterizoheshin nga ritmi dhe muzikaliteti i lirës.

Në poezinë *Vaje e pyllit* e ndërtuar me vargje shtatë rrokëshe dhe me rima konsonante rrjedh një melodi në tonalitet minor:

Pyll i mjerë ç'ke që qan

*Prej krahrorit që ngulçon,
Mos do shokve zi u mban
Që po dridhesh e gjëmon?*

Në poezinë *Dëshirë* tiparet fonetike të zanoreve, sidomos timbri i zanores O dhe rima asonante frymëzojnë mes vargjeve akustikën e një jehone:

*Fry,moj erë,
e mos pusho,
Kurr' ndonj' herë
Mos më harro.*

Në shumicën e poezive të Asdrenit harmonia muzikore e vargjeve është arritur nga vendosja e zanoreve në një pozicion të përshtatshëm edhe nga pikëpamja kuptimore edhe nga aspekti i theksit akustik. Kjo mund të shihet edhe në poezinë *Zonjës Edith Durham* :

*Një komb i tërë o Zonjës të falet
Një komb i tërë nder Ty sot të sjell,
Prej mirënjohje zemra nuk i ndalet
Por lutje ngre me lot për Ty në qiell.*

Në poezinë *Fuqia e dashurisë* muzikaliteti është arritur kryesisht me anë të përsëritjes së formave identike të të shprehurit në fillim të çdo strofe dhe të rimës eufonike :

*Kur era fryn me ëmbëlsi
...
Kur dielli ndrit me ngrohtësi
...
Kur hënëza me mfshehtësi
...
Kur rretë janë në gjënim
...
Kur deti zjen me duhi*

...
Po kur krahët m’i zgjat ti

...
Melodia e brendshme e vargjeve dhe kadencat e qeta janë elemente bazë të stilit muzikor të poezive të Asdrenit. Kjo metodë bën që në poezitë me një zhvillim më të madh vargjet të rrjedhin si disa fraza muzikore. Karakteristika të tilla mund të vihen re edhe në poezitë: *Vlorës, Lulja e zemrës, Lulja e këputur dhe Excelsior* nga vëllimi *Psallme murgu*.

Fjala latine excelsior (ë gjitha ato më të lartat) në poezinë simboliste u përdor si titull. Kështu bën edhe Asdreni me poezinë *Excelsior* kushtuar poetit Lasgush Poradeci:

*Sa herë s’jam menduar krejt pendën që ta thyej
Më mos e marr në dorë,në lot më mos e ngjyjej.
Dhe mallit tim të shkretë,vend larg t’i bëj të vejë
Si prej një hijes keqe të fshihem mos më gjejë.
Tej dua ta hedh pendën,llahuta zë mos nxjerrë
Dhe kënga-e mallëngjimit në shpirt helm më mos shtjerrë*

...
*Larg,larg prej çdo skëtere,çdo andje të përlyeme.
Dhe veç aty ndër hire,në drit’i lar’i lyer
Aty në gji t’Empirit,të këndit më të vlyer
Ta gjej gjithmonë prehjen,një Gaz të kem,një Jetë :
Tej Lart në më të Lartat,te Drita e Vërtetë!*

Në vargje të tilla konstatojmë solemnitetin festiv poetik dhe muzikor të Asdrenit.Kështu kalon ai si një hero, midis poetëve më të mëdhenj kombëtarë. Kështu mund të përjetohet edhe oda e tij *Gjuha shqipe*:

*Si Zonjë-e madhe mbaju kryenaltë
Bëj të gjëmojë zëri-i yt hyjnor,
Ndër vepra fryme mëndje më së naltë
T’ja thonë Zanat këngës mbi Tomor*

Mitrush Kuteli, në Vepra letrare 5, në faqen 169 shkruante: “Shqipja e Asdrenit është shqipja e lashtë, plot energji dhe me tingull të zgjedhur”. Ky poet solli tonalitete dhe akorde të reja në poezinë shqipe. Universi akustik i poezisë së tij shtrihet në një hapësirë të madhe, e cila nis nga monodia e heroit lirik deri tek polifonia pastorale e zërave të natyrës dhe kumbimet e forta të vargjeve me theks patriotik. Ky univers i pasur ka rëndësi sepse siç theksonte Tudor Vianu në veprën e tij Estetika (Editura Orizonturi, Bucuresti, faqe 91): “Një poezi lirike jeton jo vetëm përmes fondit të saj të vlerave dhe përmes unitetit të saj estetik, por edhe përmes strukturës tingëlluese të gjuhës në të cilën është shkruar”.

Ndër poezitë e Asdrenit janë edhe mjaft prej tyre që janë konceptuar për t’u kënduar. I pari autor që vuri në nota muzikore vargjet e poetit ishte kompozitori i lindur në Dardhë të Korçës, njëherësh dirigjent i Bandës Kombëtare “Vatra”, të cilën ai e drejtoi në koncerte të shumta në Worcester të Shteteve të Bashkuara, pastaj në Korçë dhe Tiranë, pra Thoma Nasi. Në vitin 1927 Thoma Nasi botoi në Orleans Mass këngën e kompozuar prej tij në Korçë mbi poezinë e Asdrenit *O moj ti me sytë e zinj*, në formën e një romance me frymëzim romantik. Prej gati 100 vitesh kjo këngë dëgjohet në Korçë dhe në gjithë vendin e interpretuar nga kori shekullor “Lyra”.

Me të njëjtin tekst poetik kompozitori kosovar Reshat Randobrava paraqiti nën interpretimin e këngëtarit Sabri Fejzullahu në festivalin “Akordet e Kosovës”, rreth viteve 1980 variantin e tij muzikor lirik-dinamik. Vargjet e Asdrenit e frymëzuan shpesh këtë kompozitor. Ai vuri në muzikë edhe poezi të tjera të poetit si : *Mos kërko, Dashuro, Fli më nge, Dallëndyshe, Drithma dashurie, Fuqia e dashurisë*, etj., që u kënduan nga këngëtarët e njohur të Kosovës siç ishin Nexhmije Pagarusha, Bashkim Paçuku, Sabri Fejzullahu, Edmond Islami, Fatmir Bajraktari dhe të tjerë.

Një ndër poezitë – këngë të Asdrenit është ajo me titull *Të pi*. Poeti e ka botuar atë në vëllimin *Endra e lotë*. Fati i këngës ka qenë i veçantë. Për shkak të impulseve vetiake të tipit dionisiak që rrjedhin përgjatë

vargjeve shumë të përshtatshme për t’u muzikuar, por edhe të melodisë plot ndjenjë lirike, kënga është mjaft e popullarizur dhe këndohet shpesh me emërtimin *Haj verëshitës*, sipas vargut të parë të tekstit letrar. Por, kjo këngë nuk është një këngë qytetare e Shqipërisë, siç komentohet shpesh. Autori i saj është kompozitori Gjergj Kaçinari nga Kosova (1939-2019) dhe kënga u paraqit për herë të parë e kënduar nga Vera Oruçi rreth viteve 1980.

Po ashtu, me tekst të Asdrenit, kompozitori Josif Minga, me rastin e 150-vjetorit të lindjes të poetit krijoi këngën *Këndomë çun*.

Në shkrimin mbi veprën e gjerë të poetit, të botuar më 23 qershor 1932, në gazetën *Shqipëria e Re*, që dilte në Konstanca të Rumanisë, shkrimtari Mitrush Kuteli e quante Asdrenin “Këngëtori dhe Luftëtari i Rilindjes Kombëtare”.

Veprimet e Asdrenit si luftëtar për gjuhën amëtare dhe përpjekjet e tij për arritjen e Pavarësisë së vendit kanë një përmbajtje dhe zgjojnë një pamje monumentale. Ato do të nderohen gjithmonë nga shqiptarët. Për gjithëçfarë ka bërë për atdheun, poeti ka merituar së paku një monument të denjë. Megjithatë monumenti i vërtetë dhe i plotë i poetit romantik kombëtar dhe Rilindasit të madh Aleksandër Stavre Drenova, pra Asdrenit, mbetet zëri kumbues i poezive të tij.

Ne besojmë se muzika e vargjeve të poezive të tij do t’i frymëzojë edhe më tej admiruesit e poezisë, si dhe kompozitorët shqiptarë.

ASDRENI – PROFETI I ATDHEDASHURISË NË VARGJE

Daniela STOICA
Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë
Arjan KALLÇO

Abstrakt: Artikulli *Asdreni- profeti i atdhedashurisë në vargje* është rezultati i bashkëpunimit të dy studiuesve në fushën e letërsisë, njëri rumun dhe tjetri shqiptar, të cilët, duke u mbështetur mbi veprat kryesore poetike të Asdrenit, por edhe mbi studime, analiza letrare, dokumentare dhe burime të tjera dytësore mbi jetën dhe veprën e Asdrenit, kanë analizuar ndjenjen e atdhedashurisë në veprën e poetit, autor edhe të vjershave të himnit kombëtar shqiptar. Për më shumë, duke marrë parasysh se Asdreni ka jetuar pjesën më të madhe të jetës së tij në Rumani, artikulli synon të nxjerrë në pah në pjesën e tij të fundit edhe ndikimin e letërsisë rumune, asaj tradicionale, por edhe asaj bashkëkohore mbi veprën e tij, pikërisht ndikimin e dy poetëve të mëdhenj rumunë, Vasile Aleksandri dhe Mihai Eminesku.

Fjale kyçe: *atdhedashuri, himni kombëtar, Asdreni, Eminesku, Aleksandri*

Hyrje

Në historinë e një vendi disa ngjarje mbetën në memorien e tij si ngjarjet që ia hapën rrugën drejt lirisë dhe progresit. Ndonjëherë edhe pse me vonesë, për shkaqe që shpesh nuk lidhën me kushte të brendshme, përsëri janë ngjarje që duhet të jenë gjithmonë në kujtesën e një kombi. Kur bëhet fjalë për Shqipërinë që dy shekuj më parë dhe në shekullin e kaluar, kontributet e figurave të shquara kombëtare janë guri themeltar në këtë rrugëtim. Nëse do të nisim mendimin tonë historik që nga Rilindja Kombëtare, midis shumë figurave, emri i Asdrenit në plejadën e atyre me kontribute të paçmuara për atdheun është i lidhur me njërin prej simboleve që i dallojnë kombet. Ai është himni kombëtar që për nga kushtet dhe vendi ku lindi flet për marrëdhëniet e jashtezakonshme të ndihmës dhe përkrahjes ndaj vendit tonë, djepi, ku shqiptaria kristalizoi idealet e saj kombëtare. Natyrisht që jeta në Rumani, njohja më gjithë letersinë dhe kulturën rumune janë faktor themelor në formimin e tij. Rexhep Qosja shkruan: “...ka luajtur rolin vendimtar në formimin e shijes, në formimin e ndjeshmërisë poetike, në orientimin e interesimit dhe në ndertimin shpirtëror të Asdrenit si krijues...” (Qosja 2002: 18).

Emrat e poetëve të mëdhenj rumunë Aleksandriu, Eminesku e shumë të tjerë janë dëshmia më e qarte. Himni ynë kombëtar në ngjizje, “Betimi mbi flamur” (1907), mbart gjurmën e vargjeve dhe muzikalitetin e një kulture ku shumë mirë gërshetohej në retroskenë trashëgimia jonë dhe lidhjet e fuqishme të shqiptarëve në vendin që në atë kohë ishte atdheu i tyre i dytë. Kur lindi dhe pse lindi, besojmë se çdo shqiptar që e ka në zemër atdheun, e kupton shumë qartë dhe përgjigjia është ajo e vetmja dhe e kuptueshme: lindi nga nevoja për të rilindur, për tu ringritur, për tu bërë të denjë dhe të barabartë me të gjitha kombet e tjera europiane, pas gati shekuj të errët të pushtimit otoman. Ne sot, gati pas mbi një shekull, mund të kthejmë vëmendjen tonë te simboli ynë, mund të shprehim opinione rreth kohës dhe rrethanave që çuan te krijimi i himnit, por kurrë nuk do të mundim të kuptojmë realisht dhe të imagjinojmë lindjen e tij, pasi nuk kemi qënë pjesë e asaj kohe që siç thuhet për Rilindjen europiane, kërkonte titane dhe të tillë gjeti. Në morinë e shkrimeve dhe studimeve rreth himnit ka mendime të ndryshme, që për studiuesit është liria e interpretimit të fakteve. Sot është momenti i një reinterpretimi të gjithë histories, le ta pranojmë këtë ide pas kaq kohësh.

Por fatmiresisht kemi deshmët e dy figurave të medha të letersisë sone që na dhanë me një vërtetësi të pakundershtueshme sesi lindi dhe sesi u perçua ndër shqiptarë himni ynë. “Të dy u mbrujtën atje me zjarrin e tyre të shenjtë të shqiptarizmit, njihnin frymë për frymë tërë atë grusht burrash që bënë historinë e madhe, ishin miq të ngushtë e bij në shpirt të Asdrenit.” – theksojnë dy regjizoret e dokumentarit për lindjen e flamurit¹. Me te drejte mund ta quajme Kenga e kengeve, apo Kryekenga që në momente kyçe të historisë sonë i ka ngritur peshe zemrat e shqiptarëve edhe në endrren e madhe për bashkim kombëtar.

Rrugëtimi i himnit. Jehone nëpër vite në letërsi dhe në muzikë

Lasgushi ndoshta është më i besueshmi me punimin e tij "Himni Kombëtar - Flamurit pranë të bashkuar dhe gjeneza e tij" (1999). Pra, Poeti i liqenit u bë bartësi i shënjtërisë kombëtare, rrëfyesi i krenarisë sonë, i asaj që edhe pas kaq kohësh i mbledh bashkë shqiptarët. Një

¹ Dokumentari i Top Channel Albania, *Vlorajt e Flamurit* (2019), <https://www.youtube.com/watch?v=2rqmW0JFr7s>

këngë që në ato kohe nuk mendohej se të nesërmen e agimit të madh do të bëhej trupi dhe shpirti ynë.

Një grup shqiptarësh dhe një muzikant i famshëm, me emrin Kiriak, i thote aty për aty shprehimisht Asdrenit: *"Ti je poet, bëj një strofë shqip që ta harmonizoj për korin dhe ta këndojmë"*. Poetit iu desh vetëm pak kohe që të thurte me mjeshtëri fjalet dhe vargjet e **"Rreth flamurit të përbashkuar"**. Fjalë që ishin kushtim me jehone të qartë, largpamëse dhe të patjetërsueshme në vazhdimësi e përpjekjeve tona për liri dhe pavarësi. Ashtu si vetë flamuri edhe himni për shqiptarët u bë banë e nënë, frymë dhe endërr e madhe. Dinjitet dhe besim.

"Himni i Flamurit u lind në Bukuresht. U lind jo si himn po si këngë. Vetë populli shqipëtar e njoftoi më vonë për himn. Pa ditur qysh, në një kohë të shkurtër, kënga e bërë vetëm për anëtarët e "Bashkimit" u përhap në gjithë Kolloninë e Bukureshtit. Disa të rinj që vajtmë në Korçë e shpumë dhe atje" ... "Ata ishin ca djem që e çuan deri në atdhe. Ca djem që kishin bërë shkollën e shqiptarizmit në Kolloninë e Bukureshtit" – shkruan bashkëkombasi i tij, Mitrush Kuteli².

Çajupi është shprehur me këto fjale entuziaste: "Tani besoj se Naim beu nuk vdiq, se vendin që la ai bosh e zure ti".³

I takoi Korçës dhe korçarëve merita e madhe që në pak kohë mori udhën dhe u përhap në gjithë Shqipërinë. Është rasti i dytë që qyteti i shkollës shqipe bëhet djepi me peshën më të madhe në kulturën tonë. Më 1943, i bindur se historinë e Himnit, këtë thesar të paçmuar të Kombit duhet t'ua linte deri në detaje shqiptarëve, ai ulet e shkruan dhe po këtë vit e botoi në 14 numra të fletores "Tomorri". Shkrimi titullohet "Himni Kombëtar 'flamurit pranë të bashkuar' dhe gjeneza e tij."

Të dy shkrimtarët e mëdhenj e shkruajnë fjalën Koloni me ll- ë të fortë, a thua se duan të mos e humbasin fuqinë e fjalën "kollonë", që të kujton gurin...

Sipas Profesor Ramadan Sokolit *"burimi i motivit të këtij himni, mund të gjendet shumë më larg, ndër disa balada kalorsiake të hershme, ndër disa këngë të punës si dhe ndër disa këngë patriotike gjermane. Mund ta gjesh gjithashtu në disa këngë punëtorësh të traditës çekosllavake. Një motiv i huaj mund të shfrytëzohet me dashje, por mund të ndodhë e anasjella. Të kujtosh se ke krijuar diçka të re."* (Sokoli 1985: 23)

² Historia e plotë e himnit shqiptar nga lindja deri sot, <https://tricolor.al/histori/historia-e-plote-e-himnit-shqiptar-nga-lindja-deri-sot-14/>.

³ Asdreni, <https://www.shqiperia.com/kategori/kat/knr/265/Asdreni>.

Ndërsa prof. Vaso Tole shkruan se “edhe kompozitori i shquar bashkëkohor George Ligetti e konstaton me të drejtë ngarkesën edhe origjinën internacio të parakrijimit të Himnit Shqiptar të Flamurit. Pohimi i kësaj të dhëne është me rëndësi jo vetëm për faktin se krijimi i himnit tonë në pikëpamje muzikore ishte drejtuar për nga orientimit të përgjithshëm perëndimor, por dhe se në këtë mënyrë nuk ka arsye që ende të citohet Porumbescu si krijues i tij.” (Tole 2016: 38)

Për krijimin e Himnit poeti u mbështet në fjalët e këngës së Bârsanut, por përshtatja është më tepër origjinale dhe me plot gojë mund ta quajmë krijim tërësisht të tij. Kur dy krijime kanë të njëjtin motiv, nuk mund të ndodhë që të jenë kurrë të ngjashëm, ashtu si nuk janë të tilla të dyja gjuhët dhe kulturat. Analiza e strofave na bën të kuptojmë se vargjet tingëllojnë shqip, ashtu si dhe pasardhësi i tij Noli me versionet e veta të shqipërimeve. Pra e tejkalojnë origjinalin nga ku është mbështetur për ta krijuar. Në strofën e fundit të himnit rumun kemi një largim nga koncepti i përjetësisë, thotë “shumë kombet do të humbasin”, Asdreni vë në gojen e vetë Zotit i cili pohon dhe deklaron se “Shqipëria do të rrojë”.

Një krahasim tjetër është i dukshëm dhe në fjalet që të dy autorët kanë në vargjet e tyre. Ja disa nga fjalët që tingëllojnë bukur në himnin tonë: *atdhe dhe tradhtor, burrë dhe dëshmor, shpëtim dhe armë, Zot dhe armik, theror dhe shenjtor, besë dhe trim.*

Sipas Lasgushit në punimin e vet ai thotë: “Siç shihet, tërë shpirti, ritmi dhe muzikaliteti i gjuhës janë të tilla sa e bëjnë këtë këngë etnikisht krejt të pastër”.

Duket se himni ynë ka një natyrë tepër origjinale. Nëse kqyrim me kujdes disa prej himneve kombëtare, do shohim se ka një dallim tjetër thelbësor: himni ynë kombëtar i kushtohet tërësisht një simboli tjetër kombëtar, flamurit kuq e zi dhe më pas në një linjë së bashku si pikë referimi është Atdheu.

Himne të tjerë kanë si themel figura të lavdishme të kohëve, apo referime zotash e personazhesh kuq në historinë e një vendi. P.sh ai Italian: *vëllezër të Italisë/ Italia u zgjua/ në helmetën e Shipios /e lidhi kokën... Shipione është ushtaraku romak që triumfoi mbi Anibalin... Te himni francez, permendet flamuri, por flamuri është i pergjakur: Ngrihuni bij te atdheut/ dita e lavdise mberriti/ kunder nesh flamuri i pergjakur i tiranise u ngrit...*

Së fundi edhe poeti i Mjerimit, Migjeni shkroi një poezi me titull

“Kënga qe s’kuptohet”, me referime të qarta për “Këngën e Kombit”. Të gjitha këto janë kontribute, ashtu si shumë shkrime të tjera, janë dëshmi të padiskutueshme lidhur me historinë dhe rrugëtimin, një lloj kronologjie besnike e himnit tonë. Himni “Rreth flamurit te përbashkuar” është pranuar si himn kombëtar i Shqipërisë në vitin 1912, fjalët e himnit janë shkruar nga Asdreni, muzika e himnit është kompozuar nga Ciprian Porumbescu.

Duam të ndalemi pak këtu te debatet e shumta që lindën pas viteve ’90 për të ndryshuar gjithçka që historia jone, me mund e sakrifica, kishte krijuar. Këtij debati nuk i shpëtoi dhe himni. Jemi të mendimit se asnjë këngë tjetër nuk do të kishte kaq forcë dhe fuqi, sesa himni i shkruar nga Asdreni, edhe pse autorë të tjerë të mëdhenj, si Noli me poezinë “Himni i flamurit”, janë përpjekur të sjellin versione himnesh. Himni është në vendin e vet dhe në përjetësi. Fati i tij nuk mund të ndryshohet.

Asdreni dhe letërsia rumune

Asdreni dhe Vasile Aleksandri

Duke jetuar pjesën më të madhe të jetës së tij në Rumani, siç përmendëm edhe më lart, natyrisht krijimtaria e Asdrenit u ndikua nga letërsia rumune, ajo tradicionale, por edhe ajo bashkëkohore. Ndikimi i letërsisë rumune, në veçanti i poezisë rumune romantike dhe postromantike në krijimtarinë poetike të Asdreni, konsiderohet si një hap cilësor dhe i rëndësishëm edhe në historinë e poezisë shqipe (R. Qosja 1987, L. Topciu 2021). Asdreni nuk mund të ishte i shkëputur nga zhvillimet sociale, politike dhe kulturore të Rumanisë, shtet i cili, nga pikëpamja historike, kaloi evenimente të ngjashme me ato të Shqipërisë.

Ndikimi i poezisë rumune romantike dhe pasromantike ndihet në dy aspekte kryesore, në atë të mjeshtërisë artistike dhe në atë të tematikës. Në shpirt të pastër romantik, Asdreni do të trajtojë tema të çështjes kombëtare, tema politike, shoqërore, morale, tematikë e cila koincidon me problemet në vendin e tij.

Në poezitë e fillimit të karrierës të Asdrenit shfaqen elementet e një romantizmi kombëtar, i cili konsiderohet nga kritikët letrar një ndikim i qartë të poetit dhe dramaturgut rumun Vasile Aleksandri. Si shembull sillen zakonisht nga kritika letrare poezia *Kënga e bashkimit* (Cantecul Unirii) nga vëllimi *Ëndrra e lotë* (Vise și lacrimi, 1912). Megjithatë,

Asdreni ndikohet fuqishëm edhe nga ndjenja nacionaliste që përshkon poezinë patriotike të Aleksandriut. Kur poeti i sjell lavdërime fshatarit, kur shkon të mbledhë folklor, poeti shfaqet më pak si poet romantik, por më së shumti si poet nacionalist. Për të dy poetët, fshati dhe fshatrët janë ruajtësit dhe përfaqësuesit e thelbit të popullit që ata përfaqësojnë, përkatësisht rumun dhe shqiptar. Në vizionin e këtyre poetëve, fshatari nuk i braktis kurrë zakonet, gjuhën, kostumin e tij popullor karakteristik. Për më tepër, ata nuk ngurrojnë të flasin secili për popullin e tij – përkatësisht për fshatarësinë - si një popull “i destinuar të ngjitet sa më lart”, të bëjnë deklarata dashurie për këtë popull, i cili, sipas Aleksandriut, është “i pastër, i urtë, gazmor dhe poetik në fjalet e tij” dhe edukata e të cilit është e thellë, imagjinata, shpirti satirik, zemra e mirë e tij shihen në fjalët e urta, poezitë, zakonet.” “Unë”, thotë Aleksandriu shkëlqyeshëm, “sa herë që dëgjoj doina, më duket se dëgjoj Moldavinë duke qarë për lavdinë e saj të vjetër”

Kritiku letrar Arshi Pipa (2014) vëren idilizmin e Asdrenit në paraqitjen e jetës fshatare, ka fjalë simpatie për bujqrit mëditës dhe rajatë sa herë që i bie rasti t'i përmendë ndër vjershat e tij. Në poezinë e Asdrenit ka një farë racionalizmi që në vjershat më të mira mënjanohet nga shpërthimi i ndjenjës ose vështrimi i realitetit nëpërmjet prizmit të humorit të shëndetshëm fshatarak. Lirika e tij e dashurisë trajton tema të ndryshme dhe dallohet nga konkretësia, çiltërsia, thjeshtësia, nga një lirizëm i ngrohtë që shkrihet herë-herë me një humor të lehtë. Asdreni shkruan edhe balada me subjekt me këngë dashurore që u përhapën në popull. Stili i tij i thjeshtë, direkt është i kuptueshëm dhe i kapshëm nga populli.

Asdreni, si Vasile Aleksandri, mori pjesë aktive në ngjarjet e kohës, të cilat i pasqyroi në krijimet e tij. Siç e dimë, ai u bë një nga intelektualët më aktivë të lëvizjes rilindase shqiptare. Aleksandri ishte një poet militant (që luftoi intensivisht për një parim, për një kauzë), duke shprehur në vargje patriotike idealet e Revolucionit të 1848 dhe të Bashkimit të 1859, përmes krijimeve si *Deșteptarea României* (Zgjimi i Rumanisë) dhe *Hora Unirii*. Një patriot i flaktë, Aleksandri mori pjesë në festën e organizuar në Putna në gusht 1871, me rastin e 400 vjetorit të ndërtimit të manastirit të Putnës, një ngjarje kushtuar kujtimit të sundimtarit Ștefan cel Mare, i cili ishte edhe themeluesi i këtij vendi të shenjtë. Për këtë festë, Vasile Aleksandri shkruan një himn kushtuar personalitetit të madh historik të Moldavisë, sundimtarit Ștefan cel

Mare.

Në vitin 1904, Asdreni botoi në Bukuresht vëllimin *Rreze dielli* të cilin ia kushton Skënderbeut, figurës historike shqiptare të ngjashme me atë të Stefan cel Mare, duke ngritur lart, si Aleksandriu, dashurinë për atdheun, duke nxitur bashkëatdhetarët në luftën për çlirim nga Perandoria Osmane. Nuk mund të mos përmendim këtu si shembull poezinë *Vojsava* dhe vargjet e cituar shumë shpesh:

- O Gjergj i-em i vogël, o bir pleqërije
Prej mallit e gjallë në dhët do të kallem,
Bir, eja në gjirin e mëmës të çmallem
O lule nër lulet, o hyll Shqipërije

Aleksandriu, si Asdreni, mbeti në kujtesën e atyre që e njihnin si një optimist i madh, plot energji pozitive, të cilën ai ua frymëzoi të tjerëve, duke i nxitur për vepra të mëdha apo duke i përjetësuar këto vepra madhështore, kujtimi i të cilëve përndryshe do të ishte zbehur me kalimin e viteve (Bashkimi i Valahisë me Moldavinë nga 1859, Pavarësia nga Perandoria Osmane nga 1877).

Asdreni dhe Mihai Eminescu

Një tjetër ndikim përse i përket shprehjes artistike të atdhedashurisë të Asdreni mund të konsiderohet se vjen nga poeti i madh rumun Mihai Eminescu. Eminescu përfaqësoi dhe ende përfaqëson një simbol qendror kombëtar për popullin rumun. Po aq klasik dhe modern, gazetar dhe poet, ai është një pikë referimi për mendimin rumun. Eminescu ushtron një magjepsje dhe një tërheqje të përhershme për poetët shqiptarë si Asdreni, Lasgush Poradeci dhe për shumë të tjerë. Edhe pse perceptohet më pak nga publiku në cilësinë e gazetarit, ai është ende një model për gazetarët rumunë. Nëse dikur shkrimet e tij, në veçanti ato të botuar në gazetën *Timpul* (Koha) filozofia e tij social-politike zgjoi vetëm një interes të vogël, aktualisht publiku e kupton se ideologjitë politike, konceptet socio-politike ose jeta politike e qytetit dhe shtetit përcakton në një masë të madhe edhe jetën e tyre personale. Mirëpo atdhedashuria e poetit evidentohet shumë mirë edhe në lirikën e tij: *Ce-ți doresc eu ție, dulce Românie* (Çfarë të uroj unë ty, o Rumani e ëmbël) ose *La arme* (Në armë) janë vetëm dy nga poezitë me një temë padyshim patriotike, të cilat ai i boton midis viteve 1866 dhe 1870.

Patriotizmi i tij nuk ishte për t'u treguar, thonë biografët. Vargjet patriotike kanë korrespondencën e tyre në ndjenjat më të thella të poetit.

Patriotizmi ka qenë gjithmonë një ndjenjë karakteristike e Mihai Emineskut, siç mund të shihet nga biografitë e shkruara nga George Călinescu (1932) ose nga ish-shoku i tij i shkollës Theodor Ștefanelli (1914). Ai rrezikoi gjithçka për këtë ndjenjë dhe mbi të gjitha nuk heshti kur ishte fjala për popullin rumun. Rrezikoi jetën e tij si gazetar në *Timpul* kur vetë P.P. Carp (Petru Pe Karp), kryeministri liberal i asaj kohe, kërkoi me këmbëngullje “Hiqni qafe Eminesk-un!”, sepse poeti kritikonte me shumë ashpërsi në artikuj qeverinë liberale, të cilën e konsideronte kundër interesave kombëtare. Ai kishte rrezikuar lirinë e tij edhe gjatë studimeve në Vjenë, kur u arrestua pas një fjalimi të zjarhtë. Biografët e cilësojnë atë si një atdhetar “praktikant” në jetën e përditshme, pa u kujdesur nëse ofendonte apo kë ofendonte, kur mbronte popullin e tij. Në të njëjtën kohë, Eminesku konsiderohej një vizionar i kombit, duke ëndërruar për bashkimin e plotë të të gjitha krahinave rumune.

Asdreni ka meritë të veçantë për thellësinë me të cilën ka nxjerrë në pah problematikën shoqërore që lëvron në poezinë e tij: ai pasqyron konfliktin ndërmjet shtresave të larta dhe popullit, duke e parë këtë të fundit si forcë lëvizëse të historisë. Problematika shoqërore i frymëzon Asdrenit vjersha tepër të fuqishme si *Zëri i kryengritësve* (1912) *Çpërblimi* ku ballafaqohen klasat kundërshtare në një varg dinamik e një ton të ashpër. Edhe në këto vjersha ka retorikë, por ajo tretet në dufin e fuqishëm të revoltës. Te *Burri i dheut*, duke i kënduar Luftës së Vlorës, Asdreni thekson karakterin popullor të saj dhe krijon një portret kolektiv të popullit të shfrytëzuar.

Ai vazhdon të shkruajë lirikë atdhetare e pas Shpalljes së Pavarsisë. Në poezinë *Në mërgim*, ku atdhedashuria shprehet me thjeshtësi dhe spontaneitet, ai prek temën e dhimbshme të mërgimit dhe e dënon atë si shkaputje të burimeve dhe forcave më të mira njerëzore nga atdheu, duke fajtuar ata që harrojnë vendin e tyre:

*Me sa mall e sa dëshirë
Atë ditë po e pres,
që edhe unë atje i lirë
pranë prindërve të vdes!*

Më vonë, më 1935 Asdreni do të shkruajë një vjershë po aq të fuqishme. *Trashëgimi*, që jep një imazh tronditës të gjendjes së mjeruar politike, ekonomike, shoqërore e kulturore të Shqipërisë në kohën e Zogut. Një frymë satirike shumë e ashpër përshkon vjershat *Fisnikët e Shqipërisë* dhe *Republika Shqiptare*.

Ndikimi i Emineskut të Asdreni, sipas prof. Vehbi Balës, duket në poezinë atdhetare, sociale dhe në poezinë e natyrës. Ndikim nga Eminesku ka pasur dhe në vjershat e vëllimeve të para të Asdrenit, si vjersha *Epigon*, që është imitim i vjershës me të njëjtin titull të Emineskut *Epigonii* si dhe poezia *Dëshira ime* që është një parafrazë e vjershës së tij *Mai am un singur dor* (“Kam një të vetmin mall”). Sipas studiueses J. Spaho (2013), nëse i referohemi vëllimit *Psallme murgu*, vjersha që është ndikuar e shkruar nën frymën emineskiane është ajo me titull *Venetiku*, që qëndron pothuaj në të njëjtin nivel me vjershën *Veneția* të Emineskut. Ashtu si Eminesku edhe Asdreni, këtë vjershë e shkruan në trajtën e tingëllimës, veçse me ndryshimin se Eminesku e ka ndërtuar me 4 strofa, ndërsa Asdreni me 5 dhe me një varg të vetëm në fund të tingëllimës. Ashtu si Eminesku dhe Asdreni vjershën e ka ndërtuar nëpërmjet kontrastit mes së shkuarës së lavdishme të qytetitshet Venedik, shkëlqimit, krenarisë dhe madhështisë së dikurshme dhe heshtjes dhe shkretisë që sundon sot në këtë qytet dikur i madherishëm: “*S-a stins viața falnicei Veneției/N-auzi cântări, nu vezi lumini de baluri/Pe scări de marmură, prin vechi portaluri/Pătrunde luna înălbind pereții*” [S’ka jetë Venetiku, i shkretuar, / nuk ndihen këngë, s’shihen drita e valle, / mbi shkallët prej mermeri e mbi portalle, / ndrin hëna, muret duke argjenduar (Eminesku)] dhe: —U shojt shkëlqimi i yt, o Venetik, qytet krenar ndër vepra madhështore (Asdreni).

Me kalimin e kohës, lirika e Asdrenit largohet nga retorika dhe propaganda patriotike. Shfaqen elemente të cilët i hapin rrugën modernizimit të poezisë shqipe nga pikëpamja e tematikës ashtu edhe nga pikëpamja e formës. Megjithatë poezia patriotike, e angazhuar thellësisht në jetën politike, shoqërore dhe kulturore të atdheut përkon me momente shumë të rëndësishme në historinë e kombit të tij, siç ndodhi në rastin e Aleksandriut dhe të Emineskut. Por me Emineskun, Asdreni kupton dhe ndan idealin e poetit profet (*poeta vates*) ose poetit filozof i cili gjithë jetën dhe veprimtarinë e tij e vendos në shërbim të atdheut.

Përfundime

Jeta dhe veprimtaria e Asdrenit ka lidhur edhe më shumë dy popuj dhe dy kultura me fate historike shumë të ngjashme, por që kanë mbështetur njëri-tjetrin në momente shumë të rëndësishme të historisë së tyre. Për historinë e shqiptarëve, mbështetja e shtetit rumun ka qenë vendimtare gjatë procesit historik, i cili ka çuar në shpalljen e Pavarësisë dhe në themelimin e shtetit shqiptar të pavarur dhe modern. Të mos harrojmë se Asdreni kishte shkuar në Rumani si mësues, për të përgatitur mësuesit e ardhshëm të shkollave shqipe dhe për të mbështetur çështjen shqiptare në një nga vendet më dashamirëse dhe më mikëpritëse për emigrantët shqiptarë të asaj kohe, një pjesë të të cilëve ishin edhe arumunë⁴- qytetin e Bukureshtit. Në këto kushte, ndikimi i kulturës dhe letërsisë rumune mbi poetin Asdreni ishte jo vetëm i pashmangshëm, por ka lënë gjurmë shumë të thella në poezinë e tij, një poezi e angazhuar, ku mbizotëron ndjenja e atdhedashurisë, si për shembull në vjershat e himnit kombëtar shqiptar, himn i cili nuk ka ndryshuar që prej vitit të shpalljes së Pavarësisë, 1912. Kjo tregon që edhe sot fjalët e Asdrenit gjenden thellë në ndërgjegjen e shqiptarëve të cilët, bashkë me muzikën e Ciprian Porumbeskut, i kanë përvetësuar dhe i kanë bërë pjesë të identitetit të tyre kombëtar.

Gjithashtu, ndikimi i letërsisë rumune, në veçanti i poezisë rumune romantike dhe postromantike (të përfaqësuar kryesisht nga M. Eminesku, Vasile Aleksandri etj.) në krijimtarinë poetike të Asdrenit, konsiderohet nga kritika letrare shqiptare si një hap cilësor dhe i rëndësishëm edhe në historinë e zhvillimit të poezisë dhe letërsisë shqipe, në përgjithësi. Asdreni hapi rrugën e modernitetit në veprat e shkrimtarëve pasardhës, si Lasgush Poradeci, Mitrush Kuteli etj., të cilët edhe ata u formuan nën ndikimin e kulturës dhe letërsisë rumune,

⁴ Teodorescu, I., *Kolonitë shqiptare të Rumanisë*, Editura Privirea 2008, f.102 (“Në Rumani u ngrit Shkolla Normale shqiptare, ku mësonin dhe përgatiteshin kuadrot e ardhshme pedagogjikë”), f.104 (“Ndërmjet anëtarëve të kolonive shqiptare në Rumani ishin dhe arumunët me origjinë nga Shqipëria, të cilët luftuan për pavarësinë e Shqipërisë, duke i konsideruar shqiptarët si vëllezër.”)

duke konsoliduar edhe më shumë lidhjen historike dhe kulturore midis dy vendeve.

REFERENCA

- Asdreni, *Poezi të zgjedhura*, Tiranë, 2000.
- Bala, V., “Lidhjet kulturore shqiptaro-rumune”, *Buletini shkencor I IP*, Shkodër, 1996, f.12.
- Călinescu, G., *Viața lui Eminescu*, Editura Cultura Națională, București, 1932.
- Këlinesku, Xh., *Mihai Eminescu*, Tiranë, 1994.
- Eminescu, M., *Poezii*, ediție adnotatë, Humanitas, București, 2014.
- Eminescu, M., *Poezi*, Tiranë, 2000.
- Karakaçi V., *Himni kombëtar i Shqiptarëve*, Naimi, Kosovë 2009.
- Mici A., *Himni i Flamurit, Histori, studime*, Tiranë, 2012.
- Pipa, A., *Trilogia Albanica III: Albanian Literature: Social Perspectives*, Princi, 2014, p. 112.
- Poradeci L., *Himni kombëtar, “Flamurit pranë të bashkuar dhe gjeneza e tij”*, Vepra 2, Onufri Tiranë, 1999.
- Qosja R., *Asdreni jeta dhe vepra e tij*, Toena, Tiranë, 2002.
- Qosja R., *Asdreni: jeta dhe vepra e tij: monografi*, Rilindja, botimi i dytë, Prishtina, 1987.
- Sokol, R., *Këngë patriotike*, Tiranë, 1985.
- Spaho, J., “Ndikimi i poetëve modernë rumunë në vëllimin ‘Psalmë murgu’ të Asdrenit” në *Botimin e Konferencës “Lidhjet kulturore dhe historike shqiptaro-rumune”*, Universiteti ‘Fan S. Noli’ Korçë, , Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Korçë, 2012, f. 63-69.
- Ștefanelli, Th. V., *Amintiri despre Eminescu*, Cernăuți, 1914.
- Teodorescu, I., *Kolonitë shqiptare të Rumanisë*, Editura Privirea, București 2008, f.102, 104.
- Tole S. V., *Himni kombëtar*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2016.
- Topciu, L., *Istoria literaturii albaneze de la origini până în prezent*, Colecția Albanica, Editura Asdreni, ALAR, Craiova, 2021, f. 306-331.

Referenca online

- <https://tricolor.al/histori/historia-e-plote-e-himnit-shqiptar-nga-lindja-deri-sot-14/>
- <https://www.shqiperia.com/kategori/kat/knr/265/Asdreni>

<https://www.forumishqiptar.com/threads/40701-Origjina-e-Himnit-te-Flamurit>

[*Historia e plotë e himnit shqiptar nga lindja deri sot,*](#)

<https://tricolor.al/histori/historia-e-plote-e-himnit-shqiptar-nga-lindja-deri-sot-14/>

Dokumentari i Top Channel Albania, *Vlorajt e Flamurit* (2019),

<https://www.youtube.com/watch?v=2rqmW0JFr7s>

<https://www.radiokosovaelire.com/aleksander-stavri-drenova-1872-1947-autor-himnit-te-flamurit-himnit-kombetar-shqiptar/>

<http://it.cantorion.org/music/3783/Himni-i-Flamurit-Voce>

<https://www.si24.it/2017/03/24/testo-inno-albania-parole-hymni-i-flamurit-traduzione-italiano/>

<https://www.focus.it/cultura/storia/significato-parole-inno-di-mameli>

<https://serenoregis.org/2017/11/16/a-proposito-dellinno-di-mameli-enrico-peyretti/>

<https://www.sololibri.net/Inno-di-Mameli-testo-e-significato.html>

MODERNITETIT NË POEZINË SHQIPE PËRMES VËLLIMIT “PSALLME MURGU” TË ASDRENIT

Jonela SPAHO

Universiteti “Fan S. Noli” Korçë

Asdreni është poeti shqiptar krijimtaria e të cilit shtrihet në një hark kohor gati 40-vjeçar dhe përfshin 4 vëllime poetike, të cilat shënojnë nga një fazë më vete në këtë krijimtari. Asdreni ishte nje personalitet kompleks, për të cilin krijimi nuk ishte vetëm një akt i shprehjes së vetvetes dhe të gjithçkaje që e mundonte, por ishte, piksëpar, një nevojë për të frymëmarrë. Vlera e veprës së tij nuk mund të peshohet dhe as të klasifikohet, sepse një pjesë e poezisë së tij është atdhe, një pjesë është dashuri, një pjesë është dhimbje dhe një pjesë e veçantë dilemë.

Faza e parë e krijimtarisë fillon me vëllimin “Reze Djelli”, në të cilin ai i qëndron besnik traditës poetike të trashëguar nga letërsia e Rilindjes sonë, ku vetëdija kombëtare mbisundon mbi vetëdijen artistike, por që paralajmëron poetin e vargjeve të fuqishme në të ardhmen. Faza e dytë e krijimtarisë së tij përkon më vëllimin “Ëndra e Lote”, që shënon shkeljen e shtigjeve të reja në poezinë shqipe, me një gamë tematike dhe artistike të gjerë, duke dëshmuar një përvojë shumë më të pasur krijuese. Faza e tretë lidhet me vëllimin e tretë “Psalme murgu” dhe konsiderohet si faza më e gjatë e krijimtarisë së tij, ku vihet re rritja e mjeshterisë në formë, stil e teknikë si dhe zgjerimi i gamës ideore dhe tematike. Sigurisht, edhe nga pikëpamja artistike, detajet e zgjedhura tani kanë filluar të largohen prej poezive të para. Kjo fazë shënon kulmin e krijimtarisë së Asdrenit dhe se bashku me poezinë e Lasgushit dhe “Vargjet e lira” të Migjenit, shënojnë kthesë në letërsinë shqiptare. Faza e katërt lidhet me përmbledhjen “Kambana e Krujës” (që nuk arriti të botohej), e cila mund të konsiderohet si poezi e zbehtë nga pikëpamja e frymëzimit artistik. Kjo, sipas R. Qoses ndoshta ndodh edhe për shkak të rënies së interesit të tij krijues, për shkak të kushteve jetësore, por edhe për shkak të moshës.¹

¹ Rexhep Qosja, *Asdreni, jeta dhe vepra e tij*, Tiranë, 2002, f. 245.

Periodha kur Asdreni shkruan dhe boton vëllimin “Psallme Murgu” përkon me ngjarje të përmasave botërore, përmbysje dhe ndryshime rrënjësore, që do të reflektoheshin në një mënyrë a në një tjetër edhe në jetën shpirtërore e mendore të shoqërisë shqiptare. Për pasojë dhe në brendinë, frymën, format dhe drejtimin që do të merrte letërsia shqipe. Në radhë të parë këto do t'i ndiente poezia. Poezia që ishte si gjithë letërsia do të ndiqte fatin e shoqërisë shqiptare, duke ecur nëpër një rrugë të vështirë e duke ndryshuar në varësi të saj. Nëpër këtë proces kompleks, ajo do të evoluonte, do të fitonte tiparet e veta, individualitetin e saj që do ta bënte të dallohej nga krijimtaria e mëparshme. Natyrisht, ky proces do të zhvillohej ngadalë, plot zig-zage, duke u ndeshur me pengesa nga më të ndryshmet. Ndoshta i vetmi poet i Rilindjes, që qe prodhimtar dhe vazhdoi të lëvrojë lirikën gjatë gjithë periudhës midis dy Luftërave, do të ishte Asdreni. Ai do të botonte vëllimin “*Psallme Murgu*” (1930) dhe do të përgatiste përmbledhjen tjetër poetike “*Kambana e Krujës*”. Me këtë krijimtari Asdreni do të ishte poeti që bëri, më shumë se sivëllezërit e tjerë, ndërlidhjen në mes lirikës së traditës dhe asaj moderne. Kjo do të dukej nga temat dhe motivet që trajtoi, nga poetika bashkëkohore, aq më tepër nga afrimiteti shpirtëror që ndihej në raport me poezinë e re që zhvillohej në Shqipërinë e asaj kohe.²

Por, në fokus të këtij punimi do të jetë vëllimi “Psallme Murgu”, i cili me të drejtë është cilësuar prej studiesve si fillesë e modernitetit në poezinë shqipe. Në këtë vëllim subjekti lirik bëhet më simbolik dhe ngrihet në bazë asosacionesh të largëta. Poezia e këtij vëllimi synon më fort të shprehë pikëpamjet e tij filozofike të Asdrenit, dyshimet, lëkundjet apo përshtatjet që mund të përmbledhen në përpjekjet për të kuptuar të fshehtat dhe misteret e natyrës e kozmosit në përgjithësi. Sigurisht, edhe nga pikëpamja artistike, detajet e zgjedhura tani kanë filluar të largohen prej poezive të para. Ndryshimi i gjendjes shpirtërore në këto poezi është fare i qartë. Në veprën e Asdrenit mund të gjesh vjersha që trajtojnë të njëjtin motiv, me emocione krejt të ndryshme; të gëzueshme, të çelura në pjesën e parë dhe të errta, të rënda, të trishtuara më pas.

Eqerm Cabej do të ishte i pari që do të shfaqte pikëpamje mbi modernitetin e poezisë së Asdrenit: “Po të marim në dorë veprat e

² Nasho Jorgaqi, *Antologji e poezisë lirike shqipe midis Dy Luftërave, Uegen, Tiranë, 2009, f. 12.*

Asdrenit, do të shohim të çfaqur atje fillimet e kësaj periudhe të dytë, e cila mund të quhet periudha moderne e poezisë shqiptare, dhe gjen vazhdimin e saj në vjershat e Lasgush Poradecit.”³

Robert Elsi me të drejtë thekson se Asdreni, është i pari poet modern me të dyja këmbët në letërsinë e gjysmës së parë të shek. XX. “...është edhe poeti i parë i periudhës kalimtare që mund ta vendosim, si të thuash, në anën tjetër të urës... Së bashku me dy vëllime të mrekullueshme nga Lasgush Poradeci (1899-1987), botuar në Rumani më 1933 dhe 1937, dhe vëllimi i vogël “Vargjet e lira”, 1936, nga i riu Migjeni (1911-1938), “Psallme Murgu” shënon gjithashtu një pikë kthese në letërsinë shqipe. Modernizmi tashmë kishte filluar të dukej në horizont.”⁴

Nga pikëpamja e përkatësisë në drejtimit letrar, vepra e Asdrenit, është ndër më të ndërlikuarat në historinë e letërsisë sonë. E shtrirë në një kohë relativisht të gjatë, ajo u krijua në etapa të ndryshme historike, që domosdo sollën dallime të rëndësishme në tiparet e saj. Poezitë e librit “Psallme Murgu” zënë një spektër të gjerë tematik. Autori i lë vend të gjerë lirikave meditative, erotike e të peizazhit duke bërë një thyerje nga tradita e deriatëhershme, dëshmuar edhe në sistemin metrik e figurativ. I largohet angazhimit në çështjen kombëtare dhe problematikës shoqërore, të cilat kishin mbizotëruar në dy vëllimet e mëparshme, dhe poezia e tij merr trajta subjektive. Shfaqet mbizotëruese prirja drejt një poezie me thekse meditative, ku përjetimet e kërkimet subjektive janë thelbi i botës poetike të autorit. ⁵ Sipas R.Qoses kritika e kohës, por edhe ajo e mëpastajmja, nuk ka arritur t’i shohë nën një dritë objektive këto tipare që fillojnë të shfaqen te ky autor për së pari e më tej në autorë të tjerë. Shpesh është mjaftuar vetëm me një përmendje dhe nuk shkohet më tej në trajtimin dhe analizën e tyre sipas kriterëve letrarë: “Vepra poetike e Asdrenit nuk ka zgjuar gati asnjëherë interesimin dhe as ka gjetur trajtimin përkatës në kritikën dhe historiografinë tonë letrare deri në kohën më të re. Për

³ Eqerem Cabej, Mbi poezinë e Lasgush Poradecit, Gazeta e Re, Tiranë, 22 shkurt, 1929 f.3.

⁴ Robert Elsie, Letërsia shqipe, një histori e shkurtër, Skanderbeg books, Tiranë, 2006, f.104.

⁵ Ali Xhiku, Nga romantizmi rrjedhave të realizmit, Tiranë, 1989, f.107.

të madje, është shkruar më rrallë dhe me përciptaz se për disa shkrimtarë tanët të dorës së dytë apo të tretë”⁶.

Në vëllimin “Psallme Murgu”, kryesisht, mbizotëron motivi meditativ edhe në poezitë e natyrës edhe në lirikat e dashurisë. Motivet meditative shpesh i gjejmë si boshti i një poezie të caktuar, ose të ndërthurura me motive të tjera, si p.sh. me motivin e natyrës apo të dashurisë. Përgjithësisht, Asdreni, në kritikën tonë të pas luftës deri në vitet ‘90 është vlerësuar përgjithësisht për poezinë e tij atdhetare dhe atë me motive politiko-sociale, ndërsa vëllimi “Psallme Murgu” asnjëherë nuk është marrë në konsideratë për analiza dhe studime të thelluara. Mendimi akademik i para viteve ‘90 shpesh ka vlerësuar më së shumti në krijimtarinë e Asdrenit atë pjesë që lidhet me trajtimin e motiveve patriotike. Kjo tendencë ka bërë që për një kohë të gjatë të mohohen disa vlera të rëndësishme të poezisë së tij, dhe të shkrimtarëve të tjerë, ose të interpretohen si jovlera, madje edhe të lihet në harresë. Vëllimi më i mirë i Asdrenit që siç pohohet njëzëri nga studiuesit është vëllimi “Psallme Murgu”, në tekstin e “Historisë së Letërsisë Shqipe” të vitit 1983, denigrohet deri në atë masë sa poezitë e tij vështrohen si dekadente dhe si shkëputje e njeriut dhe artit nga realiteti, madje pa marrë parasysh asnjë kriter letrar krahasohet vepra e tij me krijimtarinë e Stërmillit, Bulkës, Migjenit, etj.dhe në këtë rrafsh krahasimtar, Asdreni cilësohet edhe si anakronik; ”që pëlqen të kënaqet me zbrazëtinë e artit për art”, madje shkohet deri atje sa pesimizmin dhe trishtimin e poetit në këtë vëllim që e botoi pas të 60-ave, në një moshë kur e kishte forcuar botëkuptimin në filtrin e shumë përvojave zhgënjyese dhe ishte më se normale që të kishte humbur dhe besimin në gjëra që i kishte besuar më parë, autorët ta quajnë këtë rënie katastrofike të poetit. Përsa i përket aspektit stilistik spekulohet deri në atë masë sa që shkohet në pohimin se Asdreni orvatet ta fusë me zor mendimin në kallëpe metrike, figuracion pa efekt, ngurti në konceptim, etj⁷.

Kjo frymë ka mbizotëruar në kritikën shqipe për një kohë të gjatë duke mohuar vlerat asaj pjese të poetikës së tij që paraqet prurjen më të mirë në letërsinë shqipe. Rexhep Qosja që realizoi punimin më të plotë për veprën Asdrenit me të drejtë vë në dukje se; Jo vetëm është

⁶ Rexhep Qosja, *Asdreni, jeta dhe vepra e tij. Monografi, Botimet “Toena”, Tiranë, 2002, f. 3.*

⁷ Historia e letërsisë shqipe tiranë 1983, f.426,427,430,435,437.

shkruar rrallë për Asdrenin, por edhe është shkruar përciptazi duke qëndruar shpesh nën hijen e poetëve, krijimtaria e të cilëve qëndron shumë më poshtë se krijimtaria e tij. Një vështrim mbi receptimin e poezisë së Asdrenit nga kritika jonë dëshmon këtë paradoks.⁸

Me vëllimin “Psallme murgu” Asdreni bëhet poeti i poezisë së re, që e shkëput poezinë nga tema patriotike dhe shoqërore, që i ikën me vetëdije angazhimit të kërkuar nga romantizmi i rilindjes shqiptare. Jo vetëm në aspektin tematik, por veçanërisht në atë formal duhen parë ato tipare që e lidhin këtë pjesë të krijimtarisë së Asdrenit me poetikat moderne. Këto prirje të poezisë së Asdrenit reflektojnë njohjen e simbolizmit rumun dhe për më tepër të atij francez, që është më i dukshëm në vëllimin Psallme Murgu. Prirja simboliste e poezisë së Asdrenit, që bëhet më e dukshme në vëllimin “Psallme Murgu”, me të cilin hyn në poezinë moderne shqipe si nismëtar i saj, përpos kujdesit për aspektin tingullor, reflektohet edhe në përdorimin e figurës së simbolit, përdorur shpesh në këtë vëllimin.

Në ciklin e pare të vëllimit “Psallme Murgu” të titulluar ‘Flaga e Vatrës’, lirikat që pretendojnë të lidhen me temën atdhetare në thelb i janë shmangur në një mënyrë apo në një tjetër asaj. Siç thekson dhe profesor Ali Xhiku: “Në vëllimin “Psallme Murgu”, tek Asdreni nis të marrë trajtë një shfaqje që tani nuk mund të quhet më mezi e dukshme, prirja për t’ju drejtuar një publiku më të kultivuar, duke trajtuar në mënyrë më të rafinuar temën meditative ose duke theksuar shumë përmbajtjen filozofike të motiveve të reja. Krijimtaria e Asdrenit këtu bëhet më e vështirë për t’u kuptuar dhe shpesh ajo kthehet në një lloj jehone të vetvetes. Tani Asdrenin fillojnë të shqetësojnë dhe preokupojnë tema universale dhe kozmogonike, tema që kanë të bëjnë me shpirtin e njeriut, me njohjen e zotit, me mëshirimin e shpirtit, me një shfaqje tjetër të bukurisë dhe dashurisë, të cilën nuk nguron ta quajë mallkim, mëkat, ngasje djallëzore dhe së cilës bën mirë që t’i largohesh. Për të arritur unitetin e formës me përmbajtjen ai tenton një formë të re stilistike çka ka bërë që mungesës së frymëzimit spontan dhe shpërthyes, patetizmin dhe sinqeritetin e shprehjes ta zëvendësojë me punime këmbëngulëse me anën tingullore të vargut, me metrikën dhe figuracionin. Poezitë e vëllimit “Psallme Murgu” dëshmojnë, siç

⁸ Rexhep Qosja, Asdreni, jeta dhe vepra e tij. Monografi, Botimet “Toena”, Tiranë, 2002, f. 8.

është vënë në dukje nga disa studiues së veprës së tij, ndikime të drejtimeve e poetikave të ndryshme europiane si parnasizmi e simbolizmi. Studiues të ndryshëm të cilët janë marrë me studimin e veprës së Asdrenit i kanë evidentuar këto ndikime. Tipare të tilla si: prirja për t’i drejtuar një publiku të kultivuar, prirja për të theksuar unin, kulti i të bukurës që dëshmohej në punën e tij të kujdesshme për aspektin formal (teknika e vargut, rima, ritmi, gjuha), e lidhin poezinë e Asdrenit me drejtimin parnasist. Trajtimi i motiveve e simboleve të mitologjisë, kujdesi i veçantë për aspektin tingullor të fjalës dhe muzikalitetin e vargut, një prirje abstraksioni dhe largimi prej problemeve të realitetit fokusimi në kultin e së bukurës, krijimi i një poezie elitare, mungesa e shpërthimeve të forta të ndjenjave, teknika e krijimit të vizioneve e imazheve dëshmojnë ndikimin e këtyre drejtimeve letrare në këtë fazë të krijimtarisë së Asdrenit. Porsi parnasistët Asdreni do t’i shprehë vizionet e tij poetike me qartësi vizuale ashtu edhe kujdesi për anën tingullore të fjalës, muzikalitetin e vargut, largimi nga konkretja drejt një fryme abstrakte, tregon ndikimin e simbolizmit. Ky botim shënon një hop të ri në krijimtarinë e tij dhe e vendos Asdrenin në pozitë të një poeti me prirje të qarta të modernitetit, përfaqësues të lirikës së periudhës së gjysmës së parë të shek.XX. Me këtë vepër Asdreni shfaqet ndryshe nga autorët e tjerë që erdhën nga tradita (Mjeda, Çajupi, etj). Sipas prof ali Xhikut: “Këto tipare që ka fituar krijimtaria e Asdrenit e kanë burimin edhe në ndikimin që pësoi prej drejtimit parnasian, që, siç dihet, u përhap mjaft në letërsinë franceze. Poezia e Asdrenit, sidomos në kohët e fundit, nuk mbeti pa u prekur edhe prej ndikimeve të simbolizmit. Në vëllimin “Psallme Murgu”, Asdreni, siç e kanë vënë në dukje studiuesit, nis të kujdeset më fort për anën tingëllore të fjalës, për një varg më muzikal, më abstrakt. Ai i shpreh vizionet e tij me qartësi vizuale si parnasistët por dhe të krijojë vjersha prej një ideje abstrakte, porsi simbolistët, Asdreni në ca raste, megjithëse jo të shpeshta, kombinon metodën krijuese të të parëve me atë të të dytëve”.⁹

Cikli i dytë i vëllimit “Vallja e Jetës” meriton një trajtim tjetër që do ta shohim më pas në çështjen e ndikimeve.

Cikli i tretë “Ngjyra ylberi”, që na sugjeron poezi peizazhi merr të tjera përmasa të Asdrenit. Motivet peizazhiste kanë një tjetër trajtim, veçse

⁹ Ali Xhiku, *Nga romantizmi rrjedhave të realizmit*, Tiranë, 1989, f.10.

më së shumti dalin të ndërthurura me motive të tjera. Në trajtimin e motiveve të natyrës, në dallim nga vëllimi i parë ku shfaqet ndjeshëm ndikimi i frymës romantike, në vëllimin e dytë, e më së shumti në vëllimin e tretë, reflektohet prezenca e fortë e frymës meditative. Poeti e bën lirikën e natyrës formë të shprehjes së meditimeve të personazhit lirik. Lirika peizazhiste e kësaj periudhe mbart frymën përsiatëse dhe ndjenjat pesimiste që i gjejmë pothuajse në gjithë lirikën e vëllimit “Psallme murgu”. Kjo metodë e ndërtimit të imazhit poetik (si tipar i simbolizmit) që fillon me Asdrenin do të theksohet edhe më tej në fazat e kësaj periudhe. Dendur është krahasuar në studimet tona vjersha “Perëndim djelli në verë” e “Ëndra dhe Lote” me “Vegim perëndimi” të vëllimi në fjalë dhe me të drejtë sepse këtu mund të shohim më qartë ndryshueshmërinë dhe risitë që sjell Asdreni në këtë periudhë të krijimtarisë. I njëjti fenomen natyror këtu shihet nga predispozita të ndryshme shpirtërore. Në vëllimin e parë kemi përshkrimin e peizazhit dhe magjinë që zgjon ai, ndërsa të “Psallme Murgu” kjo poezi nuk strajtohet si lirikë peizazhi, por ka abstraguar në drejtimin e vetë jetës së poetit që po shkonte kah perëndimit, ku rinia ishte larguar për t’ja lënë udhën vjeshtë së jetës: “në luftë të pareshtur jam me vehten, / gjësend kërkonj t’i prur për ta kënaqur, / Por shoh fuqitë e mija po treten, / sikur pa shpresë prapë për te mu shfaqur.” Lidhur me sa thamë, patjetër që impulset e jashtme filtrohen e transformohen në përputhje me këtë gjendje shpirtërore. Për pasojë, vjersha nuk është më një krijim i kulluar lirik peizazh, por është një vjershë e karakterit filozofik. Objektet dhe detajet që shfrytëzon ai në këtë poezi, nuk i nënshtrohen më ligjit të kuptimit të bukurisë, të natyrës, por zgjedh atë objekt dhe detaj që i përshtatet më mirë gjendjes që mundon poetin. Sigurisht, dhe në pjesën e dytë të poezive të peizazhit, natyra ka menyrën e vet të të folurit përmes mendimit e psikologjisë së poetit, prandaj ajo nuk shfaqet e gjitha përmes mendimesh e detajesh, por përmes ndonjë mendimi e detaji që përfaqëson një gjendje shpirtërore. Në ciklin e tretë të vëllimit kemi “Lule dhe gjëmba” ku autori meditativ anon kah një satire të lehtë duke dalë në përfundime filozofike mbi jetën. Ndërsa në ciklin e fundit “Nga bota e përrallave”, ai u kthehet simboleve mitologjike, duke synuar, ndryshe nga parardhësit, që t’ju japë atyre një vlerë universal si mësim që i ka dhënë mitologjia lashtë për të parë në optikën e duhur raportet njerëzore dhe jetësore.

Duke jetuar pjesën më të madhe të jetës në Rumani, ishte e natyrshme që Asdreni të ndikohej nga rrymat e letërsisë rumune, të cilat, veçanërisht, gjatë fund shek.XIX dhe fillim shek.XX, shfaqnin një nivel më lartë zhvillimi e mjeshtërie sesa letërsia shqiptare e asaj periudhe. Siç pohon dhe akademik Rexhep Qosja: “Letërsia rumune, duke filluar prej romantizmit e këndej, ka luajtur rol vendimtar në formimin e shijes, në formimin e ndjeshmërisë poetike, në orientimin e interesimit dhe në përgjithësi në ndërtimin shpirtëror të Asdrenit si krijues. Dhe jo vetëm kaq. Është i pranueshëm fakti se poezia rumune ndikoi dukshëm në pjekurinë artistike të poetit dhe në formimin e mjaft elementeve të formës dhe përmbajtjes¹⁰. Ndikimi i poezisë rumune të Asdreni do të vinte jo vetëm prej faktit se ai jetoi në Rumani gjatë gjithë jetës së tij, por edhe për faktin se Rumania është një vend i Ballkanit, që nga pikpamja historike ka kaluar ngjarje të krahaseshme me ato në Shqipëri. Përveç aspektit artistik i cili i intereson në mënyrë të veçantë, Asdreni do të shihej në letërsinë rumune tema që përkonin me çështjet kombëtare, sociale, politike dhe morale shqiptare

Në krijimtarinë e Asdrenit, janë vërejtur dukshëm ndikime të poetëve të periudhave të ndryshme të letërsisë rumune. Çështja e ndikimit të Asdrenit nga poezia rumune është një çështje e rëndësishme për të kuptuar Asdrenin, por edhe për të kuptuar krejt tendencat e reja të poezisë shqiptare në fillim të shek.XX. Me ndikimet prej kësaj poezie Asdreni sjell një fenomen të njohur në letërsi: pasurimin e letërsive kombëtare. Në poezinë e Asdrenit pohojmë se ka ndikime, ka imitime, por ka dhe përshtatje nga poetët e njohur rumunë. Por gjithmonë, ai përshtat ato poezi që i shkojnë shijes dhe botëkuptimit të tij artistik dhe estetik. Po sipas prof.R.Qoses, sikur të mos kishte qenë në gjendje të përvetësonte një ndikim të tillë prej poezisë rumune, poezia e tij do të ishte një pasardhëse e zbehtë e poezisë së Naim Frashërit apo e poezisë sonë popullore¹¹.

Poeti rumun, i cili luajti një rol të ndjeshëm në krijimtarinë e Asdrenit, jo vetëm me idealizmin e tij panteist, brengën e shekullit dhe frymën bajroniane, por edhe me element konkretë të metrikës, vargut dhe fjalorit poetik, do të ishte poeti Mihail Eminesku. Eminesku ishte një fenomen në letërsinë rumune, i cili zëvendësoi trajtat dhe mënyrat e

¹⁰ Rexhep Qosja, *Asdreni, jeta dhe vepra e tij. Monografi, Botimet “Toena”, Tiranë, 2002, f. 278.*

¹¹ *Po aty, f. 298.*

vjetra tradicionale të poezisë me trajta të reja të papara deri atëhere, trajta të krijuara e të nxjerra drejtpërdrejt nga thellësia mistike e psikologjisë së kombit të vet. Eminesku siç thotë Kuteli ishte si albatrosi i Bodlerit, kishte krahë të gjatë e të fortë për të fluturuar në botët e idealit, po këta krahë e bënë të mos mund të ecte në tokë.¹² Ndikimi i Emineskut te Asdreni, sipas prof. Vehbi Balës duket në poezinë atdhetare, sociale dhe në poezinë e natyrës. Ndikim nga Eminesku ka pasur dhe në vjershat e vëllimeve të para të Asdrenit, si vjersha “Epigon”, që është imitim i vjershës me të njëjtin titull të Emineskut “Epigonii” si dhe vjersha “Dëshira ime” që është një parafrazë e vjershës së tij “Mai amun singur dor” (Kam një të vetmin mall). Por nëse i referohemi vëllimit “Psallme murgu” vjersha që është ndikuar e shkruar nën frymën emineskiane është ajo me titull “Venetiku” që qëndron pothuaj në të njëjtin nivel me vjershën “Venetia” të Emineskut. Ashtu si Eminesku edhe Asdreni, këtë vjershë e shkruan në trajtën e tingëllimës veçse me ndryshimin se Eminesku e ka ndërtuar me 4 strofa, ndërsa Asdreni me 5 dhe me një varg të vetëm në fund të tingëllimës. Ashtu si Eminesku dhe Asdreni vjershën e ka ndërtuar nëpërmjet kontrastit mes së shkruarës së lavdishme të Venecjes, shkëlqimit, krenarisë dhe madhështisë së dikurshme dhe heshtjes dhe shkretisë që sundon sot në këtë qytet dikur fatbardhë: “S’ka jetë Venetiku, i shkretuar, / nuk ndihen këngë, s’shihen drita e valle, / mbi shkallët prej mermeri e mbi portalle, / ndrin hëna, muret duke argjenduar (Eminesku) dhe : “U shojt shkëlqimi i yt, o Venetik, qytet krenar në vepra madhështore”(Asdreni) Asdreni përdor të njëjtat detaje dhe simbole si tek poezia homologe e Emineskut: pallate, kisha e Shën Markut, gjërimi i valëve etj: ”Shën Marku, si një murg tej motesh mbetur, / mesnatën lajmëron me zë kambane”(Eminesku) dhe: “Këmbanat e Shën Markut sot se kanë, / njetë tingëllim hyjnor që zjej qyteti”(Asdreni)

Me sa duket, Asdreni përshtati ato poezi që i afroreshin shijes së tij, por i përshtati edhe për faktin se pati mundësi të krijojë figura të reja dhe pamje të reja si në rastin e vjershës në fjalë, sikur kërkon të vërë në konkurrencë vargun e gjuhës shqipe me vargun original, për të parë se cili tingëllon më bukur. Mihail Eminesku po sipas prof V.Balës ka ndikuar duk që në titull po ashtu dhe te Asdreni është fjala pyll (“Fëshfërimë pylli”, “Pse lëkundesh ti o pyll?”, “Legjenda e pyllit”)

¹² Mitrush Kuteli, *Vepra letrare* 5, Tiranë, 1990, f. 249

dhe te Asdreni (“Vaje e pyllit”). Po ashtu përdoret shpesh fjala yll si simbol në poezitë e Asdrenit që është një ndër fjalët më të përdorura në leksikun emineskian: “Sa gjëmë yj”, “Gjer te ylli”, “Kush e di sa yje”, “Ylli i dritës” dhe “Ylli i zjarrtë”, “Ylli i harruar” te Asdreni. Po ashtu një ndër fjalët më të gjendshme te Eminesku është fjala mall, në kumtimin një mungesë një dhimbje, një ndarje ose një distancimi prej dikujt dhe diçkaje, fjalë që e gjejmë shpesh të përdorur në shumë poezi të vëllimit. Sipas prof. R.Qoses edhe simboli i korës (ikonës), që aq shpesh përmendet në vjershat e Asdrenit tek vëllimi në fjalë, është i trashëguar prej Emineskut. Ngjashmëri vërehet dhe në shfrytëzimin e simboleve mitologjike tek të dy krijuesit: Diana, Glosa, Venera dhe Madona (Eminesku) dhe Argusi, Minerva, Narqisi, Prometeu (Asdreni) Në vëllimin “Psallme murgu”, që konsiderohet si kulmi krijimtarisë potike të Asdrenit, do të ndihet dukshëm ndikimi i Aleksandru Maqedonskit, babait të simbolizmit rumun dhe i Tudor Argezit, poetit të madh lirik rumun te shek. XX. Argezi solli në letërsinë rumune një stil dhe një formë të re letrare, e cila do të ndikonte dukshëm në krijimtarinë e poetëve pasardhës. Gjurmët e Arghezit në poezinë e Asdrenit janë vërejtur në frymën mistike, në angazhimin moral, si dhe në elementet e simbolizmit dhe ekspresionizmit¹³. Në poezinë e këtij autori ndihet ndikimi i Bodlerit, simbolizmit dhe ekspresionizmit. Simbolika e poezive të vëllimit “Psallme Murgu”, si dhe ndikimi i fjalorit poetik, duket qartë që janë trashëguar prej poezisë së Argezit. Tudor Arghezi është një prej autorëve kanonikë të letërsisë rumune dhe një nga shkrimtarët më të njohur rumunë. Asdreni do të ndikohej prej vëllimit të tij “Psalmet”, të cilat trajtojnë trazimin e poetit mes pohimit dhe mohimit dhe mes besimit dhe mosbesimit. Shumica e psalmeve shprehin dëshirën e poetit për të fituar siguri në lidhje me zotin. Asdreni në fillim done ta titullonte vëllimin e tij “Mure burgu”, në mënyrë që mos imitonte Argesin me psalmet e tij, prej të cilave ndikimi në pjesën më të madhe të vjershave është i dukshëm. Te vëllimi “Psallme Murgu” ashtu si te psalmet e Argesit bëhet një lloj jehone e vetvetes. Në këtë vëllim Asdreni, ashtu si Argesi është në kërkim të zotit, është në kundërshti me veten dhe realitetin. I munduar vazhdimisht të kuptonte ç’ ishte jeta, ç’ ishte ekzistenca, ai do të shfaqte mëdyshjet më të thella tek të cilat shkonte me shumë vështirësi dhe përmes shumë sprovave shpirtërore.

¹³ Robert Elsi, Historia e letërsisë shqiptare, Tiranë – Pejë, 1997, f. 267

Ekzistojne 16 poezi me titull “Psalm” të Argezit, të botuara në vëllime të ndryshme. Cikli argezian i poezive me titull “Psalm” hedhë dritë drejt hapjes filozofike të të menduarit të poetit, gjë që i takon poezisë së dijes. Ideja qendrore e këtij cikli është kërkimi i hyjnore dhe aventura e njohjes ka dy koordinata: një të brendshme për të zbritur në vetvete, dhe një të jashtme në kërkim të zotit, tek elementet e botës materiale që e rrethojnë. Uni lirik luhetet midis dy tendencave kontradiktore: besimit dhe mohimit.¹⁴ Në thelb, Arghezi i përgjërohet fuqisë hyjnore që t’i shfaqet nën formën e një shenje të prekshme. Ai sjell si shembull rrëfimin e Dhiatës së Vjetër: “Je shfaqur disa herë, / dhe gjithmonë me rroba Perandori” (Psalmi VII).¹⁵ Në mungesë të një shenje hyjnore, Arghezi dëshiron ta provokojë duke përshtatur dy qëndrime: mohimin e zotit (uni lirik shpallet Perëndia e tij, duke qënë “kushar i qiejve që kryen mëkate të pafalshme”, ose afirmimi dhe mbarimi shpirtëror për shkak të pamundësisë së komunikimit. Psalmi VI është konsideruar si matrica e mendimit psalmik arghezian. Katër strofat e poezisë flasin për një qëndrim hezitues mes prirjeve të kundërta: rebelim ose tërheqje. Kjo sjellje del dhe nga antonimet: “zhurmë - heshtje”, “besimi - mohim”, “të jesh - të mos jesh” etj. Kërkimi i hyjnisë është i vështirë. Megjithatë, vargu: "dhe nuk i lejoj vetes t’ju rrëzoj poshtë nga qielli", është një afirmim i besimit të fortë tek Zoti, që edhe pse është i vështirë për t’u shfaqur, ai jeton në shpirtat e njerëzve. Strofa e fundit njofton, përsëri, një sfidë: "Vetëm, tani, në historinë tënde të madhe, / rri me ty të matem përsëri"¹⁶. Çështja që shtrohet këtu është një metaforë që përfshin historinë fetare të besimit, historinë e njerëzimit; dy "kundërshtarët" matin forcat e tyre, të cilat janë në fakt të pabarabarta. Edhe pse Argezi artikulon provokimin, është prapë ai që afirmon: "pa dashje të dal fitimtar", duke qene koshtient për gjendjen e tij njerëzore të kufizuar. Konfrontimi dëshmon për një dëshirë të fortë për njohuri, jo një mosbesim që e ka origjinën në pavërtetësi. Në vargun e fundit: "dua të të prek dhe të bërtas", uni lirik përsërit gjestin biblik të Thomait, i cili shpreh dëshirën për të prekur plagët e Jezusit, për të besuar se ai u ngjall nga vdekja. Uni lirik kërkon dëshmi materiale të ekzistencës së Zotit edhe pse atë e kishte parë në shpirt. Psalmet e Arghezit, të ndërtuara në bazë të dy

¹⁴ Tudor Arghezi, *Intre doua nopti*, Bukuresht, 1994, f.15

¹⁵ Po aty, f.265

¹⁶ Po aty, f. 164

tendencave të kundërta, përmbledhin (sintetizojnë) nevojën e njeriut për njohje dhe kërkim të vazhdueshëm të idealit të përsosmërisë, të mishëruar tek Zoti. E shtjelluam konceptin e Argesit tek psalmet për të bërë më të qartë çështjen e ndikimit të tij tek Asdreni ,në vëllimin “Psallme Murgu”. Ndikimi argezian është veçanërisht i dukshëm në këtë vëllim tek vjersha e gjatë ”Paradokse”, ”Hyji i harruar”, “Dëshirë pagane” dhe “Lutje e vonuar”. Në poezinë “Lutje e vonuar”, Asdreni, një besimtar i devotshëm guxon dhe ankohet ndaj zotit: “ O zot pse vajtjet nuk mi sheh, / as lutjet gjunjësh kur bie, / as herë syt e mi q’i ngreh, ndaj ty me lotë dhembshurie”.¹⁷ Ai e ndjen veten si një qenie të vuajtur dhe gjen ngushëllim tek amshimi, prandaj shpesh e identifikon veten me murgun, i cili më shumë se plotësimit të epsheve të ekzistencës, ia kushton jetën pastërtisë së shpirtit. Te “Dëshirë pagane”, nën frymën argesiane ai e fton shpirtin të largohet prej trupit: “O shpirt mos e beso atë se me mëkate vehten plot e ka”. I vetmi ngushëllim për të është qielli, kur shpirti do të shkojë te burimi dhe do të qetësohet. Në vjershën “Mister “, ashtu si Argezi edhe ai është në një gjendje mëdyshjeje ku nuk mund as të pohojë dhe as të mohojë besimin e vet. Mesa duket, nëpërmjet këtyre vjershave ai shkarkohet prej dyshimeve dhe kundërthënieve shpirtërore. Në këtë kontekst poezia “Paradoks” është një testament shpirtëror i Asdrenit. Në të zë vend një njeri i ndarë në dy persona që japin urdhëra të ndryshme, apo shfaqin dëshira të ndryshme. Edhe në lidhje me zotin, ashtu si Argezi edhe Asdreni ndihet i dyzuar, por pa humbur gjithsesi besimin: “Marr e vëzhgoj Ungjillin e Psallterin, / s’gjej faqe mos kujtohet perëndi,/ por hap do faqe dhe këndoj Volterin, / mendimet më ndryshohen për çudi”.¹⁸ Poezia bëhet një monolog i gjatë rreth atyre problemeve që e mundojnë koshiençën dhe subkoshiençën e tij, përmes pohimit dhe besimit ashtu si në poezinë argesiane: “ Të humbas në zhurmë dhe heshtje, / Dhe ndërsa fshihesh, si i gjojtur, / Më lejoni të shoh: je skifter im i preferuar, / Të të vras ty? Ose në gjunjë të kërkoj. / Për besimin apo për dyshim, / Të kërkoj me ngulm, por pa dobi, / Jeni ëndrra ime ajo më e bukura, / dhe nuk guxoj t’ju rëzoj poshtë nga qielli (psalmi VI)¹⁹

¹⁷ Asdreni, *Vepra letrare*, II, Tiranë, 1980

¹⁸ Asdreni, *Vepra letrare*, II, Tiranë, 1980, f. 110

¹⁹ Tudor Arghezi, *Intre doua nopti*, Bukuresht, 1994, f.265

Ndikimi i Argezit vihet re dhe në poezinë erotike. Ndryshe nga poetët e tjerë bashkëkohorë, Arghezi nuk u përpoq të shtjellojë shumë liriken erotike. Përkushtimi për të dhuruar, gatishmëria për dashuri janë të pranishëm në të gjithë punën e tij. Erotika argheziene përfshin qëndrime që i përkasin dy fazave: faza e vonesës, e pasigurisë, mungesës së dëshirës për të përfituar nga pasioni dhe faza e pranimi të ndjenjës erotike. Mesa duket, të vëllimi “Psallme Murgu”, Asdreni është ndikuar nga faza e mungesës së dëshirës, ose e mos pranimi të ndjenjës erotike siç ndodh te poezia e Argezit “Dashuri e vonuar”, që përkon me konceptin e poezive të Asdrenit të “Lulja e zemrës” dhe “Mëkat i fshehur”. Në të parën ai është në pozitë të një murgu dhe dashuria është ajo lulja e zemrës që fare lehtë mund të shndërrohet në mallkim dhe mëkatën e shpirtit. Ajo shihet si një mallkim që duhet t’i largohesh me logjikë të kthjellët dhe t’i shmangesh me gjakftohtësi.

Ndikimi i Argezit në poezitë e vëllimit “Psallme Murgu”, ndihet dhe në përdorimin e simboleve, ose vizoreve simbolike siç i quan R.Qosja. Diskursi biblik është shfrytëzuar në gjithë krijimtarinë e Asdrenit: motivet, simbolet, fryma përmbajtësore. Vëllimi “Psallme Murgu” evokon këtë diskurs që në titull nëpërmjet dy leksemave të cilat janë të fjalorit biblik dhe shtrihet më tej në poezi të tjera të këtij vëllimi (Juda i ri, Paqjes, Lutje e vonuar, Mëkati i fshehur, Paradokse etj.). Referencat me diskursin biblik realizohen në disa nivele: në nivelin leksikor, në mesazhet që përcillen, në simbolet e përdorura të cilat funksionalizohen e ridimensionohen në nivele të reja estetike. Tek ky vëllim fjalët murgu, pendesa, kungimi mëkati, paradoksi, akulli, vala, loti, shtrëngata, pylli, helmi, gjarpëri, reja, qyqja, janë vizore simbolike që shprehin dhe disponimin e tij të errët shpirtëror, dilemat dhe mëdyshjet e tij.²⁰ Disponimi i Asdrenit për të shtruar te “Psallme Murgu” çështje universale të shpirtit njerëzor, fatit dhe ndjenjës njerëzore, janë ndikim i drejtpërdrejtë nga Argezi. Po ashtu dhe poezia “Ekselsior” është ndikim nga vjersha me të njëjtin titull e babait të simbolizmit rumun Aleksandër Maqedonskit, gjurmët e të cilit i ndoqi dhe Argezi në krijimtarinë e tij.

Simboli më i bukur i krijuar te “Psallme murgu” është ai i vjershës “Ylberi”, ku një djalosh i mahnitur prej ngjyrave të tij dëshiron t’i kapë por nuk mundet. Ngjyrat e ylberit kthehen kështu në simbolin e

²⁰ Rexhep Qosja, *Asdreni, jeta dhe vepra*, Tiranë, 2002, f. 285

pamundësisë në jetë dhe i kalueshmërisë së çasteve të bukura që zhduken si ngjyrat e ylberit.

Pra duke parë çështjen e ndikimeve, elementët e formës artistike, muzikalitetin, simbolikën e poezisë, punën me vargun dhe shume element të tjerë, duke vështruar ndikimet parnasiste dhe simboliste në vëllimin “Psallme Murgu”, dalim në përfundimin se Asdreni bëhet promotor i një faze të re të poezisë shqipe, të asaj poezie që po hynte e brishtë dhe e ndrojtur në rrugën e modernitetit të saj, për t’u pasuar më pas me autorë të tjerë që do t’i jepnin fizionominë dhe ripërtëritjen poezisë shqipe.

Referenca

Argheszi T., *Intre doua nopti*, Bukuresht, 1994.

Asdreni, *Poezi të zgjedhura*, Tiranë 2000.

Asdreni, *Psallme murgu*, Vjersha; Bukuresht, 1930.

Elsie R., *Letërsia shqipe, një histori e shkurtër*, Skanderbeg books, Tiranë, 2006.

Elsi R., *Historia e letërsisë shqiptare*, Tiranë-Pejë, 1997.

Eminesku M., *Poezi*, Tiranë, 2000.

Hamiti S., *Letërsia moderne shqiptare*, Tiranë, ALB-ASS, 2001.

Jorgaqi, N., *Antologji e poezisë lirike shqipe midis Dy Luftërave*, Uegen, Tiranë, 2009.

Kuteli M., *Vepra letrare 5*, Tiranë, 1990.

Qosja R., *Shkrimtarë dhe periudha*, A. Sh. Sh., Shtypshkronja “Mësonjtorja”, Tiranë, 2005.

Qosja Rexhep, *Asdreni, jeta dhe vepra e tij*, Tiranë, 2002.

Xhiku A., *Letërsia shqipe si polifoni*, Tiranë, 2004.

Xhiku A., *Nga romantizmi rrjedhave të realizmit*, Tiranë, 1989

Historia e letërsisë shqiptare, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë 1983.

.

QASJE NDAJ VEPRËS SË ASDRENIT NË TEKSTET E ARSIMIT 9-VJEÇAR

Rriolla AGOLLI
ragolli@unkorce.edu.al

Eftiona BYLYKBASHI
ejosifi@unkorce.edu.al
Universiteti “Fan S. Noli”

Abstrakt

Letërsia është një nga lëndët kryesore në arsimin 9-vjeçar. Ajo ndikon në formimin estetik dhe letrar, në rritjen e aftësive krijuese dhe në pasurimin e aftësive shprehëse të nxënësve, duke kontribuar në një raport pozitiv dhe të qëndrueshëm mes tyre dhe letërsisë. Punimi ynë trajton elemente dhe teknika të veprës së Asdrenit në këtë nivel arsimor.

Metodologjikisht ky është një punim përshkrues cilësor, duke u mbështetur në kërkimin narrativ. Të dhënat cilësore merren nga hulumtimi i librave të “Gjuhës shqipe II-X” që janë faktorë të dhënash, për të hetuar fakte dhe për të sjellë argumente në kuadër të trajtimit të temës. Gjatë shqyrtimit të të dhënave është përdorur analiza e përmbajtjes. Punimi vjen me disa rekomandime. Në to theksohet se është detyrë e shkollës të ruajë dhe të transmetojë pasurinë kulturore që përcjell autori e që gjendet në rrënjët e letërsisë sonë. Strategjitë e edukimit duhet të jenë të lidhura me thelbin mbi të cilin vlerësohet individi, natyra, atdheu, me poezinë që ruan vazhdimisht një frymë të thellë demokratike.

Fjalë kyç: *arsim 9-vjeçar, kurrikul, letërsi, poet, Asdreni*

Shkolla përbën një faktor shumë të rëndësishëm dhe të pazëvendësueshëm në formimin e gjithanshëm të nxënësve me njohuri dhe kompetenca. Materialet letrare zënë një vend të rëndësishëm në kurrikulën e arsimit 9-vjeçar. Letërsia ndikon në formimin estetik dhe letrar, në rritjen e aftësive krijuese dhe në pasurimin e aftësive shprehëse të nxënësve.

Programi i letërsisë mbështetet në njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet e nxënësve. Në arsimin 9-vjeçar, letërsia mësohet e integruar

me gjuhën shqipe. Ajo shihet e lidhur me zhvillimin historik e shoqëror, me filozofinë e kohës, por jo si mjet i thjeshtë që ilustron historinë. Si çdo lëndë tjetër, ajo mundëson zotërimin e kompetencave kyçe, të cilat janë të përcaktuara në kornizën kurrikulare. Këtë “mision” lënda e realizon nëpërmjet ndërtimit dhe zhvillimit të kompetencave të saj. Nëpërmjet letërsisë nxënësit vlerësojnë rëndësinë shoqërore, historike dhe kulturore të saj dhe të shkrimtarëve si krijues.

Duhet theksuar rëndësia që ka studimi i një realiteti të largët në kohë dhe që nuk ka munguar të ofrojë shembuj të individit që përbën modelin e poetit, të cilit i shkon për dore t’i shprehë vizionet e veta në qartësinë më të madhe vizuale, po edhe të krijojë vjersha prej një ideje abstrakte, porsì simbolistët, e që në disa raste kombinon metodën krijuese të të parëve, e që shfaq interesin për motive mitologjike, jo si një prirje rastësore, por në lidhje me thelbin e poezisë së tij, që tashmë ka ndryshuar kah: nga poezi romantike në poezi novatore, (Qosja, R.1970), duke i shërbyer një objektivi të shumëfishtë që ka prioritet formimin individual me elemente të një kulture, e cila ka shënuar e vijon të jetë faktor e model qytetërimi.

Punimi ynë trajton qasjen ndaj veprës së Asdrenit në këtë nivel arsimor. Asdreni ka lindur si një qendër në letërsinë shqipe (Jorgo, K. 2004). Modernizmi filloi të dukej dukshëm vetëm me të (Robert Elsie, 1977). Metodologjikisht ky është një punim përshkrues cilësor, duke u mbështetur në kërkimin narrativ. Të dhënat cilësore merren nga hulumtimi i librave të “Gjuhës shqipe II-X” që janë faktorë të dhënash, si dhe hulumtim në literaturë për të hetuar fakte dhe për të sjellë argumente në kuadër të trajtimit të temës.

Nga të dhënat që kemi siguruar nga zyra e statistikës në Zyrën Arsimore Korçë, bazuar në përzgjedhjen e librit shkollor, shtëpia botuese me përqindjen më të lartë për lëndën “Gjuha Shqipe” është shtëpia botuese “Albas”, prandaj dhe objekti ynë i studimit u bënë botimet e teksteve të sipërcituara të kësaj shtëpie botuese.

Poezia e Asdrenit është zëri i masës së robëruar e të shtypur. “Betimi mi flamur”, kjo këngë e ngritur dhe e kënduar për të parën herë, nga

kori i kolonisë shqiptare të Bukureshtit, do të ishte himni i ardhshëm kombëtar. *Populli e gjeti të pëlqyer; vetë e dëshiroi ai ashtu, nga gjiri i tij i dha trajtën dhe frymën, vetë e shënjtëroi, duke e dashur me zemër* (Kuteli, M. 1934)

Vargjet janë thellësisht shqip në tingëllimin e tyre, me gjuhën e drejtpërdrejtë dhe luftarake. Ka gjashtë strofa katërshe me rimë të alternuar.

Në strofën e parë gjenden bashkimi, besa, shpëtimi dhe betimi, koncepte kombëtare, po edhe fryma kundërshtuese, kryengritëse që do të zhvillohet në pesë strofat e tjera. Në tërësinë e vjershës bien në sy theksime të veçanta që bëhen duke spikatur vlerat dhe vlerësimet kundërshtuese. Strofa e dytë lidhet me idetë drejtpërdrejt me strofën e fundit: tradhtari përjashtohet, pasi ikën nga përbashkimi, kurse luftëtari i lirisë, dëshmori hyjnizohet, për të arritur edhe në nivel të shenjtërimit, në strofën e fundit. Edhe strofa e tretë këndon veprimin për lirinë; kurse dy strofat e tjera, katër dhe pesë, çështjen kombëtare e lartësojnë në nivel tejkahor. Një prekje e tillë konceptuale dhe nacionale me përjetësinë bëhet në strofën vijuese, në të cilën njësohet kuptimisht veprimi, simboli e atdheu, që do të thotë i gjithë program.

Në këtë nivel kënga e himnit të flamurit hyn në sferën e përkushtimit të tërësishëm deri në nivel identifikimi; po edhe në nivel shenjtërimit. Pra, kënga e Asdrenit nis udhën e ngritjes nga kënga tokësore në një këngë qiellore, të përjetshme. “Himni i Flamurit” punohet në klasën e tretë dhe të pestë.

Asdreni futi ide të guximshme në krijimtarinë e tij poetike. Këto ide kanë gjurmë të ideve të social-demokracisë evropiane të kohës, të cilat i gjejmë te “Lulëkuqëja”, poezi e punuar në klasën e pestë. Me një forcë të gjallë ngjyra e kuqe simbolizon nevojën për çlirimin shoqëror të të varfërve. Vështrimi i tij është realist e sheh fshatarin dhe bujkun e varfër me virtytet më të larta njerëzore dhe si një forcë të pazëvendësueshme për çlirim kombëtar dhe shoqëror, duke futur një frymë të re për fatin e Atdheut, për vlerat e lashta kulturore të tij. Gjerësia e perceptimit poetik të botës, ka gjithë hapësirat në sytë e

nxënësve që i punojnë këto dy poezi të cilat nga hulumtimet tona janë të vetme në gjithë botimet e sipërpërmendura për arsimin 9-vjeçar.

Vepra e Asdrenit në historinë e letërsisë shqipe, e shtrirë në një kohë relativisht të gjatë, përmban dallime të rëndësishme në tiparet e saj (Xhiku, A. 1989), që e lidhin me drejtime dhe poetika moderne. Një periudhë e re fillon për lirikën shqipe me përmbledhjen e dytë të vjershave të Asdrenit “Ëndrra e lotë” dhe vëllimin “Psallme Murgu”. (Qosja, R. 1970). Poezia e tij merr trajta subjektive, me thekse meditative, duke u fokusuar në kultin e së bukurës, me teknika të krijimit të vizioneve e imazheve me qartësinë më të madhe vizuale, duke kombinuar metodën krijuese të të parëve me atë të të dytëve (Qosja, R. 1970).

Me një hapësirë të gjerë të frymëzimeve ai sjell ngjyra të ndryshme, një spektër të gjerë nuancash të emocioneve e mendimeve, duke trajtuar gjithë temat e zakonshme të lirikës patriotike të kohës me një theks të hapur të protestës shoqërore, që disa herë shprehet me shumë forcë në vjershat e tij, në një kohë kur çështja shqiptare mbetej e hapur dhe vazhdonte të rrezikohej edhe pas vitit 1912. Pra, ishte e natyrshme që ky romantizëm nacional, trull për t’u shfaqur në letrat shqipe, të shenjtëronte binomin komb-atdhe (Xhiku, A. 2004).

Po ashtu, Asdreni ka dhënë ndihmesën e vet dhe në lëmin e satirës. Satira e tij edhe pse është e lehtë përqesh e godet. Me në fokus gjithë elementet e botës shqiptare, duke ia drejtuar satirën parësisë si përgjegjësjë kryesore e realitetit të krijuar, nisur nga ata që e udhëheqin, kryetar shteti, ministra e deputetë, deri tek jeta e njerëzve të thjeshtë, përmes portretizimit fizik e moral ai përqesh veset e njeriut, hipokrizinë dhe djallëzinë e tij, mendjemadhësinë, pabesinë dhe veprimin sipas interesave personale, parodizon gjithë të ashtuquajturat zhvillime e mirëqenie të republikës shqiptare në të gjitha drejtimet.

Asdreni ishte poeti që, duke e vlerësuar përgjegjësinë që ka vetë krijuesi letrar në lidhje me gjuhën, e njëjtte mjaft mirë rolin shumëdimensional të saj. Për të gjuha është armë kryesore e shkrimtarit, përmes së cilës vë në qarkullim idetë, mendimet dhe

emocionet e veta, duke komunikuar me lexuesit. Gjuha e veprës së tij përmban elemente nga gjuha naimjane dhe e rilindësve të tjerë, si dhe bashkëkohësve të tij. Me nektarin poetik letrar që e mori kjo gjuhë u bë ndërlidhëse e hallkave të formimit të gjuhës sonë letrare, duke lënë një tufë margaritari kulturor, gjuhësor e letrar që do të mbetet si një visar i respektuar përjetësisht në historinë tonë kulturore, gjuhësore e letrare (Fullani, Dh. 1969).

Formimi i tij intelektual dallohet në rikujtimin me nderim të rilindasve, duke i dhënë secilit tipare të qëndrueshme, duke i pasur shëmbëlltyra ideali veprimi, si dhe duke njohur gjuhën e veprave të tyre, konceptin e së cilës e formëzoi më vonë (Lafe, E. 2002). Për të gjuha është armë për ekzistencën dhe zgjimin kombëtar është pikëmbështetje parësore dhe për trimëri, është veçori qenësore e kombit tonë, nëpërmjet së cilës do arrihej bashkimi kombëtar, pa dallim krahine, ideje a feje.

Pra, Asdreni i ka siguruar vetes vend nderi në historinë e popullit tonë si rilindës në përgjithësi dhe në veçanti si poet në fushën e lirikës shqipe. Është detyrë e shkollës të ruajë dhe të transmetojë pasurinë kulturore që përcjell autori që gjendet në rrënjët e letërsisë sonë. Strategjitë e edukimit duhet të jenë të lidhura me thelbin mbi të cilin vlerësohet individi, natyra, atdheu, me poezinë që ruan vazhdimisht një frymë të thellë demokratike.

Si një poet që ka ruajtur mirë vlerat artistike dhe edukuese, në tekstet e gjuhës dhe letërsisë në arsimin parauniversitar mund të përfshihen disa nga krijimet e tjera të tij në vargje si: “Vlera e Atdheut”, e cila mbart mallin për atdhe të mërgimtarit, vjersha “Ditë prandvere” apo “Eja prandverë”, në të cilat Asdreni na vjen si një vëzhgues i veçantë i karakteristikave të natyrës, si dhe “Republika Shqipëtare”, “Fisnikët e Shqipërisë”, “Të rinjve”, “Burri i dheut”.

Referenca

Fullani, Dh. (1969). *Asdreni. në Vepra të zgjedhura*. Prishtinë.

Jorgo, K. (2004). *Receptimi i Asdrenit dhe vendi i tij në sistemin letrar shqiptar*, në *Studime Filologjike*. Nr 1-2, Tiranë, f.10-11.

Kuteli, M. (1934). *Shënime me rastin e Ditës së Flamurit*. botuar në *Shqipëria e Re*. nr. 572, Konstancë.

Lafe, E. (2002). *Asdreni për gjuhën dhe gjuha e Asdrenit*. në *Gjuha jonë*. nr. 3-4. Tiranë.

Qosja, R. (1970). *Lirika shqipe*. në *Jehona*. Shkup, nr. 6, f. 3.

Robert, E. (1997). *Histori e letërsisë shqiptare*. Dukagjini, Tiranë-Pejë, f.104

Xhiku, A. (2000). *Parathënie e Asdrenit*. në *Poezi të zgjedhura*. Dituria, Tiranë, f. 10.

Xhiku, A. (2004). *Letërsia shqipe si polifoni*. Tiranë, Dituria, f.74.

LIRIKA MEDITATIVE E ASDRENIT, VLERAT DHE RISITË NË ZHVILLIMIN E POEZISË SHQIPE

Laureta KONOMI

Mirela SARAÇI

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë

laureta.dhoska@hotmail.com

mirelagjirokaster@yahoo.com

Abstrakt

Në poezinë e Asdrenit poezia lirike meditative zë një vend të rëndësishëm si për nga hapësira sasiore , ashtu edhe për nga veçantia e shprehjes artistike. Temat e natyrës, vdekjes, jetës, dashurisë, bukurisë, moralit, ëndrrës, shpirtit gjenden më vete, por edhe të gërshetuara me motive të tjera, si motivi atdhetar, shoqëror, etj.

Në këto poezi ai përdor perceptimin emocional për të zbuluar kuptimin e pyetjeve që e shqetësojnë atë dhe njeriun në përgjithësi. Për të shprehur këtë perceptim Asdreni kujdeset të përdorë një gjuhë të përkorë me ngarkesë stilistike të përpunuar shumë mirë artistikisht.

Arsyeja pse është zgjedhur lirika meditative e Asdrenit për këtë temë është se ajo përbën një kontribut me vlerë në historinë e letërsisë shqipe për faktin se është pikërisht, kjo lloj poezie, që mundëson kalimin nga stili romantik i shprehjes në stilin modern. Për herë të parë në letërsinë shqiptare merr përparësi shprehja e imagjitës, lirisë individuale në përmasa të tjera nga liria shoqërore dhe kombëtare, dhe qëndrimit impresionist.

Kjo poezi meriton të vecohet, dallohet, e vlerësohet veçmas dhe e krahasuar me pjesën tjetër të poezisë së tij.

Fjalët kyçe: moderne, lirikë, impresioniste, Asdreni

Gjysma e parë e shekullit XX, solli dukuri dhe individualitete të cilat, procesin e kalimit nga poetika romantike e Rilindjes e realizuan duke sjellë forma dhe modele të reja ku spikatnin prirjet moderniste, elemente të simbolizmit, parnasizmit, pra elemente që shenojnë fillimin e shpërbërjes së romantizmit.

Në vazhden e funksionimit të lëvizjeve më të mëdha letrare evropiane, në letërsinë shqiptare merr hov zhvillimi i letërsisë moderne duke bashkuar të gjithë shkrimtarët shqiptarë rreth një programi më të gjerë.

Edhe Asdreni i ndikuar nga kjo frymë e shndëroi dhe vuri poezinë e ti në shërbim të ndryshimeve të gjithanshme shoqërore e politike, për emancipim arsimor dhe kulturor dhe sidomos për zhvillimin e letërsisë realiste.

“Dhe me të drejtë vepra e Asdrenit fillon të konsiderohet” lloj” në kapërcyell të romantizmit dhe në fillim të modernizmit. Duke i njohur Asdrenit, modernizmin si tipar të shprehjes tematike e gjuhësore, arrijmë të ndricojmë edhe përbërës të tjerë të rëndësishëm të poezisë së tij, siç janë: përmbajtja intelektuale, intertekstualiteti me mitologjinë dhe historinë, një lloj patriotizmi me shqetësim të spikatur shoqëror brenda, estetizimi i shprehjes, lirizmi i pastër dhe i përhershëm edhe në trajtimin e temave historike, atdhetare dhe mitologjike, interferime të elementëve parnasianë e simbolistë”¹.

Cabej ishte i pari që bën një ndarje të letërsisë në dy periudha: “Periudha e parë ka në thelb idenë kombëtare dhe periudha e dytë ku ideja kombëtare i lë udhën idesë njërëzore”² dhe më tej vazhdon: “Po të marrim në dore veprat e Asdrenit, do të shohim të cfaqur atje fillimet e kësaj periudhe të dytë, e cila mund të quhet periudha moderne e poezisë shqiptare”³.

Këtë mission të rëndë por edhe të rëndësishëm të rilindasve e vazhdoi po me atë entuziazem ndoëse me një ton më realist edhe Asdreni, i cili u formua shpirtërisht nën ndikimin e tyre.

Ndonëse i pavënë re sa duhet, nga kritika dhe nga lexuesit, Asdreni është nga shkrimtarët më kontribues në fushën e letërsisë, në lëvizjen kombëtare të rilindjes dhe në emancipimin e letërsisë shqipe. Për shumë dekada klasifikimi i tij në mënyrë tërësore në letërsinë romantike të Rilindjes Kombëtare dhe identifikimi i përmbajtjes së veprës vetëm me shqetësimin atdhetar e shoqëror, bëri që në mënyrë, jo të qëllimshme, të mbeteshin pa u vënë re edhe shumë vlera e risi të

¹ Sabri Hamit, “Letërsia Moderne Shqiptare”, Albas, f.14

² Eqrem Cabej, “Jeta e re”, nr4, 1998, fq.662. “Gazeta e re”, 22 shkurt, 1929, f.3.

³Sabri Hamiti, “Letërsia moderne shqiptare”, alb-s, Tiranë, 2001, f.11.

poezisë së tij që lidhen ngushtë me lëvrimin e lirikës moderne në letërsinë shqipe.

Ndërsa profesor Ali Xhiku, thekson se: “poezitë e fundit të Asdrenit paraqesin dallime të rëndësishme në formë e përmbajtje nga ato të fillimit”⁴, profesor Rexhep Qosja i kushton vëmendje ndikimit të letërsisë evropiane në veprën e tij.: “ai pasuron poezinë shqipe, me një formë të re të reagimit emocional dhe shpirtëror ndaj jetës në tërësi. Me vizionet e tij mund të thuhet që në poezinë shqipe depërton edhe një hapësirë e re e realitetit , që zgjeron përmbajtjen e ndjenjave poetike”⁵ Vepra e tij shënon një hap përpara në pikëpamje të evolucionit ideo-artistik .Në qoftëse ndjenja patriotike romantike është tipari themelor i letërsisë së romantizmit shqiptar, ndjenja patriotike e përshkruar prej vetëdijes sociale, është një prej karakteristikave që përshkon poezinë e tij.

Kushtet historiko-politike të Shqipërisë në atë periudhë ndikuan në bindjen e poetit se poezia duhet të jetë në krah të politikës dhe kjo poezi do të kishte rolin kryesor në ngritjen shpirtërore të lexuesit dhe në formimin e vetëdijes kombëtare.

Vizioni i këtij shkrimtari solli ndryshime të rëndësishme ideore tematike dhe stilistike.pra për krijimin e një letërsie të re jo vetëm kritike realiste por edhe moderne.

Rexhep Qosja evidenton risitë e sjella nga Asdreni i ndikuar dukshëm nga letërsia evropiane: “ai pasuron poezinë shqipe, me një formë të re të reagimit emocional dhe shpirtëror ndaj jetës në tërësi. Me vizionet e tij mund të thuhet që në poezinë shqipe depërton edhe një hapësirë e re e realitetit, që zgjeron përmbajtjen e ndjenjave poetike”⁶

Poezia e tij sjell koloritin, peizazhet dhe ngjyrat, temat dhe motivet e letërsisë evropiane, sidomos asaj postromantike Rumune, letërsisë që ai kishte më shumë kontakt. Megjithëse jeta larg atdheut fizikisht, sepse shpirtërisht ishte atje, ndikoi që poezia e tij të merrte vullën e

⁴ Ali Xhiku, Letërsia shqipe si polifoni, Tiranë, Dituria 2004, f. 23

⁵ Rexhep Qosja, Panteoni i rralluar, Tiranë1988, f.162.

⁶ Rexhep Qosja, Panteoni i rralluar, Tiranë, 1988, f.184.

dhimbjes, gëzimit, ngadhnjimit, dështimit, shpresës, dilemat e shumta, përsëri ajo i ka zgjeruar kufijtë e saj , duke pasuruar temën dhe fizionominë e saj stilistike.

Po flasim për një poet larg vendlindjes, pa nxitje dhe motive që t'i krijon vendi dhe jeta e njerëzve të tu dhe kështu i shtrënguar detyrohet të jetojë shumë gjatë imagjinasivisht, në një të shkuar e cila është bërë edhe tema e tij më e shpeshtë, dhe në disa raste edhe e vetmja.

Ishte poeti që përkëdhelej vetëm prej poezive të tij të pabotuara, sepse të botuarat thoshte janë të popullit, poeti më shumë i pezmatuar se i gëzuar, poeti që vuante për të gjithë ata që vuanin, prandaj dhe poezitë e tij i përshkon nostalgjia dhe sentimentalizmi, por me një ndjenjë të lartë humanizmi, një vetëdije e lartë etike dhe një dashuri e madhe për njeriun pa dallim feje, kombësie, rrace një vlerë asnjëherë e vjetëruar e letërsisë së një populli të vogël.

Nga të gjitha veçoritë e mësipërme, në këtë kumtesë, kemi për qëllim të bëjmë objekt të receptimit kritik dhe interpretues prirjen meditative të poezive të Asdrenit, prirje që i hap rrugë shprehjeje modernitetit të veçantë të veprës së tij. Meditimi në poezinë e Asdrenit shfaqet si frymë përshkruese , shfaqet si motiv i pastër i tyre, shfaqet i shkrirë në motive të tjera bazë, siç janë motivi i natyrës, i dashurisë, motivi shoqëror. Në të gjitha rastet meditimi i Asdrenit është në funksion të qëndrimit dhe të pikëpamjeve intelektuale të tij dhe lirizmit të theksuar që diferencojnë veprën e tij nga tradita.

Gati në të gjithë shpërndarjen tematike të poezive të tij, Asdreni i largohet evokimit me qëllim himnizues, mitizimit, deklarativizmit dhe idealizimit të traditës letrare shqiptare, duke ruajtur tonet e qeta dhe të përmbajtura me të cilat përshkruan imazhet autentike të jetës shqiptare, pjesë të kulturës materiale dhe shpirtërore. Përmendim poezitë “Letër prej vendit tim”, “Durrësit”, “Adriatikut”, “Dodonës”, “Vlora”, “Mall vëllazërije”, etj.

Rritja e ngarkesës meditative shkon përkrah me prirjen dhe përsosjen e metodës krijuese. Në poezitë e vëllimit të parë, përkatësisht në dy përmbledhjet e para "Rreze dielli" dhe "Ëndrra dhe lotë", poezitë nxiten

nga pasioni për të qenë pjesë e qarqeve intelektuale dhe atdhetare dhe pjesë e shkrimtarëve që po shtronin me përkushtim, jo vetëm rrugën iluministe të zhvillimit të Shqipërisë, por po krijonin me seriozitet e angazhim edhe traditën e re letrare me parim të parë vetëdijen e pastër artistike e estetike.

Asdreni, sic e tregon edhe përmbajtja tematike e poezive të tij, dëshmoi angazhim maksimal në këtë drejtim. Pasioni dhe angazhimi shfaqen në shtrimin e çështjeve emergjente për zgjidhje, si çlirimi nga pushtuesit e huaj, lufta për afirmim kombëtar, lufta për kultivim të gjuhës kombëtare, rruga për përparim shoqëror përmes kulturës, atdhetarizmit dhe përparimit.

Fillimisht në këto poezi spikat ndjeshmëria romantike, e cila vjen gjithmonë duke u dominuar nga racionaliteti intelektual dhe reflektimi i poetit me qëllimin për të qenë më bindës e më i besueshëm. Dimension i realist dhe modern i kësaj poezie është edhe si pasojë e ndikimit të letërsisë rumune.

Ndikimi i letërsisë dhe i kulturës evropiane, sikundër ishte Bukureshti dhe duke njohur gjuhën rumune, Asdreni ka pasur mundësi t'i nënshtrohet dhe të pranojë ndikimet e poezisë moderne evropiane, të cilat janë treguar frytdhënëse në historinë e letërsisë shqipe.

Në vëllimin "Psallme murgu", tonet e thirrjes, kërkesës, evokimit, humbasin hapësirën shprehëse përball dyzimit, ballafaqimit të alternativave pro dhe kundër, pranisë së ndjeshmërisë individuale dhe pesimizmit tipik që karakterizoi fundin e krijimtarisë së poetit. Tani zëri i poetit është më i përmalluar, më refleksiv dhe i prirur drejt nxjerrjes së përfundimeve historike, shoqërore, etike, morale dhe filozofike.

Vëllimi "Psallme murgu" çelët me poezinë "Vjershave të mia" ku poeti identifikon veten dhe rrugëtimin e tij dhe përmes vargjeve, ligjerimit poetik në të shkuarën, përkufizon gjithë qëllimin dhe rolin e vet në jetë:

*Me ju, përmenda motin e kaluar
Në radhët shkruar pashë shpirtin tim
Me pika lotësh zemre të lënduar
Me ju të thara, mbetur si kujtim*

*Ndër ju sa case gazi dhe pikëllimi
Sa drithma trupi s"pata ndjehur plot
Kur shihja në cdo radhë dorëshkrimi
Hir dashamiri, hir që s'e gjej dot⁷*

Asdreni thekson fjalët celës që mbartin karakterizimin e poezive të tij, si gazi e pikëllimi, moti i kaluar, shpirti, kujtimi dmth dëshmia dhe së fundi dashamirësia që është e rrallë për t'u gjendur e që këtu nënkupton idealizmin e pastër dhe angazhimin e plotë në qëllimin, të cilit i ka besuar dikur.

Rexhep Qose në studimin "Asdreni, jeta dhe vepra e tij", poezitë që ne i studiojmë si meditative, i grupon në kapitullin "Poezia e paradokseve shpirtërore" duke i ndarë në "Poezia dhe Përsiatjet", "Poezia e vuajtjes dhe dhimbjes" dhe "Poezia e vizioneve kozmike".⁸

Më tej ai shprehet se "Poezia meditative e Asdrenit, shumë më dukshëm se poezia atdhetare, e natyrës dhe e dashurisë, është dëshmi e formimit të tij përfundimtar në kushte të huaja shoqërore dhe kulturore. Kjo poezi shpreh më së miri gjendjen e tij, problemet dhe mendimet e tij intime. Në qoftë se e shikon krahas poezisë atdhetare, poezia meditative e Asdrenit është e krijuar, prej dy unesh, prej dy vetash të ndarë rreptësisht nga njëri-tjetri."⁹

Asdreni krijoi poezi lirike që prej fillimeve të krijimtarisë në "Ëndrra dhe lotë" deri te vëllimi i fundit "Psallme murgu". Si lirik ai shoqëroi gjithçka që tematizoi me reagimin shpirtëror dhe intelektual. Në këtë mënyrë, meditimi dhe refleksiviteti shoqërojnë edhe poezitë me temë të atdheut, lirisë, gjuhës, çështjeve kombëtare, politike, historike, etj. Në vargjet :

*Ardhi dita e lirimit,
Dita e bukur e bashkimit,
Mblidhuni, o shqipëtarë,*

⁷ Asdreni. Poezi të zgjedhura, f. 101, Tiranë, 1999.

⁸ Rexhep Qosja, Asdreni, jeta dhe vepra e tij,

⁹ Rexhep Qosja, Asdreni, jeta dhe vepra e tij, f. 363

Qytetarë e katundarë

*Gegë, toskë vllazën jemi,
Të dy bashkë një emër kemi,
Dhe një fat në këtë botë
Shqypetar, jemi fjala thotë¹⁰*

autori parashton rrugën dhe nxjerr si kërkesë të arsyetuar dhe të mirëmenduar dashurinë për lirinë dhe përparimin e atdheut, rrjedhimisht edhe të individit. Ne perceptojmë njëkohësisht në këto vargje dy plane: dashurinë për atdheun nga njëra anë dhe bindjet, pikëpamjet dhe vizionin për mundësitë e qytetërimit në anën tjetër.

Edhe pse e cilësuar si poezi me tematikë shoqërore, aktuale, historike apo atdhetare, përmes një leximi të kujdesshëm, ne vërejmë në vëllimin "Ëndrra dhe lotë" dhe "Rreze dielli", shumë poezi me elementë të theksuar meditativ, të cilat kritika më parë i ka cilësuar thjesht poezi romantike. Tituj të tillë si "Tingëllimë", "Pamje vjeshte", "Perëndim dielli në verë", "Ardhja e dimrit", "Ditë prilli", "Shpestë udhëtarë", "Ditë prëndvere", etj, po ashtu poezi të tjera të vëllimit "Psallme murgu" i "Adriatikut", "Maleve tanë", "Letër prej katundit tem", etj, përmes raportit specifik që vendos poeti me natyrën shprehet uni i tij, përvoja intelektuale, njohja dhe vetënjohja, si dhe përfundimi filozofik si proces i natyrshëm që shoqëron krijimin.

*Në fshat ditën duket heshtje,
Sipër tym ivec rrethon,
Për matanë dushku i vogël,*

*Po tunt kryet e vajton.
Her pushimit, zë dëgjohet,
Hëna, kodra, shpesh gjëmon,*

¹⁰ Asdreni. Poezi të zgjedhura, f. 65, Tiranë, 1999.

*Zë sopate depërton*¹¹

Sic ndodh shpesh me autorët e letërsisë së viteve 1920-1930, që poezitë e tyre i grupojnë në cikle apo nënndarje tematike, edhe poezia e Asdrenit ndahet në njësi tematike të vecanta të cilat marrin edhe titujt përkatës në varësi të përmbajtjes së tyre. Cikli "Mendimtare" i përmbledhjes "Reze dielli", cikli "Mendime" i përmbledhjes "Ëndrra dhe lotë" dhe cikli "Vallja e jetës" në vëllimin "Psallme murgu" përfaqësojnë më së miri poezinë e nxitur nga motivi i pastër meditativ. Në këto poezi, përmes përjetimeve individuale, Asdreni zbulon raportin sfidues të njeriut me jetën, dashurinë, ëndrrat, moralin, të keqen shoqërore, etj. Rugëtimi i përhershëm nëpër këtë sfidë të pafund e gjithëpërfshirëse i jep edhe tonet e zymta e melankolike shumicës së poezive të tij.

Vargjet:

*S'di kështu pse jam o zot,
Që qanj dit' e nat' me lot
Edhe më s'qetohem dot!*

*Zemra here më vajton
Edhe shpirti helm kullon
Si mburimi, që s'pushon*¹²

përshkruajnë rrugën e kërkimit të lumturisë, të cilën, poeti, për vetë natyrën e tij, e sheh të pamundur për t'u arritur.

Asdreni jetoj gjithmonë me banim jashtë atdheut, por me aktivitet dhe angazhim gjithmonë në shërbim të tij prandaj shpirtërisht ai lundroi në detin e dhimbjes, gëzimit, ngadhënjimit e dështimit.

Duke qenë një poet larg vendlindjes pa nxitje dhe motive që t'i krijon vendi dhe jeta e njerëzve të tu, ai jetoj shumë gjatë imagjinativisht, në një të shkuar e cila u bë edhe tema e tij më e shpeshtë dhe në disa raste

¹¹ Asdreni, "Reze dielli", "Ëndra e lotë", f. 306, Tiranë, 1976

¹² Asdreni, "Reze dielli", "Ëndra e lotë", f. 325, Tiranë, 1976

edhe e vetmja.

Tone të qarta meditimi mbartin gjithashtu poezitë me temën e dashurisë. Në poezitë "Mallit tim", "Dashuria", "Ndën dritare", "Kujtimi i saj", ku dashuria nuk merr forma konkrete, por konceptohet si ëndërr, si kërkesë e njeriut për të përmbushur një përvojë të rëndësishme të jetës, dashuria paraqitet përmes dualiteteve dashuri-jetë, dashuri-lumturi, dashuri-vuajtje, dashuri-mall, dashuri-ëndërr.

Në këtë mënyrë ajo kapërcen ndjeshmërinë pasionante dhe merr trajtën e përkufizimit, përsiatjes, përcaktimit të rolit të saj në jetë dhe brenda njeriut, si dhe në zbulimin e misterit të energjisë së saj.

Në një prej poezive të titulluara "Tingëllimë"(autori ka shumë të tilla që i titullon thjesht tingëllimë), ai e përshkruan dashurinë përmes intertekstit me dukuri e personazhe mitike, duke bashkuar kështu përjetimin individual me përkufizimin universal të saj:

*O, lermëni tek ëndrat e mia
Të ngjitem, lemëni, ndaj qielli i lirë.
Atje ku prehje, paqe gjej më mire,
Ku shpirti I em e ka shpëtim' e tija.*

*Lark, lark, trishtime të këqija,
Lark, ju mejtime, s'dua errësirë!
Përhapini në t'dheut gjerësisë
Edhe udhë bëmëni ndaj lumtësia!¹³*

Realizimin më të arrirë motivi meditativ e arrin në poezitë që tematizojnë krijimin artistik dhe shpirtin e poetit.

Ashtu si Lasgush Poradeci, Asdreni e shikon poetin të predispozuar për përjetime e kërkime të thella shpirtërore dhe intelektuale. Kjo prirje shndërrohet në dramën dhe dhuntinë e tij gjeniale në të njëjtën kohë.

Në poezitë "Vjershave të mija", "Lumtësija", "Përfytyrim", "Çast hidhërimi", etj., shohim një shpirt e mendje që lundron në kërkime,

¹³ Asdreni, Poezi të zgjedhura, nga vëllimi "Endra e lotë", f. 86, Tiranë, 1999.

lexime, reflektime, sinteza të cilat e përfshijnë tërësisht atë.

*Ju mbloodha, vjersha, nga ju kasha lënë
E një nga një ju pashë prap me mall,
Më dridhej dora si njëj të pangrënë,
Që dridhet pas ca buke q’e sheh rrall’...*¹⁴

Qënia e dyjësuar e poetit, vetëdija, nënvetëdija, ëndrra, imagjinata etj., janë tipare që shtrihen pothuajse në të gjithë këtë lloj poezie dhe do të ndikojnë që Asdreni të tërhiqet në guackën e vet të vetmisë, ku është i detyruar të dëgjojë zërin e vetëdijes dhe ndërdijes, e cila është pjesa më e tronditur e qënies së tij dhe arsyeja që kjo do të ushqejë imagjinatën e tij krijuese për të shkruar edhe poezinë e problemeve irracionale.

Konceptin e Asdrenit për Zotin do ta shohim në monologjet e gjata me veten, ku poeti reagon ashpër ndaj praktikave fetare, madje shkon deri atje sa vë në dyshim ekzistencën e tij.

Ai shumë rrallë e thërret dhe i zhgënjyer prej tij gjithë vizionet që ka mbi jetën i shpreh në mënyrë fataliste.

Poezia “Paradoks” është një prej poezive më të fuqishme, ku jo vetëm stigmatizon rolin e fesë, por ngrihet edhe ndaj paradoksizmit të saj.

Për poetin jeta është si një rreth vicioz dhe ku atje njeriu është i dënuar përjetësisht të vuajë pakënaqësinë, pafuqinë për të dalë prej këtij rrethi. Dhe ky njeri është vetë ai.

“Paradoks” si testament shpirtëror i Asdrenit, është një monolog i gjatë i poetit të dyjësuar, por pa humbur besimin në Zot, i gjithë problemeve që shqetësojnë koshiençën dhe subkoshiençën e tij.

Jeta për të është vetëm një iluzion, një mashtrim, ku të gjitha dëshirat dhe shpresat e kanë fundin të hidhur dhe zhgënjyes.

Përmendim poezinë “Kotesia” ku pesimizmi dhe fatalizmi tipare të letërsisë moderne europiane, do të mbizotërojnë në këtë poezi.

Qenia njerëzore për Asdrenin është hipokrite, lakmitare dhe egoiste ndaj ai i godet ashpër, “Pendim egoist”, “Lulja e zemrës” etj. dhe duke

¹⁴ Asdreni, Poezi të zgjedhura, nga vëllimi “Endra e lotë”, f.101, Tiranë, 1999.

qenë në mëkat ndaj natyrës vuajtja është çmimi që do të marrë prej saj. Poeti e gjen ngushëllimin te amshimi, prandaj shpesh e identifikon veten me murgun, i cili më shumë se plotësimit të epsheve të ekzistencës, ja kushton jetën pastërtisë së shpirtit siç ndodh te “Deshirë pagane”. Shpirti i larguar prej trupit do të shkojë në qiell, i cili është i vetmi ngushëllim për të dhe kështu do të qetësohet.

Duke përfunduar mund të themi se poezia në të cilën gërshetohen motive, refleksive, peisazhi a filozofike dhe veçanërisht poezia me motiv të pastër meditativ, dëshmon jo vetëm karakterin modern të lirikës së tij, por edhe angazhimin e vazhdueshëm dhe punën e gjatë sistematike të poetit për të realizuar një vepër të rëndësishme në formë dhe në përmbajtje.

Ishte një poezi e poetëve që po vetëdijësoheshin për vlerat estetike dhe artistike të letërsisë dhe që u ndikuan nga modelet më të mira të letërsisë europiane.

Pjesë e kësaj prirjeje për estetizim, emancipim, integrim dhe përsosje të kulturës shqiptare ishte edhe Asdreni.

Bibliografi e shfrytëzuar:

Jorgo Bullo, “Magjia dhe magjistarët e fjalës”, Tiranë 1983”.

Ali Xhiku, “Letërsia shqipe si polifoni”, Tiranë, 2004.

Sabri Hamiti, “Studime letrare”, Prishtinë, 2004.

Rexhep Qosja ,”Shkrimtarë dhe periudha” Tiranë, 2005.

Sabri Hamiti, “Letërsia bashkëkohore”, Prishtinë, 2002.

Agim Vinca, “Struktura e zhvillimit të poezisë shqipe”, Prishtinë, 1997.

Asdreni, vëllimi “Ëndra dhe lotë”, Bukuresht 1912.

Asdreni, vëllimi “Psallme murgu”, Albania in Constantza,1930.

Asdreni,” Poezi të zgjedhura”, Tiranë, 1999.

Asdreni, “Rreze dielli”, “Endra e lotë”, Tiranë, 1976.

FUNKSIONET E FJALËZËS NJË NË GJUHËN E VEPRËS SË ASDRENIT

Hysnie HAXHILLARI
Universiteti “Fan S. Noli” Korçë

Abstrakt

Fjalëza *një* kryen disa funksione në gjuhën shqipe: ajo shërben si *nyjë* e pashquar, si *numëror* dhe si *përemër* i pacaktuar. Dy funksionet e fundit të fjalëzës *një* njihen dhe janë studiuar gjerësisht në gramatikat e gjuhës shqipe, ndërsa funksioni i saj si *nyjë* e pashquar është vënë në diskutim, deri në mosnjohje (Gramatika e gjuhës shqipe, I, 1976). Në këtë kontekst shihet e nevojshme të përcaktohet statusi i fjalëzës *një* si *nyjë* e shqipes, e ngjashme për nga funksioni me *nyjën* e anglishtes *a/an*. Për të realizuar këtë qëllim, i referohemi veprës së Asdrenit, si mbartëse e një tradite më të hershme gjuhësore, si një variant historik dhe poetik, ku do të synojmë gjurmimin e sintagmave caktuesore me caktuesorin e pashquar *një*. Realizimit të këtij qëllimi do t’i shërbejë edhe analizimi dhe dallimi i dy funksioneve të tjera të saj, si *numëror* dhe *përemër* i pacaktuar.

Fjalë kyç: gramatikë, një, *nyjë* e pashquar, numëror, përemër i pacaktuar

I. Hyrje

Njohja me funksionet gramatikore të fjalës “*një*” në gjuhën e veprës “Poezi të zgjedhura”¹ të Asdrenit përbën një nga ato studime gjuhësore që mbështeten në një variant gjuhësor që i përket një shekulli më parë, si dhe një regjistri gjuhësor të veçantë siç është ai poetik. Thënë kjo, objekti ynë i studimit – funksionet e fjalës “*një*” kushtëzohet nga diakronia, tiparet e shqipes të një shekulli më parë, si dhe nga gjuha poetike e Asdrenit, nga stili i tij etj. Megjithëkëtë, gjuha e veprës së Asdrenit përbën një burim të gjendjes së gjuhës shqipe në gjysmën e parë të shek. XX, prandaj edhe ka rëndësi për studimet gjuhësore. Qëllimi im është që të shoh përdorimin e fjalëzës “*një*” në të tria përdorimet e saj: si *nyjë* e pashquar, në përdorimin e saj si *numëror* dhe

¹ Asdreni, Poezi të zgjedhura, Dituria, 2000

si përemër i pacaktuar. Ky vëzhgim do të nxjerrë në pah se cili është përdorimi më i shpeshtë i saj ndër këto përdorime. Me anë të këtij vëzhgimi do të mund të shohim se a ka fjalëza *një* funksionin e nyjës së pashquar në gjuhën shqipe të gjysmës së parë të shek. XX, a është e domosdoshme nyja e pashquar në sintagmat emërore në gjuhën poetike, a është e zëvendësueshme ajo në këto kontekste dhe me cilin element mund të këmbëhet.

Në gramatikën e gjuhës shqipe fjalëzës “një” i njihen dy funksione kryesore, ai i numërorit dhe funksioni i përemrit të pacaktuar. Ndërkaq, funksioni i fjalës “një” si nyjë e pashquar nuk njihet (Gramatika e gjuhës shqipe, I, Akademia e Shkencave, 1976), edhe pse në mjaft gramatika para dhe pas botimit të saj, fjala “një” klasifikohet si nyjë e pashquar, e ngjashme për nga funksioni me nyjën e pashquar të anglishtes *a/an*. Nyja e pashquar *një* përbën një çështje mjaft të diskutuar në gramatologjinë shqipe për dy arsye: ajo nuk njihet si pjesë më vete e ligjëratës, as si mjet i realizimit të kuptimit të pashquarsisë siç ndodh me gjuhët që kanë nyjë të pashquar. Madje, nyja e pashquar *një*, nga pikëpamja sintaksore, trajtohet si gjymtyrë më vete e fjalisë, jo si një gjymtyrë me emrin që i paraprin.

Morfologu Sh. Demiraj në tekstin universitar “Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe” nyjën *një* e quan “një fjalëzë proklitike”, duke i njohur vlerat e saj si element dallues i trajtës së pashquar të emrit. “Kur një emër i përgjithshëm përdoret në trajtë të pashquar të numrit njëjës, – shkruan Demiraj, – ai zakonisht shoqërohet me fjalëzën *një*, e cila si nyje e trajtës së pashquar shqiptohet e patheksuar”². Emri me nyjën joshquese *një* shënon “një frymor, një send etj., të pacaktuar, dmth. cilindro nga frymorët, sendet etj., të një klase” dhe në këtë rast mund të zëvendësohet me mbiemrin e pakufishëm *çdo* a *secili*, p.sh.: **një** (= **çdo** a **secili**) nxënës..., **një** (= **çdo** a **secili**) njeri etj.; por edhe “një frymor, send, etj. të caktuar, që folësi e njeh, kurse dëgjonjësi nuk e njeh ende”, p.sh.: *Dje më erdhi në shtëpi një shok, i cili më solli një libër*.

² Sh. Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Prishtinë, 1971, f. 55

Gramatika akademike në kreun e parë “Njohuri të përgjithshme” nuk e quan nyjën si pjesë të veçantë të ligjëratës, por në pjesën e fundit të kreut mbi emrin, nyja “përfshihet në klasën e përcaktorëve, të cilët shërbejnë për të individualizuar”, por dallon nga përemrat dëftorë, përemrat pyetës, përemrat pronorë, disa përemra të pacaktuar dhe numërorët themelorë, sepse “nuk ka kuptim leksikor të mëvetësishëm dhe është bërë kështu një fjalë shërbyese”³. Në këtë paragraf thuhet se “dalohen dy lloje nyjash, nyja e caktuar ose nyja shquese dhe nyja e pacaktuar ose nyja joshquese” dhe shpjegohet se emri me nyjë shquese shënon një frymor a send plotësisht të individualizuar si për folësin, edhe për dëgjuesin, ndërsa emri i shoqëruar me nyjën e pacaktuar nuk është plotësisht i individualizuar, pasi është i panjohur për dëgjuesin. Më tej, përmenden “treguesit gramatikorë që i përgjigjen nyjës shquese” (-i, -u, -a për njëjës dhe -t(ë) për gjininë asnjansë dhe shumësin e të tri gjinive) dhe si mjet për shprehjen e pashquarsisë pranohet nyja e pacaktuar (“si nyjë e pacaktuar shërben fjala *një*”).⁴ Në këtë gramatikë përcaktohet origjina e nyjës së pashquar *një* për të cilën thuhet se “ka dalë nga numërori themelor *një*, i cili, kur përdoret si nyjë, ose e dobëson kuptimin e të treguarit të numrit, ose gati e humbet fare dhe shkrihet kuptimisht me emrin, duke u shndërruar në një fjalë shërbyese”. Më tej, vihen në dukje dallimi midis numërorit *një* dhe nyjës joshquese *një* që “ka një theksim të dobët” dhe ngjashmëria e numërorit me nyjën homonime për sa i përket kategorisë së gjinisë, që mungon tek të dy. Po veç këtyre, kur është nyjë *një* ka edhe kuptim sasior të dobësuar dhe në ndonjë rast, si p.sh. kur emri i pashquar është në funksionin e kallëzuesorit, nyja edhe mund të hiqet; “kur është numëror themelor”, një “ka theksin e vet dhe mund t’i vihet për përforsim edhe pjesëza vetëm” ose mund t’u kundërvihet në fjali numërorëve të tjerë (bleva *vetëm* një libër; bleva një libër, jo *dy*); dhe, kur është përemër i pacaktuar, *një* nuk shoqërohet nga emri)⁵.

³ *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe*, II, Akademia e Shkencave e RP së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1976, f. 120.

⁴ Po aty.

⁵ *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe*, II, vep. e cit., f. 122–123.

Për sa i përket aspektit kuptimor, në këtë vepër vihet në dukje se nyja e pacaktuar *një* përdoret kryesisht kur emri ka kuptim të individualizuar, por edhe kuptim të përgjithësuar. Kur përdoret me kuptim të individualizuar, emri me nyjën joshquese *një* tregon një nga sendet e një klase, po pa e përcaktuar se cilin syresh, pra individualizimi nuk është i plotë. Sipas autorit të kreut të emrit, kur përdoret “në këtë kuptim nyja një afron me përemrin e pacaktuar *një farë*”, duke vënë në dukje tiparet e përbashkëta të një sendi me sendet e tjera të së njëjtës farë.

Aty tregohen edhe rastet e përdorimit të emrit të pashquar me nyjën *një*: kur emri përdoret për herë të parë, duke qenë i njohur për folësin, po jo për dëgjuesin (Te praku i portës qëndronin dy hije: **një plak** dhe **një plakë**.), kur emri del si kryefjalë, si kundrinë, si përcaktor në gjinore, si plotës vendi pas parafjalëve *në, nëpër, mbi, nën* (*Në hajat kërceu një lepur. Tashti kishte në shpinë një brengë të vazhdueshme. Krisma e një rrufeje* u duk sikur e çaut tokën dysh. Vështirimi shëtiti në **një amfiteatër**.); kur është kallëzues emëror dhe i ndjekur nga një përcaktor (Lugina e Matit është **një prehje** dhe **një gëzim** i rrallë për syrin.)⁶

Në çështjen e funksionit si nyjë e pashquar dhe dallimit të fjalës *një* nga numërori *një* i referohemi edhe studiuesit M. Çeliku i cili këmbëngul në dallimin e numërorit *një* nga nyja *një*: “nyja *një* nuk tregon sasi, nuk ka theks, emri në bashkëvajtje me të ka kuptime e përdorime karakteristike, të veçanta; nyja është e pamungueshme në gjinore e dhanore; krijon kundërvënie me mbaresat shquese; është e krahasueshme me nyjën joshquese të gjuhëve të tjera”. Prandaj, përfundon ai, nyjat joshquese *një* e *ca (disa)*, “që shoqërojnë emrat në trajtën e pashquar, janë fjalë shërbyese dhe pavarësisht nga numri i vogël i tyre, ato mund të trajtohen si pjesë më vete të ligjëratës”⁷.

⁶ Po aty, f. 121–122.

⁷ M. Çeliku, *Kontribut për dy probleme të morfologjisë së sotme shqipe*, Studime filologjike, 1971, nr. 1, f. 155.

Në vijim të përcaktimit prej Çelikut të nyjës së pashquar *një* si “fjalë shërbyese” mund të saktësojmë edhe rolin sintaksor që luan ajo në sintagmën emërore. Përkundër vështirimit të kësaj nyje si gjymtyrë përcaktore (Gramatikë., I, 1976), studimet gjenerative i njohin nyjës së pashquar rolin e elementit funksional, pa përmbjatje leksikore, por që shërben si kokë funksionale e sintagmave caktuesore (Abney, 1987). Në lidhje me emrin që paraprin, nyja e pashquar, së bashku me caktuesorë të tjerë të emrit, nuk kryen funksionin sintaksor të përcaktorit, pra të jetë gjymtyrë më vete e fjalisë, por ajo shërben si një fjalë ndihmëse ose shërbyese, e cila bën të mundur që emri të bëjë pjesë në thënie ose të hyjë në ligjërim.

II. Përdorimi i fjalëzws *një* si nyjë e pashquar

Nga vepra poetike e Asdrenit janë parë mjaft raste të përdorimit të fjalëzës “*një*” me funksionin e nyjës së pashquar. Këndvështrimi im në këtë punim është që fjalëza *një* të shihet si caktuesor i emrit, një kategori funksionale, joleksikore, e cila ndihmon emrin të hyjë në thënie.

Në këto përdorime vihen re këto veçori që e bëjnë atë të funksionojë si nyjë e pashquar:

- del e patheksuar
- nuk shërben për të numëruar
- përdoret me emra me kuptim të përgjithësuar dhe pjesërisht të individualizuar
- paraqet një koncept të panjohur për dëgjuesin, por të njohur për folësin (heroin lirik)
- i shërben emrit për hyrjen e tij në thënie

Nga shembujt e shumtë që janë vjelë në tekstin poetik të Asdrenit, veçojmë së pari një përdorim të rrallë të nyjës së pashquar të shqipes, me trajtën eptimore *njëj*, e cila del para një emri të pashquar në rasat emërore, gjinore e rrjedhore:

ju shkunda letra, dorës sime shkruar / **njëj** gjumi, munt q’as juve s’ju

pëlqen; më dridhej dora si **njëj** të pangrënë / kur **nj'** ankth përbrenda do s'më lë qetuar; qysh zëri i **njëj** vjolie tingëllfjetur / çdo brengë si me dorë që ta merr; dhe si **njëj** korës herë q'i përkulesh / nj'ashtu dhe jush përpara po ju rri; sa kini përkujdesjet **njëj** kreshniku / që veç nër ju ka gjetur ngushëllim (Vjershave të mia f. 11, 12)

Në shembuj të tjerë ku fjala *një* ka funksionin e nyjës së pashquar vihet re se ajo shfaqet në këto rrethime:

- paraprihet nga një pjesëz krahasore, në përbërje të sintagmës emërore (si kryefjalë): *Si një yll shumë i çkëlqyer*
- në përbërje të sintagmave parafjalore me parafjalët *me, prej*: *Me një zë të perëndishmë; prej një së vjetër*
- në përbërje të sintagmave gjenitive: zëri i **njëj** vjolie; dor' e **njëj** fuqie së padukur
- në sintagma emërore me emër të pashquar, por edhe shembuj ku nyja e pashquar shfaqet në sintagma emërore me emër të shquar: **një** miku im i vërtetë (Njëj zogut, f. 99)

III. Përdorimi i fjalës *një* si numëror

Fjalëza *një* ka funksionin e saj edhe si numëror, me kuptimin leksiko-gramatikor të klasës së numërorëve që tregon numra abstraktë ose sasi të caktuar sendesh a qeniesh të një fare⁸. Në këtë përdorim fjala *një* shfaqet para emrave të numërueshëm, konkretë dhe kryesisht të përgjithshëm. Funksioni i numërimit e dallon nga fjala homonime *një* nyjë e pashquar, që nuk ka funksionin e numërimit, por të paraqitjes së konceptit të panjohur, remën e fjalisë, të paraqesë realien të pandarë nga klasa ku bën pjesë etj., si në shembujt: Gegë, toskë, vllazën jemi / **të dy** bashkë **një** emër kemi / dhe **një** fat në këtë botë; Prej **një** nane kemi lerë; me **një** diellë jemi rritur; si **dy** lisa pranë ngjitur; Të dy kemi një dëshirë / se **një** sisë kemi pirë / **një** të qeshur, **një** të qame; e **një** zemër të pandame (Kënga e bashkimit, f. 42). Këtë dallim e bën të qartë edhe Gramatika e gjuhës shqipe I, ku shkruhet “ Kur përdoret me vlerën

⁸ Gramatika e gjuhës shqipe, I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 1976, f. 203

e vet parësore, si fjalë që shënon sasi, numërori *një* është i theksuar dhe në këtë rast kuptimi i tij mund të përforcohet nga pjesëza *vetëm*.⁹

Në përdorimin si numëror fjala *një* përdoret edhe vetëm, pa emrin, duke u afruar kështu me përdorimin e saj si përemër i pacaktuar. Në këtë rast dallimi me përemrin bëhet nga funksioni i numërimit që ajo ka në këtë rast si në shembujt: e **një** nga **një** ju pashë prap’ me mall (Vjershave të mia, f. 11); Mejtimet s’rrjedhin **një** nga **një** (Mall i vonuar, f. 92).

Fjalëza *një* nga pikëpamja funksionale përbën sasiarin në sintagmat sasiore në të cilat shërben si kokë e sintagmës. Në grupin e sasioreve, në literaturën gjenerative klasifikohen si numërorët, ashtu edhe përemrat e pacaktuar. Nga shembujt e vjelë dallohen këto struktura:

- sasiori **një** + **emër** (plotësor): **Nji** kang’ po ashtu tuj e prit! (Zani i lahutës, f. 36); Gegë, toskë, vllazën jemi / të dy bashkë **një** emër kemi / dhe **një** fat në këtë botë; me **një** diellë jemi rritur; si **dy** lisa pranë ngjitur; Të dy kemi **një** dëshirë / se **një** sisë kemi pirë / **një** të qeshur, **një** të qame; e **një** zemër të pandame (Kënga e bashkimit, f. 42); veç rrall’e tek, **një** lule mbin ndën hije; Atij **një** përmendore të pavdekur (Krujës, f.44); **Nji** trup banie anemban’ Shqypninë (Kosovës, f. 48)

- sintagma sasiore të përbëra vetëm nga koka *një*: e **një** nga **një** ju pashë prap’ me mall (Vjershave të mia, f. 11); Mejtimet s’rrjedhin **një** nga **një** (Mall i vonuar, f. 92)

- sasiori *një* në përbërje të sintagmës parafjalore: po do t’luftonjë për **një** dhe / ku i madhi çlodhet Skanderbe! (Varrit të Skanderbegut, f. 33); Prej **një** nane kemi lerë; me **një** diellë jemi rritur (Kënga e bashkimit, f. 42); për **një** dru e për **një** tra (Vaje e pyllit, f. 73); Pa **një** fjalë, pa kuvent / Heth vështrimin të pasosur (Mendime qetësie, f. 90).

IV. Përdorimi i fjalës *një* si përemër i pacaktuar

Në grupin e sasioreve, në literaturën gjenerative klasifikohen si numërorët, ashtu edhe përemrat e pacaktuar. Fjalëza *një* përbën një sasiar, si në rastin kur është numëror, po ashtu edhe kur është përemër

⁹ po aty, f. 130

i pacaktuar. Duke qenë se qëllimi i këtij punimi është të krahasohen të tri përdorimet e lartpërmendura, po vijohet me dallimin në përdorim të fjalëzës një si përemër i pacaktuar.

Përdorimi i fjalës *një* si përemër i pacaktuar lidhet me kuptimin leksiko-kategorial të klasës së përmerave, si pjesë ligjërata që tregon në mënyrë të përgjithshme, pa i emërtuar frymorë, sende, tipare ose sasi të pacaktuara¹⁰. Si përemër i pacaktuar fjala *një* tregon frymorë a sende në mënyrë të pacaktuar ose sasi të pacaktuar të tyre. Kuptimi themelor i fjalës *një* si përemër i pacaktuar dhe që e dallon nga dy përdorimet e lartpërmendura është pacaktuesia e cila ruhet në çdo rrethanë ligjërimi. Për prejardhjen e përemrit të pacaktuar *një* Gramatika e gjuhës shqipe I dëshmon se lidhet me numërorin *një*, por ndryshon prej tij, sepse nuk tregon një sasi të caktuar, por një frymor apo send në mënyrë të pacaktuar. Ndërsa për sa i përket rrethimeve ku shfaqet përmendet se përemri i pacaktuar *një* ndiqet nga një emër me parafjalën nga, prej ose nga një fjali e varur përcaktore¹¹. Shembujt e vjelë nga vepra e Asdrenit “Poezi të zgjedhura” (2000) tregojnë se përdorimet e fjalës *një* si përemër i pacaktuar janë të paktë krahasuar me përdorimet e saj si nyjë e pashquar dhe numëror. Në këta shembuj përemri i pacaktuar *një* përdoret në dy rrethime: pa emrin dhe para një fjalie të varur ftilluese: **Një** argjendit, arit tjetër sot i falet! (Zëri i kryengritësve, f. 39); po veshin **një** s’m’a ve / as dorë s’m’ep njeri! (Luftari lypës, f.58); Këtu dukej **një** se urdhëronte; që shum’ i faleshin me unjësi (Një ëndërr, f.81); **një** zë e ckuqet, tjetër mverdheth (Mendime qetësie, f. 90)

Në përfundim të vëzhgimit të përdorimeve të fjalës *një* në gjuhën e veprës së Asdrenit, që përfaqëson edhe gjendjen e gjuhës shqipe në gjysmën e parë të shek. XX mund të themi se përdorimi i fjalës *një* me funksionin e nyjës së pashquar kryeson ndaj dy funksioneve të tjera, të numërorit dhe të përemrit të pacaktuar. Mbartja e funksionit të nyjës së pashquar nga fjala *një* në këto përdorime lidhet me atë që kuptimi gramatikor i pashquarsisë është i domosdoshëm të realizohet në thënie

¹⁰ Gramatika e gjuhës shqipe, I, AKAademia e Shkencave, f. 218

¹¹ po aty, f. 253

me anë të kësaj nyje. Ky funksion nuk mund të realizohet nga ndonjë element tjetër, qoftë semantikisht, në paraqitjen e një realije të panjohur për dëgjuesin, një realje me kuptim të përgjithësuar, qoftë sintaksorisht për të plotësuar emrin me caktuesorin përkatës që e lejon të bëjë pjesë në një thënie të caktuar dhe të kryejë role sintaksore në të. Nyja e pashquar një në shqipe shfaqet në përndarje plotësuese me caktuesorë të tjerë të emrit si përemrat dëftorë ose pronorë të paravendosur. Prandaj, si rrjedhim, funksioni i fjalës *një* si nyjë e pashquar, duke qenë i domosdoshëm në thënie a ligjërim, duhet të njihet nga gramatikat e ardhshme të gjuhës shqipe.

Bibliografi e shfrytëzuar:

Abney, S. P., *The English NP in its sentential aspect*, vol. 1, B.A., Indiana University (1983), MIT, 1987.

Agalliu, F., *Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*, Universitetit i Tiranës, Tiranë, 1988.

Agalliu, F., *Mbi pjesët e ligjëratis në gjuhën shqipe*, Studime filologjike, 1970, 4.

Buchholc, O., Fiedler, Ë., *Albanische Grammatik*, Leipzig, 1987.

Chomsky, N., (1970) *Remarks on Nominalisation* in R.A. Jacobs and P.S. Rosenbaum (eds) “Reading in English Transformational Grammar”, Ëaltham (Mass), Ginn & Co, 1970.

Cipo, K., *Gramatika e shqipes*, Instituti i Shkencave, 1949.

Cipo, K., *Sintaksa*, Tiranë, 1952.

Constantinescu–Dobridor, Gh., *Gramatica limbii române*, Editura Didactică si Pedagogică, Bucureşti, 2001.

Çeliku, M., *Probleme të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*, SHBLU, Tiranë, 1997.

Çeliku, M., *Sintaksë e gjuhës shqipe, (Përbërësit sintaksorë)* ILAR, Tiranë, 2012.

Çeliku, M., *Kontribut për dy probleme të morfologjisë së sotme shqipe*, Studime filologjike, 1971, 1.

- Da Lecce, F., M., *Osservazioni grammaticali nella lingua albanese*, Roma, 1716
- De Rada, J., *Grammatica della lingua Albanese*, G. de Rada, Firenze, 1870, në *Opere grammaticali*, Rubbettino, 2005.
- Demiraj, Sh., *Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe*, Tiranë, 1972.
- Demiraj, Sh., *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1961,
- Dhima, Th., *Gjuha Shqipe (Sintaksa)*, ShBLU, Tiranë, 2005.
- Dhimo, A., Angoni, E., Hysa, E., Lafi, E., Likaj, E., Agalliu, F., Demiraj, Sh., *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe*, II, Akademia e Shkencave e RP së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1976.
- Dozon, A., *Manual de la langue chkiye ou albanaise*, Paris, Ernest Leroux, 1879.
- Frashëri, S., *Shkronjëto e gjuhës shqip*, Dritë, Bukuresht, 1886.
- Graffi, G., *Sintassi*, Il Mulino, Bologna, 1994.
- Gramatika e gjuhës shqipe*, I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 2002.
- Gramatika e gjuhës shqipe*, II, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2002.
- Hysa, E., *Diskutim i gjerë i maketeve të “Morfologjisë” të “Gramatikës së gjuhës së sotme shqipe”*, Studime filologjike, 1974, 2.
- Hysa, E., Përnaska, R., *Studimet gramatikore gjatë 40 vjetëve të çlirimit*, Studime filologjike, nr. 1, 1985.
- Jungg, G., *Elementi grammaticali della lingua Albanese*, Scutari, 1881.
- Kamarda, D., *Saggio di Grammatologia Comparata della Lingua Albanese*, Livorno, 1864.
- Kostallari, A., Lafi, E., Totoni, M., Cikuli, N., *Gjuha letrare shqipe, elemente të normës së sotme letrare* (botim i dytë), Prishtinë, 1984.
- Kristoforidhi, K., *Gramatikë e gjuhës shqipe sipas dialektit toskë*, 1882.
- Mann, S., *A short Albanian Grammar*, London, 1932.
- Memushaj, R., *Koncepte dhe risi teorike në veprën shkencore të prof. M. Çelikut*, në “Mehmet Çeliku – personalitet i gjuhësisë shqiptare”,

Tiranë, 2016.

Memushaj, R., *Bukuria e gjuhës*, 2, Enti i teksteve dhe mjeteve mësimore, Podgoricë, 2008.

Myderrizi, O., *Gramatika e re e shqipes*, Gutenberg, Tiranë, 1944.

Neëmark, L., Hubbard, Ph., Prifti, P., *Standard Albanian – a reference grammar for students*, Standford University Press, Standford, California, 1982.

Pekmezi, Gj., *Grammatik der albanesischen Sprache*, Ëien, 1908.

Resuli, N., *Grammatica Albanese*, Patron Editore, Bologna, 1985.

Riza, S., *Vepra V*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Prishtinë, 2009.

Roehrs, D., *The morpho-syntax of the Germanic noun phrase: Determiners move into the determiner phrase*, Indiana University, 2006.

Rrota, J., *Analizimi i rasavet t’emnit e zhvillimi historik*, Shkodër, 1931.

Rrota, J., *Gramatika e shqipes*, Shkodër, 1930.

Sheperi, I., D., *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe*, Vlorë, 1927.

Topalli, K., *Nyjat e shqipes*, Toena, 2009.

Turano, G., Rrokaj, Sh., *A proposito del sintagma nominale in albanese. Il caso di un dimostrativo seguito da un DP definito*, *Lingua e stile*, 2000, Anno XXXV, No. 1, ff. 95–128 (ribotuar në Sh. Rrokaj, *Çështje të gjuhës shqipe*, Albatros, 2007, f. 47–88).

Xhuvani, A., *Libri i gjuhës shqipe*, II, K. Luarasi, Tiranë, 1937.

“PSALLME MURGU” – MËRZIA SI PARADOKS

Mirela SHELLA

Universiteti “A. Xhuvani”, Elbasan

Departamenti i Letërsisë dhe i Gazetarisë

mirela.shella@uniel.edu.al

Abstrakt

Është i pranuar nga të gjithë studiuesit se përmbledhja poetike “Psallme murgu” përfaqëson dhe veprën e pjekurisë artistike të Asdrenit, që padyshin është e lidhur ngushtë me pjekurinë e tij si njeri. Robert Elsie pohon: “Së bashku me dy vëllime të mrekullueshme nga Lasgush Poradeci (1899-1987), botuar në Rumani më 1933 dhe 1937, dhe vëllimi i vogël “Vargjet e lira”, 1936, nga i riu Migjeni (1911-1938), “Psallme murgu” shënon gjithashtu një pikë kthese në letërsinë shqipe. Modernizmi tashmë kishte filluar të dukej në horizont”¹. Ne gjykojmë se natyra moderniste nuk lidhet vetëm me faktin se kapërcehen temat tipike të Rilindjes, apo përdorimi i vargut të lirë. Siç do të përpiqemi të trajtojmë edhe në këtë punim, ne mendojmë se theksin modernist poezive të vëllimit “Psallme murgu” ia jep qasja ndaj kotësisë dhe mërzi, si ndjenjat rreth të cilave ndërtohet mendimi modernist. Mërzia si paradoks është rezultat i dy tendencave divergjente, të cilat janë krejtësisht të papërputhshme me njëra-tjetrën. Nga njëra anë kemi një dëshirë të fortë për të reaguar, ndërsa nga ana tjetër qëndron ndjesia e pamundësisë për të vepruar, që buron nga një ndërgjegje e hidhëruar dhe e zhgënjyer, e bindur për kotësinë absolute të çdo lloj veprimi. Shoqëria moderne drejt së cilës orientohej edhe shoqëria shqiptare, zhvillimet e të cilës Asdreni i ndiqte nga larg, nxirrte zbuluar – nën shenjën e “spleen”-it – peizazhin e shkretë të shpirtit modern.

Fjalë kyçe: *Asdreni, modernizëm, mërzi, spleen, letërsi shqipe*

Takimi me shenjat që shkrimtari lë për t'u "lexuar" në përhershmëri është gjithnjë joshës, edhe pse mund të mos arrijë në çdo rast të

¹ Robert Elsie, Histori e letërsisë shqiptare, Dukagjini, Tiranë-Pejë, 1997. f. 104.

komunikojë si dhe sa duhet me lexuesit², si pasojë e faktorëve të ndryshëm, moskuptimesh a paragjykimesh. Qosja shprehet: “Vepra poetike e Asdrenit nuk ka zgjuar gati asnjëherë interesimin dhe as ka gjetur trajtimin përkatës dhe historiografinë tonë letrare deri në kohën më të re. Për të madje, është shkruar më rrallë dhe me përciptaz se për disa shkrimtarë tanët të dorës së dytë apo të tretë”.³; megjithatë është domethënës fakti që njeriu krijues lë shenja të pashlyera pikërisht prej veprës së krijuar, më shumë se prej jetës së jetuar. Në fakt, për krijuesin, jeta e tij e vërtetë është pikërisht në veprat që ai krijoi, sepse aty janë ngulitur përjetimet, dëshirat, këndvështrimet, përpjekjet për t’u vendosur në një territor përtej së zakonshmes përmes diskurseve të përfutura nga vepra e krijuar dhe pamundësisë për ta gjetur a për t’u ndalur në atë territor, së bashku me ngushëllimin që vepra ka të tjera përmasa në kohë, jeton edhe përtej jetës së krijuesit të saj. Janë këta tregues shenjat e vërteta të jetës së krijuesit, përmes të cilave mundësohet krijimi i produktit estetik; është ky kërkim që i mundëson shkrimtarit të dialogojë me lexuesit në përhershmëri. Por, “Pozicioni i Asdrenit në kuadër të sistemit letrar shqiptar është dikotomik. Kritika e ka pasqyruar këtë gjendje në mënyrë të vetvetishme, por mozaikale, pa mundur, shi për këtë arsye të dytë, ta formalizojë e ta ndriçojë deri në fund. Asdreni, si fare pak krijues të tjerë shqiptarë, është njëherësh periferik dhe qendror. Ai lind si një qendër e periferizuar në kuadër të letërsisë shqipe. Periferik është kryesisht në vetvete; qendror e bën kryesisht gjendja e përgjithshme e sistemit letrar dhe kulturor shqiptar.

² Edhe Kristaq Jorgo është i mendimit se “Studiuesit (...), edhe pse mund ta kenë konstatuar paradoksin, nuk e kanë parë në këtë mënyrë vendin që i kanë dhënë Asdrenit në historinë e letërsisë shqipe të lidhur me faktin e receptimit të kufizuar kritik të veprës së tij. Bëhet fjalë për një keqkuptim, për një moskuptim të poetit, apo, së fundi, për një nga shembujt e të ashtuquajturit receptim jo i njëkohshëm? Në çdo rast, përse do të duhej të shprehej kjo me pothuaj heshtjen e kritikës dhe cilat do të ishin arsyet historiko-letrare të një fenomeni të tillë? Si do të pajtohej më në fund kjo situatë me rëndësinë e nënvizuar të Asdrenit në historishkrimin e letërsisë shqipe?” Jorgo, K., *Receptimi i Asdrenit dhe vendi i tij në sistemin letrar shqiptar*, në “Studime Filologjike” nr 1-2, Tiranë 2004, fq.5

³Qosja, R., *Asdreni. Jeta dhe vepra e tij*. Monografi, Botimet “Toena”, Tiranë, 2002, f. 3.

Ai ka lindur nën këtë shenjë, po përveç kësaj, - e kjo përbën të veçantën e tij, - vijon ta ruajë këtë status edhe sot e gjithë ditën”⁴.

Krijimtaria letrare e Asdrenit, në gjykimin tonë, ndërtohet si një tërësi, në të cilën misioni i shkrimtarit parakupton jo vetëm lëvrimin e llojit që është më pranë dhuntisë së tij të shfaqur më dukshëm (sipas periudhave në të cilat i shkroi), por sidomos eksperimentimin e lëvrimin e tematikave nga më të larmishmet. Krijimtaria e tij u ngjiz duke njohur paraardhësit, por e përqendruar sidomos në atë çka mund t'u shërbente pasardhësve, duke u prirur t'ua lehtësonte orientimin në hulli që ende nuk ishin hapur a përpunuar; qenia e tij u end qartazi në hapësira të ligjërimeve e diskurseve letrare, duke u dhënë jetë veprave të tilla që i japin atij një vend të lëvdueshëm në Historinë e Letërsisë shqipe. Duke patur parasysh rrethanat në të cilat formësohet Asdreni, gjykojmë se qenia e tij tekstore (ajo që shpërfaqet në vëllimet e tij poetike) kalon përmes një procesi që përvijon pozicionimin e tij ku harmonizohen tregues të qenies biografike, psiko-sociale, kulturore e intelektuale, që bart një njohje të caktuar të shoqërisë nga vjen dhe asaj ku formohet kulturalisht, me nevojat e shkrimtarit për t'u integruar në institucionin letrar, çka mundësohet nga pozicionimi i tij estetik, që përftohet nga nevojat e fushës letrare dhe njohjes së institucionit letrar në tërësi; por, sigurisht, edhe prirjeve të talentit, dhuntive krijuese, njohjes e vlerësimeve estetike që mundësojnë përmbushjen e misionit të shkrimtarit. Statusi i shkrimtarit (i lidhur ngushtë me fushën letrare të kohës, dhe përmes saj me vetë shoqërinë e kohës) përvijohet në radhë të parë nëpërmjet produktit letrar, i cili ka të bartur në suksesin a mossuksesin e tij edhe pozicionimin estetik të shkrimtarit, kahun a drejtimin letrar përkrahës a përfaqësues i të cilit shkrimtari bëhet (në tërë veprën e tij, a në një kohë a në një pjesë të veprës). Asdreni krijon i frymëzuar nga qasje të ndryshme, “... ai si poet u formua në një klimë letrare ku zjenin edhe idetë e mbasromantizmit, simbolizmi,

⁴Jorgo, K., Receptimi i Asdrenit dhe vendi i tij në sistemin letrar shqiptar, në “Studime Filologjike”, Nr 1-2, Tiranë 2004, f.10-11.

parnasizmi, etj.”⁵, të cilat i mundësonin që motivet që ai trajtonte në poezitë e tij, për shkak të hapësirës së gjerë të frymëzimeve të tij. T’i sillte në art duke mbajtur parasysh probleme të aktualitetit, me vështrim nga ndryshimi, e ardhmja. Gjykojmë se kjo është dhe një nga arsyt pse poezia e tij ndryshon kah nga romantizmi i vëllimeve të para, tek modernizmi i vëllimit të fundit me poezi (Psalme murgu), duke ekuilibruar paradoksalisht traditën me modernen.

Është pranuar nga të gjithë studiuesit se vepra e fundit e Asdrenit, përmbledhja poetike “Psalme murgu” përfaqëson dhe veprën e pjekurisë artistike të tij, që padyshim është e lidhur ngushtë me rrethanat në të cilat ai formësohet, por edhe me pjekurinë e tij si shkrimtar⁶. Robert Elsie pohon: “Së bashku me dy vëllime të mrekullueshme nga Lasgush Poradeci (1899-1987), botuar në Rumani më 1933 dhe 1937, dhe vëllimi i vogël “Vargjet e lira”, 1936, nga i riu Migjeni (1911-1938), “Psalme murgu” shënon gjithashtu një pikë kthese në letërsinë shqipe. Modernizmi tashmë kishte filluar të dukej në horizont”⁷. Të shumtë janë studiuesit që e kanë vënë theksin tek modernizmi që shfaqet në poezitë e Asdrenit dhe sidomos të veprës së botuar prej tij në 1930^{ën}. Kështu Rexhep Qosja është i mendimit se me krijimtarinë e Asdrenit paralajmërohet periudha e re e lirikës shqipe në gjysmën e parë të shek XX: “Kjo periudhë e re e lirikës shqipe fillon me përmbledhjen e dytë të vjershave të Asdrenit “*Ëndrra e lotë*” dhe, me një degë të vetën, zgjat gjer në prak të çlirimit,...”⁸, madje më tej

⁵ Smajli, R., Shumësia e tekstit, 1980, f. 159

⁶ Është me vend të bëjmë një shpjegim të shkurtër të këtij emërtimi sipas D. Maingueneau-së, i cili thekson se në entitetin “krijues-autor” barten tri instanca përbërëse që i japin jetë krijimtarisë: *personi* fizik, *shkrimtari* dhe *qenia tekstore* a *nënshkruesi* në tekst. Emërtimi “person” i referohet individit të pajisur me të dhënat e një gjendjeje civile, të një jete vetjake, private; “shkrimtari” tregon aktorin që përvijon një trajektore në institucionion letrar; ndërsa “nënshkruesi” tregon thënësën në tekst, subjektin e procesit të të thënit që bart e transmeton njëherazi edhe statusin e përvijuar ndërkohë të individit biografik e shkrimtarit në fushën letrare” ⁶ Shih Dominique Maingueneau, *Le discours littéraire, Paratopie et scène d’énonciation*, Armand Colin, 2004, 2014, faqe 107-108

⁷ Elsie, R., Histori e letërsisë shqiptare, Dukagjini, Tiranë-Pejë, 1997. f. 104.

⁸ Qosja, R., “*Lirika shqipe*”, në “Jehona”, Shkup 1970, Nr. 6, f. 3.

në artikullin e tij do të pohojë se Asdreni është: “Poet të cilit i shkon për dore t’i shprehë vizionet e veta në qartësinë më të madhe vizuale, porsi parnasistët, po edhe të krijojë vjersha prej një ideje abstrakte, porsi simbolistët, Asdreni në ca raste, megjithëse jo të shpeshta, kombinon metodën krijuese të të parëve me atë të të dytëve”⁹. Ndërsa Ali Xhiku do të shprehët: “Këto tipare që ka fituar krijimtaria e Asdrenit e kanë burimin edhe në ndikimin që pësoi prej drejtimt parnasian, që, siç dihet, u përhap mjaft në letërsinë franceze. (...) Poezia e Asdrenit, sidomos në kohët e fundit, nuk mbeti pa u prekur edhe prej ndikimeve të simbolizmit. Në vëllimin “Psallme Murgu”, Asdreni, siç e kanë vënë në dukje studiuesit, nis të kujdeset më fort për anën tingëllore të fjalës, për një varg më muzikal, më abstrakt”¹⁰.

Ne gjykojmë se natyra moderniste në vëllimin “Psallme murgu” nuk lidhet vetëm me faktin se kapërcehen temat tipike të Rilindjes a përdorimi i vargut të lirë, trajtimi i motiveve e simboleve të mitologjisë, kujdesi i veçantë për aspektin tingullor të fjalës dhe muzikalitetin e vargut, një prirje abstraksioni dhe largimi prej problemeve të realitetit (shoqërore, politike, etj.), fokusimi në kultin e së bukurës, krijimi i një poezie elitare që kërkon një lexues më të kualifikuar, mungesa e shpërthimeve të forta të ndjenjave, apo teknika e krijimit të vizioneve e imazheve. . Siç do të përpiqemi të trajtojmë edhe në këtë punim, ne mendojmë se theksin modernist poezive të vëllimit “Psallme murgu” ia jep qasja ndaj kotësisë dhe mërziisë, si ndjenjat rreth të cilave ndërtohet mendimi modernist. Mërzia si paradoks është rezultat i dy tendencave divergjente, të cilat janë krejtësisht të papërputhshme me njëra-tjetrën. Nga njëra anë kemi një dëshirë të fortë për të reaguar, ndërsa nga ana tjetër qëndron ndjesia e pamundësisë për të vepruar, që buron nga një ndërgjegjje e hidhëruar dhe e zhgënjyer, e bindur për kotësinë absolute të çdo lloj veprimi. Shoqëria moderne drejt së cilës orientohej edhe shoqëria shqiptare, zhvillimet e të cilës Asdreni herë i ndiqte nga larg e herë duke u përfshirë në këto zhvillime , nxirrte zbuluar – nën shenjë

⁹ Po aty, f. 5

¹⁰ Xhiku A., *Parathënie* “Asdreni, Poezi të zgjedhura”, Dituria, Tiranë 2000, f. 10

e “spleen”-it – peizazhin e shkretë të shpirtit modern.

Lë të bëjmë një parantezë. Nuk mjafton të flasim vetëm për mërzinë, në rastet kur i referohemi ndjesisë së spleen-it, sepse kjo e fundit nuk është vetëm një ndjenjë mërzie, por i korrespondon asaj eksperience specifike të tëhuajzimit në raport me botën që e ka origjinën dhe e përcakton veten në kontekstin e qytetërimit modern. Në tonalitetin emotiv të spleen-it, mërzia – e cila sigurisht është e pranishme (por në forma hibride dhe të përziera, si efekt i të cilave herë pas here prek kufijtë e malinkonisë e ndonjëherë edhe të ankthit) – shndërrohet në objekt të shëmbëllimit. Ndryshe do të thonim se ajo, mërzia, pëson një metamorfozë të mirëfilltë që modifikon aspektet thelbësore, duke i transferuar në një kuadër të ri.

Tek spleen, si mërzi pa shkaqe të dukshme, që karakterizohet nga neveria për gjithçka, uni, i cili është gjithnjë i huaj me vetveten, projektohet i gjithi tek gjërat; është kaq i shkrirë dhe i ngatërruar me to sa evokohet tërësisht prej tëhuajsisë së tyre rrënoqethëse.

*Një send e dua fort, por prap s’e dua;
Një lule marr e puth, më dhemb për të,
Mërzitem fare shpejt – çudi po thua,
E flak si send pa vlerë, si kurrgjë!
Pyetem vet’ – e jo të pakta herë
Tek mua shoh dy veta të përzjerë.*

Paradokse f. 107

Mërzia, spleen, është mohim radikal i idesë së progresit me të cilën periudha moderne promovon besimin tek zhvillimi i pakufishëm i forcave që do të duhej ta projektonin përpara, drejt asaj që do të ishte më e “mira”, por që ashtu siç konstatojnë simbolostët, apo edhe Asdreni, kjo ecje përpara nuk duket se ndodh për gjërat thelbësore: këtë duket se pohon poezia “Qytetërimi”

*Sot qytetërimi është një fjal’ e thatë,
U duk me punë e ngjarje që pohohen
Se zjarri q’i ra botës gjer’ e gjatë,*

Si faqe libri janë që s’mohohen!
Çdo dit’ është porsi nj’ e tmerhtë natë,
Me sy po shoh kaq vepra si dërrmohen,
Ato që vet’ krijon njeriu i ngratë,
Po me një grimë posht’ prej tij rrëzohen!
Mësimi i zbut vetijat sa për faqe –
Sepse egërsimi mbet në trup krejt brënda
Kur sheh papra qysh derdhen vala gjaqe!
Ja fryti i qytetërimit gjer më pikë,
Njeriu në shtazë qysh ndrrohet kur i kënda:
Si penda që iu ndërrua sot në thikë!

Apo

*E di, mësimi pror dobi, hap rrugë
Sa rrozullimin anekënd e njeh,
Por deti qumësht t’jet e s’pate lugë
Me sy një dit’ të bardhë kurrë s’e sheh (Paradokse)*

Pasiviteti, ky është armiku i errët të cilit i mërzituri përpiket t’i kundërvihet më kot dhe kundër të cilit lufton duke gjetur ngushëllim tek kotjet që i ofron e përditshmja.

Mbyllur zemra rri si qene,

S’do të çohet jasht një çap/ strehve treten dhe krongjihtë/ shterin lotët gjith pik pik ... gjumit zemra s’do t’i shkundet/ asnjë ndjenjë asaj s’i flet etj etj poezia Ora e zemrës

Ky pasivitet është stisma epokale e jetës në periudhën kur bota i ofrohet njeriut pa asnjë mundim (duke qenë se atij nuk i duhet të bëjë asgjë për ta patur atë, nga momenti që ajo është aty “e gatshme”)

Karakteristikë e këtij hero i është fakti se ai nuk vepron, por turbullohet.

Nuk jeton, por përkundrazi mbijeton brenda një konteksti në të cilin ekzistenca shndërrohet në një mënyrë jopersonale për të kaluar kohën.

si njëj plot etje, vendit që s’i rrihet

*si njëj durim që s'ka, me sa vështron,
dhëshirës tija s'mund sesi t'i shtrihet,
por sende dit për dit të ra kërkon,
edh'un' ashtu një grimë s'kam pushuar
kufi t'i gjej njëj andjes së pushuar*

Kjo është strofa me të cilën nis poezia Paradoxke, dhe ku me një gjuhë të thjeshtë e pa stërhollime Asdreni na jep thelbin e heroit modern. Mërzia është e pranishme si tek heroi romantik ashtu dhe tek ai modern, por, ndryshe na vjen mërzia e romantikut, ajo vjen si rezultat i faktit se bota, sado e madhe të jetë, i rri ngushtë heroit romantik. Është një mërzi sublime, si shenjë e sublimitetit të unit, i cili edhe pse vuan nga zbrazëtia ngrihet përballë hiçit të gjërave. Këtë lloj mërzie nuk e gjejmë tek Psallme murgu, sepse ajo nuk i ka shenjat e sublimes. Heroi lirik është i vetëdijshëm se sado është përpjekur për ta arritur lumturinë, gëzimin, nuk e ka arritur atë.

*Një rreze qiellit prita kot
Vargonj të thyej dhe mjerime,
u binda fatit fuqiplot',
si trim i rrahur në luftime
Më kot ëndërrova, pa t'ëndrojoj
me sot me nesër t'jem i lumtur,
mjerisht i lumtur s'jam, vështronj,
po rob i vuajtjeve pa numur.*

Lutje e vonuar Asdreni, vëll. II, f. 83

Natyra identike e atyre që ndodhin përqark heroit lirik, e ngjashmja gjithnjë e ngjashme me vetveten, monotone dhe e zbrazët; e pafundme dhe që është e destinuar të përsëritet të krijojë përshtypjen se asgjë nuk mund të ndodhë përqark tij. Ajo që duhet të ndodhë nuk ndodh, sepse heroi nuk gjen guximin që ta bëjë ndryshimin, ai e pranon fatin e tij: Rro, pra qyqe nd'arrati,/ se ky qenka fati yt,/ gjith pa shok e pa

shtëpi,/ gjith me vaje e lot ndër sy! Përdorimi i urdhërores në këtë rast dëshmon dorëzimin, pra mosndryshimin (Qyqja, fq. 130)

Jeta vazhdon si “më parë”, jeta rrjedh si gjithmonë – në mënyrë të pashmangshme. Ferri – apo më saktë e pafundmja, pa fillim e fund – është pikërisht kjo vazhdimësi me thyerje (periodizimet), për shkak të së cilës koha përsëritet. Ky është imazhi i kursit të kohor që karakterizon në mënyrë më të saktë vizionin të cilit i referohet miti (kaq i dashur për simbilostët). Kjo karakteristikë e mitit, pra vazhdimësia katastrofike, të cilën miti e bën të përjetshme (mjafton të kujtojmë Sizifin) shfrytëzohet mjeshtërisht nga Asdreni. Të shumta janë poezitë me elementë mitologjikë nga mitologjia antike: Fjala e Dodonës, Afrodita, poezitë e cilkut Nga bota e përrallave apo me elementë historikisht të qëndrueshëm nga historia e popullit tonë: qytetet antike si Durrësi, Apollonia, apo gjuha, flamuri, malet, etj; por dhe nga figurat biblike Juda i ri (dua të theksoj këtu se edhe pse poezitë e tij kanë natyrë mistike, Asdreni shpesh i referohet Krijuesit, perëndisë, Krishtit etj, përsëri i vetmi personazh tek i cili ndalet gjatë, është Juda). Do të guxoja ta shihja këtë aspekt katastrofik të së përhershmes që ofron miti si një gërshetim midis universales, kombëtares dhe individuale. Thënë konkretisht elementet nga mitologjia antike janë pjesë e vëllimit, sepse kompensojnë shkatërrimin modern, por dhe shpjegojnë dukuritë universale mbi të cilat është ndërtuar shoqëria njerëzore; ndërsa Durrësi, Adriatiku, Apollonia, gjuha etj qëndrojnë jo vetëm si shenjë e vazhdimësisë kombëtare, por edhe për t’iu kundërvënë shbjerrjes dhe humbjes së kombëtarizmit (aspekti katastrofik), për sa kohë që luftëtari lyp ndihmën e bashkëkombasve (lëftova për atdhe/ lëftova për liri/ por veshin një s’më/ as dorë s’m’ep njeri. Ndërkohë Juda ka ruajtur emrin, për t’u shndërruar në mijëra shëmbëllime të tij në jetën e përditshme: Pra, mos ju zërë çuda/ se s’gjej dhe sot si miq e dashamirë,/ fytyrë shtaze e frym armiku/ si judë që të puthin, t’adhurojnë/ por siç e kanë për zakon: as mik as fjalë mos nderojnë (Juda i ri, fq. 89). Duket sikur shfrytëzimi i të gjitha elementeve që merren nga mitologjia, teologjia apo kombëtarja i shërben asaj që mund ta konsiderojmë si

bindja e poetit në këtë vëllim, se asgjë e re nuk ka ndodhur nën qiellin e ngjyrosur nga spleen, përveçse konstatimi që në këtë botë asgjë nuk është realisht e re (moderne). Të gjitha përsiatjet mbi këtë botë vetëm sa konstatojnë kotësinë, mosndryshimin thelbësor, por vetëm sipërfaqësor, sepse njerëzia dhe shoqëria vazhdon të jetë një rrjetë mashtrimesh dhe mirazhesh, një copë shumëngjyrëshe e mbështjellë rreth hiçit, ëndrra që i thur jeta për të na dhënë mundësinë të jetojmë apo për të na detyruar të jetojmë, pa patur mundësinë ta ndryshojmë. Në përfundim mund të themi se zhgënjimi që pësoi Asdreni nga ngjarjet politike të viteve 20^{-të} apo ato që ndjeu në jetën personale janë burimi i tharë nga i cili rrjedh, buron ndjenja e mërzi. Përzierje paradoksale që ka si përbërës kryesor rënien, e cila ndërkohë që i drejtohet zemrës – jep dorëheqjen prej poezisë së zemrës: “mashtrimet, joshjet, kaq të dashura” – iluzionet jetësore që nuk e dinë se janë gënjeshtarë dhe pretendojnë të jenë të përrjetshme – në fakt shfaqen tashmë krejtësisht të treta. Çmagjepsje radikale.

Por, kjo braktisje e zemrës nuk prek strukturën e fortë të unit, i cili transfuzion, indukton vuajtjen e vet tek hidhërimi i një patosi që proteston dhe akuzon. Pasion i ngrirë dhe i akullt – i ngjeshur – i katandisur në dridhje dhe rrënoqethje. Fjalë që në radhë të parë i drejtohen vetes, prej atij që, pasi ka parë zbrazëtinë e jetës, zbret në “ferr” me sigurinë e një heroi tragjedi.

Asgjë thelbësore në vetëdijen që arrin të ngrihet edhe nën peshën e zgjedhës që e shtyp. Kjo sepse një vetëdije e tillë i përket një uni që, edhe pse plot me zbrazëti, është gjithnjë në gjendje t’i drejtohet vetes si burim i fundit, edhe pse në fund të çdo magjepsjeje gjendet bota e sheshtë dhe e zbehtë, pa formë dhe e njëjtë, të cilën gjen forcë brenda vetes për ta rrefuzuar, por që po nga ky refuzim ushqehet. Kjo sepse realiteti është një prani e pashmangshme dhe obsesive, e cila është aty dhe aty do të mbetet – si afirmim paradoksal i një monotonie të destinuar të imponohet deri në mërzi.

Bibliografia e shfrytëzuar:

Asdreni, vëll. II, “Endra e lotë”, Tiranë, 1999.

Elsie, R., Histori e letërsisë shqiptare, Dukagjini, Tiranë-Pejë, 1997

Jorgo, K., *Receptimi i Asdrenit dhe vendi i tij në sistemin letrar shqiptar*, në “Studime Filologjike” nr 1-2, Tiranë 2004

Maingueneau, D., *Le discours littéraire, Paratopie et scène d’énonciation*, Armand Colin, 2004, 2014

Qosja, R., “Lirika shqipe”, në “Jehona”, Shkup 1970, Nr. 6

Qosja, R., *Asdreni. Jeta dhe vepra e tij*. Monografi, Botimet “Toena”, Tiranë, 2002

Smajli, R., Shumësia e tekstit, 1980

Xhiku A., *Parathënie “Asdreni, Poezi të zgjedhura”*, Dituria, Tiranë 2000

**NGA PËRSHTATJA DREJT NJË POLIFONIE
INTERTEKSTUALITETI
(Jehona intertekstuale në krijimtarinë e Asdrenit dhe poetëve që
u ndikuan prej tij)**

**Esmeralda HIDRI
Valbona KALO
Universiteti “Aleksandër Xhuvani”
Departamenti i Letërsi-Gazetarisë
esmeraldahdr@gmail.com**

Abstrakt

Konsideruar si poeti që shenjoi përfundimisht një poetikë moderne në letërsinë shqipe, krijimtaria Asdrenit do të jetë objekt i hulumtimit tonë jo në ato tipare që dëshmojnë këtë prirje të re të poezisë së tij, por pikërisht në ato krijime të cilat, të shmangura ose interpretuara me synimin e evidentimit dhe pse jo, arsyetimit të ndikimeve, nuk kanë manifestuar dot bukurinë e një rrugëtimi intertekstual. Duke besuar se përmes këtij të fundit, subjektiviteti i krijuesit i jep një jetë të re citimeve apo ideve të vjela si pëlqime gjatë leximeve të shumta, do të shohim nën një dritë të re interpretimi, aspekte të konsideruara si shfaqje të ndikimeve tematike apo estetike nga rrymat letrare të kohës, të cilat luajtën rol në formimin e poetit.

Me synimin e rishikimit të tyre si jehona intertekstuale të zërave letrarë të kohës, zëra që referonin përgjithsisht problematika të njejta të një kohe e përmase gjeografike me rezonancë të përbashkët, do përpiqemi të argumentojmë se prania e shpeshtë dhe e pafshehur e tyre, përveçse instiktive, e dëshmon intertekstualitetin zgjedhje të ndërgjegjshme, pjesë e estetikës krijuese tek Asdreni dhe të shumë krijuesve të kohës së tij. Në këtë këndvështrim, edhe ndërtekstualiteti si gjetje letrare, mund të konsiderohet edhe si një nga provat më të mira të modernitetit letrar tek Asdreni.

Fjalë kyç: intertekstualitet, përshtatje, jehona intertekstuale

Poeti, publicisti, aktivisti, patrioti dhe njeriu Aleksandër Stavër Drenova, pati fatin të jetonte në një nga momentet më të rëndësishme të historisë së kombit të tij dhe më gjërë. Koha më aktive e tij si shkruer,

fillimi i shekullit të ri, përkoi me të parin përvijim në të cilin letërsia shqipe mund të aspironte njëkohësinë me atë europiane. Rugëtimi i pangjashëm i letërsisë shqipe krahasuar me letërsitë e tjera europiane e më pranë, përgjatë gjithë gjallimit të saj të para këtij momenti, i kishin dhënë asaj një pamje asimetrike në raport me to.¹

U desh gati një shekull që letërsia jonë të krijonte më së fundi një fond letrar të shkruar në gjuhën shqipe. Shekulli XIX pasuroi një fond të ngrirë prej kohësh, falë prurjeve arbëreshe dhe të atyre në hapësirën shqiptare. De Rada, Serembe, N.Frashëri etj, ndërtuan një traditë ekstraterritoriale të shkrimit shqip, që më së fundi do t’u shërbente si taban letrar atyre që shkruan më pas, por duke qenë gjithsesi larg nga zhvillimet e përgjithshme të letërsive europiane.² Idetë rilindase në një frymë romantike shënjuan një histori shkrimi letrar me karakter të qartë kombëtar, me përvijime të pakta me njëkohësisë letrare europiane. Në rrethana tashmë të ndryshme historike, shkruarit e gjuhës shqipe mundën me fillimin e shekullit XX-të, të reflektonin një karakter letrar postromantik me tipare moderne simbolike. Pikërisht në një klimë të tillë Asdreni bëhet pjesë e një letërsie nacionale që ushqehet nga tradita, ndërsa aspiron njëkohësinë.

Konsideruar si poeti që shenjoi përfundimisht një poetikë moderne në letërsinë shqipe, kemi zgjedhur të bëjmë objekt të hulumtimit tonë, jo ato tipare që dëshmojnë këtë prirje bashkëkohore të poezisë së tij, por pikërisht ato krijime, të shmangura ose interpretuara më së shumti me synimin e evidentimit të ndikimeve dhe arsyeve sipërfaqësore të pranisë së tyre. Lehtësia e gjetjes së materialit të huazuar në një pjesë të konsiderueshme tek krijimet e Asdrenit, ka shtyrë për një kohë të gjatë, në interpretime me karakter evidentues të huazimeve apo ndikimeve në poezinë e tij. Kjo është sigurisht e kuptueshme për kohën e studimeve të para të thelluara për autorin, kohë në të cilën konceptet letrare konsistonin në linjën historiografike ku gjetjet krahasimtare

¹ Për më gjërë shiko A. Xhiku, *Letërsia shqipe si polifoni*, Tiranë 2004, f.13.

² Të mos harrojmë se deri atëherë dukuritë letrare ishin rajonale dhe pa ndikim tek krijuesit e tjerë. Bejtexhinjtë as nuk i njihnin.

mbesnin në kontekstin e cilësimit përmes emërtimeve si *ndikime*, *huazime*, *përshtatje* e kështu me rradhë. Në këtë linjë interpretimi, ndikimi i teknikave dhe frymës së re letrare të kohës janë trajtuar lehtësisht si përshtatje ose rimarrje, pa u thelluar në çështje të karakterit përzgjedhës dhe përfshirës të vetë krijuesit, dhe aq më pak në teknika krijuese të frymëzimit poetik, që teoritë letrare bashkëkohore i zbërthejnë tashmë bazuar në nocione të tekstualitetit. Legjitimiteti i origjinalitetit autorial është rikonceptuar tashmë nga inovacionet në fushën e letërsisë së krahasuar, sidomos ato të viteve '60-të e më tutje, të cilat ridimensionuan parimet interpretuese dhe shtynë teorikët drejt nocioneve të reja siç është ai i intertekstualitetit.³

Në këtë kuptim, besojmë se ka ardhur koha për një kënvështrim të ri hulumtues në poezinë e Asdrenit, ku evidentimi i aspekteve të konsideruara si shfaqje të ndikimeve tematike apo estetike nga rrymat letrare të kohës, të cilat luajtën rol në formimin e tij, të shihen nën një dritë të re interpretimi, si jehona intertekstuale të zërave letrarë të kohës, zëra që referonin përgjithsisht problematika të njejta të një kohe e përmase gjeografike me rezonancë të përbashkët. Prania e shpeshtë, e pafshehur dhe e vazhdueshme e këtyre jehonave, na bëjnë të besojmë se përveçse instiktive dhe të konsideruara normale si prani letrare për letrarët e kohës së autorit, intertekstualiteti zgjidhet si pjesë e estetikës krijuese tek Asdreni dhe të shumë krijueve të tjerë, të ndërgjegjshëm për praninë dhe rolin e tij në krijimtarinë e tyre dhe të atyre që do të ndikoheshin në vijim.⁴

³ Përdorur si term së pari nga Julia Kristeva (falë një rruge të hapur më parë nga Barthes e Foucault) intertekstualiteti presupozon marrëdhënien që vendos ndërteksti në tekstin në të cilin është rikontekstualizuar, duke fituar statusin e një teksti origjinal. Shiko Julia Kristeva, *Sèmeiotike Recherche pour une semanalyse*, **Seuil**, Paris, 1969.

⁴ Shtrirja në një kohë të gjatë e krijimtarisë letrare të Asdrenit, solli sipas studiuesve, dallime të shumta në tiparet e poetikën e tij. Ajo që mbetet konstante pavarësisht nga periudha historiko-letrare e kohës së shkrimit, është pikërisht prania e të ashtëquajturave citime, përshtatje apo huazime. Rreth tipareve të lirikës së Asdrenit shiko Ali Xhiku, “Çështje të diskutueshme të drejtimeve letrare, Poezia e Asdrenit”, *Nga romantizmi rrjedhave të realizmit*, Tiranë, 1989, f. 107; R. Smajli, *Shumësia e tekstit*, 1980, f. 159.; Rexhep Qosja, *Lirika shqipe*, “Jehona”, Shkup 1970, f. 5.

Duke zgjedhur të mos ndalojmë në ato poezi, shpesh të fazës së tretë të krijimtarisë së Asdrenit, në të cilat gjejmë lehtësisht të dallueshme dhe si të tilla edhe të interpretueshme, shenjat e parnasizmit dhe simbolizmit, do të fokusohemi në ato krijime, herë të thjeshta e herë të tjera trajtuar si të tilla, të cilat janë klasifikuar si të ndikuara në formë apo përmbajtje nga letërsia shqipe e kohës, poezia rumune, ajo franceze e përtej, veçanërisht tek ato të cilësuar shpesh si përshtatje.⁵ Kjo për të sygjëruar një tezë të re studimore, që sheh në këto prani të qarta jo më ndikimin, por përzgjedhjen autoriale për t'i përfshirë pasazhet dhe sygjërimet e teksteve të shkruara nga të tjerë krijues, pa u shqetësuar për të ashtëquajturin “origjinalitet”, si intertekste të integruara tashmë në një realitet të ri poetik. Ndërtekstualiteti si gjetje letrare, besojmë se do të jetë një nga provat më të mira të modernitetit letrar tek Asdreni, si një zgjedhje artistike instiktive dhe origjinale.

Të flasësh për intertekstualitet (ndërtekstualitet) ndërsa je duke iu referuar krijimeve artistike të shkruara në gjuhën shqipe në vitet e para të shekullit XX-të, mund të duket disi jashtë kontekstit letrar të kohës. Ndaj dhe nxitojmë t'u themi paraprakisht se ajo që duam të ndërtojmë nuk ka të bëjë as me përfshirjen e Asdrenit në formacione letrare të përparuara për kohën edhe për Evropën apo edhe më gjërë dhe as të katalogojmë poezitë që kemi në fokus, si avangardiste. Por nuk mund të harrojmë se përpara se veçoritë letrare të studiohen e emërtohen, ato sendërtohen në vepra letrare të cilat e gjejnë intertekstualitetin si fenomen letrar që në antikitet. Fakti që tekstet komunikojnë mes tyre, strukturuar si ide letrare vetëm në postmodernizëm, u bë i tillë qëkur njeriu pati instiktin të konservojë histori e ndjenja përmes shkrimit, histori e ndjenja këto që gjenin njëra tjetrën në kohë e përmasa gjeografike të largëta. Kur Derrida konkludon se çdo lloj shkrimi çon tek një tjetër shkrim, e ky tek një tjetër, e një tjetër sërish, ai kishte përpara syve një histori të hershme shkrimi që e vërtetonte këtë.⁶

⁵ Për klasifikimin në faza të krijimtarisë së Asdrenit kemi ndjekur ndarjen e Rexhep Qoses.

⁶ Derrida, *Dalla grammatologia*, **Jaca Book**, Milano, 1969, fq 110-111.

Sikurse U. Eko pranon se nuk do të mund të ishte i lirë nga jehona e intertekstualitetit, ndërsa zbulon atë që shkrimtarët e kanë ditur gjithmonë (e që shpesh na kanë thënë): që *librat flasin gjithmonë për libra të tjerë dhe çdo histori tregon një histori të rrëfyer më parë. E dinte Homeri, Aristoteli ...*”⁷

Vetë termi *intertekstualitet*, nuk nënkupton vetëm një metodë letrare, poetikë të prodhimit të tekstit letrar, por dizenjon njëkohësisht një mënyrë interpretimi të tij. Pranohet njëzëri nga studiuesit tashmë, si karakter specifik dhe i përhershëm, intertekstualiteti i shkrimeve letrare, me specifikën që në një pjesë të tyre ai është i shtresëzuar (fshehur) e në raste të tjera lehtësisht i dukshëm në aktin gjuhësor.⁸ Në rastin e Asdrenit, intertekstualiteti nënkupton atë që Genette përcaktonte si tipin e parë të intertekstualitetit, ku dallohej në formë të qartë citimi dhe ku nënkuptohej dukshëm **plagio**, kopja dhe aludimi.⁹ Por ajo që e qartëson më shumë si prani është koncepti i Segresë i cili e cilëson këtë prani letrare me termin analog “interdiscorsivita”, pra si një marrëdhënie ndërbisedimi mes një teksti dhe kodit kultural të kohës që vendoset si një nënsistem i gjuhës poetike.¹⁰ Kjo nënkupton se në periudha të caktuara historiko-letrare, bashkëekzistenca e ideve të njejta me të tjerë poetë nën frymën e kohës, me bashkëekzistencën e stileve letrare mund të interpretohet edhe si një shtresëzim intertekstualitetesh, gjë që e bën artin e poezisë të interpretueshëm edhe nën këndvështrime psikanalitike përveçse atij social, lingistik dhe filozofik. Thë thjesht, poetët e kohës së Asdrenit nuk cilësonin kopje e as ndikim, tekste poetike që lindnin nën frymëzime dhe nevoja të përbashkëta të kohës. Por kjo nuk duhet të thjeshtohet nga studiuesit si aspekte utilitare të poezisë së poetëve intelektualë të kohës së Asdrenit,

⁷ U.Eko, “Postile”, *Il nome della rosa*, Bompiani, 2002, fq.512-513.

⁸ P.M.Bertinetto, Metafora co(n)testo e intertesto. Per una caratterizzazione della metafora poetica, in AA.VV., Padova, 1980, f.247

⁹ Për më gjërë shiko G. Genette, *Palimpsestes*. La littérature au second degré, Paris, 1982, f. 7-14.

¹⁰ C. Segre, “Intertestuale/interdiscorsivo. Apunti per una fenomenologia delle fonti”, Teatro e romanzo. Due tipi di comunicazione letteraria, Torino, 1984, f. 103-118.

pasi kjo do të orientonte drejt një tendence kritike thjesht evidentuese për ato poezi të cilësuar lehtësisht si përshtatje apo huazime nga poetë të tjerë.

Autenticiteti ideor, gjuhësor, ndjesor, poetik i këtyre poezive, zbehet kështu në dritën e fortë të synimeve realiste të interpretimeve. Këto krijime, të shmangura ose interpretuara me synimin e gjetjes së ndikimeve, humbin bukurinë e një rrugëtimi intertekstual, ku subjektiviteti i krijuesit i jep një jetë të re citimeve apo ideve të vjela si pëlqime gjatë leximeve të tij të shumta.

Mos harrojmë se frymëzimi poetik, krijuesit i nxitet shumë nga pëlqimet poetike të momentit apo edhe të ngulitura në formimin e tij kulturor. Në këtë shteg poetik të veçantë, besojmë se Asdreni ka ende shumë për të thënë. Intertekstualiteti tematik, të cilin e kemi thënë me zë të ulët, ai ideor dhe poetik, në kontekstin e stileve letrare, janë jo vetëm strukturë domethënëse e eksperiencës së tij poetike, por mbi të gjitha manifestim i një vlere të shtuar në letërsinë shqipe, dëshmi e një ligjërimi poetik mjeshtëror, zë heterogjen që përmes citimit sjell universalen dhe origjinalen në gjuhën shqipe.

Po atëherë kur, në këtë metaletërsi që karakterizon sidomos këto periudha letrare, në një terren pjellor për shumë arte poetike, intertekstualiteti bëhet pjesë e ndërgjegjshme e karrierës letrare të poetit? Ne kemi parë sesi në Shqipëri romantizmi bashkëjetoj me neoklasiçizmin dhe vazhdoi paqësisht edhe në modernizëm, si një prani e përfshirë në të gjitha tendencat novatore të kohës. Dhe kjo pasi letërsia si një terren që ushqehet nga realiteti dhe aspektet jetësore të një populli e të një kohe, shënohet nga këto aspekte antropologjike dhe sociale të cilat nuk i takojnë vetëm një populli, por edhe fqinjëve, shpesh me histori të ngjashme. Këtu e ka ngjizjen dhe kjo tendencë ndërkomunikuese e Asdrenit, e cila nuk ishte thjesht letrare, por edhe gjuhësore.¹¹

¹¹ Koncepti i pastishit duket se i ka pëlqyer Asdrenit edhe në kontekste gjuhësore pasi ai ishte pjesë e bashkëkohësve të cilët uniform me qëndrimin e Kristoforidhit kërkonin normëzimin e gjuhës letrare kombëtare jo krejtësisht mbi bazë njëdialektore. Termi i krijuar prej tij, me *përzijim*, nënkuptonte pikërisht përzierjen e elementeve

Fryma e ngjashme poetike me poetë të tjerë shqipshkrues të kohës, është lehtësisht e kuptueshme pasi gjendja Shqipërisë dhe problematikat e saj imediate sigurisht që ka çuar në poezi me tonalitete ndjesore të përngjashme. Ndaj kur flasim për ndikime të kësaj natyre, duam të evidentojmë një lloj jehone intertestualiteti që përfshin krijuesit shqiptarë dikë më shumë e dikë më pak. Vetë Asdreni, ndërsa shkruan për Naimin konstaton: "*se edhe aq të tjerë veteranë, të cilët ishin në lidhje mendimesh e dëshirash, të ushqyer të gjithë me një ideal*", prandaj është e kuptueshme që Asdreni do të ketë qenë i ndikuar jo vetëm nga shkrimet e një personi po edhe i të tjerëve veteranë të ushqyer me një ideal.¹²

Kështu kuptojmë sesi fryma jo entuziaste e vargjeve të Baba Tomorrit të Çajupit, ridimensionohet tek Rreze drite e Asdrenit: ("*U shkretove anembanë,/ Shqipëri,/Se Shqipëtarët s'kanë/dashuri.*" Baba Tomorri fq.22 - "*Shqipëri e mjerë,/Prit, prit nga bijt`e tu/ Ky gjumi q`i ka blerë/ Ndë vdekje i ka çu!*" Asdreni, Rreze drite).¹³

Por në të njëjtën mënyrë, por tashmë në kahje të kundërt edhe poezitë Zëri i kryengritësve dhe Krerë tradhëtorë të Asdrenit, të konsideruara si fillime të lirikës së mirëfilltë shoqërore, u manifestuan si një jehonë intertekstualiteti në poezinë e Nolit dhe të tjerëve që pasuan. Ligjërimi i fortë akuzues nolian që shkon gjer në idenë e dhunës si mjet politik për të vendosur drejtësi shoqërore, është artikuluar së pari tek Asdreni ndaj dhe vjen si jehonë e vargjeve të këtij të fundit: *Gjarpërinj pushoni! Helmin tej e çpormi,/Mos dalim tej kufirit të durimit:/Që më në fund se ç`mbuall ju të korrni!*

*Juda i ri i Asdrenit, që jo vetëm Krishtin e ka shitur për ca të holla,*¹⁴

gjuhësorë nga toskërishtja dhe gegërishtja, që u bë edhe gjuha e tij letrare për të ndihmuar pikërisht në këtë lloj standartizimi pasi siç sygjeron edhe prof. Aleksandër Xhuvani *gjuha e shkrimtarëve të dalluem të merret si "gjedhë" për formimin e gjuhës letrare*.¹¹ Toskërishtja e gegëzuar e Asdrenit u përdor prej tij si një *përzijim ndër dialektor*, koncept i ngjashëm me pastishin letrar të ideve, stileve dhe temave.

¹² Naim Frashëri si idealist shqiptar, rib. *Kambana e Krujës* 1971, f. 196-197

¹³ Fakt ky i evidentuar qartësisht tek A.Xhiku, Letërsia shqipe si polifoni, Dituria, 2004, fq. 75-76

¹⁴ Asdreni, *Vepra*, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, Tiranë, 1980, fq.89-91

rijeton tek Noli jo thjesht si motiv biblik por si një pasuri tematike që në vargjet e Asdrenit ushqehen dhe me përditshmërinë. Po ashtu vargu: “Mbahu, mëmëdhe i shtrenjtë...” (Nënë Shqipëri-Asdreni) ritingëllon si eko ndërsa lexon: “Mbahu, Nëno, mos kij frikë...” (Jipni për nënën-Noli)

Me të njëjtën logjikë, pse mos të shohim *Vargjet e lira* të Migjenit si një ridimensionim të ideve të *Paradoks*-it të Asdrenit, ku cinizmi, fuqia e së keqes, pabarazia njerëzore vjen njësoj si një ligj i gjithëpushtetshëm i sundimit mbi të dobëtit:

“ Në botë sheh aq mij` të pasur,/ Për ta një mannë qielli munt që ra./ Por sa të ngratë s`dergjen buzëplasar/ Shtëpi` e tyre mbetur pa një tra./ Mi sa kufoma ata nuk janë ngritur/ Që shpirtin me pahir ua kanë qitur.” Pikërisht kjo poemë filozofike duket si një gjallim aktiv i gjithë ideve që shohim të artikuluar si minitema shoqërore tek Migjeni.

Për sa i takon letërsisë së huaj, nisur edhe nga rrethanat jetësore, sigurisht që e para në këtë listë të gjatë pëlqimesh prej poliedriku për Asdrenin do të ishte letërsia rumune. Që të mos bëhemi edhe ne eko përsëritëse, përmendim këtu vetëm Rexhep Qosen i cili nënvizon jo vetëm rolin që letërsia rumune pati në formimin e shijes e të ndjeshmërisë poetike tek Asdreni. Citojmë: *në orientimin e interesimit dhe në përgjithësi në ndërtimin shpirtëror të Asdrenit si krijues*.¹⁵

Në mënyrë të sintetizuar nënkuptojmë këtu ndikimin në formë, përmbajtje, tema, përkime, që ne i gjejmë në krijimtarinë e poetit tonë jo si imitime, por si produkt origjinal i një shpirti poetik të mbrujtur me një kulturë të gjërë amtare dhe ndërkombëtare dhe siç shkruan Sabri Hamiti: *vetëm poetët me kulturë të madhe mund të japin vepra me kualitet të mirë artistik*.¹⁶

Ndalojmë pak këtu, për të parë si shembull më konkret, ndikimin e shumëpërmendur të poetit lirik rumun Tudor Arghezit, parë specifikisht në vëllimin “Psalme murgu”. Lehtësisht të evidentueshme, notat mistike të poezisë së Asdrenit, përfshirja e synuar në tema sociale dhe

¹⁵ R. Qosja, Asdreni, jeta dhe vepra, Tiranë, 2002, f. 278

¹⁶ Sabri Hamiti, *Teksti i dramatizuar*, Rilindja, Prishtinë 1978, fq.26

madje klasore, të cilat trazohen nga përplasje e konflikte në kërkimin e Zotit, por edhe në fjalorin poetik të tij, janë disa prej tipareve të konsideruara si ndikime.¹⁷ Veçse ndërsa i listojmë këto, le të kujtojmë edhe se, përveçse ndikoi me stilin dhe formën letrare në krijimtarinë e mjaft poetëve pasardhës, vetë Arghezi konsiderohej nga bashkëkohësit e tij si Bodleri rumun dhe se vëllimi i tij "Lule myku" (*Florile de mucegai*) vjen pikërisht si një jehonë tekstuale e “Luleve të së keqes” së Bodlerit. Madje, aq subjektive ishte ky proces përkthimi i vargjeve të poetit francez, sa këto përkthime më shumë se të tilla mund të konsiderohen edhe si variacione të tekstit burimor.

Prirja për t’iu drejtuar një publiku më të kultivuar, konsideruar si një lloj lirije që mundësoi edhe hermetizmin e vargjeve të tij, para se të analizohej nga Ali Xhiku, ishte nënvizuar edhe nga Çabej, i cili karakterizon poezinë e Asdrenit që tek *Rreze dielli*, *Endrra e lot* e më pas *Psallme murgu* si një tendencë drejt përsosmërisë formale që mundësohet vetëm kur poezia shkarkohet nga detyrimet nacionale, për t’u bërë më shumë vepër arti.¹⁸

Pavarësisht nga ndikimet apo sygjërimet e ndërëgjegjshme apo intuitive, ajo që mbetet për t’u nënvizuar është shenja dalluese që vepra e Asdrenit la në letërsinë shqipe. Si një organizëm i mirëfilltë poetik, me “kontinuitet organik” poezia e tij ishte shprehje e një individualiteti krijues që, siç thotë prof. Çabej, bëri gati poezinë shqipe për një kalim të ri drejt poezisë moderne. Në këtë këndvështrim, edhe ndërtekstualiteti si gjetje letrare, mund të konsiderohet edhe si një nga provat më të mira të modernitetit letrar tek Asdreni, ndaj ritheksojmë se një analizë më e thelluar e këtij aspekti, do të ndriçonte edhe krijime të autorit, të para shkarazi si huazimi apo ndikime.

¹⁷ Për më shumë shiko: Jonela Spaho, Ndikimi i potëve modernë rumunë në vëllimin “Psallme murgu” të Asdrenit, Botimet e konferencës shkencore Lidhjet kulturore dhe historike shqiptaro-rumune, Korçë, Primo print, 2014, f.69

¹⁸ Ali Xhiku, Letërsia shqipe si polifoni, Tiranë, 2004, f. 171

Bibliografi e shfrytëzuar

- Asdreni, 1980, *Vepra*, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, Tiranë.
- Bertinetto, P. M, 1980, Metafora co(n)testo e intertesto. Per una caratterizzazione della metafora poetica, in AA.VV., Padova.
- Derrida J., 1969, *Dalla grammatologia*, Jaca Book, Milano.
- Eko U., 2002 , “Postile”, *Il nome della rosa*, Bompiani.
- Hamiti S., 1978, *Teksti i dramatizuar*, Rilindja, Prishtinë.
- Genette G., 1982, *Palimpsestes. La littérature au second degré*, Paris.
- Kristeva J., 1969, *Sèmeiotike Recherche pour une semanalyse*, Seuil, Paris.
- Lafe Emil, 2002, “Asdreni për gjuhën dhe gjuha e Asdrenti”, *Gjuha jonë*, nr. 3-4, Tiranë.
- Qosja R., 2002, *Asdreni. Jeta dhe vepra e tij. Monografi*, Botimet “Toena”, Tiranë.
- Rugova I., 1996, *Krahe dhe premisatë kritikës letrare shqiptare 1504-1983*, Eurorilindja.
- Spaho J., 2014, *Ndikimi i poezisë modernë rumunë në vëllimin “Psallme murgu” të Asdrenit*, Botimet e konferencës shkencore “Lidhjet kulturore dhe historike shqiptaro-rumune”, Korçë.
- Segre, C., 1984, “Intertestuale/interdiscorsivo. Apunti per una fenomenologia delle fonti”, *Teatro e romanzo. Due tipi di comunicazione letteraria*, Torino.
- Xhuvani A., 1972, *Çështje të fjalorit të gjuhës shqipe*, SL II, Tiranë.
- Xhiku A., 1989, *Nga romantizmi rrjedhave të realizmit*, Tiranë.
- Xhiku A., 2004, *Letërsia shqipe si polifoni*, Dituria, Tiranë.

ASDRENI, PERSONALITET I NJOHUR I RILINDJES KOMBETARE SHQIPTARE

Ermelinda KASHAH
Universiteti “Eqrem Çabej”Gjirokastrë
e.kashahu@gmail.com

Abstrakt

Asdreni është poet dhe autor/publicist shumë i njohur. Aleksandër Stavre Drenova, i njohur në letërsinë tonë me pseudonimin Asdreni ishte nga ata poetë krijimtaria e të cilëve u përket njëherësh dy periudhave. Poezia e tij u shkroi që nga faza e fundit e Rilindjes deri në periudhën e Pavarësisë. Poeti pati një jetë të gjatë krijuese, rreth dyzet vjet. Asdreni u bë i njohur si publicist, por ishte edhe autor tekstesh shkollore e përkthyes. Po ai, para së gjithash, mbetet në letërsinë tonë si një poet i talentuar lirik.

Në lirikën e vet poetike Asdreni u rikthehet të gjitha temave të poezisë së Rilindjes, po u jep një frymë më të hapur kushtuese. Jo më kot ai lëvron kryesisht llojet e himnit dhe të marrshit. Të njohura janë vjershat "Betimi mbi flamur" (1907) që pas vitit 1912 u bë dhe është Himni ynë Kombëtar, vjersha "Përpara", që dallohen nga një stil patetiko-oratorik, i cili shpreh një patos të zjarrtë të brendshëm. Vargjet e shumta dhe dinamike dhe njëkohësisht të thjeshta, kanë një forcë komunikuese të veçantë.

Fjalë kyçe: Shkrimtari, poezia, rëndësia

Të dashur kolegë!

I nderuar drejtues i seancës.

Si gjithmonë Korça jonë e bukur dhe atdhetare na bën surpriza me ftesat e saj të veçanta në fushën kulturore, letrare, madje edhe më gjerë. Sigurisht që konferencat sjellin një risi të re, sjellin atë formën e bashkëpunimit dhe të shkëmbimit të ideve , duke bërë kështu që bota akademike të mos ndalet, por të respektojë me vëmendje figurat e ndritura të Letërsisë. E them këtë, sepse sot jemi mbledhur për një personalitet si Asdreni, kur dimë fare mirë se nëse lexojmë Asdrenin,

kemi njohur rëndësinë e madhe të arsimimit të popullit shqiptar. Prandaj dhe sot, autobiografia e tij është një ftesë e mirë për të njohur një jetë njerëzore, por dhe një ftesë e mirë për të rrokur një personalitet të rëndësishëm artistik, që ushqen kuriozitetin intelektual, prandaj dhe ky personalitet rrok çështje të hapësirave të mëdha, lexohet me endje, nga të paktët poet ku krijimtaria i përket gati dy periudhave.

Asdreni është poet dhe autor/publicist shumë i njohur. Aleksandër Stavre Drenova, i njohur në letërsinë tonë me pseudonimin Asdreni ishte nga ata poetë, krijimtaria e të cilëve u përket njëherësh dy periudhave. Poezia e tij u shkri që nga faza e fundit e Rilindjes deri në periudhën e Pavarësisë. Poeti pati një jetë të gjatë krijuese, rreth dyzet vjet. Asdreni hyri në letërsi në një kohë me Çajupin dhe Gramenon, me fillimin e shekullit të ri, në prangun e kryengritjeve të mëdha populllore, që do të çonin në çlirimin e vendit. Është ai çasti kur, siç e kemi parë, acarimi dhe diferencimi klasor u bë i dukshëm në radhët e lëvizjes sonë kombëtare, dhe kur u mendua në të ardhmen e Shqipërisë. Optimizmin për arritjen e idealeve kombëtare dhe për një të ardhme më të mirë, poeti e ka mbështetur vazhdimisht në shpresën të vegjël. I vetmi shkrimtar dhe kurajoz që ishte i qartë për rolin shoqëror në letërsi. Kujtojmë këtu parathënien e librit “Ëndrra dhe lot”, të cilën ai e formuloi kështu pozitën e vet: *“Është një fakt i pamohuar që letërsia e ka veprimin përmbi shtetin shoqëror dhe politik të një kombi”*. Ky koncept shpjegon edhe theksin realist që do të merrte shpesh arti i poetit, kur ishte fjala që ai të përshkruante jetën e popullit të shtypur dhe të shfrytëzuar. Vitet ‘20 kanë qenë vitet ku ai humbi perspektivën dhe u tërhoq në një si kullë të fildishtë, ku dhe ushqeui kështu ide mistike. Këto nuk ishin gjë tjetër, veçse spekulime të një stoicizmi idealist. Si një artist që i mori temat më pak nga jeta, e më shpesh nga letërsia, bëri të vetëm filozofinë e shkëputjes së njeriut dhe të artit nga realiteti.

Do të veçonim disa veçori në lidhje me këtë temë:

Poezia e tij mbeti përgjithësisht romantike, me natyrën e konceptimit dhe pasqyrimin të jetës.

Shfaqjet realiste mund të thuhet se janë sporadike në vjershat e para të poetit.

Deri në fillim të viteve 30, krahas frymës dhe tonit të përgjithshëm romantik, pasqyrimet të zbuluar të jetës, idealizimit të së kaluarës, ka dhënë dhe një krijimtari relativisht të gjerë, prandaj dhe tematika shoqërore u bë karakteristika për lirikën e Asdrenit.

Por e reja që sjell mendimi poetik, është sidomos në vështirimin realist që ka për të ardhmen. Krijimet e kësaj periudhe lanë gjurmë të ideve të socialdemokracisë evropiane.

Me forcë të rrallë akuzuese, poeti godet atë regjim që duan ta kthejnë prapa rrotën e historisë.

Ka krijime të tilla si: “Thëllënza e Lekës”, “Prej katundit”, “Në krua”, “Shega”, të llojit liriko-epik ose baladë, që përfundon hareshëm dhe pa konflikt, që edhe pse nuk kanë atë koncept realist të përcaktuar mirë të krijimtarisë së Çajupit, janë të tipit të idileve, që të fusin mirë në mjediset e fshatit shqiptar.

Pse themi që është personalitet i Rilindjes kombëtare shqiptare?

Sepse Asdreni furnizoi lexuesin me përvoja personale të këndshme, në mënyrë aq intensive.

Diti të jepte arsyen e çdo gjëje apo fragmentarizmin e kohës së leximit, shpërqëndrimet dhe shpërbërjen e jetës sonë bashkëkohore.

Shkrimtari i cili pohoi aksiomomën themelore të letërsisë, thelbin e joshjes së saj dhe leximi i veprave të tij, të fut në një gjendje reflektimi të qetë, në gjërat që ka bërë dhe nuk ka bërë, duke krijuar kështu personalitetin e vet shpirtëror dhe kulturor në botën shqiptare dhe duke rimarrë kthimin e madh të shtratit të vet kulturor.

Ngjarjet që pasuan shembjen e shtetit të lirë kombëtar, shkaktuan tek poeti një dëshpërim të thellë, që u shpreh në krijimet e periudhës 1914-1920 («Shqipëria më 1914», etj Në vjershat e viteve të fundit të jetës përshëndeti ngadhënjimin e revolucionit popullor në Shqipëri. Veprat e tij ishin në sintezë dhe shqyrtuan impaktin e kulturës së Rilindjes mbi jetën personale dhe shoqërore të njerëzve, sa në diakroninë dhe sinkroninë e historisë së njerëzimit, shkrimtari i cili radikalizoi dhe

universalizoi peshën e mendimeve të tij.¹

Nëse shohim korrespondencën e tij, është e pasur si dokument me vlerë për njohjen e lëvizjes sonë kombëtare, sidomos të shqiptarëve të Rumanisë. Ajo ka një interes të veçantë për studimin e historisë së letërsisë shqipe në vitet e para të këtij shekulli. I nisur në ndikimkin e Naimiut dhe Samiut, u duk se ishte një poet luftarak që shprehu hapur kushtimin kundër “, qenit të pabesë”, siç e quan ai Turqinë. Shkrimtari më përparimtar i Rilindjes bëri emër të madh në vitet e para të shekullit XX, poet, patriot dhe demokrat, shkrimtari që përkrahu qeverinë e Vlorës dhe priti ardhjen e Vidit. Ishte i pari që çeli një shkollë shqipe për fëmijët e mërgimtarëve tanë të Konstancës dhe një nga udhëheqësit e lëvizjes patriotike ndër shqiptarët e Rumanisë. Kujtojmë këtu sesi ai i shkruan mikut të tij, i gëzuar.

Citoj : “Tani besoj se Naim beu nuk vdiq, se vendin që la ai bosh, e zure ti”.² Në veprat e tij përmenden feudalët anakronikë dhe aleatët e tyre borgjez, ai shpreh mosbesimin në forcat popullore, të cilët ai i pandeh të pazonjat për ta ndërruar gjendjen dhe që jetojnë në mizerje fatale. E thënë troç, ai përfaqësoi në mënyrë të denjë idealet përparimtare të kohës, po ai që dhe mbeti i paqartë për shumë çështje dhe probleme. Kryesorja, që ai e nisi krijimtarinë e tij poetike me të vdekur Naimi dhe në vazhden e poetit të madh, si romantik përparimtar, ai i kushtoi rëndësi një të ardhme të mirë për popullin e vuajtur. Në një varg vjershash të fundit të viteve 30, vihet re përpjekja për të çliruar problemet e misticizmit e të fatalizmit dhe dëshira për t’u kthyer sërish në fushën e luftës për realizmin e qëllimeve fisnike në jetë. Këto synime formojnë brendinë e një varg poezive të shkruara nga fundi i viteve 30. Këto krijime me poemën “Trashëgimi” në krye tregojnë për idealet e larta morale dhe qytetare. Në një varg krijimesh të periudhës së fundit, poeti u prir drejt aluzioneve të errëta, simboleve të mjegullta dhe stërholimeve të tepruara. Kontributi i Asdrenit në fushën e lirikës shoqërore, ishte më i rëndësishëm. Me veprën e tij poetike ai i qëndroi

¹ Asdreni. “Poezia shqipe”, f.90

² Çajupi, vepra 1, f.327, letër prej Kajros, 3 shkurt 1904

afër jetës dhe në krijimet e tij ai arriti të japë veçoritë tipike të realitetit të kohës.³ Prandaj sa më shumë largohet prej nesh epoka e Asdrenit, aq më e afërt bëhet për njerëzit tanë patriotizmi i zjarrtë i poetit dhe dashuria e tij për vegjëlinë. Në lirikën e vet poetike, Asdreni u rikthehet të gjitha temave të poezisë së Rilindjes, po u jep një frymë më të hapur kushtuese. Jo më kot ai lëvron kryesisht llojet e himnit dhe të marrshit. Të njohura janë vjershat "Betimi mbi flamur" (1907) që pas vitit 1912 u bë dhe është Himni ynë Kombëtar, vjersha "Përpara", që dallohen nga një stil patetiko-oratorik, i cili shpreh një patos të zjarrtë të brendshëm. Vargjet e shumta dhe dinamike dhe njëkohësisht të thjeshta, kanë një forcë komunikuese të veçantë.

Shkrimtari mbetet i veçantë në llojin e vet, sepse jeta atdhetare, kulturore dhe letrare e tij, u shfaq si një prirje e qëndrueshme, që u përhap jo vetëm në krijimtari, por luftoi për afirmimin e vet edhe në rrafshin teorik.

Edhe kur shkrimtari nuk pati kohë të kristalizonte faktet, zhvillimet historike të vendit, rrodhën në mënyrë të tillë që krijuan të gjitha kushtet për triumfin e Rilindjes Kombëtare, tani të një tipi të ri.

Angazhimi i thellë pas çështjeve jetike të epokës , tendencioziteti i theksuar atdhetar dhe qëndrimet e hapura demokratike, qartësia e shprehjes artistike dhe të tjera karakteristika të Letërsisë së Rilindjes, fituan brendi të re dhe u thelluan më tej. Këtu shkrimtari nuk e kufizoi mundësinë për ta pasqyruar në mënyrë më të plotë dhe më të thellë jetën shqiptare të kohës së tyre.

Emocionin e lexuesve shkrimtari u përpoq ta ngjalli vetëm nëpërmjet vërtetësisë së episodeve, vërtetësisë së përshkrimit të ndryshimeve të gjendjeve shpirtërore. Këtu parapëlqehen edhe gjykimet dhe qëndrimet shpirtërore, ironia dhe sarkazma therrëse duke kultivuar ato tipare shpirtërore që ai përshkon.

Shkrimtari kishte aftësi të mira për të vjeshtëruar dhe zotërim të mjeteve të stilit , si përpjekje për pasurimin e vjershërisë shqipe me

³ Asdreni. "Reze dielli" " Ëndrra dhe lotë", Tiranë 1981, f.149

vargje, metra, strofa.⁴

Letërsia sipas tij është një mjet që i qaset më mirë realitetit historik dhe kulturor, formë letrare që realizon këtë përmasë nëpërmjet mjetit të gjuhës, të praktikës letrare, si një dimension i brendshëm i formave shprehëse të ligjërit artistik. Shtojmë këtu se kontributi i çmuar i shkrimtarit mbi shtypin shqiptar të kohës dhe mbi çështjet e ndryshme të lëvizjes kombëtare, përforcoi edhe më shumë konceptin e Rilindjes Kombëtare. Ky koncept objektiv ishte mjeti për të zbuluar realitetin dhe përshëndeti mundësitë krijuese dhe moderne të një mendimi të pavarur.

Si përfundim, me rrugën e saj të gjatë, krijimtaria poetike e tij, me përjashtim të periudhës fillestare dhe të fundit, njohu një rritje të vazhdueshme. Ndikimi i poezisë rumune dhe asaj evropiane, luajti rol për rritjen e kërkesave të tij ndaj mjeshtërisë artistike, duke bërë kështu që autori të hyj në radhën e shkrimtarëve përparimtarë, që krijimtarinë letrare dhe publicitike ta vendosi në shërbim të përparimit të atdheut. E pra, çdo gjë e bukur e ka dhe fundin e vet. Me shpresën se herën tjetër do të mblidhemi për një tjetër shkrimtar të fushës së letrave, ashtu siç ky qytet di të vlerësojë njerëzit e punës, unë ju uroj suksese në vazhdimësi.

Faleminderit!

Literatura e shfrytëzuar:

Asdreni. “Reze dielli” “ Ëndrra dhe lotë”, Tiranë 1981, fq.149

Asdreni. Poezi të zgjedhura. Nga libri “Reze dielli”, Tiranë, 1972

Asdreni. “Poezia shqipe”, ShB. Naim Frashëri

⁴ Asdreni. Poezi të zgjedhura. Nga libri “Reze dielli”, f.156

REXHEP QOSJA PËR ADRENIN

Edlira GUGU
Fakulteti Shkencave Humane
Departamenti Letersi –Gazetari
Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan
egugu6@gmail.com

Abstrakt

Monografia “*Asdreni, jeta dhe vepra*” është vepra në të cilën Rexhep Qosja si kritik i letërsisë trajton për herë të parë në një vështrim monografik të plotë jetën dhe krijimtarinë e Asdrenit.

Punimi merr në konsideratë metdoën e vështrimit të krijimtarisë e poetikës së Asdrenit nga Qosja duke synuar të shpjegojë:

- prirjet e poetit;
- tipologjizimin e evolucionit krijues të Asdrenit të ndarë në etapa dhe ndikime;
- strukturën e vëllimeve poetike të Asdrenit, temat mbizotëruese, gjuhën dhe figuracionin artistik.
- veçoritë e procesit krijues në këtë kontekst e deri në ç’masë këto risi letrare të sjella prej tij modifikuan perspektivën e zhvillimit të letërsisë shqipe.

Poetika e shkrimtarit, interpretohet mbështetur në prirjet moderniste të krijimtarisë së Asdrenit bashkëngjitur me tendencën për të zbuluar tipare të brendshme filozofiko- letrare individuale si praktikë e cila në shkrimet kritike dhe në historiografinë letrare të kohës mungonin.

Fjalë kyç: monografi, krijimtari, poetikë, kritikë, evolucion krijues.

Monografia “*Asdreni, jeta dhe vepra*”¹ e studiuesit të letërsisë Rexhep Qosja, botuar për herë të parë në vitin 1972 në Prishtinë, ishte studimi i parë i këtij lloji, pasi në shkrimet kritike dhe në historiografinë letrare

¹ Rexhep Qosja e ka shkruar tezë për mbrojtjen e titullit doktor shkencash pranë universitetit të Prishtinës dhe hedh hapat e parë të një studiuesi të pasionuar me prirje drejt historisë së letërsisë.

të kohës mungonin gjykime shkencore mbi krijimtarinë poetike të Asdrenit, vlerën artistike dhe vendin e saj në letërsinë shqipe.²

Ky studim monografik³ me anë të titullit: *Asdreni dhe jeta e tij*, i orienton synimet e tij plan kulturorohistorik duke paralajmëruar qasjen metodologjike⁴ të studiuesit.⁵ Qosja duke vlerësuar kontributin e Asdrenit njeri dhe poet e ndan monografinë në dy pjesë:

Pjesa e parë e organizuar në dhjetë kapituj dhe vë në dukje elementët jetësorë të poetit si:

Fëmijëria dhe shkollimi fillor; Vitet e para në mjedisin e ri; Fillimi i veprimtarisë atdhetare etj., në të cilën studiuesi i kushton rëndësi të dhënave biografike dhe atyre psikologjike të Asdrenit sepse krijojnë mundësinë të kuptohet psikologjia e autorit (Asdrenit) e cila ndikon në procedenë krijuese për të rendur më tej drejt kuptimit të veprës së tij.

Pjesa e dytë ndahet në dhjetë kapituj mbi tipare të krijimtarisë së tij duke tipologjizuar:

- Elementë që realizojnë në mënyrë të plotë procedenë krijuese të nën ndikimin e faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm;
- Temat dhe motivet;
- Tipologji të elementëve që lidhen me formën e stilin e poetit.

I. Elementë të procesit krijues

a. Konteksti social- kulturor

Konteksti social-kulturor është një nga elementët e qasjes në plan diakronik, i nevojshëm për të kuptuar procese, fenomene letrare e

² Rexhep Qosja, “*Asdreni jeta dhe vepra e tij*”, Toena, Tiranë, 2002, f.22

³ Pjesa e parë vështron jetën dhe veprimtarinë social-politike të shkrimtarit dhe pjesa e dytë përqëndrohet në krijimtarinë letrare të tij.

⁴ Metoda mbizotëruese është qasja krahasimtare e tipi gjenetik, e cila ka për objekt ngjashmëritë që lindin përmes kontaktit, duke zbuluar të dhëna të hollësishme rreth tyre e duke pohuar që kontakti ka qënë i vërtetëm i plotë i hetuar në lidhjet personale të tij dhe korrespondencën.

⁵ Qosja është i mendimit që vëzhgimi i veprës së një shkrimtari duhet të realizohet si në drejtim të kontekstit historik e kulturor, procedesë artistike ashtu edhe në drejtim të vlerave estetike të saj. Të dhënat e detajuara biografike të Asdrenit dhe ato psikologjike bëjnë të mundur të kuptohet psikologjia, bota e brendshme e autorit e cila krijon mundësi të kuptimit të veprës së tij.

zhvillimin e tyre si kategori historike, dhe për të realizuar interpretimin e tyre në këtë kuadër.⁶

Sipas kësaj pikëpamjeje R. Qosja me anë të hetimit të kontekstit social-kulturor vë në dukje e traditën letrare të asaj kohe dhe faktorë që ndikuan në zhvillimin e saj dhe sollën lindjen e kategorive të reja estetike dhe individualiteteve letrare.⁷

Vështrimi i kontekstit social-kulturor dhe zhvillimit të poezisë shqipe në fillim të shekullit XX në monografinë për Asdrenin përqendrohet në disa të çështje të rëndësishme si: koha kur Asdreni fillon të botojë poezitë e veta⁸; konteksti kulturor dhe shkrimtarët përfaqësues të tij, prirjet krijuese të tyre,⁹ temat dhe motivet mbizotëruese; karakteristikat kryesore në krijimtarinë e shkrimtarëve.

Kështu ai heton zhvillimin e perceptimit të përgjithshëm ndaj poezisë dhe identifikon brenda tij tendencën për t’u pasuruar dhe të sjellë risi në tematikë, forma të reja dhe ndjeshmëri.

b. Ndikimet

Sipas Qosjes ndikimet luajnë rol të rëndësishëm në krijimtarinë e Asdrenit, për shkak edhe të ndjeshmërive të caktuara sociale e kulturore të tij. Hetimi i tyre nëpërmjet *ndërtekstorësisë* së brendshme e të jashtme vë në dukje veçantitë e mendimit të Asdrenit, ndikimet nga kultura rumune, ngjashmëritë por edhe origjinalitetin e tij. Qosja është

⁶ Cituar sipas Floresha Dados, në “Sfida teorike të historiografisë letrare”, Bota shqiptare, Tiranë, 2009, f. 249

⁷ Po aty

⁸ Shënim: Asdreni ka filluar të botojë poezitë e veta më 1901 një vit pas vdekjes së Naim Frashërit dhe dy vite para vdekjes së Jeronim De Radës- dy shkrimtarë të mëdhenj me karakteristikë të Rilindjes. Pas vdekjes së tyre letërsia ishte pa autoritete krijuese, por jo edhe shkrimtarë që premtinin se do ta shpinin tutje fjalën artistike dhe do ta zgjerorin e pasuronin letërsinë shqipe. Qosja Rexhep, *Asdreni dhe jeta e tij*, Toena, Tiranë, 2002, f. 221.

⁹ Shënim : Qosja vë në dukje qëllimin e këtyre shkrimtarëve: I bashkonte lufta për ngritjen kulturore dhe kombëtare të shqiptarëve dhe për çlirimin e tyre nga robëria otomane. Ata shkruajnë aso poezish me të cilat supozojnë se do të mbërrijnë më lehtë dhe më shpejtë në qëllimin kryesor: mobilizimin shpirtëror të shqiptarëve para luftës për pavarësi...tek këta krijues e bashkë me ta edhe Asdreni më shumë e fuqishme është vetëdija se në shkrimet e veta duhet të luajnë rolin mesianist të ideologëve shoqëror se sa vetëdijen artistike. Po aty f. 222.

i mendimit që krijimtaria e Asdrenit nuk është imitim, por ajo paraqet rrugëtimin e natyrshëm të autorit, i cili është pjesë e dukurive dhe e procesit të zhvillimit historik të letërsisë shqipe.

Në vëzhgimin që Qosja i bën *ndikimeve letrare të Asdrenit*, heton reminishenca, huazime, imitime, përshtatje, ngjashmëri etj. si fermente zotëruese të frymëzimit apo të paraqitjes artistike, të cilat e ngrenë krijimtarinë në një shkallë më të lartë; i sheh si marrëdhënie që zbulojnë origjinalitetin artistik të Asdrenit duke evidentuar vlera të veçanta në dialog me traditën së cilës i përkasin, por nga ana tjetër, duke çuar më tej, brenda kësaj tradite, kategorinë e cilësisë së tyre.

Gjurmimin e shndërimeve të poetikës krijuese të Asdrenit, Qosja e lidh me ndikimet e shumta kulturore, zhvillimi të interesimeve të tij ndaj poezisë dhe formave të saj të shprehjes e për këtë arsye botimi i veprave të tij është bërë në distanca të mëdha kohore. Përveçse i bën një paraqitje të të gjitha fazave të krijimtarisë së Asdrenit¹⁰, ai analizon dhe krahason zhvillimin e shndërrimin e procedesë krijuese të

¹⁰ Shënim: si faza të krijimtarisë së Asdrenit, Qosja përcakton : Faza e parë-përmbledhja Rreze dielli, ku poeti i qënron besnik traditës poetike, trajton tema dhe nuk del përtej rrethit të ndjeshmërisë së njohur të kohës, patetizmit, pa shprehje të përpunuar artistike, figurative dhe metaforike, tema të ngushta shprehje të zbehtë poetike, mbizotërim i vetëdijes kombëtare, strukturë ritmike e rëndë. Faza e dytë e krijimtarisë së tij fillon që pas botimit të përmbledhjes së parë dhe zgjat deri në botimin e përmbledhjes së dytë dhe shënohen si karakteristika vazhdim i prirjeve të afirmuara në vjershat e së parës dhe dëshmon prirjen e një tendence të re që lidhet me organizmin e poezive në cikle, përmbledhje zgjerim tematik duke u frymëzuar prej sferash metafizike, poezia nuk është mjet i propagandës, sjell forma të ndryshme të reagimit subjektiv etj. zgjohet interesi i autorit të njohë traditat e letërsisë botërore duke pësuar ndikime sidomos nga poezia evropiane. Faza e tretë fillon pas botimit të përmbledhjes së dytë dhe zgjat deri në botimin e përmbledhjes së tretë. Ai shfaqet si lirik me përvojë të madhe krijuese duke realizuar një ndjeshmëri poetike karakteristike specifike. Ndryshon qëndrimi i tij ndaj botës duke përcjellë më shumë në poezi ndjeshmëri të përjetimit të brendshme, duke krijuar një poezi psikologjike meditative, me tema universale , ku përdor vargun e lirë nën ndikimin e poezisë bashkëkohore që lexon. Faza e katërt fillon me botimin e përmbledhjes *Psallme murgu* dhe merr fund në 1945 kur dhkruan vjershat e mbrame dhe bën gati për shtyp përmbledhjen *Kambana e Krujës*. E njeh si fazën e rënies së talentit të tij si për nga ana cilësore dhe ajo sasiore. Karakterizohet nga kthimi pas në temat e së kaluarës historike, varg rrëfimtari i njëtrajtshëm etj. Rexhep Qosja, “*Asdreni jeta dhe vepra e tij*”, Toena, Tiranë, 2002.

vështruar në drejtime të ndryshme: si prirjet poetike dhe frymëzimet; ndikimet nga tradita e letërsisë shqipe dhe asaj të huaj; tematikën e trajtuar; llojin e vargut dhe të shprehjes artistike, përpunimin e tyre; rendjen drejt metafizikës shpirtërore, raportin art, poezi shoqëri dhe funksionet e saj në periudha të ndryshme etj

Ai i përcakton ndikimet me anë të tipologjisë kryesisht si formë e brendshme: si stil, imazhe, karaktere, tema, procedime, përmbajtje, mendime, ide etj.

Si tipe ndikimesh indentifikon kryesisht:

- *Ndikime të veprës mbi veprën*.¹¹

- *Ndikime të shkrimtarit* si njeri nga një individ a shkrimtar tjetër (i pasqyruar kryesisht në stil e në botëvështrim më shpesh se në formën artistike.

- ndikimet e letërsisë shqipe

- ndikimet e letërsive të huaja.

Duke bërë një prerje tipologjike evidenton ndikimet më të fuqishme të Asdrenit të realizuara nga: *kontakte të jashtme dhe të brendshme* :

1. *në kontakteve të jashtme* të ndërmjetësuar, të realizuara prej shkaqesh joletrare¹²:

a. Studiuesi vë në dukje *ndikime nga Naimi* në formimin e tij si atdhetar dhe poet, ndikim nga pikëpamjet themelore, botëkuptimit, të ideve, iluminizmit të tij;

¹¹ Shënim: mund t'i referohemi këtu ndikimeve që përmend Qosja kryesisht nga poezia parnasiane, simboliste etj konkretisht në poezinë *Në krrua* apo poezia *Pamje*. Po aty f. 227.

¹² Shënim: Me kontakte të jashtme kam parasysh informacionet nga fusha të ndryshme të jetës të cilat nuk luajnë rol të drejtpërdrejtë në procesin e brendshëm letrar. Ato krijojnë jehonë në mjedisë krijuese dhe në mjedisë të tjera mbi fenomenet letrare. Kontaktet e brendshme realizohen në mënyrë të drejtpërdrejtë me procesin letrar, duke lënë gjurmë në të. Këto kontakte kushtëzohen nga faktorë të jashtëm dhe të brendshëm. Kontakte të drejtpërdrejta janë ato kontakte që pasqyrojnë lidhjen e drejtpërdrejtë me veprat letrare dhe parakuptojnë kontaktin me origjinalin. Kontaktet e ndërmjetësuar realizohen me anë të ndërmjetësit, që mund të jenë të llojeve të ndryshme nga informacionet publicistike e deri tek artikujt e studimet shkencore. Jorgo, Kristaq, Kategoritë themelore të raporteve ndërletrare individuale dhe tipet kryesore të krahasimit, në *Leksione për letërsinë e krahasuar*.

b. *ndikime nga letërsia popullore*: këto ndikime shfaqen në interesimet e tij për folklorin, mbledhjen dhe promovimin e tij;

c. *ndikime nga letërsia e huaj*. Për të bërë një paraqitje të plotë të ndikimeve nga letërsia e huaj, Qosja, realizon një vështrim në kontekstin kulturor të kohës, përmend faktin që Asdreni ka lexuar shumë dhe ka njohur veprat e shkrimtarëve të Antikitetit, Mesjetës, Rilindjes Evropiane apo edhe shek XVIII dhe XIX.

2- kontakte të brendshme të drejtpërdrejta realizuara prej shkaqesh letrare:

a. Ndikime nga Naimi të cilat të vlerësuara nga cilësia e lidhjes shfaqen si ndikime pasive¹³ - në orientimin e trajtimit të temave historike, në përfshirjen në krijimtarinë e tij të elementeve të mitologjisë greke, himnizimin e natyrës shqiptare, ndikim në veçoritë formale të poezive, në pikëpamje të leksikut, strukturës figurative e ritmike të vargjeve, përdorimi i shprehjes zvogëluese etj.

b. ndikime nga folklori: në huazimin e motiveve¹⁴ dhe formave të shprehjes, ndikimin në mënyrën si portretizon vashën dhe djalën, si përshkruan dhe si e përjetojnë dashurinë mes tyre, përshkruan lindjen e ndjenjës mes tyre, përdorimin e emrave me të cilët emërton personazhet, në përdorimin e figuracionit artistik (kryesisht metaforës), në ndërtimin e ritmik figurativ.

c. ndihet ndikimi i poezisë evropiane e kryesisht i asaj franceze, poezisë romantike e më tej i poezisë parnasiste.

Këto *ndikime aktive të drejtpërdrejta*,¹⁵ i sheh në përdorimin e shprehjes së formalizuar, në fjalorin e veçantë i cili dëshmon zhvillimin e

¹³ Shënim: Me ndikime pasive kam parasysh që elementi dominant është fenomeni ose elementi i huazuar, që zotëron autorin përvetues dhe krijimin e ri. Në këto raste kemi një transferim mekanik të vlerave dhe jo një ridimensionim krijues të tyre. Po aty.

¹⁴ Shënim: Qosja bën analiza dhe interpretime për secilin rast të ndikimit duke përcaktuar rolin e ndikimit në krijimtarinë e Asdrenit. Qosja Rexhep, *Asdreni dhe jeta e tij*, Toena, Tiranë, 2002, f. 223.

¹⁵ Shënim: ndikimet aktive janë ato ndikime të cilat çojnë në një rivlerësim, në një ridimensionim të fenomenit të huazuar në nënshtrimin e tij ndaj synimeve të reja që në thelb nuk kanë të bëjnë me apo që janë të një natyre tjetër nga ato të origjinalit. Ato

imagjinatës. Identifikon në poezi të veçanta¹⁶ forma të ndikimit nga poezia parnasiste e cila në raste të caktuara shfaqet e gërshetuar me ndikim nga poezia e simbolizmit¹⁷ dhe ekspresionizmin¹⁸. Qosja bën një analizë të gërshetimit të këtyre elementeve dhe forma të shfaqjes në poezinë e Asdrenit. Mund të sjellim si shëmbuj të tillë nga letërsia e huaj¹⁹: ndikime nga Dante Aligeri- rigjallërimin e disa simboleve, shfrytëzimin e konceptimeve qiellore, sikundër janë Parajsa, Ferri, përzgjedhjen e njëmbëdhjetërokëshit dantesk etj; ndikim nga francezët (Marselino Debord, Hygo) prej të cilëve ka huazuar moton për poezinë e *Drinit*, *Dëshira ime* dhe *Të falura*²⁰. Përmes këtyre dukurive studiuesi shpjegon ndjeshmërinë e veçantë të poezisë së Asdrenit, kryesisht pasromantike, apo krahasimin me parnasizmin (detajet në poezitë Liqeni i Prespës , Endërr e vërtetë), kultin e formës të huazuar prej tyre etj duke pohuar se roli i tyre në krijimatinë tij ka qenë vendimtar.

d. *Ndikime të poezisë rumune* janë shprehur më së shumti në fazën e pjekurisë krijuese të Asdrenit. Studiuesi sjell arsye të ndikimit të plotë: *si përjetimi i vlerës artistike të tyre dhe gjetja në to i tematikave,*

gjithnjë çojnë në krijimin e një vepre të re, të paidentifikueshme me asnjë tjetër. Jorgo, Kristaq, *Kategoritë themelore të raporteve ndërletrare individuale dhe tipet kryesore të krahasimit*, në *Leksione për letërsinë e krahasuar*.

¹⁶ Është fjala për poezinë e Asdrenit , *Në krua*, ku Qosja identifikon pamjet tipike parnasiane në të cilën përshkrimi shprehës i situatës i mbivihet çdo qëllimi tjetër krijues. Në këtë poezi, Asdreni përshkruan takimin e papritur ndërmjet vashës që ka vajtur të mbushë ujë në krua dhe djalit kaluar , që ndalet t’i kërkojë ujë. Në letërsinë popullore, por as në letërsinë e Rilindjes nuk ndeshen raste të tilla të përshkrimit të mashkullit kaluar që në stilin e aristokracisë evropiane i qaset vashës. ...këto lloj përshkrimesh mund të gjenden vetëm në poezinë parnasiste. Qosja Rexhep, *Asdreni, jeta dhe vepra*, Instituti albanologjik, Prishtinë, 2010, f. 226.

¹⁷ Ky ndikim i gërshetuar ka nxitur interesin e tij për mitet dhe simbolet , aleksandrinin, njëmbëdhjetërokëshin, për tingëllimën, për organizmin e përpiktë të vjershave nëpër cilke dhe për një kompozim racional të përmbledhjeve. Po aty Qosja Rexhep, *Asdreni dhe jeta e tij*, Toena, Tiranë, 2002, f. 227.

¹⁸ Pamjet kozmike, ashtu dhe reagimet ndaj luftës botërore, kulti i mbinjeriut etj. Poezia Pamje të përkujton format poetike , me trajtën e monologut, rimat mezi të dukshme, ritmikën e thyer etj elementë tipikë të ekspresionizmit. Po aty f. 227.

¹⁹ Po aty, f. 271.

²⁰ Po aty f. 225.

motiveve, problematikave të cilat përkonin edhe me realitetin shqiptar. Edhe brenda këtyre ndikimeve Qosja identifikon elemente që i përkasin fazave të ndryshme të zhvillimit të letërsisë rumune të lidhura ngushtë me vlerën artistike, prirjen ideore dhe përkatësinë stilistike²¹ si dhe të shfaqura tashme brenda veprës së Asdrenit si cilësi organike të formës dhe zhvillimit të tij krijues. Analiza e ndikimeve është relativisht e detajuar sa përcakton konkretisht ndikimet të cilat lidhen me trajtimin e motiveve të veçanta në krijimtarinë e Asdrenit.²² Si shembuj të tillë do të sillnim:

- Ndikime pasive të drejtpërdrejta nga Vasile Aleksandriu, poeti shkruan poezi *Kënga e bashkimit*, që është një përshtatje e poezisë *Hora uniti* të Aleksandriut, poezia *Vjeshta etj*; Eminesku prej të cilit ka ndikimet të shumëfishta, kap pamje, ide, forma të ndjeshmërisë, të vargut, strofave, poezive. Poezia *Epigonët* është imitim, *Dëshira ime* parafrazë etj; ndikime nga Xhorxhe Koshbuk- *Zëri i kryengritësve*, *Krerëve tradhëtorë* etj, Tudor Argezi - ndikime në idetë mistike, përdorimin e shprehjeve të caktuara si murgu, pendesa, lutja, kungimi, shpirti, mëkata etj.

Duhet thënë që studiuesi duke evidentuar se si janë sendërtuar artistikisht këto ndikime, si dhe përmes përcaktimit të tyre edhe pse në raste të caktuara shfaqen pasive, krijon mundësi të zbërthejë në mënyrë origjinale parimet krijuese (në planin psikologjik, në aspektin historik-letrar) dhe të përligjë vazhdimësinë e zhvillimit të lirikës shqipe në drejtim të vlerës estetike e formës.

II. Temat dhe motivet

²¹ Qosja identifikon shkrimtarët rumunë që kanë ndikuar më së shumti si: Vasile Aleksandriu, Mihai Eminesku, Xhorxhe Koshbuk, Tudor Argezi etj. Po aty f. 229.

²²Për trajtimin e motiveve atdhetare Qosja përcakton ndikim thelbësor krijimtarinë e Vasile Aleksandriut, për poezinë lirike, ndjeshmërinë tepruar dhembjen format e vargut dhe të strofave, kryesisht në poezinë atdhetare, sociale dhe të natyrës përcakton Mihai Emineskun. Xhorxhe Koshbuku gjithashtu ka ndikuar në krijimtarinë e Adrenit në lidhje me këto elementë, e po ashtu Tudor Argezi ndikimet e të cilit Qosja i sheh edhe në titujt e poezive, cikleve dhe përmbledhjeve psh: “Psallme Murgu”. Po aty f. 232.

Klasifikimi tematik që i bën krijimtarisë së Asdrenit, konsiston në vëzhgimin e temës në dy plane:

- realizimi i procedesë krijuese mbi një tematikë të caktuar, e nxitur dhe e përfutur si produkt i ndjenjës e disponimit shpirtëror;
- si *kategori makrostrukturale* në plan të përgjithshëm, pjesë e inventarit dhe e klasifikimit të temave e motiveve kryesore, e evolucionit të tyre, rimarrjes apo zëvendësimit etj.

Analiza karakterizohet nga një përshkrim i detajuar në plan sasior i poezive me një tematikë të caktuar; i procesit krijues dhe frymëzimit që i ka nxitur ato; i ndryshimit të disponimit shpirtëror i cili sjell ndryshime konceptuale të përmbajtjes e si rezultat ndryshim edhe në trajtimin e motiveve të rrimara. Qosj vë në dukje vetëdijen e Asdrenit jo vetëm për trajtimin, zhvillimin e temave por edhe të transformimit të kuptimit e të domethënies së poezive. Në sinkroni studiuesi, përmes krahasimit bën një analizë të hollësishme, të shpërfaqjes së motiveve dhe mënyrës së trajtimit të tyre, nga njëra vepër tek tjetra, ndërsa në diakroni me letërsinë shqipe dhe ato të huaja, qasja tematike, evidenton risitë dhe të veçantat e trajtimit të tyre.²³

a- Motivi Atdhetar

Gërshetimi i *motivit atdhetar me atë social* të sjellë përmes elementeve simbolike që përdor autori (Asdreni) në poezi, interpretohen nga studiuesi si fryt i frymëzimit nga realiteti e konteksti i kohës dhe njihen si forma të poezisë së angazhuar. Evidentimi i motiveve mbizotëruese në poezinë e angazhuar shoqërohet me një analizë të të metave që i karakterizojnë e cila konsiston në vënien në dukje të:

- në drejtim të realizmit të procesit krijues si: mungesa e frymëzimit dhe përjetimit, sepse poeti shkruan nën diktatin e situatave momentale politike dhe historike,
- në drejtim të përmbajtjes: tema dhe motive të përsëritura;

²³ Shënim: Mund të përmendim psh dallimin që bën Qosja tek monografia e Asdrenit trajtimin e motivit të natyrës dhe të peisazhit kur shprehet: me visoret e tij mund të thuhet se në poezinë shqipe depërton edhe një hapësirë e re e realitetit, që zgjeron përmbajtjen e ndjenjave poetike, pasuron poezinë shqipe me një formë të re... Qosja Rexhep, *Asdreni dhe jeta e tij*, Toena, Tiranë, 2002, f. 263.

-në drejtim të formës: shprehje e drejtpërdrejtë dhe publicistike, vargje të njëtrajtshme, ton i ashpër solemn apo i butë sentimental etj.

Rëndësia e tyre për Qosjen, më shumë si krijime artistike, qëndron në vlerën dokumentare të tyre, si pjesë e krijimtarisë, e njëkohësisht si substancë nistore për t’u marrë në konsideratë si mundësi që dëshmon evoluimin e pikëpamjeve të poetit ndaj krijimit artistik dhe procedesë krijuese në tërësi, duke ia përshtatur formën e saj, përmbajtjes.

b. Motivi filozofik

Motivin e natyrës Qosja e trajton në disa plane:

-në raportin që zë kjo pjesë e krijimtarisë së tij kundrejt gjithë motiveve të tjera duke specifikuar të veçantën pasi për Qosjen, ai është poeti i parë që temës së natyrës, e trajton në mënyrë të barabartë me motivet e tjera të poezisë lirike.

-në diakroni të trajtimit të këtij motivi me letërsinë botërore dhe atë shqiptare, duke evidentuar risinë e sjellë nga Asdreni të ndikuar nga letërsia evropiane: *ai e pasuron poezinë shqipe me një formë të re të reagimit emocional dhe shpirtëror ndaj jetës në tërësi.Me visoret e tij mund të thuhet që në poezinë shqipe depërton edhe një hapësirë e re e realitetit , që zgjeron përmbajtjen e ndjenjave poetike.*²⁴

-Në tipologjinë e parë, të titulluar *si Visorja e humanizuar*, motivi i natyrës realizohet në funksion të marrëdhënies dhe lidhjes që ka poeti me vendlindjen, nevojës për të përcjellë me anë të saj, jo vetëm ndjenja tipike ndaj saj, por edhe të transmetojë mesazhe të ndryshme moralizuese përmes tyre. Qosja identifikon si tendencë të këtij lloji të poezisë dhe të shfrytëzimit të mjeteve të saj duke trajtuar: ciklin jetësor, kuptimin dhe qëndrimin e njeriut në harmoni me të, humanizimin e natyrës në funksion të kësaj marrëdhënie. Vëzhgimi i tij përqendrohet në mënyrën e veçantë të organizimit të këtyre motiveve dhe në përcjelljen e pikëpamjeve të poetit mbi këto dukuri.

- Në tipologjinë e dytë të titulluar *Visorja simbolike*, studiuesi e synon domethënien përmes funksionit simbolik që i poeti i vesh natyrës. Njëkohësisht ai evidenton elementët që bëjnë ndryshimin ndaj

²⁴ Po aty f. 263.

tipologjisë së parë,²⁵dhe përmes qasjes krahasimtare të poezive me tema të njëjta, vë në dukje evoluimin e formave të procedesë krijuese të Asdrenit në dy faza të ndryshme të krijimtarisë.²⁶Në këtë kontekst merr në shqyrtim mjetet me të cilat poeti realizon procedenë krijuese dhe prodhon një domethënie të caktuar, ndryshimi i të cilës duket në qëndrimin e autorit ndaj përmbajtjes, depersonalizmin dhe shkrirje të unit poetik ndaj dukurisë, përdorimin e figurave stilistike, përcaktimin e detajeve simbolike, asociacioneve që zgjojnë ato në këtë funksion etj. Përcaktimi i elementëve të tillë e çon Qosjen në gjurmë të impresionizmit në poezinë e Asdrenit.

c. Motivi erotik dhe figura e femrës

Në evidentimin e procedesë krijuese të poezive me motiv erotik Qosja fokusohet tek: *qëndrimi e poetit ndaj figurës së femrës, pikëpamjet ndaj saj, ndikimet dhe momenti në të cilin e krijon këtë lloj të poezisë*. Për këtë arsye vlerësimin e nis nga: mënyra dhe këndvështrimi me të cilin shihet ndjenja e dashurisë (aspekti social- etik), nga aspekti estetik (glorifikimi i së bukurës) dhe nga aspekti meditativ (meditimi për shfaqjen e formave të ndryshme të saj).

Studiuesi, e konstaton evolucionin e motiveve të dashurisë të realizohet përmes transformimit, duke kaluar nga përjetimi i ndjenjës në estetizimin e së bukurës, me anë të simboleve dhe figurave mitologjike. Gjithashtu huazimi i elementeve mitologjike nga antikiteti grek, për pasurimin e përmbajtjes së tyre shihet prej tij pikërisht në këtë funksion.

Interes paraqesin për studiesin përdorimi i mjeteve poetike me karakter strukturor si: identifikimi i njësive kuptimore, efekteve tingullore, njësive sintaksore etj. Këto elemente për Qosjen, zgjojnë asociacione

²⁵ Qosja specifikon si të tillë: ngritja e të veçantës në funksion të së përgjithshmes; më shumë sugjeron se përshkruan; në vend të syrit i kushtohet mendjes; nuk i intereson sipërfaqja e objekteve , por brendësia e tyre; synon thellësitë e dukurive; në vend të pamjeve rrafshore synon ato pingulore; mbizotërimi i elementeve tingullore, harmonia, disonancat akustike; disponim i ngrysur, fjalor i veçantë etj. Qosja Rexhep, *Asdreni dhe jeta e tij*, Toena, Tiranë,2002.

²⁶Shënim: Është fjala për dy poezitë e Asdrenit: *Perëndim dielli në verë* dhe *Vegim perëndimi*. Po aty.

të ndryshme kuptimore, i krijojnë mundësi të vlerësojë trajtën së poezisë kundrejt përmbajtjes së saj, të përcaktojë estetizimin e ndjenjës si parim krijues i poetit. Nuk i shpëton vëmendjes së studiuesit përdorimi i gjuhës, përpunimi i shprehjes artistike dhe fjalori në funksion po të këtij parimi.

Një trajtë më e zhvilluar procedesë artistike rreth këtij motivi për Qosjen, është *përsiatja* dhe *meditimi* për të transmetuar forma të reja konceptimi të ndjenjës, figurës së femrës, ku studiuesi dallon risi në teknika: krijimin e situatave psikologjike, ndërtimin kompozicional dhe përdorimin e shprehësisë me funksion simbolik. Gjatë gjithë interpretimit, e synon ndërtimin e përjetimit të poetit, rezultat të të cilit merr forma të ndryshme të shfaqjes së poezisë.

a. Poezia meditative

Poezia meditative e Asdrenit shquhet nga Qosja për veçoritë specifike që mbart në krahasim me lloje të tjera të lëvuara prej tij të evidentuara në disponimin shpirtëror, temat e motivet,²⁷botëkuptimin, unin e dyzuar etj. Asdreni e krijon këtë lloj poezie nën gjendje të ngarkuara psikologjike individuale, duke dalluar edhe subjektin të cilit, i drejtohen këto poezi.²⁸Studiuesi e synon në plan të përgjithshëm kuptimin e poezisë meditative të Asdrenit, e për këtë, ideja kryesore që i shoqëron në tërësi, vjen përmes interpretimit në atë pjesë të krijimtarisë ku është më e dukshme, tipike.

Qënia e dyzuar e poetit, vetëdija, nënvetëdija, ëndrra, imagjinata etj, janë elementë të teorisë psikanalitike të cilat i vijnë në ndihmë studiuesit përmes leximit të përgjithshëm tij perceptiv, për të realizuar

²⁷ Ndër motivet mbizotëruese Qosja identifikon motivin e dhembjes dhe vuajtjes e cila vjen nga shkaqe të ndryshme si : vuajtja për shkaqe të natyrës shoqërore dhe të shkaqeve metafizike, poezia e pamjeve kozmike. Jeta dhe kuptimi i saj, shpirti, vdekja dhe përjetësia , liia e vullnetitdhe mëkati, këto janë problemet më të shpeshta por jo të vetme me të cilat është ngarkuar qënia e tij intime dhe të cilat i shquan në poezitë meditative etj. Qosja Rexhep, *Asdreni dhe jeta e tij*, Toena, Tiranë,2002, f. 294.

²⁸ Qosja dallon: Poezia meditative bëhet ashtu poezi e problemeve intime shoqërore, që e mendojnë autorin e tyre dhe për këtë arsye shquhen për tonin intimist, çfarë nuk mund të gjendet as ne vjershat kushtuar natyrësas në ato kushtuar dashurisë dhe femrës. Po aty f. 293.

domethënien e poezive. Por duhet shtuar që Qosja vetëm i dallon këto elemente, pa analizuar në tekst si prodhohet kuptimi. Studiuesi është i prirur më shumë të analizojë kushtet të cilat bëjnë të mundur të prodhojnë një poezi me shenja të tilla.²⁹

Ndërkohë në poezi të ndryshme shquan motive të trajtuara edhe në poetë të njohur të simbolistë.³⁰ Studiuesi vetëm sa gjen pika takimi por nuk e shtrin analizën në nivele krahasimi. Si risi, të lidhura ngushtë me tematikën që trajton, shquan edhe elementët teknikë që realizojnë këtë lloj poezie psh: leksiku me anë të të cili krijon një atmosferë misterioze, fantazmagorike.³¹

III. Stili i Asdrenit

Stili është një nga elementët të cilit studiuesi i kushton rëndësi të veçantë në hulumtimin e tij. Duke qënë se stili në thelb është kategori jokohore, ai formohet dhe ndryshon krejtësisht në varësi nga botëkuptimi, nga tipi i marrëdhënieve me mjedisin përreth³² e gjithashtu kushtëzohet nga karakteri i shkrimeve pararendëse,³³ Qosja e koncepton stilin si shprehje e personalitetit të autorit nga ky këndvështrim.

Në monografi në e Asdrenit realizon dy prerje të përgjithshme:

²⁹ Qosja shprehet: *I pezmatuar për shkak të fatit intim, për shkak të atdheut të çliruar prej të huajit, por të sunduar me dhunë prej të brendshmitAsdreni tërhiqet në guaskën e vetmisë në të cilën doemos është shtyrë të dëgjojë zërin e vetëdijes dhe të ndërrijes. Për herë të parë në krijimtarinë tij dëgjon më shpesh ndërrijen, këtë pjesë të tronditur të qënies së tij , prandaj dhe fillon të shkruajë poezinë e problemeve irracionale. Më tepër se prej realitetit të jashtëm imagjinata e tij krijuese tani ushqehet prej ndërrijes sesa në vetëdijen e tij. Poezia meditative e Asdrenit bëhet monolog i gjatë me veten e tij....Po aty, f. 301.*

³⁰ Shënim : është fjala për poezinë e Asdrenit *Hija e keqe* në të cilën gjen motive fantazmagorike të ngjashme me poezinë *Korbi* të Edgar Alan Poe. Po aty, f. 302.

³¹ Shquan si fjalë që përdor më shumë në këtë lloj poezie të Asdenit: kulshedra , gjarpëri, kufoma, kërma, hieja, fati, vdekja, shtriga, pafundja, varri, qivuri etj. Po aty f. 301.

³² Po aty, f. 213.

³³ Koncepte te formalistëve në Jeferson Ann, Robey David, *Teoria letrare moderne-njw paraqitje krahasuese*, Albas, Tiranë, 2006, f. 42-69.

Karakteristika të stilit, Vjershërimi dhe kompozicioni. Parë në këtë kongtekst stili trajtohet si *zbukurim apo në mënyrën tradicionale*³⁴ ku vihen në dukje : *evidentimi i elementeve specifike të gjuhës si shmangie nga gjuha e zakonshme, përsëritje të tingullit, përdorimi invers i fjalëve, ndërtimi i fjalive të përbëra e të bashkërenditura, sipas hierarkisë kuptimore, për t'i shërbyer një qëllimi estetik.*

III.1. Studiuesi i kushton një vend të veçantë përpunimit gjuhësor të shprehjes në procesin krijues të Asdrenit në kapitullin *Vuajtjet krijuese dhe përsosja e shprehjes*. Ai merr në konsideratë shprehjen artistike të poetit dhe evoluimin e saj duke konstatuar që shprehja artistike dhe zhvillimi i saj vjen si rezultat i punës³⁵ së poetit dhe jo i frymëzimit. Në këtë kontekst ai thekson se ndërgjegjësimi për përsosjen e shprehjes artistike tek autori ka lindur si domosdoshmëri me kalimin e kohës. Këtë e tregon në frekuencën e korrigjimeve në fazat të ndryshme të krijimtarisë së tij në gjatë procesit krijues për arsye se depërton në sfera të reja frymëzimesh, duke pasur si synim përqendrimin dhe shprehje më të thelluar e më të fuqishme artistike:

- **poezitë të cilat kanë pësuar më shumë ndryshime të shprehjes artistike** - poezia meditative duke sjellë ndryshimin në kuptimin e poezisë, në përdorimin e figurave artistike, në pikëpamje të ritmit dhe rimës, të strukturës së vargut në vëllimin *Psallme murgu*;
- **ndryshime gjuhësore** të cilat kryesisht vijnë si rezultat i qëndrimeve të paformuara të gjuhës³⁶;
- **ndryshime për motive të përsosjes së vlerës artistike** (përdorime të figurave të ndryshme artistike, zgjerime të kuptimit tyre me anë të përpunimit të shprehjes etj.).

³⁴ Është mënyra më e vjetër e vështirimit të tij përmes figurave poetike si epitetet krahasimet, metafora, hiperbola, simboli- Rene Èellek, Austin Èarren, *Teoria e letërsisë*, Onufri, 2007, f.123

³⁵ Variantet e poezive të tij e dëshmojnë këtë. Qosja Rexhep, *Asdreni dhe jeta e tij*, Toena, Tiranë, 2002, f. 384.

³⁶ Shënim: Qosja është i mendimit se lëkundjet gjuhësore të Asdrenit janë të kuptueshme se ngjasin në një kohë kur gjuha shqipe po përpunohej artistikisht, kur shkrimtarët sa kishin filluar të njihnin mirë veprat e njëri-tjetrit dhe kur gjuha shqipe nuk ishte formësuar si gjuhë e njehsuar letrare. Po aty.

- ndryshime në nivel strukturor;
- ndryshime në të gjithë poezinë.

Këto lloj ndryshimesh lidhen me: ndërtimin e poezive në variante, me përdorimin e vargjeve të caktuar të cilat sjellin përmirësim në pikëpamje kuptimore, ndryshime të fjalëve të caktuara, shkallëzim të ndjesive, ndryshime të ritmit, të shënjavave të pikësimit, të strukturës së poezisë etj.

- ndryshime të një vargu/ grup vargjesh³⁷, të cilat nuk i vlerëson si ndryshime të dukshme. Këto ndryshime realizohen me qëllim përsosjen e vargut dhe përfitim të vlerës artistike etj

- ndryshime në titujt e poezive³⁸ të cilat janë të lidhura me ndryshimet dhe përmirësimet që realizon poeti brenda poezive, për të qënë sa më përgjithësues në kuptimin e tyre dhe t’i përgjigjen sa bukur përmbajtjes.

1. Karakterizimi i stilit përcillet përmes strukturës gjuhësore të tekstit si një strukturë dinamike, si një tërësi, duke vënë në dukje mbizotërimin e një grupi elementesh si:

-mjetet me të cilat përftohet shprehja artistike si: shmangiet sintaksore dhe lidhjen e tyre me ritmin strukturën rrokjesore elementët përmbajtësore, figurat etj.

- pjesët përbërëse të të cilit janë elementët e dukshëm si: strofa, vargu, metri, ritmi duke synuar të shpjegojë efektin estetik të veprave në tërësinë e tyre.

Qosja i klasifikon figurat në dy grupe kryesore:

-Figura të përdorura më parë nga tradita;

-Figura të përdorura si risi nga poeti.

Ndër figurat e përdorura rëndom, studiuesi identifikon *epitetin*, *krahasimin*³⁹ *personifikimi* dhe *metafora*, *apostrofa*, për të cilat i

³⁷ Në vëllimet e para *Rreze dielli*, *Endra e lotë*. Po aty, f.388.

³⁸ Qosja kostaton se këto ndryshime bëhen kryesisht në vëllimin *Psallme murgu*. Po aty, f. 330.

³⁹ Qosja e identifikon si mjet të konkretizimit të pamjes dhe thellimit të përfytyrimeve të veta, në përdorimin e të cilit ndikojnë përmbajtja prej së cilës frymëzohet dhe literatura që njeh dhe lexon. Krahasimi shërben si mjet i fuqishëm për qartësimin dhe konkretizimin e përfytyrimit të pamjeve, si dhe të thellimit artistik dhe psikologjik

mëshon më shumë mënyrës si e prodhojnë artistikisht shprehjen. Ka raste kur figurat në bazë të mundësisë shprehëse të tyre realizojnë subjektivimin e objekteve,⁴⁰ për këtë arsye figura të caktuara kanë funksione përtej detyrës së zakonshme (të përpunojë format e të shprehurit).

Përsa i përket *simboleve* është interesant konstatimi i tij: që poezia e Asdrenit kryesisht është simbolike –alegorike. Rëndësinë e simboleve e sheh jo vetëm në aspektin formal por edhe në funksion të domethënies e të vlerës artistike të poezisë. Për të kuptuar më mirë rolin dhe funksionin e simboleve i klasifikon kryesisht sipas:

a-llojit:

-simbole subjektive kontekstuale

-simbole të përhershme universale

b-teknikave të mënyrës së ndërtimit :

-Prej përsëritjes së një fjale brenda një poezie⁴¹

-Prej përfytyrimeve pamore që përmbajnë një përvojë të përgjithshme kombëtare universale.

Qosja përcakton burimin e simboleve, të huazuara nga mitologjia, tradita, historia kombëtare, shpjegon mënyrën e formimit, dhe funksionin e tyre Gjithashtu identifikon edhe rastet kur poeti i përdor simbolet edhe si stolisje formale e poezisë duke e vlerësuar si të metë të procedesë pasi në to nuk shfaqet shumë krijues.

III.2 Në kapitullin *Vjershërimi dhe kompozicioni*, studiuesi analizon mënyrat e formimit të vargjeve në funksion të përmbajtjes. Konstatimin e praktikës së ndjekur e lidh me traditën popullore dhe traditën e poezisë shqipe për huazimin e vargjeve,⁴² duke identifikuar si risi të sjellë rishtas shprehjen përmes vargjeve të lira. Analiza

të poezisë, pasurojnë strofat me nëntekst. etj Qosja Rexhep, *Asdreni dhe jeta e tij*, Toena, Tiranë, 2002, f. 336-340.

⁴⁰ Shënim: Qosja pranon që poeti i përdor këto figura të kryejnë funksione përtej asaj çfarë jemi mësuar të shohim në poezi të tjera rëndom. Po aty. f. 345.

⁴¹ Shënim: këto lloj simbolesh Qosja i quan kontekstuale. Po aty.

⁴² Po aty, f. 442.

përshkallëzohet në pikëpamje sasiore dhe të frekuencës së përdorimit të vargjeve të llojeve të caktuara⁴³, si dhe motivet në të cilat i përshtat më mirë ato. Ndërkohë që konstaton se kjo dukuri nuk ndodh me vargjet e shkurtra të cilat i përshtaten më së miri praktikës së tij(psh tetërrokëshi e përdor më së shumti.). Qosja shquan edhe dalje të poetit nga skemat për shkak të përmbajtjes si tendencë e vetë prirjes së tij.

Klasifikimi i llojeve të ndërtimit të vargjeve të poezive të hershme dhe atyre më të vona vë në dukje se zhvillimi i tij në pikëpamje të ndërtimit të vargut (vargut të lirë) ka ardhur si rezultat i përvojës por edhe i temperamentit krijues të poetit. Këto analiza sasiore marrin në konsideratë si procedura teknike të ndërtimit të vargjeve(të lira dhe të matura) edhe rolin, funksionin të tyre dhe llojit të poezisë në të cilin e përdor, psh. analiza e organizmit tingullor⁴⁴ e çon Qosjen në përfundimin se Asdreni përmes zgjedhjes së fjalëve shprehëse i kushton më shumë rëndësi shprehësisë muzikore sesa melodisë; njëkohësisht lëvrimi i rimave të reja sjell pasurim të fondit të rimave të poezisë shqipe.

Një tjetër aspekt në të cilin studiuesi e vëzhgon krijimtarinë e poetit është *niveli ciklik dhe kompozimi i përmbledhjeve* të cilin e shquan si risi të sjellë prej poetit nën ndikimin e poetëve modernë të letërsisë botërore, në një kohë kur mungonte tradita mbi këtë element. Një organizimin i tillë strukturor e kompozicional i përmbledhjeve, për Qosjen është shprehje e botëkuptimit, e gjendjes shpirtërore, e qëndrimit ndaj realitetit dhe jetës shoqërore në tërësi dhe përkushtim

⁴³ Kemi parasysh këtu analizën e detajuar që bën poeti për përdorimin e llojeve të ndryshme të vargjeve si psh sa shpesh përdor gjashtëmbëdhjetërrokëshin apo njëmbëdhjetërrokëshin etj.

⁴⁴ Muzikalitetin e këtyra vargjeve pasi nuk mund ta krijonte me anë të rimave si në pjesën e përparme, Asdreni e krijon në përsëritjen e tingujve *s,z,r*, e sidomos të fonemës *sh*, që cakton atmosferën dëgjimore të vargjeve në tërësi. Pothuaj në çdo vjershë të shkruar me vargje të lira mund të veçohen disa tinguj, që janë bartës të muzikalitetit të tyre: ose zanore- çfarë ndodh më së shpeshti, ose bashkëtingëllore posaçërisht kumbuese-çka ndodh pak a shumë më rrallë. Kjo do të thotë se në vjershat e përmbledhjes Psallme murgu, Asdreni nuk ia vë theksin melodisë por shprehësisë muzikore, dëgjimore të vargjeve përkatësisht të tingujve. Qosja Rexhep, *Asdreni dhe jeta e tij*, Toena, Tiranë,2002, f.363.

ndaj aktit krijues.⁴⁵ Gjithashtu po *risi të poetit*, studiuesi konstaton prirjen e tij më shumë në drejtim formës sesa përmbajtjes. Ciklet dhe përmbledhjet ndjekin një logjikë të rreptë kompozicionale dhe kryesisht kuptimi i poezive realizohet në kontekst të ciklit apo të tërësisë së përmbledhjes.

Përfundime

Përfundimet që merr Qosja në fund të studimit, janë të karakterit historiko-letrar të realizuara përmes disa lloje qasjesh. Ato studiuesi i ka përshtatur në lidhje me informacionin dhe materialin me të cilin është përballur. Për të përvijuar individualitetin dhe veprimtarinë social-politike të Asdrenit, i shërben metoda kulturoro-historike. I interesuar kryesisht për procesin krijues përmes të cilit studiuesi kërkon të mbërrijë tek krijimtaria shfrytëzon ndikimet, ndërtekstorësinë duke evidentuar specifikën e krijimtarisë së Asdrenit. Evoluimin e përvojës krijuese, studiuesi e sheh në karakterin meditativ që i jep poezisë dhe në përkushtimin e tij ndaj larmishmërisë së formave, shprehjeve, figurave, vargjeve, ritmeve, rimave, përpunimit gjuhësor dhe artistik të shprehjes etj. Çdo formë krijuese dhe risi e sjellë vjen e motivuar prej Qosjes në plan të konceptimit dhe plan artistik të shtyrë së brendshmi dhe së jashtmi nga faktorë të ndryshëm. Organizimi strukturor ciklik tek Asdreni i cili është parim krijues i poetit, merr vëmendjen maksimale të vlerësimit kundrejt përvojës në letërsinë shqipe dhe të huaj. Edhe ky aspekt i veprës së poetit vlerësohet nga studiuesi si element thelbësor dhe njëkohësisht është shprehje e botëkuptimit të tij për procesin krijues dhe qëndrimin ndaj atij jetësor në tërësi.

Bibliografi e shfrytëzuar

Qosja Rexhep, *Asdreni dhe jeta e tij*, Toena, Tiranë, 2002,
Aristoteli, *Poetika*, Çabej, Tiranë, 2006
Barthes Roland, *Aventura semiologjike*, Rilindja, Prishtinë, 1989
Barthes Roland, *Theory of text*, Encyclopedia Universalis, 1973

⁴⁵ Po aty, f. 371.

Bulo Jorgo, *Profili shkencor i R Qosjes*, në “Krijimtaria letrare dhe shkencore e R Qosjes”, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2007

Dado Floresha, *Intuitë dhe vetëdije kritike*,”Onufri”,2006

Dado Floresha, *Sfida të historiografisë letrare*, Bota shqiptare, Tiranë , 2009

Dado Floresha, *Teoria e veprës letrare- Poetika*, SHBLU, Tiranë, 1999.

Freud Sigmund, *Psikanaliza e artit dhe e letërsisë*, Dituria, 2000

Lotman Jurij, *The structure of artistic text*, Translated from the Russian by Gail Lenhoff and Ronald Vroon. (Michigan Slavic Contributions 7.)

Ann Arbor: University of Michigan, Department of Slavic Languages and Literatures, 1977

Jakobson Roman, *Language in literature* THE Belknap Press Of Harvard University Press Cambridge, Massachusetts London, England 1987

Krijimtaria shkencore dhe letrare e Rexhep Qosjes”, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 2007

Jeferson Ann, Robey David, *Teoria letrare moderne- njw paraqitje krahasuese*, Albas, Tiranë, 2006

Jung Gustav Carl, *Mbi letërsinë dhe artet*, Fan Noli, Tiranë, 2005

Lacan Jacques, *Ligjërimi dhe ndërdija*, ëëë. letteratour, it

Milivoj Solar, *Hyrje në shkencën për letërsinë*, SHBLU, Tiranë, 2001

Rugova Ibrahim, *Teoria letrare*, Prishtinë, 2013

Rene Ėellek, Austin Ėarren, *Teoria e letërsisë*, Onufri, 2007

Thibaudet Albert, *Physiologie de la Critique*, NRC, Ėditions de la Nouvelle Revue Critique, Paris, 1930

Zhenet Zherar, *Figura*, Rilindja, Prishtinë, 1985

Artikuj

Jorgo, Kristaq, Kategoritë themelore të raporteve ndërletrare individuale dhe tipet kryesore të krahasimit, në Leksione për letërsinë e krahasuar.

SIMBOLIZMI STRATEGJIK NË POEZINË E ASDRENIT

Elvira LUMI

Lediona LUMI

Universiteti “Aleksander Xhuvani”, Elbasan

elviralumi@yahoo.com

lediona12@yahoo.com

Abstrakt

Imazhi, simboli dhe miti ishin veçori e asaj rryme letrare në shekullin e ‘19 që u quajt romantizëm dhe që u përhap si në Evropë dhe në Shqipëri. Asdreni është një përfaqësues i poezisë romantike që e përdori simbolin për të shprehur jo vetëm botën e brendëshme, natyrën dhe dashurinë por dhe si një mënyrë për të kuptuar botën njerëzore dhe natyrën e saj me ndryshimet që po ndodhnin në mekanikë dhe krijimin e kombeve-shtet, duke i paraprirë një poezie moderne që do të lindte më vonë.

Qëllimi i këtij punimi është të zbulojmë ndikimin e kulturës së gjerë europiane dhe letërsisë shqiptare e rumune tek ky autor në funksionin e simbolizmit si një mënyrë e të menduarit dhe të ndjerit në ide sublime. Ai parashikoi simbolin e flamurit që më vonë u bë hymni ynë kombëtar. Simbolizmi si shprehje e një bote romantike universale te Asdreni u shfaq te *e bukura* si koncept estetik i një mendimi të thellë dhe emotiv që u përzie me filozofizëm, misticizëm dhe religjion që do të jenë objekt i këtij studimi. Në vëllimet me poezi si “Rreze dielli”, “Endrra dhe lot”, “Psallme murgu” dhe “Këmbana e Krujës” simbolizmi shfaqet si një zgjedhje e qëllimshme në formën e një *simbolizmi strategjik*, ku strategjemat parashikojnë dhe paralajmërojnë idenë kombëtare por dhe iluzionet e brendëshme të poetit romantik, të zhgënjyer në “një botë mundimesh e lotësh” në prag të Pavarësisë. I ndikuar nga idetë social-demokrate europiane dhe nga Naimi, Asdreni zgjedh simbolin e “Lulëkuqes”, “Murgut”, “Lotët” “Këmbana”, “plumbi”, “korbi”, “kufoma” që përfaqësojnë atdheun dhe gjendjen e brendëshme të poetit, por që parashikojnë dhe të ardhmen e turbullt. Simbolet janë përshkrim i një bote të trazuar herë nga një hero niçean, herë nga një hero mistik që tërhiqet në një botë të mbyllur endjesh siç është Bibla dhe që çoi në tërheqjen e poetit nga lëvizja politike e mëvonshme.

Neveria, zhgënjimi total, pesimizmi, ndjenja mistike, ëndërrimi egocentrik i simbolizmit janë tipare të ndikimit të postromantizmit, poezisë kontemplative, të akullt, parnasiane dhe simboliste të lirikës së Asdrenit. Simbolet qëllimshëm shndërrohen në metafora e alegori dhe poeti merr pamjen e një të martirizuarit të shoqërisë, pesimist, të dëshpëruar, me një gjendje psikologjike të turbullt, një poezi sentimentaliste me nota elegjiake dhe tragjike, tipare këto që çuan në një lirikë origjinale me gjurmë të artit Bodlerian dhe që do të trajtohet më hollësisht gjatë këtij punimi.

Fjalë kyç: lirika e Asdrenit, romantizëm, simbolizëm strategjik, hero niçean, misticizëm.

Imazhi, figura, simboli dhe miti ishin veçori e asaj rryme letrare në shekullin e ‘19 që u quajt romantizëm dhe u pasua nga simbolizmi që u përhap si në Evropë por deri diku dhe në Shqipëri. Asdreni është një përfaqësues i poezisë simboliste që e përdori simbolin për të shprehur jo vetëm atdheun, natyrën, botën e brendëshme, mendimin, dashurinë dhe zotin, por dhe si një mënyrë për të kuptuar botën njerëzore dhe natyrën e saj me ndryshimet që po ndodhnin në mekanikë dhe krijimin e kombeve-shtet. Simboli është shenjim në mënyrë strategjiste i projektimit të botës, duke i paraprirë një poezie moderne sureale që do të lindte më vonë. Simboli te Asdreni shfaqet një shenjë që emërton nëpërmjet imazheve konkrete dhe figurave artistike një ide abstrakte siç është flamuri, shpirti, zoti dhe ka dy funksione: a. emocionale dhe intelektuale. Si emocion i brendshëm nënkupton lidhjen e heroit lirik me atdheun, dashurinë, zotin, natyrën dhe gjendjen shpirtërore. Si simbol intelektual ai ka funksion abstrakt, strategjist dhe përgjithësues dhe lidhet me nocionet dhe konceptet e situatave mes tyre me një lidhje universale, kozmogonike por dhe me një eksperiencë dhe kulturë private e individuale sa lokale aq dhe globale që ofron një vizion artistik që lidhet me të ardhmen, por dhe me përjetësinë. Karakteristikë e të menduarit në mënyrë strategjiste është veçori e njerëzve religjiozë dhe krijues, veçori që te Asdreni janë prezente në poezinë e tij.

Simbolizmi tek ky autor u shfaq si një mënyrë e të menduarit dhe të ndjerit në ide sublime. Ai parashikoi me anë të lirikës himnin-simbol të flamurit që më vonë u bë hymni ynë kombëtar, duke përmbledhur në një tekst lirik ndjenjat, dëshirën dhe vizionin e një populli të tërë që do të fitonte përjetësinë dhe identitetin e kombit shqiptar. Si shprehje e një bote romantike universale por dhe lokale te Asdreni, simbolizmi u shfaq te *e bukura* si koncept estetik i një një lirike meditative me mendim të thellë dhe emotiv që u përzie me filosofizëm, misticizëm dhe religjion që me notat kushtruese dhe kritike po i paraprinin idesë së lirisë dhe pavarësisë.. Në vëllimet me poezi si “Rreze dielli”,

“Endrra dhe lot”, “Psallme murgu” dhe “Këmbana e Krujës” simbolizmi shfaqet si një zgjedhje e qëllimshme në formën e një *simbolizmi strategjik*, ku strategjemat parashikojnë dhe paralajmërojnë idenë e lëvizjes kombëtare për krijimin e kombit –shtet, por dhe iluzionet e brendëshme të poetit romantik, të zhgënjyer në “një botë mundimesh e lotësh” që kalonte nga entuziazmi e krenaria, në dëshpërim e ankth, nga shpërthimi i zemëratës dhe i padurimit, në ndikimin e drejtëpërdrejtë nga ngjarjet politike., nga ëndërrimi simbolist në realizmin dhe surrealizmin fantastik e futurist. Duke iu referuar tekstit të Himnit Kombëtar Shqiptar “Betimi mbi flamur” poeti shkruan:

*Rreth flamurit të përbashkuar
Me një dëshir’ e një qëllim,
Të gjith’ atij duk’ iu betuar
Të lidhim besën për shpëtim.*

Që në fillim të poezisë ai e përdor simbolin e flamurit me dy funksione: 1. emocional, patetik si një himn për lavdërues kolektiv që prek dëshirat dhe emocionet e një populli me metaforën “me një dëshirë dhe funksionin 2. intelektual “ e një qëllim”, si një vision dhe projektion i së ardhmes së një populli. Duke iu referuar strategjës së flamurit poeti arrin të bëjë lidhjen mes simbolit shenjues dhe idesë kombëtare si një vizion unitar për lirinë dhe atdheun, që buron nga një popull luftarak dhe që ka jetuar e do të jetojë në shekuj i bekuar nga Zoti., ndryshe nga kombet e tjera që janë shuar përmbi dhé. Simboli i flamurit shenjon kështu projektionin e një kombi-shtet që ka funksion identitar, shquhet jo vetëm përbashkues dhe unitar.

Asdreni i përket atij brezi burrash të rrallë që kanë vënë nga një gur themeli në ndërtesën e kulturës shqiptare dhe që lidhet me një vepër nacionale, pra me simbolin e flamurit dhe idenë e kombit shqiptar. Betimi mbi flamur fillimisht lindi si një projekt letrar simbolik, që do të popullarizohet dhe do të marrë trajtën e një ideje kombëtare që ruhej dhe mbrohej që nga shekulli 15 i Skënderbeut si mesazh i qëndresës për liri...Lirika është e përfshirë në vëllimin e tij të dytë “Endra dhe lot”

(1912) po paralajmëronte ardhjen e një letërsie tjetër që ishte në kapërcyell nga romantizmi evokues drejt simbolizmit dhe realizmit futurist. Në lirikën për flamurin poeti eksperimenton në disa variante poezish që i kushtohen këtij simboli si “Betimi mbi flamur”, “Besa jonë”, “Shqiponja me dy krerë”, “Lulëkuqja”, “Kosovës”, “Prej katundit” që sjellin përvoja estetike të njohura dhe të panjohura për poezinë shqipe. Përvoja estetike të njohura të Asdreni lidhen me trajtimin poetic të temave klasike, romantike dhe religjioze duke iu referuar poezisë klasike rumune dhe asaj shqiptare. Asdreni ndikohet nga Naimi, Noli, Cajupi, Poradeci, por dhe nga letërsia dhe kënga rumune. *Himni i Flamurit u lind në Bukuresht. U lind jo si himn po si këngë. Vetë populli shqipëtar e njoftoi më vonë për himn. Pa ditur qysh, në një kohë të shkurtër, kënga e bërë vetëm për anëtarët e “Bashkimit” u përhap në gjithë Kolloninë e Bukureshtit. Disa të rinj që vajtmë në Korçë e shpumë dhe atje” shkruan Mitrush Kuteli në 1934 në revistë “Shqipëria e re”. Dy emigrantë të thjeshtë anonimë që nuk u dihet emri, një gjuhë e një racë, një gjak e një flamur të kuq si gjaku i tyre.... Ec e ec përmes Ballkanit dhe Shqipërisë me ngarkesën më të çmuar kombëtare që ka hyrë ndonjëherë në trojet e Arbërit. Ata po binin një këngë që do të bëhej nesër Himni i Atdheut. Ky do të jetë Himni i Shqipërisë kur të bëhemi shtet. Çojeni në shtëpitë tuaja, mësojuani shokëve, çojuni djemve që kanë dalë komitë në male, shpjerjeni deri ku te mundeni...dhe bëjeni të njohur. Betimi mbi flamur merr kështu statusin e simbolit strategjik që i kushtohet së nesërme, asaj që pritët të ndodhë..*

Në atë kohë këndohej në Rumani an’ e mb’anë kënga e kompozitorit rumun Ciprian Porumbeskos “Pe al nostru steag” (“Mi flamurin tonë”). Disa prej tyre iu drejtuan poetit Asdreni dyke iu lutur t’iu bëjë një këngë pas këngës të tij, që t’a këndojnë në rrethin e tyre. Sukses i plotë! “Sa djem e sa dëshmorë ka frymëzuar Himni i Flamurit. Populli dhe bijtë e tij nuk pyeteshin që nga vinte kënga. Ata ishin të drejtuar prej fjalëve ideal, liri e flamur dhe nuk kërkonin “origjinalet” me qiri si kërkojnë epigonët e kësaj dite.

Siç e vlerësonte Lasgushi, te Asdreni, përmbledhet një *manifest kombëtar*, prandaj edhe nuk do të harrohet dot asnjëherë dhe i përket së ardhmes. “*Sepse Vjershëtori, sikundër shkruante ai për të, nuk rron jetën e vdekur të vet, po jetën e pavdekur të Kombit të vet*” që rron në shekuj. Ndikuar nga poeti rumun Eminescu, Asdreni krijoi një lirikë humaniste me karakter profetik, ku poeti merr natyrën e një profani futurist e surreal. Në qendër të poezisë së tij ishte si atdheu dhe natyra, si qytetari dhe fshatari, si i pasuri dhe i varfëri, si kryengritësi dhe tradhëtar, si dimri dhe pranvera, si Zoti dhe Shqipëria, si populli dhe shqiptari i vërtetë. Asdreni është nga të parët që përdori vargun e lirë simbolik dhe alegorik.

M. Kuteli, te një shkrim i tij te “Revista letrare” (1944), arrin që të vrejë një rrymë të re, që kjo vepër veçanërisht “Psallme murgu” sjell në poezinë shqipe: pikërisht modelin poetik meditativ, refleksiv dhe simbolist. Nën një petk të jashtëm religjioz, në poezitë e Asdrenit përthihen rrethanat dhe gjendjet e vështira të njeriut – në raportet e tij vetmitare e vazhdimisht ballafaquese e përsiatëse me ato situata të vështira dhe hera herës edhe ekstreme. Vizionet e natyrës dhe simbolika e peizazhit”, “Vizionet e femrës dhe ndjenja e dashurisë” si dhe “Poezia e paradokseve shpirtërore” si vetmia, mërzia, mërgimi, zhgënjimi, vegimi i errët, vdekja etj shfaqen në mënyrë të veçantë në lirikën e tij filozofike si Lulja e vetëm, Varri i harruar, Malli i vonuar, Tingëllimë, Ora e zemrës, Qyqja, Vegim përëndimi, Narcizi, Lulja ngushëllimi etj. Ndërtohen kështu simbole të mendimit në plan abstrakt njerëzor, që lidhet me dukuritë fiziologjike të vetmisë, pesimizmit, pleqërisë, pa u kushtëzuar në thelb nga ngjarjet historike të gjysmës së viteve ‘20 dhe të viteve ‘30. Rënia shpirtërore e Asdrenit, motivet e vetmisë, të pesimizmit dhe të zhgënjimit e misticizmit nuk mund të kuptohen jashtë tragjedisë së madhe të iluzioneve të atdheut dhe lirisë të gjithë popullit shqiptar pas pavarësisë por dhe rënies së poetit nga një poet romantik e ëndërimtar, në një poet sentimentalist, mistik, religjios pse jo dhe depresiv e bipolar.

Indikuar nga idetë social-demokrate europiane por dhe nga Naimi, dhe letërsia europiane, Asdreni përdor simbole që vishen me alegori si “Lulëkuqja”, “Murgu”, “Lotët” “Këmbana”, “plumbi”, “korbi”, “kufoma” që shënojnë gjendjen e atdheut por dhe gjendjen e brendëshme të poetit, që parashikon të ardhmen e turbullt të shtresës së vegjëlisë dhe zhgënjimin e tij ndaj parisë së vendit.. Simbolet janë përshkrim gjithashtu dhe i një bote të trazuar herë nga një hero niçean, herë nga një hero mistik që tërhiqet në një botë të mbyllur endjesh siç është Bibla dhe që çoi në tërheqien e poetit nga lëvizja politike e mëvonshme. Neveria, zhgënjimi total, pesimizmi, ndjenja mistike, ëndërrimi egocentrik i simblizmit janë tipare të ndikimit të postromantizmit, poezisë kontemplative, të akullt, të errët, alegorike e parnasiane ku eksperiencia e poetit ofron simbole private të një bote të errët, here herë të dhunshme dhe kryengritëse që e shfaqin poetin me ide të majta e social-demokrate dhe here-herë mistike e religjioze.. Simbolet qëllimshëm shndërrohen në metafora e alegori dhe poeti merr pamjen e një të martirizuari të shoqërisë, pesimist, të dëshpëruar, me një gjendje psikologjike të turbullt, të trazuar, një poezi sentimentaliste me nota elegjiake dhe tragjike, tipare këto që çuan në një lirikë origjinale me gjurmë të artit Bodlerian. Koncepti transhendental i lirisë dhe atdheut zhvillohet në idenë mistike neoplatonike të religjionit kristian që i jep simbolit siç është flamuri, lulkuqja, murgu, lotët karakter universal dhe një ngurtësi dhe hermetizëm emocinal poetik. Në rastin e Asdrenit kemi pjekurinë e poetit, nën ndikimin e lëvizjeve letrare moderne, që qarkullonin aso kohe në letërsinë rumune, të cilën, ai e njihnte mjaft mirë. Një frymë estetizante, prirjet për nga simbolizmi, të ashtuquajturat kujdesjet e tepruara për formën, qëndisjet stilistike, këto dukuri e prirje të reja, paradoksalisht të kritikuar viteve më parë, si ndikime formaliste e dekadente, sot janë veçori e origjinalitetit poetik të Asdrenit. Në fakt, ato dëshmonin orientimin e tij tashmë më të stabilizuar e më të pjekur, ndaj artit të njëmendët. Fryma dhe dekori stilistik i poezisë së Asdrenit, mbartin kështu kapërximin e suksesshëm estetik dhe tematik – nga traditat rilindase, drejt prirjeve moderne në

poezinë shqipe. Pra, ai është krijuesi kërkues, që sillte një vlerë të shtuar me artin e vet poetik, krahas atij të mëparshmit, ku dihet se lirika patriotike, do të zinte aso kohe vendin parësor dhe kjo ishte e motivuar, në kontekstet historike të Shqipërisë së atyre viteve, kur në plan të parë, dilte kauza e pavarësisë kombëtare. Në poezinë simbol “Lulëkuqja” që të kujton “Manushaqja” e Naimit, apo “Ylli lart në qiell” i Emineskut, Asdreni do të shkruajë:” Po veç ngjyra e saj si gjaku/Si një yll që xixëllon/Tërë bota e imiton/Eshtë shenjë për së mbari/nga shëkon” është një vizion poetik simbolik kozmogonik.

Simbolika në lirikën e Asdrenit shërbeu dhe në kthimin e teksteve letrare në himne dhe këngë lirike që do të popullarizohen e këndohen më vonë dhe që vazhdojnë të këndohen dhe sot e kësaj dite. Tekstet lirike “Ti me sytë e ziinj”, “Bohem”, “Ditë maji”, “Kënga e të riut 20 vjeç”, i këndohet dashurisë në fillim si ndjenjë adhurimi, respekti, miqësie dhe së fundi një frikë mëkati dhe ndjenjë e thellë mistike që lidhet me shpirtin dhe transhencën. Tek “Endrra dhe lot” poezia është e mbushur me këshilla simbolike për të “ruajtur shpirtin” si në poezi me simbole ekzotike dhe mistike si: “Mëkati i fshehur”, “Lulja e zemrës”, “Trëndafili”, “Shega”, “Qyqja” simbole që zbulojnë botën religjioze, romantike dhe neo platonike të Asdrenit..

Në përfundim duke iu referuar karakterit internacional të himnit të flamurit dhe poezive meditative, filozofike e refleksive të Asdrenit zbulojmë natyrën simboliste, kozmogonike dhe religjioze e mistike të poezitë të Asdrenit. Simbolet janë shfaqe e divinitetit dhe e profanizmit poetik që shenjojnë jo vetëm një figurë konkrete realiste siç është atdheu, natyra, femra, ylli, peizashi, në një figurë imazhiniste abstrakte e një simbolizmi strategjik siç është flamuri, zoti, transhencën, vetmia, mistika, murgu, korbi, qyqja, shpirti etj. Me mjeshtëri gjuhe, me imazhe dhe simbole alegorike Asdreni dëshmoi se poezia e tij nuk ishte thjesht propagandë atdhetare, por nën ndikimin e poezisë rumune i këndoi kultit të bukurisë si bukuri universale e veshur me petk religjioz. Asdreni shfaqti një angazhim të fortë social e politik dhe ndikim nga babai i simbolizmit rumun Aleksandro Makedonski që do

të shfaqet në volumn “Psallme murgu”. Tre vjet para daljes së këtij libri murgu rumun Argezi kishte botuar lirikat e tij simboliste “Psalme de taina “1927, “Psallmet e fshehtësisë” dhe poezia e Asdrenit jo vetëm që është ndikuar nga ky poet dhe poezia kozmopolite rumune, por me përsosmërinë e vet klasike, duke qenë një nga vëllimet më të mira të poezisë simboliste me nota Bodleriane, luajti rol vendimtar në vënien e poezisë shqiptare drejt modernitetit dhe simbolizmit strategjik si një projekt poetik futurist.

ASDRENI, HIMNI KOMBËTAR DHE KISHA SHQIPE E BUKURESHTIT NË SHËNIMET E LASGUSHIT

Illir SHYTA

Universiteti “Fan S. Noli” Korçë

ilirshyta@yahoo.com

Abstrakt

Në shkrimin “Himni Kombëtar “flamurit pranë të bashkuar” dhe gjeneza e tij”, Lasgush Poradeci sjell për herë të parë historinë e krijimit të Himnit të Flamurit Kombëtar. Sipas shkrimit, kori kishtar shqiptar i Bukureshtit filloi të gjallërohej në fillim të viteve 1900. Bukureshti në atë kohë ishte kryeqyteti shqiptar i mërgimit. Kori udhëhiqej nga profesori rumun Kiriak, i cili më pas, ia la në dorë drejtimin 25-vjeçarit Ionesku. Ky i fundit, përveç këngëve shqipe, i mësonte korit edhe këngë popullore a marshe patriotike, si dhe himnin kombëtar të Rumanisë “Mbi flamurin tonë”. Një rol të madh në hartimin e fjalëve të poezisë së himnit ka Asdreni.

Himni i Rumanisë ishte shkruar nga poeti Ioan Barsan me muzikë të Çiprian Porumbeskut në vitin 1907. “Të entuziazmuar nga ky himn, koristët shqiptarë ju lutën Asdrenit të thurte disa vargje të përshtatura me atë melodi, që të këndohej prej tyre. Kori kërkonte një himn shqip. Vetëm pas disa ditëve Asdreni solli tekstin e himnit “Rreth flamurit të përbashkuar”, titulli origjinal “Betimi mbi flamur”. Fjalët poetike të Asdrenit u shkrinë në melodinë e himnit kombëtar rumun. Më 1912, me ngritjen e flamurit në Vlorë, himni i shqiptarëve të Bukureshtit, tashmë i kënduar edhe në Shqipëri, u njoh si himni ynë kombëtar”. shkruan Poradeci. Shënimet e Lasgushit na ofrojnë në çdo kohë mundësi studimi dhe interpretimi rreth ngjarjeve të mëdha historike që shoqëruan jetën e tij dhe kombin shqiptar.

Fjalë çelës: himn, komb, kishë, gjuhë, flamur, kor, shënime

Në shkrimin “Himni Kombëtar “flamurit pranë të bashkuar” dhe gjeneza e tij”, Lasgush Poradeci sjell për herë të parë historinë e krijimit të Himnit të Flamurit Kombëtar. Shënimet janë mbajtur me shumë pasion dhe ndjesi krenarie nga autori i tyre. Kjo shije përjetohet në tekst nga gjithëkush kur e lexon atë. Sqarojmë se ky lloj ditari dhe shënime për ngjarje të mëdha historike të vendit, shkruar nga Lasgush Poradeci lexohen me një frymë nga lexuesit. Bazuar në veçoritë e mënyrës së trajtimit të tyre, veçanërisht në tematikën dhe shkrimin dokumentaro-

artistik të përdorur, këtë shënim por edhe shënime të tilla të ndryshme i grupojmë në: -Shënime personale, që trajtojnë ngjarje realiste historike, të cilat prekin jetën e kombit shqiptar. Saktësisht, prezantimi dhe përshkrimi i ngjarjes së madhe mbarëkombëtare, asaj të krijimit të Himnit tonë Kombëtar, jepet në mënyrë objektive, moment që tregon se pozicionimi i narratorit është sinkronik. Ky narrator në të shumtën e herës së tij përshfaqet i nënkuptuar. Herë-herë prania e tij është e padukshme, e fshehur nga gjykimet, vëzhgimet dhe konstatimet interesante. Mirëpo shpesh ndodh që zëri i narratorit autorial të vërehet qartë kur ai ndërhyr me komentin e tij përfundues. Ndonjëherë ky lloj narratori eklipson parimin estetik në qëndrimin filozofik të Lasgush Poradecit. Kjo lloj proze dokumentare apo shënime personale për ngjarje dhe data të mëdha të jetës së autorit realizojnë mënyrën e veçantë të strukturimit kompozicional të saj apo strategjisë narrative të përdorur. Prezantimi i rrëfimit dokumentar bëhet nga prespektiva e gjithëdijshme në vetën e parë ose të tretë. Shembulli më i mirë i trajtimit dhe i përjetimit artistik të një problematike dokumentare që mbështet në elemente intelektuale është shkrimi për himnin kombëtar. Në strukturën e shënimeve nuk hasim në figuracion letrar. Çdo gjë është dhënë në mënyrë të drejtpërdrejtë nga prespektiva e psikologjisë historike, në dukje naive, por befasisht e zgjuar, e nxitur nga gjendja faktike dokumentare e ngjarjes. Vendi pikëtakues është ambienti kishtar dhe kolonia e shqiptarëve të rumanisë. Profilizmi intelektual i kësaj kohe të madhe historike plot vlerë kombëtare, jepet nga këndvështrimi i poetit. Gjithashtu, në këtë lloj përshkrimi një vend të veçantë zë rrëfimi në vetën e tretë, i zhveshur nga shtresa e emocionit figurativ. Këtë e realizon figura kryeqytetit rumun Bukureshti dhe përpjekjet e shqiptarëve të kolonisë për të lindur, rritur dhe jetësuar më pas himnin kombëtar.

“Kollonija e Bukureshtit jo vetëm që e fitoj famën e saj të pavdekur si veterane me një veprim politik të shumëanshëm, po veçanërisht u shqua si pishtar i vërtetë i përhapjes kulturore jashtë dhe brënda Shqipërisë. Ajo shtypi librat e Naim Frashërit dhe të Asdrenit, që

përflaknë të rinj e pleq me zjarrin e përvëlur të atdhedashurisë. Ajo e përmbajti në gjirin e saj dhe përtej, shpirtin e kombit të etuar për liri dyke e nxitur pa pushim në punë vetëthërrorije, dyke i rrëfyer me njëmijë shëmbëlla udhën e shenjtë që shpinte për në jetën e pavarrur të shtetit shqiptar të ardhshëm”¹, nënvizon Lasgush Poradeci në shënimet e tij.

Në shkrimin “Himni Kombëtar “flamurit pranë të bashkuar” dhe gjeneza e tij”, Lasgush Poradeci sjell për herë të parë historinë e krijimit të Himnit të Flamurit Kombëtar. Sipas shkrimit, kori kishtar shqiptar i Bukureshtit filloi të gjallërohej në fillim të viteve 1900. Bukureshti në atë kohë ishte kryeqyteti shqiptar i mërgimit. Kori udhëhiqej nga profesori rumun Kiriak, i cili më pas, duke pasur shumë punë me korin e tij të shoqërisë “Karmen”, ia la në dorë drejtimin 25-vjeçarit Ionesku. Ky i fundit, përveç këngëve shqipe, i mësonte korit edhe këngë popullore a marshe patriotike, si dhe himnin kombëtar të Rumanisë “Mbi flamurin tonë”.

“Ishte një djalë i ri njëzetepesë-vjeçar, i qojtur Ionesku, i cili e zotëronte korin me përsosje dhe që specializuar për këngët korale të kishës. Profesor Ionesku, përveç këngëve kishëtare shqipe të korit, i-u mësonte nxënësve shqiptarë shpesh herë dhe këngë popullore rumune si dhe marshe patriotike, që të mundin këta të ushtërohen në këndim dhe në harmoni për vjershat e vjershëtorëve të tyre. Nër të këtilla raste i-u këndonte Himnin kombëtar të Rumanisë Mi flamurin t’onë - fjalë prej poetit Ioan Barsan, muzikë prej kompozitorit Çiprian Porumbesku”². Himni i Rumanisë ishte shkruar nga poeti Ioan Barsan me muzikë të Çiprian Porumbeskut në vitin 1907. “Të entuziazmuar nga ky himn, koristët shqiptarë ju lutën Asdrenit të thurte disa vargje të përshtatura me atë melodi, që të këndohej prej tyre. Kori kërkonte një himn shqip. Vetëm pas disa ditëve Asdreni solli tekstin e himnit “Rreth flamurit të

¹L. Poradeci, “Himni Kombëtar “Flamurit pranë të bashkuar” dhe gjeneza e tij”, në: Vepra II, Publicistikë; Kritikë letrare; Antologji shqipe e kësikohëshme, Tiranë, “alb PAPER”, 2010, -f. 75 “Himni Kombëtar “Flamurit pranë të bashkuar” dhe gjeneza e tij”, f. 75

² Po aty, f.80

përbashkuar”, titulli origjinal “Betimi mbi flamur”[...]*“Përpara se të ish kënga, ish ndjenja e mëmëdhetarëve dhe ish nevoja e tyre për organizim, për çdo mjet që mund ta shtynte një hap më përpara veprën e filluar. Ajo ndjenjë shqiptare përmbloodhi atë kolloni, ajo kolloni bëri atë shoqëri shqiptare, ajo shoqëri atë shkypshkronjë shqiptare, atë fletore shqiptare, atë shkollë shqiptare, atë kishë dhe xhami shqiptare, atë Kor Kishëtar shqiptar dhe ky kor desh tashi, midis himneve dhe për lavdurimeve të Zotit në gjuhën shqipe, edhe këngën e tij kombëtare, Himnin e Shqipërisë, Himnin e Flamurit Shqiptar”*³. Dhe himni arrin të bëhet këssoj Himni Kombëtar i Kollonisë së Bukureshtit, që përfaqësonte Shqipërinë në atë vend mërgimi aq të djegur për atdhe, duke u bërë zakon të këndohej rregullisht përpara dhe pas çdo ushtrimi të korit. Fjalët e Asdrenit u njehsuan në melodinë e himnit kombëtar rumun.

“MI FLAMURIN T’ONË”

Ioan Barsan

*Mi flamurin t’onë është shkruar bashkim,
Bashkim në vetëdije dhe në ndjenja,
Dhe nënë hijen e tij të madhërishme
Do përballim çdo goditje.*

*Në luftën e rëndë trembet ay,
Që vetë është mëndje-arratisur,
Po ne të bashkuar në çdo kohë
Do jemi, do jemi mundës.*

*E armatosmë dorën t’onë
Që të mpruajmë një vënd të shtrenjtë,
E drejta jonë është zotëronjëse,
Dhe qëllimi ynë i shenjtë.*

Dhe në librën e përjetësisë shkruan

³Po aty, f. 85

*Se shumë kombe do humbasin,
Po Rumanija jonë e shtrenjtë
Përjetë, përjetë do lulëzojë.⁴*

“RRETH FLAMURIT TË PËRBASHKUAR”

Asdren

*Rreth flamurit të përbashkuar
Me një dëshirë-e një qëllim,
Të gjith atje duk’ i-u betuar
Të lidhim besën për shpëtim.*

*Prej lufte veç ay largohet
Që është lindur tradhëtor
Kush është burrë nuk frikohet,
Po vdes, po vdes si një dëshmor.*

*Në dorë armët do t’i mbajmë,
Të mprojmë-atdhenë më çdo kënd,
Të drejtat t’ona ne s’i ndajmë,
Këtu armiqtë s’kanë vënd.*

*Se zoti vetë tha me gojë
Që kombe shuhen përmi dhë,
Po Shqipëria do të rrojë,
Për të, për të luftojmë ne.*

*O flamur, flamur, shënjë- e shtrenjtë,
Tek ty betohemi këtu
Për Shqipërinë- atdhenë-e shtrenjtë,
Për nderë- edhe lavdimn’ e tu.*

Trim burrë quhet e nderohet

⁴Po aty, f. 86

*Atdheut kush i-u bë therror,
Përjetë aq do të kujtohet
Mi dhet, mi dhet si një dëshmor.*⁵

Janë, këto dëshmi poetike, që kanë ndërtuar më pas identitetin tonë kombëtar të njehsuar në trashëgimi të vleratë atdhetare. Ato dëshmojnë se çfarë ngjau vërtet me himnin tonë kombëtar sikurse nënvizon në shkrim edhe Lasgush Poradeci. Himni rumun ka gjithsej katër strofa, himni i Asdrenit gjashtë, prej të cilave dy të fundit u krijuan krejt origjinale. Dy strofat e para të himnit: ajo që nis me fjalët: Pranë flamurit... dhe tjetra: Prej lufte..., janë të lidhura me njëra me tjetrën në mënyrë të logjikshme, drejt vargut mesazh: Po vdes, si një dëshmor. Dy strofat e tjera, ajo me fjalët: Në dorë armët do t'i mbajmë dhe ajo që nis: Se Zoti vetë e tha me gojë, përbëjnë trupin e himnit, ekzistencën e Shqipërisë, të cilën e mbrojmë ndër shekuj. Titulli “Betimi mi flamur”, që Asdreni i ka vënë himnit të tij, nuk gjendet në origjinalin rumun. Betimi është një koncept shqiptar që origjinën e ka të besa e shqiptarit: “Të lidhim besën për shpëtim”. “Origjinali përmban fjalët: “Po Rumanija jonë e shtrenjtë/ Përjetë, përjetë do lulëzojë”. Asdreni i transformon për hir të qëllimit shqiptarizojës që ka në vetëdije, sqaron Lasgushi: “Po Shqipëria do të rrojë,/ Për të, për të luftojmë ne”.

“Për sa i përket melodisë së këngëve, autorët e tyre si dhe populli nuk çanin kryet dhe aq shumë për origjinalitet ose huarjes; ia ngjitnin zërin këngës siç iu tekej se vinte më mirë dhe atje ku e gjenin, në këngët e tjera ballkanike ose evropiane: përsëritnin dhe ata një fenomen të përbashkët në procesin e përhapjes së këngëve popullore të melodijuara- të përbashkët dhe me kombet më të mbledhenj të botës: melodinë e një kënge, qoftë dhe së huaj së vet siç mirnin dhe vjershat e poetëve të kohës, të rastit, vjersha kulte më shumë ose më pak, dhe i këndonin, i-u ndryshonin tekstin sipas kujtesës dhe nevojës, pas një intuete intime të ligjës së poetikës popullore”.⁶

⁵Po aty, f. 86-87

⁶Po aty, f. 87

Më 1912, me ngritjen e flamurit në Vlorë, himni i shqiptarëve të Bukureshtit, tashmë i kënduar dhe në Shqipëri, u njoh si himni ynë kombëtar”. shkruan Poradeci. Fakti që Lasgushi nuk rreshti së shkruari as në këtë formë dëshmon se autori i tyre ishte në rrugë të mbarë përta i përket krijimtarisë letrare realisht të paktë, vetëm në dy vëllime poetike. Në Bukuresht Lasgushi lidhet me lëvizjen atdhetare të Kolonisë Shqiptare, u miqësua me Asdrenin, të cilin e zëvendësoi si sekretar i përgjithshëm i kolonisë. Për miqësinë e tyre, por edhe madhështinë e vargjeve të himnit tonë Kombëtar, Lasgushi e pavdekson në vargjet e tij:

*Djem të rinj e pleq të shkuar
Që të shajnë pa pushuar-
Djem e pleq Atdhe-mohuar,
S’dijnë më ç’j-u ke dhuruar:
S’dijnë, sepse kanë-harruar
Kush Atdhenë- e pat krijuar...⁷*

Shkrime të tjera të kësaj natyre janë kryesisht ato të përmbledhura në veprën 2 të Poradecit: “Shqipërija, Vënd i Ri”; “Asdreni një manifestim kombëtar”; “Rrëfimet e Mitrush Kutelit”; “Musine Kokalari. Siç më thotë nënua plakë”; “Mbi shfaqjen e dramës Besa prej Grupit të Shoqërisë Dragoj të Poradecit”; “Gjergj Fishta Lirik, Shkëmb i Tokës dhe Shkëmb i Shpirtit Shqiptar”; “At Gjergj Fishta, Vazhdimtar në Mendimin e Kombit”; “Misioni i Shqiptarëve të Bukureshtit dhe Naim Frashëri”; “Naim Frashëri, Vjershëtor i Bukureshtit”; “Lirika e Naim Frashërit”; “Himni Kombëtar “flamurit pranë të bashkuar” dhe gjeneza e tij”; “Një fatos i vetëranërisë shqiptare”; apo “Vepërimi Kombëtar i Shqiptarëve të Rumanisë me Kryeqëndër Kolloninë e Bukureshtit”; Përfundime:

Në këtë kapitull bëhen përpjekje drejt hulumtimit të të dhënave

⁷ L. Poradeci, Kujtim’ i Asdrenit, në: *Vepra I Poezia*, Tiranë, “alb PAPER”, 2009, - fq. 312

biografike të mbledhura shkallë-shkallë, për të hedhur dritë rreth gjenezës së himnit tonë kombëtar, sipas Lasgush Poradecit. Shënime të tilla kanë dhënë dhe do të vijojnë të japin edhe më tepër receptues grupmoshash të ndryshme ndër vite.

Konkretisht shënimet e Lasgushit, ne mund t'i grupojmë në: -Shënime personale që trajtojnë ngjarje realiste historike, të cilat prekin jetën e kombit shqiptar. (“Shkolla shqipe e Poradecit”; “Himni Kombëtar “flamurit pranë të bashkuar” dhe gjeneza e tij” etj.)

Prej shkrimesh të tilla, lexuesi i poezisë së L. Poradecit, i shikon këto publikime si mundësi për interpretime të plotësuara të krijimtarisë poetike të autorit, apo për të rritur kreativitetin rreth ngjarjesh të mëdha kombëtare. Karakteristika e llojit të shkurtër të ditarit apo prozës poetike gjithashtu të shkurtër që Poradeci lëvron, mbetet interesante, në aspektin e të gjithë elementëve që përbëjnë tërësinë strukturale të këtij punimi. Interesantja përshfaqet edhe në kuadër të tematikës kombëtare për ngjarje të mëdha historike të trajtuara në këto shkrimeve. Gjithashtu, artikulli ynë dëshmon lexues të shënimeve të L. Poradecit, të cilët pasi i lexojnë ato, u rikthehen poezive për lexim ose bëjnë të kundërtën, ndalojnë në ngjarje të mëdha kombëtare për të bërë analizë poezish të autorit. Punimi evokon vlerën e madhë të Asdrenit, i cili krijoi dhe pavdeksoi himnin tonë kombëtar, përmes vargjeve të tij plot kredo atdhedashurie. Asdreni duke përshtatur Himnin, (që tashmë të gjithë e njohim si himni i tij), shënoi përmes rastësisë së ardhur ardhur prej Korit të Kishës shqipe të Bukureshtit, momentin më kulmor të Shqipërisë Himnin tonë Kombëtar.

Bibliografi e shfrytëzuar:

- Poradeci, L. *Vepra I Poezia*, Tiranë, “alb PAPER”, 2009, 383 f.
- Poradeci, L. *Vepra II, Publicistikë; Kritikë letrare; Antologji shqipe e kësikohëshme*, Tiranë, “alb PAPER”, 2010, 456 f.
- Baylon, Ch., Mignot X. *Komunikimi*, Shtëpia botuese, Logosa, Shkup, 2004, 335f.
- Chevrel, Y. *Letërsia e Krahastuar*, Shtëpia botuese Albin, Tiranë, 2012, -160f.